

Jusuf BUXHOVI

DOSJA E HAPUR

(Roman)

Redaktor:
Nazmi Rrahmani

Recensent:
Ramadan Musliu

(Një pamja letrare shtetndërtimit të Kosovës)

.....

PROLOG

Ditën e 17 shkurtit të vitit 2008, vdiq tragjikisht Bashkim Kosova.

Bashkim Kosova ishte kampion i gjashtëfishtë i Kosovës në kategorinë gjysmë të rëndë të boksit, kampion i katërfishtë i Jugosllavisë së dikurshme në të njëjtën kategori, kampion i pesëfishtë shtetëror me klubin “Prishtina”, pastaj kampion ballkanik, kampion european, fitues i medaljes së artë në lojërat olimpike të vitit 1984 në Los Anxhelos në Shtetet

e Bashkuara të Amerikës dhe së fundit edhe nënkampion botëror në Kampionatin e Boksit Amator në Toronto në vitin 1986.

Bashkim Kosova, kampioni më i madh shqiptar i boksit i të gjitha kohëve, ishte i njohur edhe për meritat e tij në lëvizjen kombëtare të fundviteve të tetëdhjeta dhe atyre të nëntëdhjeta :pjesëmarrës në Kuvendin Themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputet i parë i kuvendit të Parlamentit të parë të Kosovës të vitit 1992,i burgosur politik nga vitet 1993-1999 nën akuzën që si i përfshirë në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës kishte marrë pjesë në përgatitjen e rezistencës së armatosur.

Meqë atë ditë, me të drejtë, e gjithë vëmendja e shtypit kishte qenë e kthyer kah shpallja e Pavarësisë së Kosovë, vetëm të nesërmen u mor vesh çfarë kishte ndodhur në orët e hershme të 17 shkurtit në katundin Hade, të komunës së Kastriotit - ish Obiliqit.

Ra në sy se njoftimi që u dha ishte jashtë jehonës që duhej ta kishte kjo ngjarje, që lidhej me vdekjen e një personaliteti të madh të përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare, sukseset e të cilit lidheshin me afirmimin e Kosovës brenda dhe jashtë, por edhe me procesin e shtetformimit.

Por, interesimin për vdekjen tragjike të kampionit të madh, që kishte shpërthyer me të drejtë në opinion pas heshtjes në të cilën ai ishte mbështjellë gjatë atyre tetë viteve të protektoratit ndërkombëtar, në të vërtetë e kishte provokuar pikërisht informata zyrtare në të cilën ishte thënë se Bashkim Kosova ishte gjetur në një gjendje thuajse pa shpresë, i përplasur nga një veturë e panjohur para kafenesë “Vatra”.

*Informata mbyllej me stereotipin e njohur se “po punohej që të ndriçohej rasti”!
Kaq!*

Të nesërmen, kjo informatë, ishte vërtetuar nga gjykatësi hetues, por tash duke u cilësuar si “aksident komunikacioni me pasoja tragjike”.

Bazuar në deklaratat e hetuesit zyrtar të çështjes të dhëna me aq nguti, fitohej përshtypja se i gjithë rasti do të mund të mbyllej shpejt e shpejt dhe Bashkim Kosova, mund të shpallej madje shkaktar i fatkeqësisë, nga ndonjë pakujdesi, pse mund të ketë qenë i dehur ose i hallakatur fare, dhe me aq rastit t’i vihej pika!

Pse jo, kur ditë më par, për një drejtues të një institucioni të lartë, që ishte gjetur me fyt të prerë dhe shumë e shumë plagë të marra në trup nga një thikë, ishte thënë se kishte bërë vetëvrasje!

Me siguri se edhe rasti tragjik i Bashkim Kosovës, kampionit të madh të boksit, do të mbyllej sipas asaj që ishte thënë nga hetuesia, po të mos ishte dëshmia e mjekut kujdestar dr. Gazmend Bardhi, që nuk e kishte lejuar këtë.

Mjekut, që pacientin e kishte pranuar të vdekur, kishte mbikëqyrur autopsinë, me të cilën ishte vërtetuar se shkak i vdekjes nuk ishte përplasia në makinë, siç thuhej nga hetuesi, por ishin tri të rëna që viktimat kishte marrë në kokë (mund të ishte fjala për shufra hekuri), së paku tetë orë para se të arrinte në spital (që lihej për t’u kuptuar se lëndimet vdekjeprurëse, sipas të gjitha gjasave me shufra hekuri, kishin ndodhur diku nga mesnata dhe jo si thuhej në orën e hershme të ditës).

Kjo dëshmi, ndryshe nga të dhënat që kishte paraqitur gjykatësi hetues, hapte çështjen e një vrasjeje me paramendim, në të cilën, gjykuar sipas gjurmëve të shufrave të hekurti, kishin marrë pjesë më shumë se një person.

I tronditur nga ajo që kishte rrjedhur në shtyp dhe media dhe veçmas i befasuar nga deklarata e gjykatësit hetues (edhe pse autopsinë ia kishte dorëzuar personalisht dhe me procedurë të plotë zyrtare Gjykatës së Prishtinës po atë ditë rreth orës 16), dr. Gazmend Bardhi, me dosjen e plotë të autopsisë, ashtu siç ia kishte dorëzuar Gjykatës, ishte paraqitur në redaksinë e gazetës “Dje”.

Gazeta “Dje”, me një titull që për shumëkënd simbolizonte kohën e shkuar si vlerë dhe, krahasuar me të tjerat që fund e krye ishin organe të partive politike ose që vepronin nën mbikëqyrjen e përhershme të shërbimeve informative partiake që caktonin por edhe filtronin ato që duhej t’i jepeshin opinionit, dëshmime të mjekut Gazmend Bardhi u kishte bërë jehonë të madhe. I nxori në faqen e parë, të përcjella edhe me komentin redaksional, ku hapej dyshimi se edhe kjo vrasje mund të ishte në vazhden e atyre që kishin ndodhur pas luftës, viktima të cilave ishin intelektualë të njohur nga radhët e lëvizjes së rezistencës institucionale.

Dyshimi ishte bërë edhe më i madh kur në të njëjtën gazetë, rreth këtij rasti tragjik, kishin filluar të dilnin në pah edhe deklarata të tjera, herë anonime e herë të drejtpërdrejta, siç ishin ato të boksierëve Luan Hoti dhe Bekim Krasniqi, nxënës shumëvjeçar të kampionit Bashkim Kosova, me ç’rast ata kishin deklaruar se kampioni kishte kohë që ishte kërcënuar me atentat gjë që për ta kjo paraqiste një vrasje të paralajmëruar.

Këtë bindje boksierët e rinj e kishin pasur nga çasti që Kampionin e kishin gjetur në atë gjendje të rëndë para kafesë “Vatra” dhe, me të shpejtë, me makinën “Pasat” kishin marrë rrugën për në Qendrën e Emergjencës në Prishtinë, të cilin e kishin përballuar me shumë vështirësi (u ishte dashur mbi një orë). Në atë ngarendje të mundimshme me kohën, që po u ikte, sa më shumë që i kishin humbur shpresat se Kampionit mund t’i ndihmohej disi, sikur kishin gjetur paksa ngushëllim me ato çirrijet lemëristës rreth vrasjes së Kosovës, që ishin përhapur gjithandej si një ogur i ligë që kishte marrë dhenë.

Çirrijet për vrasjen e Kosovës, ata i kishin përsëritur edhe para dyerve të Qendrës së Emergjencës në Prishtinë kur tashmë e kishin të qartë se ai kishte shkuar. Të njëjtat ia kishin thënë edhe mjekut kujdestar dr. Gazmend Bardhit, kur ia dorëzuan trupin e pajetë. Të njëjtat fjalë ia kishin thënë edhe hetuesit të çështjes. Dhe, të njëjtat i kishin përhapur kudo edhe pse nga disa të panjohur ishin kërcënuar haptas...

Shkrimet në gazetën “Dje”, bashkë me deklaratat e sipërpërmendura, por edhe ato të hallës Shpresa Kosova-Berisha se nipi Bashkim Kosova gjatë tre muajve të fundit, i sëmurë rëndë dhe fare i palëvizshëm, nuk kishte pasur mundësi të dilte jashtë e lërë më të ecte rrugës dhe vetëm në atë kohë të pakohë, deshtë a pa deshtë kishin hapur dyshimin se edhe ky rast tragjik kishte prapaskenën e vet, veçmas pse e gjitha kishte ndodhur pikërisht atë ditë të shënueshme dhe në ato rrethana dhe, pse hetuesi kishte desh ta anashkalonte shkakun e vërtetë të vrasjes.

Dhe, në përputhje me trysninë e opinionit, e me ndërhyrjen e EULEX-it, që ato ditë kishte filluar të vendoste misionin në Kosovë, Prokuroria e Qarkut të Prishtinës, jo vetëm që kishte anuluar hetimin e nisur ditë më parë, ku e gjithë çështja shihej si “aksident komunikacioni me pasoja tragjike”, por kishte caktuar një hetues tjetër, i cili punën do ta nisë nga e para dhe me dyshimin “e krimin të kryer me paramendim dhe të organizuar”, hetim ky, që ndonëse kishte shtrirë pistat e veta në shumë drejtime (pa përjashtuar në të

edhe përfshirjen e faktorëve ndërkombëtar), si edhe shumë të tjerët të kësaj natyre gjatë atyre viteve, kishte mbetur i hapur dhe çështje ishte se a do të zbardhej ndonjëherë?...

*Por, kjo nuk e kishte penguar Arsim Shpatin që të mos i ndahej kësaj çështje. Pas dy vjetësh pune të palodhshme, fillimisht si reporter i gazetës “Dje”, që kishte ngritur gjithë çështjen në opinion dhe, më vonë në cilësinë e publicistit të pavarur, pasi që kishte marrë në shqyrtim fakte të shumta si dhe deklarata të panumërta, kishte dalë me librin “**Dosja e hapur**”.*

PJESA E PARË

Kush ishte Bashkim Kosova?

(Shënime të thjeshta biografike, të shoqëruara me të tjera nga burime të ndryshme të kohës, përfshirë këtu ato nga shtypi dhe opinionet e shumta, me të cilat krijohet një kornizë biografike e veçantë për të nxjerrë në pah një personalitet po ashtu të veçantë, i cili ishte i mundur vetëm në një kohe të tillë të veçantë me çka po ashtu mund të thuhet se janë rrethanat e veçanta ato që u japin kuptim ngjarjeve të cilat megjithatë mbesin të veçanta pse nuk mund të jenë të ngjashme në rrethana të tjera...)

I lindur më 17 shkurt të vitit 1956 në Bileqe në Bosnje dhe Hercegovinë nga prindërit:

I ati: **Naim Kosova**, i lindur në Prishtinë në vitin 1928. Me profesion: pilot i aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë.

E ama: **Maria Paleviq**, e lindur në vitin 1932 në Zarë. Me profesion motër mjekësore me shërbim në Spitalin Ushtarak të Armatës Popullore të Jugosllavisë në Bileqe.

Të martuar në Bileqe më 29 nëntor të vitit 1954.

Naim Kosova, shkollimin fillestar katërvjeçar e kishte nisur në Prishtinë, në shkollën mbretërore “Aleksandar Karagjorgjeviq” në vitin 1936, me vazhdue mandej në gjuhën shqipe në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë nga viti 1941-1944, në rrethanat e asaj që fashistët e kishin quajtur “Shqipni e Madhe”. Nga fundi i vitit 1945 ishte dërguar në një kurs partiak nëntëmujor në Nish, për me e vazhdue shkollimin e mëtutjeshëm, së pari në Shkollën Ushtarake në Beograd, për me e ndjekë pastaj Akademinë Ushtarake, në gjininë e aviacionit, të cilën e kishte kryer në vitin 1952 me sukses të shkëlqyeshëm. Në tetorin e vitit 1952, si kadet i aviacionit, ishte dërguar në një specializim njëvjeçar në një bazë amerikane në Turqi, ku kishte ushtruar që të riaftësohet që detyrën e pilotit ta kryejë jo vetëm në aeroplanët ushtarak sovjetik (MIG-49), por edhe në ata amerikanë, me të cilët do të duhej të pajisej së shpejti një pjesë e flotës luftarake të aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë. Në nëntor të vitit 1953 komandohet në Bazën Ajrore të Armatës Popullore të

Jugosllavisë në Bileqe me gradën e pilotit-kapter. Në vitin 1960, gjatë një fluturimi me një aeroplan ushtarak, i ngritur nga baza ajrore e Bileqës, kishte humbur jetën, pasi që aeroplani ishte përplasur mbi një masiv të bjeshkëve Dinara në Kroaci. Për arsye të fshehtësive ushtarake nuk ishte dhënë as tipi i aeroplanit dhe as shkaqet që kishin sjellë te rrëzimi i tij. Por, tragjedia e pilotit-kapter Naim Kosova, kishte vazhduar ta përfshinte dhe pjesën tjetër të familjes. Po atë ditë, bashkëshortja Maria Paleviq – Kosova, kishte humbur jetën tragjikisht në një fatkeqësi komunikacioni jashtë Dërvarit, në rrugë e sipër për në Shibenik, ku ndodhej kufoma e të shoq. Nga andej duhej ta përcillte për në Bileqe, ku do të varrosej pas dy ditësh.

Në procesverbal ishte shënuar se shkak i fatkeqësisë vdekjeprurëse për Maria Paleviq – Kosovën kishte qenë “pëlçitja e gomës së parë (të majtës), me ç’rast vetura “Jep”, me targën JNA-212, që po drejtohej nga shoferi A.L. kishte rënë në greminë. Në vendin e fatkeqësisë ajo kishte mbetur e vdekur, ndërkohë që nga plagët e marra, në rrugë për në spitalin e Dërvarit, kishte vdekur edhe shoferi A.L. Pa lëndime, për fat, kishte shpëtuar i biri gjashtë vjeçar, Bashkim Kosova.

Piloti-kapter i aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë, Naim Kosova, që kishte vdekur tragjikisht gjatë fluturimit me aeroplanin ushtarak, si dhe bashkëshortja Maria Paleviq-Kosova, e cila po ashtu kishte vdekur tragjikisht pas gjashtë orësh në rrugë e sipër për me e shoqërue arkivolin e bashkëshortit, ishin varrosur bashkërisht me nderime të mëdha ushtarake në Parkun Memorial të Luftëtarëve të Luftës Nacional-Çlirimtare në Bileqe. Komanda e Aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë, me dekret të jashtëzakonshëm kishte dekoruar postmortum kapterin Naim Kosova me “*Urdhrin dëshmorit të popullit në rrethanat e paqes*” me yll të argjendtë.

Meqë, kapteri i aviacionit Naim Kosova, nuk kishte prindër (nëna, Ajshja, amvise i kishte vdekur në vitin 1939, ndërsa i ati Samiu, arsimtar kishte rënë në frontin e Sremit në mars të vitit 1945, bashkë me shumë kosovarë nga Brigadën e Shtatë e Kosovës, kryesisht e përbërë nga “vullnetarët”, që dërgoheshin në luftimet përfundimtare në veri kundër forcave gjermane), në varrim ishte ftuar të merrte pjesë, Arsim Kosova, vëllai i vetëm, mësues në shkollën fillore në katundin Hade.

Në të njëjtën kohë, në Prishtinë, në Shtëpinë e Armatës Popullore të Jugosllavisë, ishte mbajtur një mbledhje përkujtimore, në të cilin kishin marrë pjesë oficerë të lartë të Armatës së Tretë dhe të Armatës së Parë si dhe udhëheqja më e lartë politike e Krahinës së Kosovës dhe Metohisë.

Maria Paleviq – Kosova, e lindur në vitin 1932 në Zarë, me profesion motër mjekësore e punësuar në Spitalin Ushtarak të Armatës Popullore të Jugosllavisë në Bileqe. Maria Paleviq ishte bijë e avokatit të njohur nga Zara Franjo Paleviq, mik i ngushtë i shkrimtarit abresh nga Zara Josip Relja. Franjo Paleviq, njëherësh bënte pjesë në rrethin e miqve të shkrimtarit të madh kroat, Miroslav Kerlezha. Pas luftës, si jurist i njohur, një kohë kishte qenë në Gjykatën Supreme të Kroacisë. Pas viteve të gjashtëdhjeta, iu kishte përkushtuar detyrës së avokatit të pavarur në Zarë. Meqë kishte prejardhje arbëreshe, bashkë me shkrimtarin Josip Relja dhe disa intelektual të tjerë, ia kishin dalë që vendbanimit Arbanasi në afërsi të Zarës me ia sigurue statusin e “pakicës shqiptare”, ku kishin hapur një bibliotekë me libra shqipe dhe kishin formuar shoqërinë kulturore “Arbanasi”.

Maria Paleviq – Kosova ishte vajza e vetme e Franjo Paleviqit, por ai kishte edhe djalin Josipin, ushtarak me karrierë tejet të suksesshme.

Maria, përcaktohet për profesionin e infermieres, meqë dëshironte të bëhej si e ëma, Vera Paleviq, e cila ishte mjekë, që kishte vdekur e re nga një karcinom në gji. Pasi kreu shkollën e mesme të mjekësisë, punësohet praktikante, përkohësisht në spitalin ushtarak në Bileqe, prej nga duhej të vazhdonte studimet në Zagreb. Por, aty takohet me ushtarakun Naim Kosova me ç'rast midis tyre u lidh dashuri e zjarrtë që përfundoi me martesë. Pas pak do të vijë edhe fëmija Bashkimi, i cili do të mbyllë përfundimisht ëndrrën e saj me u ba mjekë. Por, si do të shihet nga deklarata e të vëllait, gjeneralit në pension, Josip Paleviq (*shih në pjesën “Shtojca”, në faqen...*), ajo ishte e lumtur pse jeta e saj kishte marrë atë kthesë dhe dëshironte që t'i përkushtohej familjes.

(Shënimet e para biografike për Bashkim Kosovën, sipas burimeve zyrtare të plotësuara edhe me disa të dhëna të tjera nga shtypi i kohës)

Pasi që brenda 24 orëve , në dy fatkeqësi të ndryshme (njëra ajrore dhe tjetra tokësore), Bashkim Kosova kishte humbur prindërit, të cilët kishin qenë të punësuar në Armatën Popullore të Jugosllavisë (i ati si pilot me gradën e kapterit dhe e ëma motër mjekësore në Spitalin Ushtarak në Bileqe), me ligjet e Armatës Popullore të Jugosllavisë, ai gëzonte mbikëqyrjen e plotë të shkallës së parë, e cila i siguronte kushte shumë të mira që nga koha parashkollore, shkollimi fillor dhe ai i mesëm e deri te moshë madhore.

Kështu, në moshën katërvjeçare, ishte dërguar në jetimoren e Qendrës Ushtarake në Dërvar, prej nga pas pak ishte dërguar në edukimin parashkollor në Karlovac, ndërsa pas një viti, po në të njëjtin qytet, në Internatin e Jetimoreve të Armatës Popullore të Jugosllavisë, kishte hyrë në bankat shkollore, ku kishte kryer ciklin e ulët shkollor katërvjeçar. Gjithnjë nën përkujdesjen e Armatës Popullore të Jugosllavisë, ciklin e dytë të shkollimit fillor, e kishte vazhduar në Zagreb, në kuadrin e një edukimi orientues me të cilin do të mund të përfshihej në shkollimin e mëtutjeshëm ushtarak. Por, në Zagreb, nxënësi deri më atëherë i shkëlqyer Bashkim Kosova, kishte zënë të tregonte më tepër interesim për sportin se sa për të tjerat. Në kuadrin e aktiviteteve të lira, ishte regjistruar në klubin e boksit, ku në moshën dhjetë vjeçare kishte mahnitur trajnerët që merreshin me talentet në kuadër të pionierëve. Meqë në atë kohë, pra në vitin 1968, kishte mbushur dymbëdhjetë dhe, kjo me ligjin e përkujdesjes së jetimoreve, detyronte institucionin që ta vente në lidhjet e mëtutjeshme familjare (ato farefisnore dhe më të gjëra), në këtë rast me xhaxhanë Arsim Kosova, mësues në Hade, i cili, me anën e letrave, vazhdimisht ishte interesuar për gjendjen e të nipit, por që këtë herë, me shpenzimet e Armatës Popullore të Jugosllavisë, ishte ftuar në Zagreb për një qëndrim njëjavor, ku do ta kalonte me të nipin. Pas këtij takimi, që kishte qenë i dobishëm, sipas një marrëveshje me Qendrën Shkollore të APJ-së, Bashkim Kosova, me dëshirën e tij, për herë të parë ishte lejuar që t'i kalonte pushimet verore në Kosovë.

Gjatë dy muajve (nga një qershor deri më një shtator), Bashkim Kosova një pjesë të pushimit e kishte kaluar në Hade, ndërsa pjesën tjetër e kishte kaluar në Prishtinë te kushëriri Baki Kosova, avokat i njohur, ndërsa disa ditë i kishte kaluar në Vushtrri tek halla Shpresa Kosova – Berisha, ku kishte vu lidhje tejet miqësore me fëmijët e saj: bijtë Mendimin dhe Fisnikun (mocanikë të tij) dhe vajzat: Teutën dhe Blertën gjimnaziste. Gjatë dy muajve të

qëndrimin në Kosovë, Bashkim Kosova, fillimisht kishte përdorur gjuhën serbokroate (meqë kishte ruajtur shumë pak nga ato që si fëmijë në shtëpi fliste me prindërit), ndërkohë, që ditëve të fundit, ia kishte dalë të fliste edhe shqip dhe kjo i kishte habitur që të gjithë. Pas kthimit në Zagreb, kishte kërkuar që sapo ta mbarojë gjimnazin, të kthehej në Prishtinë me vazhdue studimet. Xhaxhai Arsim Kosova, këtë kërkesë ia kishte paraqitur zyrtarisht Qendrës Shkollore të APJ-së në Zagreb, kërkesë kjo që ishte plotësuar me deklaratën që kishte dhënë vetë Bashkim Kosova, i cili pasi që do të kthehet nga pushimet vjetore të kaluara në Kosovë për të dytën herë radhazi, do të thirret në një bisedë në drejtorinë e shkollës për të arsyetuar vendimin. Bashkim Kosova kishte deklaruar se arsyeja e vetme që kërkonte të kthehej në Prishtinë ishte dëshira që të vazhdonte studimet në Prishtinë pranë rrethit familjar, që deri më atëherë i kishte munguar, ku ndjehej mirë dhe shpresonte se do t'ia dilte të sendërtonte dëshirën që, krahas studimeve, t'i përkushtohej boksit.

Çështjen e përkushtimit ndaj boksit, ku po tregonte gjithnjë e më shumë suksese dhe trajnerët e shkollës së boksit, tashmë i parashihnin një të ardhme tepër të suksesshme, duke mos ngurruar që të thoshin se përpara kishin një kampion të ardhshëm, do ta theksojë si arsye edhe para një grupi pedagogesh, që do ta intervistojnë para se të merrej vendimi përfundimtar që t'i lejohej kthimi në Prishtinë. Me këtë rast do ta zërë ngojë klubin e boksit “Radnički” dhe shkollën e boksit, ndër më të mirat në vend, që udhëhiqej nën mbikëqyrjen e trajnerit Lis Mani.

Kështu, në qershor të vitit 1970, pasi që ta ketë kryer Shkollën Fillore dhe atë Orientuese pranë Qendrës Ushtarake të Armatës Popullore të Jugosllavisë në Zagreb, Bashkim Kosova, do t'i aprovohet kërkesa që shkollimin e mesëm ta vazhdojë në Prishtinë. Xhaxhai Arsim Kosova u thirr të nënshkruajë marrëveshjen me Armatën Popullore të Jugosllavisë rreth “përkujdesjes së mbikëqyrur dhe të përkohshme” (deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare), kur i njëjti institucion, pra APJ do të vendosë për rrugën e mëturtyeshme të tij. Gjatë kohës së “përkujdesjes së përkohshme”, Bashkim Kosova do të mbikëqyrej nga organet kompetente të APJ-së, të cilat edhe më tutje ruanin të drejtën që atij t'i sigurohej mbikëqyrja e plotë sociale, ndërkohë që xhaxhai do të merrte rregullisht një ndihmë materiale (e përafërt sa paga e tij mujore si mësues) me të cilën do t'i plotësohen që të gjitha nevojat gjatë shkollimit. APJ, po ashtu ruante të drejtën që me anën e inspektorëve për çështje civile me mbikëqyrje mirëvajtjen e shkollimit, gjendjen shëndetësore si dhe edukimin në përputhje me normat e moralit socialist dhe, sipas nevojës të ndërhynte, nëse vlerësohej se ato nuk përmbusheshin ose shkeleshin.

(Shkollimi në gjimnazin “Ivo Lola Ribar” në Prishtinë)

Në gjimnazin “Ivo Lola Ribar” të Prishtinës, Bashkim Kosova regjistrohet në vitin shkollor 1970/71 në paralelen VI. Arsimtar kujdestar kishte Afrim Shkodrën, profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, i diplomuar para një viti në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Universitetit të Kosovës. Klasa kishte tridhjetë e pesë nxënës, ndërkohë që mësimi për klasat e para dhe të dyta zhvillohej paradite. Kjo i mundësoi kohë të mjaftueshme me iu përkushtue boksit (dy orë në mbrëmje) në kuadër të shkollës së boksit të klubit të boksit të qytetit, i cili ato ditë e kishte ndërruar emrin nga “Radnički” (“Punëtori” në serbokroatisht) në “Prishtina”.

Vitin e parë të gjimnazit “Ivo Lola Ribar” në Prishtinë, Bashkim Kosova e kishte kryer me sukses shumë të mirë. Ambiciet që të jetë i shkëlqyeshëm kishin pasur për pengesë njohjen e plotë të gjuhës shqipe si dhe shprehjen e lirë në këtë gjuhë. Por, kur dihej se shkollën fillore e kishte kryer në gjuhën serbokroate në Zagreb, larg lidhjeve me gjuhën e folur shqipe (me përjashtim të dy pushimeve vjetore të kaluara në Kosovës gjatë viteve të fundit), atëherë përparimi i Bashkim Kosovës në këtë drejtim ishte vlerësuar si tepër i suksesshëm dhe madje befasues.

Por, në vitin e dytë, Bashkim Kosova do të arrijë atë që synonte: suksesin e shkëlqyeshëm. Siç do të shihet nga deklaratat e mëvonshme nga disa nga shokët e shkollës, veçmas shoku i tij i pandashëm Kujtim Shllaku, shoqja Vera Bardhi dhe Kristina Gjini, si dhe një shënim afirmativ në gazetën “Rilindja”, Bashkim Kosova, edhe për nga e folmja e edhe për nga theksi madje, do të shfaqej i njëjtë me të tjerët. Ndërsa në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe do të tregohet ndër më të mirët, ngaqë krahas lekturës shkollore, lexonte edhe vepra të tjera nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.

Interesim të madh tregoi edhe për lëndën e historisë. Jashtë detyrimeve, në vitin e tretë, arsimtarit të historisë Pëllumb Shytit, ia dha për lexim një punim të shkurtër, ku bëhej fjalë për historikun e familjes Kosova, të parë nga dëshmi të brendshme familjare.

Ky punim, por i zgjeruar edhe me disa dokumente do të gjendet në kuadër të bibliotekës së familjes që ia kishte dorëzuar hallës, Shpresa Kosova – Berisha, në Vushtrri, që të ruhej. (*Dokumentet plotësuese bashkë me ato që Bashkim Kosova do t'i shkruajë si kujtime apo si rrëfime gjenden në Pjesën e Tretë “Çfarë tha Bashkim Kosova?”, në faqe ...*).

Gjimnazin “Ivo Lola Ribar” në Prishtinë, Bashkim Kosova e kreu me sukses të shkëlqyeshëm në qershor të vitit 1974. Këshilli mbikëqyrës i Armatës Popullore të Jugosllavisë, dega në Prishtinë, e vërtetoi këtë dhe i shprehu mirënjohje xhaxhait Arsim Kosova për përkujdesjen e duhur me ç’rast zyrtarisht iu falënderua me anën e një shkrese, në të cilën, po ashtu do t’i bëhet me dije, se meqë Bashkim Kosova, kishte mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçe, gjithnjë në përputhje me të drejtën e APJ-së që për t’u plotësuar kushti ligjor që ai të fitojë të drejtën moshës madhore, kur lirohej nga çfarëdo mbikëqyrje dhe me këtë shpallej i pavarur, duhej të kalonte edhe një vit nën mbikëqyrjen e të ashtuquajturës “Qendër për Edukimin Jetësor” (në gjuhën serbokroate “Centar za Zivotno Vaspitanje) në Beograd, ku do të ketë mundësinë që të orientohet për “profesionin jetësor”, që mund të merrej me mend se kërkohet të ishte mbetja e mëtutjeshme në rrjetin shkollor të Armatës Popullore të Jugosllavisë, po qe se për këtë do t’i jepej “nota kaluese”.

(Në shkollën e boksit të klubit “Prishtina” si dhe sukseset e para në këtë fushë në kuadër të ekipit të juniorëve)

Bashkim Kosova u regjistrua në shkollën e boksit të klubit “Prishtina” në gusht të vitit 1970. Me vete kishte sjellë edhe diplomën nga “Shkolla e Boksit e Qendrës Sportive të Armatës Popullore të Jugosllavisë”, ku përshkruheshin aftësitë e jashtëzakonshme si dhe talenti i tij për t’u dëshmuar në sportin e “shkathtësive fisnike”. Aty, thuhej se Bashkim Kosova, pas dy vitesh pune intensive mund të kalojë në kategorinë e juniorëve, pra jo para se të mbushte gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Në të vërtetë, Bashkim Kosova, pas një viti u bart në kategorinë e juniorëve. Kjo u bë në sajë të një certifikate mjekësore, të dhënë nga Qendra Mjekësore e Prishtinës, në të cilën mjeku i sportit dr. Nebojsa Gjuriq (një kohë edhe mjek i klubit të boksit kur quhej “Radnički”), do të përshkruajë aftësitë e mëdha fizike të Bashkim Kosovës si dhe mundësitë e tij që të ushtrojë me juniorët, në të cilën pos tjerash thuhej se “ato ishin në përputhje me konstruktin e tij fizik dhe mental tejet të qëndrueshëm”.

Në kuadrin e ekipit të juniorëve, Bashkim Kosova filloi karrierën e boksierit amator me duelet, që mbaheshin si paralojë e atyre që ekipi i parë i “Prishtinës” zhvillonte me rivalët me renome në kuadër të Ligës së Parë të Jugosllavisë, në të cilën hyri në vitin 1972 pas garës dyvjeçare në Ligën e Dytë. Kështu, pas vitit të dytë dhe të tretë, në këtë kategori, ku zhvilloi mbi njëzet duele dhe që të gjitha i fitoi, në ndeshjen e fundit të pjesës pranverore të kampionatit, kur tashmë klubi “Prishtina” kishte siguruar titullin e parë të kamionit të Jugosllavisë, në duel me “Radniçkin” e Beogradit, inkuadrohet në ekipin e parë, në kategorinë velter.

Edhe ky debi do të lejohet nga mjeku i ekipit dr. Ruzhdi Fehrati, i cili në certifikatën shëndetësore, pos tjerash, do të shënojë se “Bashkim Kosova fizikisht ishte i gatshëm që të luftonte para se të arrinte moshën e lejuar, pra atë tetëmbëdhjetë vjeçare”.

Në luftë me boksierin me renome, Pavloviq – kampion i trefishtë i Jugosllavisë, Bashkim Kosova fitoi në raundin e dytë me ndërprerje nga ana e gjyqtarit të ringut Svetislav Joketi nga Nishi. Me këtë rast mbi gjashtë mijë shikues në stadiumin e Sporteve të Vogla në Prishtinë, me brohoritje të gjata, përshëndeten kampionin e ardhshëm. Shtypi i Prishtinës dhe ai i Beogradit, por edhe i qendrave të tjera përshëndetën shfaqjen e “talentit më të rrallë” me fjalët se e priste një e ardhme e ndritshme. (*Më gjerësisht, bashkë me komentin e “Rilindjes” dhe gazetave të tjera shih në Pjesën e Dytë “Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?”, në fejtounin “Vitet e Kampionit” në faqe...*)

(Viti i shkëputjes nga Armata Popullore e Jugosllavisë dhe hapja e rrugës drejt sukseseve të pandalshme)

Pas kryerjes së gjimnazit në Prishtinë, Bashkim Kosova, gjithnjë sipas rregullores së Armatës Popullore të Jugosllavisë për mbikëqyrjen e të miturve, kishte qenë i detyruar që nga tetori i vitit 1974 deri në tetor të vitit 1975 të kalonte një vit në “Qendrën për Edukimin Jetësor”, institucion ku i tipit të internatit, ku mund të arrihej vazhdimi i mëtutjeshëm me Armatën Popullore të Jugosllavisë me anën e një kontrate (për shkollim të mëtutjeshëm akademik në kuadër të sistemit ushtarak, për punësim të menjëhershëm në përputhje me arritjen profesionale), ose përfundimi i saj, gjithnjë në përputhje me ligjin për përgjegjësinë e moshës madhore, që nënkuptonte vazhdimin e jetës në rrethanat e shoqërisë civile sipas përcaktimit individual. Edhe në rastin e dytë, sipas nevojës, Armata Popullore e Jugosllavisë, mbetej ombrellë e përhershme.

Sidoqoftë, Bashkim Kosova do të përcaktohet për kthimin në jetën civile si qytetarë i lirë, i cili merrte përgjegjësinë mbi vete. Pedagogët e “Qendrës për Edukimin Jetësor” nuk do të ngulin këmbë që përcaktimit të tij për t’u marrë me boks profesional t’i propozojnë ndonjë alternativë tjetër, ngaqë ai tashmë kishte dëshmuar se është një talent i jashtëzakonshëm, një kampion i lindur me aftësi të rralla fizike për një sport të tillë, gjë që

gjatë atij viti, Bashkim Kosovës, i ishin dhënë që të gjitha mundësitë (ndër më të mirat që posedonte shteti jugosllav për talentet e rinj), që ai të ecte përpara. Kështu, nën përkujdesjen e dy trajnerëve të kategorisë së parë (njërit për kondicion fizik dhe tjetrit për shkathtësi ringu), ishte dërguar në Qendrën për Ushtrime Fizike në Tashmajdan prej nga do të regjistrohet (përkohësisht) në klubin e boksit “Partizan” të Beogradit, në të cilin rëndom kalonin që të gjithë kampionët e vendit. Trajneri Gojko Kaçar, dikur reprezentues i njohur i Jugosllavisë në kategorinë gjysmë të rëndë (kampion i shumëfishtë i vendit, kampion i Ballkanit, nënkampion europian dhe fitues i medaljes së bronzit olimpike), me të shpejtë do ta fusë në ekipin e parë dhe pas kategorisë velter, ku do të ketë pesë duel që do t’i fitojë me nokaut, do ta bartë në kategorinë gjysmë të rëndë, ku do të mbesë përgjithmonë.

(Kthimi në Prishtinë në klubin e boksit “Prishtina” dhe karriera e jashtëzakonshme si boksier, që do të kurorëzohet me atë të kampionit olimpike)

Në tetor të vitit 1975 Bashkim Kosova kthehet nga Beogradi në Prishtinë me dëshirë, pasi që të ketë nënshkruar marrëveshjen me Shërbimin për Përkujdesje të Armatës Popullore të Jugosllavisë, nën mbikëqyrjen e të cilit ligjshmërisht kishte qenë nga mosha katërvjeçare (pas fatkeqësisë së prindërve në vitin 1960). Do të regjistrohet në degën Sociologji-Filozofi të Universitetit të Prishtinës, por studimet i anashkaloi paksa deri sa i lënë fare, nga shkak se i tjeri, në klubin “Prishtina”, iu përkushtua boksit.

Megjithatë, karriera e tij tejet e suksesshme sportive filloi në verën e vitit 1978, kur fitoi titullin e parë ndërkombëtar, atë të kampionit të Ballkanit në kategorinë gjysmë të rëndë në Sofje, me ç’rast ai do të ballafaqohet me sfidën më të madhe nga brenda, me atë të heqjes nga oreoli i famës së jashtëzakonshme të kampionit aktual të Jugosllavisë në kategorinë gjysmë të rëndë, të boksierit nga Bosnja dhe Hercegovina, Marjan Benesh. *(Më gjerësisht rreth këtij dueli shih në Pjesën e Dytë “Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?” në fejtordin e gaztës “Rilindja”: “Vitet e Kampionit”, në faqe...).*

Kjo karrierë e suksesshme, e përcjellë me shumë e shumë fitore, me shumë e shumë tituj shtetërorë e ndërkombëtarë dhe medalje në garat e mëdha botërore (Lojërat ballkanike, kampionatet Europiane, Lojërat olimpike dhe Kampionati Botëror i Boksit) do t’i ndërpritet dhunshëm në verën e vitit 1968, nga Shtabi Teknik i Lidhjes së Boksit të Jugosllavisë, me dorëzimin e duelit në luftë për medaljen e artë, pra për titull të kampionit botëror në Kampionatin Botëror të Boksit në Toronto të Kanadasë në verën e vitit 1986. Lufta me boksierin sovjetik Igoriev për titullin e më të mirit në botë, njëherësh shënon paraqitjen e tij të fundit në ring dhe humbjen e parë në karrierën e tij, por pa luftë, gjë që mbetet boksieri i vetëm në botë që kishte arritur një rekord të tillë. *(Më gjerësisht rreth këtij dueli shih në Pjesën e Tretë “Çfarë tha Bashkim Kosova?”, në “Lufta ime e madhe”, në faqen...)*

Por, para se do të vijë te fundi, pra nga fitorja në verën e vitit 1978 e tutje, ai e kishte pasur të hapur rrugën nga fitorja në fitore, që parashikohej se një ditë do të kurorëzohej me atë të kampionit botëror. Që të arrihej deri te kjo pikë, Bashkim Kosova, pasi që të heqë sfidën e jashtëzakonshme Marjan Benesh, një vit më parë, për të dytën herë fitoi titullin e kampionit të Ballkanit (këtë herë në Athinë, kur për të dytën herë radhas mposhti kamionin e këtij vendi Dimitrov, të quajtur “Goxilla”), ndërkohë që kjo do t’ia hapë rrugën titullit për kampion të Europës, që do të mbahet në Berlinin Lindor. Pas dy vitesh, titullin e kampionit

europian do ta mbrojë në Madrid. Aty, në finale ndeshet prapë me një boksier tjetër bullgar, Todorov, edhe pse me dëshirë priste kampionin sovjetik, Medvedev, i cili nga lëndimi i krahut, nuk do të jetë në gjende të boksojë me bullgarin Todorov. *(Më gjerësisht në “Vitet e kampionit” në Pjesën e Dytë të librit “Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?”, në faqen...)*

Koha nga titujt europianë deri te ai olimpik, pra nga qershori i vitit 1982-1984 për boksierin Bashkim Kosova, qe me sfida të shumëfishta, më shumë shoqërore se sa sportive, meqë sukseset e tij sportive (fitorja e katërt me radhë e titullit të kampionit të Jugosllavisë në kategorinë gjysmë të rëndë, e katërta me klubin “Prishtina” si dhe fitoret në disa turnirë ndërkombëtar, do të përcillen edhe me përpjekje që me mjete jospportive (pra politike) t’i pengojë ose t’i rrënojë karriera sportive. Gjatë kësaj kohe, në disa qytete (Nish, Prokuplje dhe Çaçak), por edhe në Banjallukë, krahas fyerjeve që i vinin nga publiku, do të ballafaqohet edhe me përpjekjet e hapura dhe të pareshtura të gjyqtarëve t’i merreshin fitoret herë me anën e vërejtjeve publike, të pamerituara (gjoja për boks të papastër), e herë me kërkimin e lëndimeve edhe aty ku nuk ishin (gjakderdhjet e rëndomta nga hundët) që për arsye “humanitare” të diskualifikohej, gjë që do ta detyrojë që ndaj kundërshtarëve në ring të përdorë ashpërsinë e skajshme dhe t’i nokautojë edhe atëherë kur kjo nuk ishte e nevojshme.

Megjithatë, edhe në këto rrethana, nëpër ringjet jugosllave, Bashkim Kosova shënoi 42 fitore, 35 prej tre me KO (nokaut klasik), shumicën në raundin e parë. Gjatë kësaj kohe ai mendonte vetëm për fitoret e shpejta dhe të ashpra. Kjo mënyrë e boksit bëri që në disa ringje jugosllave, në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, t’i jepet nofka “ubica” (vrasës), me të cilën ai rëndom do të pritët me fishkëllima që nga fillimi i dueleve e deri te përfundimi i tyre. Shurdhuese dhe të përcjella edhe me gjuajte të ndryshme të shisheve dhe metaleve në ring, do të jenë thujtë që të gjitha paraqitjet e tij në ringjet serbe, të cilat, kohëve të fundit përcilleshin me kërcënimet shfrenuese: “*shiftarski ubica*” (“vrasës shifter” – fjalë fyese për shqiptarët në gjuhën serbokroate), të cilat shfaqeshin më shumë si artikule politike të natyrës shoviniste ndaj të cilave do të reagojnë edhe disa nga gazetatat kryesore të Kroacisë, Sllovenisë dhe të Vojvodinës. *(Më gjerësisht rreth këtyre dukurive shih në Pjesën e Dytë “Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?” në “Dosjen e urrejtjes”, në faqen...)*

I ballafaquar me këtë atmosferë Bashkim Kosova, arriti edhe nominimin për reprezentacionin shtetëror të Jugosllavisë që të garonte në Lojërat Olimpikë të vitit 1984 në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Seleksionuesi i reprezentacionit jugosllav të boksit, kroati Bruno, u ballafaqua me përpjekje të pareshtura të Lidhjes së Boksit të Serbisë dhe të klubeve të kësaj republike, e cila përfaqësohej me gjashtë ekipe në Ligën e Parë nga dhjetë sa kishte, që të mos lejoheshin që krahas Bashkim Kosovës, për në Los Anxhelos të udhëtonin edhe dy boksier të tjerë të klubit “Prishtina”, kampion aktual të Jugosllavisë: Lik Begu në kategorinë e lehtë dhe Metë Boga, në kategorinë velter. Bruno nuk do të lëshojë pe, meqë kishte argumentet sportive ato që rrënonin të tjerat. *(Më gjerësisht edhe rreth kësaj shih në Pjesën e Dytë, në “Dosja e urrejtjes”, në faqen...)*

(Vitet e përgatitjeve për titullin e kampionit botëror dhe fillimi i ashpër i fushatës kundër karrierës së tij sportive me mjete politike dhe trysni të tjera)

Kthimi i Bashkim Kosovës nga Los Anxhelosi me titullin e kampionit olimpik në kategorinë gjysmë të rëndë si dhe i suksesit të madh të boksierëve të klubit “Prishtina” (Lik

Agu në të lehtë dhe Metë Boga, në kategorinë velter, të cilët kishin fituar medaljet e bronzta), shënoi suksesin më të madh të boksit kosovar dhe atij jugosllav deri më atëherë në arenën ndërkombëtare. Madje, edhe shtypi i Beogradit, me prirje kundër boksierëve të Prishtinës, gjoja nga shkaku i “rivalitetit” sportiv me klubin e Prishtinës për dominim në ringjet jugosllave - edhe pse fjala ishte për depërtim e nacionalizmit serb, i cili kishte dalë hapur nga vitit 1981 e tutje - do të pranojë sukseset, por edhe me këtë rast nuk la pa e sulmuar Bashkim Kosovën dhe sjelljen e tij “inferiore” gjatë intonimit të himnit jugosllav “*Hej slloveni*” si dhe shfaqjen pa flamurin jugosllav “*trobojnicës*” si “stoli patriotike” në gjoks (siç veprojnë boksierët e secilit vend) me rastin e marrjes së medaljes.

Nga “Politika” e Beogradit do t’i shihet për të madhe pse nuk ishte deklarua kundër demonstruesve të organizuara nga shqiptaro-amerikanët, të cilët gjatë ekzekutimit të himnit jugosllav ishin paraqitur me parullën “*Kosova Republikë*”, demonstrim ky, që sipas kësaj gazete serbe, nuk mund të shihej i shkëputur nga qëndrimi “mbrojtës” i Bashkim Kosovës ndaj nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, i cili sportin dhe hapësirën e tij e kishte kthyer në një arenë demonstrues ndër më të suksesshmet. (*Më gjerësisht rreth këtij rasti shih shkrimin e gazetës “Politika” të Beogradit në Pjesën e Dytë “Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?” në “Dosja e urrejtjes”, në faqe...*)

Në Kosovë, dhe veçmas në Prishtinë, Bashkim Kosovës dhe boksierëve të tjerë të klubit “Prishtina” pas kthimit nga Los Anxhelosi iu bë pritje madhështore. Nga aeroporti i Prishtinës në Sllatinë, nëpër Fushë të Kosovës e deri në qendër të qytetit, para hotel “Grand Prishtina”, rrugët ishin të mbushura plot e përplot dashamirë të boksit, por edhe qytetarë të tjerë, që kishin dalë me i përshëndetë si thuhej nëpër pankarta “*Heronjtë e Kosovës*” dhe kampionin e kampionëve Bashkim Kosovën.

Në stadiumin e madh të Prishtinës, para katërdhjetë mijë vetave, Bashkim Kosova kishte parakaluar me medaljen e artë olimpikë në qafë. Me këtë rast as fjala përshëndetëse e Kryetarit të Lidhjes së Sporteve të Kosovës, as ajo e Kryetarit të Kuvendit të Prishtinës dhe as e Kryetarit të Lidhjes Socialiste të Kosovës, nuk kishin mund të dëgjohen nga jehona e këngës “*Oj, Kosovë, nana jonë*” dhe brohoritjet:

“*Bashkim! Bashkim!*”

“*Rroftë Bashkimi!*”

E njëjta këngë dhe të njëjtat brohoritje: “Bashkim” dhe “Rroftë Bashkimi”, kishin mbushur rrugët dhe sheshet e kryeqytetit të Kosovës dhe e njëjta kishte depërtuar edhe në të gjitha pjesët tjera të Kosovës (ngaqë nga stadiumi RTP kishte bërë transmetim të drejtpërdrejtë për dy orë rresht).

Manifestimi kishte përfunduar me këngën:

“*Besa, besë, besën ta kam dhanë për Kosovë jetën kam me e dhanë...*”

Atë ditë, krahas flamujve zyrtar (atij jugosllav, partiak dhe flamurit kombëtar shqiptar), me të cilët ishte stolitur e gjithë Prishtina, para hotelit “Grand Prishtina” dhe në stadium ishte parë edhe flamuri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që në një lagje të Fushë Kosovës, Graçanicë dhe Çagllavicë kishte ardhur deri tek grumbullimi dhe protestat e popullatës serbe ndaj “shkeljes së sovranitetit jugosllav në Kosovë nga ana e nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë me anën e flamurit amerikan”. (*Më gjerësisht rreth kësaj shih në Pjesën e Dytë, komentit redaktorial të gazetës “Jedinstvo” të Prishtinës nga “Dosja e urrejtjes”, në faqen...*)

(Shkuarja në Kampionatin Botëror në Toronto dhe komploti që të t'i pamundësohet lufta në ndeshjen finale për titullin e kamionit botëror)

Edhe përkundër ndërhyrjeve të natyrës jospportive (të shumtën politike), që t'i pamundësohet shkuarja në Kampionatin Botëror të Boksit Amator në Toronto në korrikun e vitit 1986, Bashkim Kosova, më në fund, fitoi të drejtën me shkue në këtë kampionat dhe të arrijë finalen, pasi që t'i ketë fituar pesë duele radhas (në gjiron e parë ndaj boksierit gjerman Shulc, në gjiron e dytë ndaj rumunit Marinesku, në gjiron e tretë ndaj boksierit spanjoll Rodriguez, në gjiron e katërt ndaj boksierit polak Jarushinski dhe në gjysmëfinale ndaj boksierit nga Kuba, Martinez).

Pra, lufta deri në finale e përballi me kamionë të shumëfishtë dhe të niveleve të ndryshme nga ai ballkanik (rumuni Marinesku), europian (gjermani Shulc), kampioni olimpiq i vitit 1980 në Moskë polaku Jarushinski dhe kampioni paraparak botëror (Martinez nga Kuba). Me përjashtim të duelit gjysmëfinal me kamionin botëror, kubanezin Martinez, duelet tjera i kishte fituar me nokaut klasik (atë me Rodrigezin dhe Jarushinskin), ndërsa me nokaut teknik, pra me ndërprerje (me gjermanin Shulc dhe me rumunin Marinesku).

Me ish kampionin botëror, kubanezin Martinez, ishte shpallur fitues me pika (tre me dy), me ç'rast gjyqtarët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Gjermania i kishin dhënë pesë pikë përparësi ndaj rivalit kubanez (120 me 115), ndërsa gjyqtari sovjetik dhe ai në ring, bullgari Todorov, i kishin dhënë dhjetë pikë përparësi boksierit nga Kuba, vlerësim ky skandaloz, që ishte përcjellë me fishkëllima të gjata dhe protesta të tjera. *(Më gjerësisht rreth këtij dueli shih "Lufta ime e fundit..." në Pjesën e Tretë "Çfarë tha Bashkim Kosova?", në faqe...)*

Fitorja në gjysmëfinale ndaj kampionit aktual botëror, kubanit Martinez, Bashkim Kosovën, me një lavdi, e bëri të njohur në gjithë botën. Nga transmetimi i drejtpërdrejtë televiziv me miliona shikuesve kishin parë se as referimi skandaloz i bullgarit Todorov (i kishte dhënë vërejtje publike në vend se të ishte e kundërta si dhe kishte ndërhyrë me ndërprerje të luftës kur kubani ndodhej para nokautit) dhe as ngacmimet jospportive përreth ringut që i vinin nga ekipi i kundërshtarit, por edhe nga persona të tjerë zyrtarë dhe gjysmëzyrtarë (gjë që për këtë trajneri Bruno kishte protestuar dy herë), nuk kishin qenë në gjendje që ta shpëtojnë nga humbja kubanin, i cili deri më atëherë ishte vlerësuar boksieri më i mirë i të gjitha kohëve në kategorinë gjysmë të rëndë dhe ishte krahasuar me Kasius Klejin (Muhamed Alinë), që duhej të kalonte në boksion profesionist në mënyrë që atje, pasi të kalonte në kategorinë e rëndë, të arrinte titullin e më të mirit në botë. Thuhej se, që të bëhej pasues i Muhamed Alisë, personalisht Fidel Kastro kishte përgatitur lejen që ai të kalonte në boksion profesionist. I duhej vetëm titulli i dytë në Toronto që përfundimisht t'i jepej ringut profesional.

Por, parashikimet se tashmë bota kishte një kampion të madh, për të cilin finalja me sovjetikun Igoriev, i cili në duel me boksierin hungarez Farkash (nuk kishte fituar me poenë, por në saje të përparësisë, që ka mundur të jetë edhe në anën e kundërt), nuk do të përmbushen nga shkaku i vetëm pse mjeku i reprezentacionit jugosllav, dr. Rashkoviq, do të vlerësojë se "Bashkim Kosova, nga të rënat e shumta në kokë, ndodhej në një gjendje nokdauni psiko-fizik!" Andaj, "nuk mund t'i lejohet paraqitja në ring, madje as stërvitjet në

një kohë prej dy muajsh, sepse kjo rrezikonte shëndetin, por edhe jetën”. Përpos trajnerit Bruno, i cili këtë vlerësim e kishte quajtur absurd dhe kishte kërkuar që Bashkim Kosova të dalë në ring, anëtarët tjerë të shtabit profesional (maqedonasi Vasilevski, boshnjaku Markoviq, malaziasi Zharkoviq, serbit Vlajkoviç) kishin përkrahur mjekun Rashkoviç me konstatimin se “Kosova nuk është në gjendje me i kryqëzue dorëzat me sovjetikun, meqë rrezikohet shëndeti i tij e me këtë edhe renomeja e Jugosllavisë si ekip”.

Me këto arsyetime ata kishin nënshkruar vendimin që “dueli final në kategorinë gjysmë të rëndë, ku Bashkim Kosova duhej të luftonte për titullin e kampionit botëror, të dorëzohej”. *(Më gjerësisht rreth eliminimit nga lufta për titullin e kampionit botëror shih në Pjesën e tretë “Çfarë tha Bashkim Kosova” në “Lufta ime e madhe”, në faqe...)*

(Fundi i dhunshëm i karrierës sportive si dhe vazhdimi i luftës me mjete të tjera kundër Bashkim Kosovës, të cilat do ta dërgojnë buzë rrënimin psikik)

Nëntitulli i kampionit botëror, ndonëse si sukses i madh sportiv, veçmas kur dihej se nëpër ç’rrugë kishte kaluar (pesë fitore: dy prej tyre me nokaut klasik dhe dy me nokaut teknik dhe vetëm njëra në poenë), si dhe dorëzimi i finales me arsyetime shëndetësore, në Prishtinë dhe në përgjithësi në Kosovë, do të merret fitore e jashtëzakonshme dhe historike tutje përmasave sportive madje, pse kundër saj ishte një komplot i pazakontë shtetëror (shtabi teknik i reprezentacionit – me përjashtim të seleksionuesit Bruno), ajo kishte ndarë edhe opinionin jugosllav në tri pjesë: në atë që kishin arsyetuar qëndrimin e Shtabit Teknik (kryesisht ky opinion vinte nga Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi); në atë që kishte kundërshtuar atë (kryesisht ky opinion vinte nga Kosova, Kroacia, Sllovenia dhe pjesërisht nga Vojvodina) dhe në atë që nuk deklarohesh për apo kundër, pos që kërkonte që rasti të mos politizohej (siç ndodhte me opinionin në Bosnje dhe Hercegovinë dhe një pjesë të opinionit në Vojvodinë).

Kjo megjithatë kishte pasur pasoja të drejtpërdrejta për fundin e dhunshëm të karrierës së Bashkim Kosovës, që kishte ardhur me anën e një suspendimi të paafatizuar, të shqiptuar nga Lidhja e Boksit e Jugosllavisë. Shkas për këtë kishte qenë deklarata e Bashkim Kosovës dhënë BBC-së, ku kishte theksuar se privimi nga e drejta për me luftue për titullin e kampionit botëror ishte çështje politike.

“Dikujt në Beograd i pengoi Kosova në oltarin e kampionit botëror”!

(Më gjerësisht rreth kësaj çështje shih në Pjesën e Tretë “Çfarë tha Bashkim Kosova?”, në “Lufta ime e madhe”, në faqe...)

Suspendimi i paafatizuar për Bashkim Kosovën do të thoshte fund i karrierës, meqë atij i pamundësohej edhe veprimtaria sportive në klubin “Prishtina”. Njëherësh, atij i pamundësohej që të kalonte në boks profesionist jashtë vendit, me çka mund të thuhet se këtu do të fillojë ajo që mund të quhet komplot kundër karrierës së tij sportive me pasoja të rënda për të ardhmen e tij, kur dihej se nga sukcesi i madh në Toronto, Bashkim Kosova kishte filluar me marrë oferta të ndryshme nga menaxherë të njohur botëror për me e vazhduar karrierën në boks profesionist, ku atij i parashihej një e ardhme e shkëlqyer, që mund ta çonte edhe te titulli i kampionit në kategorinë e rëndë dhe super të rëndë madje.

(Kthimi jetës private: martesë me Drita Rracin, punësimi në “Rilindje” dhe ballafaqimi me ndjekjet politike)

Në kohën e përfshirjes në një krizë të madhe shpirtërore, e cila e kërcënonte me rrënime të mëtutjeshme, Bashkim Kosovës i ndihmoi me marrë veten Drita Rraci, me të cilën u njoh gjatë seancave të para të terapisë te psikiatri doktor Afrim Bega. Ishte hera e parë që Bashkim Kosova, pas dashurisë së madhe që kishte pasur me Nora Bardhin që nga vitet e gjimnazit e deri te vdekja e saj e parakohshme në vitin 1976, përballë kishte një vajzë, e cila jo vetëm që përkujdesej që seancat e caktuara të bisedave me doktor Afrim Begën, të përcilleshin me rregullin e duhur, por që prania e saj në atë ambient të mbyllur, pastaj fjalët që ndërronte me të para dhe pas seancave rreth terminëve, si dhe lëvizjet e saj të lehta, do të bëjnë që ai nga hera në herë të ndjehet i lidhur për të dhe praninë e saj më shumë se për ato që dëgjonte në seancat psikiatrike. Kjo do t'i pëlqejë doktor Afrim Begës, që si do të shihet, u përkujdes që kjo lidhje me u ba sa më e natyrshme dhe sa më e frytshme, për me përfundue në një lidhje të përhershme. *(Më gjerësisht rreth lidhjeve me Drita Rracin dhe martesës me të shih në Pjesën e Tretë “Çfarë tha Bashkim Kosova” në kujtimet “Dashuria në kohën e shtetrrrethimit”, në faqe...)*

Një tjetër moment i rëndësishëm i rikthimit të Bashkim Kosovës kah ajo që ai do ta quajë “normalitet jetësor”, ishte punësimi në gazetën “Rilindja”, në shërbimin teknik. Kjo u bë do në sajë të përkujdesjes së redaktorit të rubrikës së sportit, Ali Bala, i cili jo vetëm që kishte përcjellë karrierën sportive të Bashkim Kosovës, por ai kishte qenë shok fëmijërie me të et, Naim Kosova dhe dinte gjithë ato nëpër të cilat kishte kaluar familja e tij, të cilat në njëfarë mënyre, por në rrethana të tjera, do ta ndjekin edhe të birin.

Me punësimin në “Rilindje” te Bashkim Kosovës, kjo gazetë ditore në gjuhën shqipe, e cila përherë kishte qenë në shënjestër të qarqeve nacionaliste dhe shoviniste të Beogradit, njëherësh kishte marrë në mbrojtje sportistin më të suksesshëm shqiptar të të gjitha kohëve, të cilit, karriera sportive do t'i ndërpritet dhunshëm çastet që ai i kishte sjellë më së shumti suksese Kosovës si dhe boksit jugosllav në arenën ndërkombëtare! *(Më gjerësisht rreth kësaj çështje shih në Pjesën e Dytë “Çfarë u tha për Bashkim Berishën?” në fejtonin “Vitet e Kampionit”, në faqe...)*

(Sëmundja e rëndë e bashkëshortes Drita Rraci, ndarja dhe përfshirja në “shtetin paralel të shqiptarëve”)

Pas marrjes së të drejtës që të merrej me boks, asnjëherë të shpallur publikisht, por që atij i ishte kthyer në realitet pas suspendimit të paafatizuar, Bashkim Kosova kishte gjetur ngushëllim në familje dhe punë. Duket se këtu ndikimin më të madh kishte pasur bashkëshortja Drita Rraci, me të cilën zyrtarisht ishte martuar pas një viti, pra në pranverën e vitit 1987, pasi lirimit nga terapia psikiatrike. Doktor Afrim Begës, i cili e kishte pasur nën mbikëqyrjen njëvjeçare psikiatrike, i kishte deklaruar “Rilindjes” se ishte e çuditshme se si Bashkim Kosova, nga gjendja e një shkallimi shpirtëror (kur e kishte marrë në trajtim), brenda një kohe të shkurtë kishte arritur një gjendje thujse të natyrshme, që mund ta kenë vetëm personat e kënaqur me familjen, profesionin dhe shoqërinë (që në ato rrethana ishin të rrallë). Me këtë rast ai kishte theksuar rolin e Drita Rracit, por kishte zënë ngojë edhe

përcaktimin e Bashkim Kosovës që, me anën e leximit dhe shkrimeve, jetës t'ia kthejë anën intelektuale, e cila deri më atëherë i kishte munguar. Madje, ai kishte kërkuar, që në përputhje me atë që ishte quajtur “terapi intelektuale”, të fillojë dhe të shkruajë rreth atyre nëpër të cilat kishte kaluar, që nga dueli i parë dhe ai i fundit, e gjitha duke u parë në përputhje edhe me zhvillimet e kohës dhe shqetësimet shoqërore dhe politike, të cilat ishin të pandashme edhe nga karriera e tij sportive, që si do të shihet kështu edhe do të ndodhë.

Por, ajo që nga doktor Afrim Bega ishte quajtur “normalitet jetësor”, Bashkim Kosovës nuk i kishte zgjatur shumë. Jo shumë kohë pasi që i lindi i biri Bekimi, nga fundi i vitit 1990, bashkëshortja Drita Rraci, papritmas hetoi një gjëndër në gjirin e djathtë. Meqë si infermiere që ishte, kishte njohur se për çfarë mund të ishte fjala, iu nënshtrua testeve të para (ekzaminimit dhe biopsisë), sipas të cilave do të vërtetohet dyshimi se fjala ishte për një karcinom, që duhej hequr sa më parë, por që më pas nevojitej edhe një hemoterapi.

Vetëm pasi i kompletoi që të gjitha analizat, Drita ia hapi çështjen Bashkimit, ani pse e kishte pasur të vështirë, meqë e dinte se ç'vuajtje i kishte sjellë atij vdekja e Nora Bardhit nga leukemia vite më parë, me të cilën nuk kishte mundur të pajtohej kurrë. Andaj, i kishte folur e qetë, thujse fjala ishte për ndonjë flamë. Ngjashëm do t'i flasë edhe doktor Afrim Bega, i cili, megjithatë do t'ia bëjë të ditur dy gjëra: domosdonë e një operacioni sa më të shpejtë dhe po ashtu domosdonë e hemoterapisë, mundësisht sa më shpejtë dhe mundësisht jashtë vendit.

Se operacioni dhe shërimi duhej të bëhej jashtë vendit, kjo ishte më se qartë, kur dihej se në Prishtinë, si dhe gjithë Kosovën, nga Klinikat e Universitetit të Prishtinës, me futjen e masave të dhunshme të Serbisë, ishin përjashtuar nga puna që të gjithë mjekët, specialistët, anesteziistët dhe personeli tjetër mjekësor shqiptar.

Njëherë kishte menduar që operacionin ta bënte në Shkup dhe kjo lidhej me mundësinë që ta kishte nën mbikëqyrje të birin dyvjeçar Valnorin. Por, kishte ndërruar mendjen nga ato që kishte pasur nga një bisedë telefonike me dajën në Zagreb, Josip Paleviq, i cili i kishte thënë se duhej të niseshin sa më parë për në Kroaci.

PJESA E DYTË

Çfarë u tha për Bashkim Kosovën?

VITET E KAMPIONIT

(Fejton i gazetës “Rilindja”, i cili filloi të botohet më 1 korrik të vitit 1990, por do të ndërpritet më 5 korrik, ditën që Qeveria Serbe e Beogradit, pas shpalljes së Deklaratës së

Pavarësisë nga deputetet e Parlamentit të Kosovës të dy korrikut, mbylli këtë gazetë bashkë me të gjitha mediumet tjera në gjuhën shqipe. Tërësia e fejtimit bashkë me disa shkrime të tjera u siguruan nga Hysen Matoshi, përgjegjës i arkivit të “Rilindjes”, i cili do ta shpëtojë atë bashkë me një pjesë të dokumentacionit të kësaj gazete nga një rrënim tjetër, ai i nëntorit të vitit 1999, me të cilin me një brutaliteti të paparë u rrënuar arkivi i kësaj gazete.)

Karriera sportive e boksierit tonë më të madh të të gjitha kohëve, Bashkim Kosova, i ngjanë asaj të Atllasit, kur fuqia e ngritjes pasqyrohet në përputhje me atë të shtypjes, që do të thotë se suksesi sfidohet nga përpjekja e të kundërtës.

Po që se çështjet shikohen nga këndvështrimi i boksit, kjo është edhe e natyrshme, sepse suksesi në “shkathtësinë fisnike” matet vetëm me humbjen e kundërshtarit, që sa më e rëndë që të jetë nxjerr në pah fuqinë e fituesit.

Kur bëhet fjalë për kampionin e madh Bashkim Kosova dhe luftën dhjetëvjeçare në ring (1976-1986), mund të thuhet se ajo mbetet e veçantë për faktin se gjuha e boksit me ligjet e saj të fitores dhe të humbjes, nuk do të vlejë për të. Sepse, Bashkim Kosova, mbetet boksieri i vetëm në botë i cili gjatë 486 dueleve (86 prej tyre ndërkombëtare) nuk do të përjetojë asnjë humbje. Madje, ky numër imponant, bëhet edhe më imponant, nëse kihet parasysh se në mbi gjysmën e tyre fitoret janë shënuar me nokaut klasik, të shumtën në raundin e parë, ndërsa pjesa tjetër kanë përfunduar me nokaut teknik. Vetëm një duel i vetëm, ai i gjysmëfinales në kampionatin botëror në Toronto me kampionin aktual botëror, Martinez nga Kuba, kishte përfunduar me vendimin e gjyqtarëve tre me dy, i cili, si do të shihet do të jetë edhe i fundit për boksierin e madh.

Kështu, në përputhje me këtë ecuri të furishme, Bashkim Kosova tetë herë radhas (1977-1984) fitoi titullin e Kampionit të Kosovës. Gjashtë herë radhas (1978-1983) fitoi titullin e kampionit të Jugosllavisë. Po ashtu pesë herë radhas (1978-1983) fitoi edhe titullin e kampionit të Jugosllavisë me ekipin “Prishtina”.

Në arenën ndërkombëtare, Bashkim Kosova, dy herë fitoi titullin e kampionit të Ballkanit (më 1978 në Sofje dhe 1979 në Athinë), dy herë fitoi atë të Kampionit të Europës (1980 në Berlinin Lindor dhe në vitin 1982 në Spanjë), ndërsa në vitin 1984 do të fitojë medaljen e artë në Olimpiadën e Los Anxhelosit.

Në vitin 1986, në Kampionatin Botëror të Boksit për Amator në Toronto të Kanadasë, arriti finalen, me çka kishte siguruar medaljen e argjendtë, por lufta për titullin e kampionit botëror nuk do t'i lejohet, ngaqë Shtabi Teknik i Reprezentacionit të Jugosllavisë (pa pëlqimin e Seleksionuesit të reprezentacionit, kroatit Bruno), do të vendosë që atë ta dorëzojë me arsyetimin se Bashkim Kosova “e kishte të lënduar dorën” dhe se “paraqitja e tij në ring rrezikonte shëndetin e tij”, ani pse dihej se Bashkim Kosova fizikisht ishte i gatshëm për sfidën e tij më të madhe të jetës – titullin e kampionit botëror.

Por, para se të vijë deri te zenit i karrierës së kampionit tonë të madh, vlen të theksohet se ajo që më parë paralajmëronte se do të ishte e tillë. Shenjat do të vinë qysh nga mosha dymbëdhjetë vjeçare, kur do të regjistrohet në shkollën e talenteve të rinj në Zagreb në vitin 1968.

Atëbotë, Bashkimi edhe më tutje ndodhej nën përkujdesjen e Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe shpresohet se ai do të shkojë gjurmëve të të et, pra që të mbetet në Armatë.

Fotoja e të et me rrobat e pilotit, të cilën e mbante përherë pranë, përherë do t'ia nxisë kureshtjen për fluturimin dhe lartësitë si diçka të veçanta, që joshin çdo njeri, por do të jetë boksi dhe ringu ajo që do ta fascinojë. Ëndrra për të mbizotëruar ringun do të jetë më e fuqishme se prirjet tjera. Asaj do t'i jepet me mish e me shpirt çastin që do të shohë boksierin amerikan, Kasius Klej (më vonë Muhamed Ali) në duelet e tij të famshme me Xhoe Frejzerin për titullin e kampionit botëror, kur i madh e i vogël do të mrekullohen me ato që do të tregojë boksieri i ri me lëvizjet e një valltarit të përkryer të ndërlidhura me gjuajtjet herë me të majtën e herë me të djathtën që shprehin më tepër përparësinë e shkathhtësisë fisnike se sa fuqinë e rrënimin. I tillë do të bëhem një ditë, do t'i ketë thënë Bashkimi vetit dhe të njëjtat pa ndonjë hezitim do t'ia thotë edhe trajnerit, i cili duke e ledhatuar i kishte thënë se ata që kanë vullnetin për fuqi mund t'i arrijnë majat. Një ditë kam me u ba kampion, ia kishte kthyer Bashkimi me bindjen se kjo edhe do të ndodhte.

Nga ajo kohë e tutje, Bashkim Kosova do të ketë përpara vetëm ëndrrën e kampionit. Ajo, madje, do të jetë aq dominuese, saqë do t'i përjashtojë të tjerat. Këtë do t'ia thotë edhe xhaxhait Arsimit me rastin e takimit të parë në Zagreb, kur ai do priste që i nipi t'i fliste për planet e ardhmërisë. Me boksue, i kishte thënë xhaxhai, është një aktivitet i mirë sportiv, por kjo nuk do të thotë që të lesh prapa shkollën dhe studimet. Mirëpo, Bashkimi i kishte thënë se boksi për të shfaqej mbi të gjitha.

Kur do të kthehet në Prishtinë, boksingun do ta sjellë me vete. Pa ia nisur mësimet në Gjimnazin "Ivo Lolla Ribar" të Prishtinës, Bashkim Kosova regjistrohet në shkollën e boksit të klubit "Prishtina". Njohuritë e fituara në Zagreb si dhe aftësitë që kishte treguar, bënë që pas pak, të bartet nga ekipi i pionierëve në atë të juniorëve.

Sukseset e pandalshme të Bashkim Kosovës nga ai fituesit të turnirit të juniorëve të Kosovës në qershor të vitit 1972 e deri te kampioni olimpik, që do ta fitojë dymbëdhjetë vite më vonë në Los Anxhelos, pasqyrojnë një vullnet të jashtëzakonshëm për të arritur sa më shumë, që mund ta ketë vetëm ai që ka mentalitetin e fitimtarit.

Dhe, Bashkim Kosova, kishte bindjen e fitimtarit të paepur dhe të përhershëm. Këtë madje ia kishte thënë trajnerit të klubit "Prishtina" Lis Manit me rastin e dorëzimit të kupës së fituesit të turnit të parë të juniorëve të Kosovës, kur ai i kishte dëshiruar edhe shumë e shumë fitore. Për mua vlen vetëm fitorja, ia kishte kthyer ai. Tjetër nuk njoh... Për këtë do të bindeni.

Pas një viti, Lis Mani do të jetë ai që Bashkim Kosovën do ta bartë nga ekipi i juniorëve në atë të parin. Gjatë sezonit vjeshtor e mbajti pranë e pranë, që të mësohet me atmosferën e fitoreve, të cilat "Prishtina" kishte filluar t'i demonstronte në Ligën e Parë, ndërsa në sezonin pranveror, me anën e lejes mjekësore, Bashkimin do ta radhisë në përbërjen e gjerë të ekipit të parë.

Aftësia e tij fizike dhe gatishmëria psikike (në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare kishte lartësinë prej 1,75 cm. dhe peshën 75 kilogram) bënë që ai të fillojë në kategorinë e mesme, prej nga një vit më vonë, në saje të peshës së shtuar dhe shtatit të hedhur, do të kalojë në atë gjysmë të rëndë, ku do të mbesë përherë.

Kështu, duelin e parë në kuadër të ekipit "Prishtina", Bashkim Kosova, do ta ketë më 29 qershor të vitit 1974 në Prishtinë kur u ballafaqua me kampionin e trefishtë të Jugosllavisë, Todoroviq nga "Radnički" i Nishit. Meqë klubi "Prishtina" e kishte siguruar titullin e kampionit të Jugosllavisë, shfaqja e talentit të ri në ring ishte paraparë më shumë si

pjesë e përrurimit të boksierëve të rinj, të cilët po bëheshin gati të merrnin përgjegjësinë nga boksierët me renome, të cilët, me mund të madh, në ringjet jugosllave ia kishin dalë që të dëshmonin se “Prishtina” tashmë ishte e gatshme të dominonte ringjet jugosllave, pa marrë parasysh sfidat me të cilat ballafaqohej, që kjo të mos i lejohej. Trajneri Lis Mani, i cili kishte besim të madh te Bashkim Kosova dhe aftësitë e tij, kur kishte vendosur që ai të debutojë me kamionin e trefishtë të Jugosllavisë kishte parasysh pikërisht përkushtimin dhe vullnetin e madh të Bashkimit që në luftën e parë ta ketë përballë një kampion.

Kampion bëhesh vetëm duke mposhtur kampionet, i kishte thënë trajnerit, kur po futej në ring.

Kështu, atë ditë të nxehtë qershori, në Pallatin e Sporteve të Vogla pranë kinemasë “Rinia”, rreth pesë mijë shikues, të cilët gjatë gjithë kohës kishin kremtuar titullin e kampionit të Jugosllavisë, pritnin me padurim shfaqjen e Bashkim Kosovës në ring. Këtë prisnin edhe mediet e vendit dhe ato jugosllave, veçmas ato serbe nga Beogradi, të cilat paralajmërimin nga Prishtina që kampioni jugosllav Todoroviq të ketë për kundërshtar një boksier që për herë të parë shfaqet në ring, e kishin quajtur si ngacmim, por edhe provokim madje, që mund të kishte pasoja për vetë boksierin e vendës, nga shkak se kampioni jugosllav, i njohur për të djathtën e tij tepër të fortë, me të cilën ai shumë kundërshtar i kishte hedhë poshtë para kohe, duke mos lejuar që të humbë autoritetin, mund të kundërpërgjigjet me “masa radikale”, pra me një të rënë të fortë, gjë që për shtypin beogradas kjo paraqiste rrezikim me qëllim të një të riu, i cili mund të mbetej përherë i shtrirë poshtë.

Bashkim Kosova nuk kishte çarë gjithaq kokën për këto kërcënime. Televizionit të Beogradit i kishte thënë se “kamponi jugosllav, në Prishtinë, ka me e pa fuqinë e të djathtës së Kosovës”.

Dhe kështu kishte ndodhur. Në raundin e parë, i bartur nga duartrokitjet dhe përkrahjet frenetike të mijëra shikuesve, kishte filluar ta sulmojë boksierin jugosllav, i cili në mënyrë provokuese mbante gardin e hapur, duke u mbajtur të djathtën të gatshme për gjuajtje. Por, grushtimet e të majtës së Bashkim Kosovës, që pareshtur gjenin kokën e kampionit jugosllav, nga fundi i raundit ua lëshuan vendin dy të rënave me të djathtën në kokë, të cilat do ta tronditin së tepërmi atë, që po mos të ishte gongu gjyqtari do të duhej t’i numëronte. Gjatë pushimi të shkurtër trajneri Lis Mani, i befasuar edhe vetë për atë që po ndodhte në ring, boksierit të ri i sugjeroi të vazhdonte siç e kishte filluar, por pa harruar kujdesin ngaqë hapjes së tepërt mund t’i paguante haraç të madh.

Më vonë trajneri Mani, do të pranojë se kjo kishte qenë një aventurë e rrezikshme, që ka mundur t’i kushtojë shtrenjtë boksierit të ri, mbase edhe me përhëndetje nga ringu, pa u futur mirë në të, por ishte besimi i madh në fuqinë e tij si dhe dëshira që dueli i parë i tij në ring njëherësh të paraqesë një ballafaqim të suksesshëm me kamionin e Jugosllavisë, ato që do t’ia marrin arsyen.

Në të vërtetë, në raundin e dytë Bashkim Kosovës iu deshën vetëm njëzet sekonda që me dy direkte me të majtën t’ia hapë gardin kampionit jugosllav dhe me një të rënë me të djathtën ta plandos atë. Ishte ky nokaut klasik, por që gjyqtari në ring, do ta pengojë (pra nuk do t’i numërojë) të pranohet si i tillë, me ndërprerjen e luftës gjoja me arsyetimin se Todoroviqit i kishte pëlçitur arkada.

Edhe pse në protokollin zyrtar të ndeshjes, treshja referuese, humbjen e kampionit me nokaut klasik do ta fshehë me anën e formulimit “ndërprerje për shkaqe shëndetësore”, me

çka, së paku para opinionit, mund “t’i mbrohej nderi” kamionit jugosllav, megjithatë, shtypi i Beogradit, nuk do ta fshehë habinë dhe dëshpërimin që Todoreviq të gjunjëzohet në Prishtinë para një “adoleshenti”. Dhe në vend se kjo të kremtohet si një fitore sportive, që ka të bëjë me ardhjen e një kamioni të ri, tepër premtues, siç ishte Bashkim Kosova, gazeta “Veçernje Novosti” e Beogradit (që kishte tirazhin më të madh në jugosllavi dhe, nga fillimi i viteve të tetëdhjeta e tutje, do të jetë e njohur për kursin nacionalist serb), do të mundohet që t’i hapë të çarat e para midis tij dhe dashamirëve të shumtë që e kremtonin në Kosovë dhe gjetiu duke e quajtur “boshnjak me përcaktim jugosllav”. Me këtë rast do të theksohet vendlindja e tij Bileqe (Bosnje dhe Hercegovinë), e ëma kroate si dhe i ati, pilot i Armatës Popullore të Jugosllavisë, të cilët mbaheshin si jugosllavë.

Nga kjo gazetë, nofka e “jugosllavit”, gjithnjë në funksion të shkëputjes nga Kosova dhe përcaktimi i tij kombëtar si shqiptar, Bashkim Kosovës nuk do t’i ndahet edhe atëherë kur në Sofje, në vitin 1978, fitoi titullin e parë të kampionit të Ballkanit në kategorinë gjysmë të rëndë dhe, para kamerave të BBC-së deklaroi se ishte shqiptar nga Kosova, gjë që, si do të shihet, vite më vonë (pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 e tutje) shtypit të Beogradit, veçmas “Politikës” dhe “Ekspres politikës”, kjo do t’i shërbejë që ta padisë për “nxitës të kundërrevolucionit në Kosovë”, me çka do të kërkohet që të mos i lejohet shkuarja në Lojërat Olimpikë të Los Anxhelosit në vitin 1984 dhe Kampionatin Botëror të Boksit Amator në Toronto të Kanadasë në vitin 1986.

Se fitorja ndaj kampionit të dyfishtë jugosllav Todoroviqit, nuk ishte as e rastit e as, siç shkruante ato ditë gazeta në gjuhën serbokroate “Jedinstvo” e Prishtinës, “fryt i lëndimit të kundërshtarit”, këtë do ta dëshmojë Bashkim Kosova, nga vjeshta e vitit 1975 e tutje, që pas qëndrimi njëvjeçar në Beograd, (kur edhe do të përfundojë perkujdesja nga Armata Popullore e Jugosllavisë, të cilën ai e gëzonte si fëmijë jetim deri në moshën madhore), do të paraqitet në formacionin e parë të klubit “Prishtina”.

Por, para se të arrijë në arenën ndërkombëtare të boksit, ku do të fitojë pesë medalje të arta (dy ballkanike, dy europiane dhe atë të Kampionit Olimpik), Bashkim Kosova kishte përpara pengesën e ringut jugosllav. Kjo dukej e pakalueshme, pse në kategorinë e tij, aktualisht ndodhej boksieri Marjan Benesh, nga ekipi “Borac” i Banjallukës, kampion aktual jugosllav, kampion i dyfishtë i Ballkanit dhe pretendent kryesor për titullin e kampionit të Evropës, që atë vit mbahej në Bukuresht.

Duke parë se fjala ishte për një kampion të ri, i cili nuk kishte të ndalë (meqë gjashtë duelet e deriatëhershme të sezonit vjeshtor i kishte fituar me nokaut klasik), trajneri i “Boracit” të Banjallukës, do t’i ikë duelit me Bashkim Kosovën, duke e “zbritur” Beneshin në një kategori më poshtë, pra në atë të mesme, me arsyetimin se kjo bëhej për “shkaqe taktike”, ndërkohë luftën në kategorinë gjysmë të rëndë, do ta dorëzojë po ashtu nga shkaqe shëndetësore me arsyetimin se boksieri Marjanoviç ishte i lënduar.

Ky “mashtim” taktik, megjithatë nuk do ta shpëtojë Marjan Beneshin nga kryqëzimi i dorëzave me Bashkim Kosovën, në pranverën e ardhshme, kur klubi “Prishtina” duhej të shkonte në Banjallukë për të zhvilluar ndeshjen me “Boracin”, të vlefshme për kampionin e Jugosllavisë, ku fitorja prishtinasit, për herë të parë, i mbante në luftë për titullin e kampionit të Jugosllavisë, i cili atë vit zhvillohej në një rivalitet të madh me ekipin “Beograd” të Beogradit.

Kështu, më 22 maj të vitit 1976, erdhi deri te dueli me Marjan Beneshin, kampioni i dyfishtë ballkanik, i shpallur favorit edhe për titullin e kampionit europian, pas dy muajsh, në Bukuresht, me synimin që sukseset e tij të vazhdonin edhe në olimpiadën e Moskës, të vitit 1980.

Duelit me Marjan Beneshin do i paraprinë një mori “këshillash miqësore” se si duhej shmangur nokauti klasik që në raundin e parë, të cilat Bashkim Kosovës i vinin nga shtypi i Beogradit, ku më e shpeshta ishte ajo e dorëzimit pa dalë në ring, ose e hedhjes së peshqirit nga ana e trajnerit, sapo të fillojë dueli.

Sidoqoftë, Bashkim Kosovës, nuk i bënë përshtypje as “këshillat” e as kërcënimet që merrte nga Beogradi. Radio Televizionit të Beogradit i deklaroi, që të kishin durim deri sa të përfundonte dueli, ndërsa Televizionit të Sarajevës, (i cili transmetonte drejtpërdrejtë duelin për rrjetin televiziv jugosllav), dhe si me “miklim” do ta quajë “boshnjak” (pse kishte lindur në Bileqe), do t’i deklarojë se nuk njihte autoritet në ring, pos atë të unit të vet, që ishte mbi të tjerët.

Se nuk njihte autoritet në ring, kjo do të shihet që nga çastet e para të duelit me Marjan Beneshin, kur Bashkim Kosova do t’i vërsulet atij dhe, qysh në fillim, e detyroi të kërkonte shpëtim nga “klinqi”. I pamësuar me diçka të tillë, Beneshi do t’u kthehet bërrylave dhe kokës madje, që të lirohet nga ofensiva e paparë e kundërshtarit. Kjo solli para një heshtje thujse mortore hallën e madhe të sporteve të mbushur përplot me mbi shtatë mijë shikues, të cilët, të mësuar me fitoret e shpejta të boksierit të tyre (të shumtën me nokaut klasik), nuk po u besonin syve. Që t’i ndihmojë Beneshit ta marrë veten “nga ajo e papritur” në skenë doli gjyqtari në ring, Trajkoviq nga Serbia, i cili disa herë ndërpreu ofensivën e boksierit nga Prishtina gjoja nga shkakut i boksit të papastër që bënte edhe ai, ani pse ishte kundërshtari i tij, që këtë e bënte (duke hyrë në klinq dhe duke përdorur bërrylat).

Sidoqoftë, gongu i përfundimit të raundit të parë, e kishte shpëtuar boksierin vendës nga më e keqja, ndërsa publikun e kishte liruar paksa nga gjendja e shokut në të cilin kishte rënë. Trajneri vendës, Lubojeviq, dhe shtabi teknik përreth, po bënë përprjekje të mëdha që Beneshit t’ia kthenin vetëbesimin. Madje, në ato rrethana ankthi, do të jetë banda frymore e simpatizuesve, që sipas urdhrit të dikujt nga nikoqiri, përpique të ringjallë atmosferën, me çka ndikoi për pak që shikuesit të ringjallën. Por, ishin prapë sulmet e furishme të Bashkim Kosovës drejt Beneshit, që publikut serish ia kthyen heshtjen. Edhe pse dukej se me dy-tri kontra të shpejta, boksieri vendës, po lirohej nga trysnia e madhe e boksierit nga Prishtina dhe, madje mund të rikthehej në lojë me marifetet e tij të njohura, e djathta e Bashkim Kosovës, në këtë hapje e sipër, kishte bërë që me një të qëlluar në kokë, ta hedhë Beneshin në dysheme. Ishte hera e parë që kampioni jugosllav dhe ballkanik dhe idhulli i gjithë Jugosllavisë, përjetonte diç të tillë, që për shumëkund ishte e pa besueshme dhe e paparashikueshme, së paku në ringjet jugosllave. Gjyqtari në ring Trajkoviq, nuk i mbetej tjetër pos që t’i numëronte boksierit vendës, ndërkohë që Bashkim Kosova, ishte tërhequr në këndin e tij dhe priste që ta vazhdonte luftën, nëse për këtë do të kishte nevojë. Më shumë i ndihmuar nga referoi se sa që do ta marrë veten, Beneshi, i cili ishte më se e qartë se gjendej në grogi, do të ngrihet. Me mjegullën para syve dhe çirrjet hysterike të publikut “*Ubij shiftara!*” (Vrite shiftarin), sulet drejt Bashkim Kosovës me kokë dhe trup, gjë që në atë gjendje, nuk do ta qëllojë, por do të bëjë përprjekje që t’i ikte luftës përderisa gjyqtari në ring ta ndërpresë këtë sjellje josp sportive. Por, për të qenë e keqja më e madhe, gjyqtari Trajkoviq,

jo vetëm që këtë nuk po e bënte, por përpjekjet e boksierit nga Prishtina me e largue Beneshin nga lufta e papastër (vërsuljet me trup dhe kokë), do t'i ndëshkojë me një vërejtje të hapur publike, që mund t'i kushtonte, po qe se çështja do të shkonte te njehsimi i pikëve, ose që të diskualifikohej, nëse do t'i jepej edhe një tjetër, gjë që mund ta humbte duelin. I përballur me mundësinë që t'i merrej fitorja në atë mënyrë, Bashkim Kosova, pasi që ta ketë vjedhur me vështrim trajnerin Lis Mani dhe të ketë kapur shenjën e tij me vazhdue ku kishte mbetur, pra me e qëllue me sa fuqi kishte, me dy të rëna, me të majtën dhe me një të qëlluar të rrufeshme me të djathtë në pleksus, për të dytën herë e plandosi Beneshin në dysheme. Këtë herë nuk kishte më shpëtim për të. Por, në skenë doli trajneri vendës, Lubojeviq, që e hodhi peshqirin para se gjyqtari të fillojë numërimin. Ishte ky një dorëzim, para se të pranohet gjendja e nokautit klasik, por që në protokollin e ndeshjes do të shënohet si “ndërprerje për shkaqe shëndetësore” (plasje e arkadës).

Në këtë mënyrë, gjyqtarët, ekipi vendës dhe gjithë ata që Marjan Beneshin dëshironin të shihnin kampion të të gjitha kohëve dhe të të gjitha ringjeve, zyrtarisht ia kishin mbrojtur nderin boksierit të tyre, por këtë nuk kishin mundur ta bënin as para dhjetë mijë shikuesve, që ishin të pranishëm në atë duel, e as para atyre qindra mijëra shikuesve të cilët kishin ndjekur duelin nga transmetimi i drejtpërdrejtë që kishte bërë Radio Televizioni i Sarajevës për rrjetin jugosllav dhe kishin parë lindjen e një kampioni tjetër, njëzetvjeçarit nga Prishtina me emrin *Bashkim* dhe mbiemrin *Kosova*.

Lindjen e kampionit të ardhshëm Bashkim Kosova, një pjesë e opinionit të Jugosllavisë (në Serbi, Maqedoni dhe në Bosnje dhe Hercegovinë), sikur nuk e shihte me sy të mirë, fillimisht pse ajo lidhej me rrënimin e “fronit” të Marjan Beneshit dhe, më vonë edhe me klimën politike (veçmas pas vitit 1981), ku sukseset e shqiptarëve, qofshin edhe të natyrës sportive, shiheshin si “trimërim i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”.

Por, fitorja e Bashkim Kosovës në Banjallukë ndaj Marjan Beneshit, edhe pse e dhimbshme për shumëkënd, nuk do të ndikojë që kampioni jugosllav të zbresë nga maja ku qëndronte dhe duhej të mbahej me çdo kusht, përkundër paralajmërimit të qartë që i kishte ardhur nga Prishtina dhe të vërtetës së në ring kurora i takonte fituesit. Sikur të mos kishte ndodhur gjë, Lidhja e Boksit e Jugosllavisë, menjëherë pas humbjes së tij në Banjallukë, Marjan Beneshin do ta emërojë për në Kampionatin European të Boksit, i cili mbahej në korrik të atij viti në Bukuresht. “Sporti” i Beogradit edhe më tutje Beneshin do ta quajë “të pamposhtur”, ndonëse ishte po ajo gazetë që me rastin e humbjes së tij në Banjallukë nga Bashkim Kosova, ishte e vetmja që këtë e kishte pranuar, por që në komentin e saj kishte kritikuar ashpër trajnerin e “Boracit” pse kishte lejuar një duel të tillë, kur diheshin sukseset e boksierit nga Prishtina dhe veçmas, kur diheshin edhe pretendimet e boksit kosovar, për t'u dëshmuar kundër kampionëve të merituar jugosllavë.

Bashkim Kosovës e as trajnerit të tij Lis Mani nuk u kishin bërë gjithaq përshtypje ato që shkruante shtypi jugosllav në mbrojtje të Beneshit, qoftë edhe me mjete josportive, e as që ia vunë veshin anashkalimit të boksierëve të Prishtinës nga reprezentacioni i Jugosllavisë në Kampionatin European të Bukureshtit. Ç'është e vërteta, Lis Mani, i pyetur se çfarë vlerësimi kishte për mospërfshirjen e boksierëve të tij në reprezentacionin shtetëror, kur shumë prej tyre këtë e meritonin në saje të sukseseve në ring, me ato që kishte thënë se më mirë ndjehej kur i shtrohej pyetja pse nuk janë aty se sa po t'i thuhej pse janë, kishte ironizuar paksa. Por, ai kishte qenë i bindur se në një të ardhme të afërt, në reprezentacionin e

Jugosllavisë do të gjejnë vend edhe boksierët nga Kosova, meqë logjika e sportit, por jo vetëm e sportit, pranon fituesit dhe jo humbësit.

“Ndodh që dikush të nominohet për reprezentacion në saje të mbështetësve, pra me mjete josportive, por kjo nuk ia siguron titullin e kampionit”

Se kishte të drejtë kur fliste kështu, këtë do ta dëshmojë me të shpejtë edhe debakli i reprezentacionit të Jugosllavisë në Kampionatin European në Bukuresht, kur nga dhjetë boksierët shtatë do të eliminohen raundin e parë të garës. Ndër tre që kaluan në raundin e dytë ishte edhe Beneshi, që fitoi me mund të madh ndaj boksierit grek, por në gjiron e dytë, edhe ai, bashkë me të tjerët eliminohet. Marjan Beneshi, aq shumë i favorizuar nga shtypi jugosllav, veçmas ai i Beogradit, humbi në duel me kampionin gjermanolindor Myller me nokaut teknik në raundin e dytë.

Edhe kjo humbje sy botës, si ajo me Bashkim Kosovën muaj më parë në Banjallukë, do të bëhet përpjekje të paraqitet si “ndërprerje për shkaqe shëndetësore” (nga pëlçitja e arkadës), ani pse gjyqtari në ring kishte qenë i detyruar ta ndërpriste atë pas një pushimi në kënd me anën e numërimi, nga shkakut se boksieri jugosllav nga të rënat e marra, pa përqendrim të qartë, mezi rrinte në këmbë.

Në ato rrethana të debaklit thuajse të paraparë të boksit jugosllav në një manifestim të madh ndërkombëtar, kishte qenë vetëm “Danasi” i Zagrebit, që kishte shtruar pyetjen se pse nuk ishin marrë në reprezentacion boksierët nga Prishtina, veçmas Bashkim Kosova, i cili, sipas kësaj gazete, Beneshit ia kishte treguar vendin (dyshe-menë) dhe jo fanellën e reprezentacionit.

“Të tillët, po mundohen që edhe humbjen e rëndë të Beneshit në Bukuresht ta paraqesin si “eliminim nga lëndimi”, në vend se ta shohin ashtu si ishte edhe në duel me Bashkim Kosovën – fillim i fundit të një kampioni, që është e natyrshme se duhet t’ia lëshojë rrugën një tjetri, që po vjen, dhe për fat të mirë të boksit tonë, ai do të shkëlqejë për shumë kohë.”

Duket se në Beograd kritika e “Danasi” dhe ato që do të fillojnë të shfaqen si shushuritje në shtypin e vendit rreth përditimit të kohës së Beneshit, por edhe të injorimit të boksierëve nga Kosova, nuk do të çojnë gjithaq kandar. Sikur të kërkohej të ndalej koha për inatë të një zhvillimi të natyrshëm por edhe të pashmangshëm, që lidhej me një tjetër, siç ishte Bashkim Kosova, Beneshi edhe më tutje përcillej me nofkën “kampion i madh”, të cilit serish do t’i parashihet medalja e artë në Lojërat e ardhshme Olimpikë, që do të mbahen në Moskë në vitin 1980. Madje, gjithnjë sipas shtabit të reprezentacionit të Jugosllavisë, Seleksionuesi i reprezentacionit shtetëror, në bashkëpunim me klubin “Borac” nga Banjalluka, gjithë konceptin duhej t’ia nënshtronin triumfit të Beneshit në Moskë, me çka atij do t’i caktohet tretman i veçantë në të gjitha aspektet. “Politika” e Beogradit, gjithnjë duke aluduar te takimet e mundshme të Beneshit me Bashkim Kosovën, haptas doli me qëndrimin se nuk duhet lejuar assesit që kampioni i madh të sfidohet nga kundërshtarë të papërshtatshëm, hakmarrës. Që të mbrohet kampioni nga të tillët, duhet përdorur duelet seleksionuese, vlerësonte kjo gazetë, e cila, kur kërkonte mbrojtjen me çdo kusht “të autoriteteve”, motivet sportive kishte filluar t’i zëvendësojë me ato jo sportive që nuk mund të ishin tjera pos politike, që nuk do të vonojnë dhe, si kudo, do të dalin sheshas edhe në sport.

Sidoqoftë, do të jetë trysnia e madhe e opinionit të vendit dhe sukseset e njëpasnjëshme të boksierit nga Prishtina, Bashkim Kosova, që do ta detyrojnë ekipin e Banjallukës, që të mos i shmangët më tutje duelit me Bashkim Kosovën, siç kishte bërë gjatë sezonit vjeshtor, kur në gjiron e gjashtë, përkundër paralajmërimeve bombastike se Bashkim Kosovës do t'i tregohet vendi, Beneshi nuk do të udhëtojë fare në Prishtinë. Klubi kishte përmendur “arsyet taktike”, por ishte më se e qartë se Banjalluka kishte filluar t'i përmbahej strategjisë së “Politikës” së Beogradit që të mos lejohej që kampioni i Jugosllavisë të rrënohej në Kosovë, meqë kjo do të paraqiste më shumë se disfatë sportive.

Por, këtë herë, ikja e dytë e Beneshit nga dueli me Bashkim Kosovën para publikut të vet, jo vetëm që nuk do ta mbronte, siç thoshte gazeta e Beogradit, por do ta rrëronte autoritetin e tij. Madje, edhe propozimi që ai të zbriste në peshë për pesë kilogram (nga kategoria gjysmë e rëndë në atë të mesme), krahas humbjes së autoritetit e ballafaqonte edhe me rrezikun e një humbjeje tjetër, të cilën mund ta pësonte nga boksieri tjetër i “Prishtinës” në këtë kategori, Lik Shema, i cili, ishte i pamposhtur në këtë kategori dhe, madje, nga vetë shtypi i Beogradit, ishte përmendur si kandidat i mundshëm për reprezentacionin e Jugosllavisë.

Në këtë poker, Marjan Benesh kishte vendosur t'i kryqëzojë dorëzat me Bashkim Kosovën. Paralajmërimin e bëri në një intervistë me Televizionin e Beogradit, duke thënë se nuk ishte i sigurt sa sekonda do t'i duheshin që t'i qërojë njëherë e mirë hesapet me boksierin nga Prishtina, por tekstualisht kishte thënë:

“Kosova do të përjetojë aso debakli, që do ta mbajë përherë të shtrirë”!

Kërcënimeve të Beneshit, Bashkim Kosova nuk do t'u përgjigjet me të njëjtën gjuhë. Përkundrazi, shfaqej i matur kur thoshte se ringu është ai që nxjerr fitues dhe humbës. Aty nuk ndihmojnë fjalët, por takati... Pyetjes se a kishte mundësi që dueli të përfundonte pa fitues, pra baras, do t'i përgjigjet se kjo përjashtohej, meqë ai njihte vetëm fitoren dhe asgjë tjetër.

Duket se çështja e duelit pa fitues, kishte qenë pjesë e atyre hesapeve, që dy boksierët të vazhdonin sukseset e mëtutjeshme pa ia zënë rrugën njëri-tjetrit, në mënyrë që Beneshit t'i krijoheshin që të gjitha rrethanat për olimpiadën e Moskës, ndërsa boksierit të Prishtinës, po qe se do të vazhdonte ashtu siç ia kishte nisur, t'i lejohej ringu ballkanik dhe ai european, meqë Beneshi që të dy këta tituj i kishte fituar, pa marrë parasysh se në kampionatin e kaluar european nuk ia kishte dalë ta mbronte titullin.

Edhe pse ky hesap kishte filluar të fitonte në kandar, madje edhe në radhën e disa anëtarëve të klubit të Prishtinës, që këtë e merrnin për sukses, Bashkim Kosova kishte për qëllim fitoren e dytë ndaj Beneshit, pa qarë kokën se cila do të ishte rruga e depërtimit në arenën ndërkombëtare, së cilës përfundimisht i hapeshin dyert pas epilogut të luftës në Banjallukë.

Me këtë përkushtim Bashkim Kosova për të dytën herë u gjend në ringun e Banjallukës përballë Marjan Beneshit. Ishte prapë muaji maj, dhe ishte serish ai publik i ndezur, i tëri i mbërthyer në pritje dhe kërkim të fitores, që kaherë kishte kaluar përmasat e sjelljeve sportive. Sepse, fanatizmi i fitores, që kërkohet me çdo kusht, lidhet me kërkesën për shkatërrimin e kundërshtarit, ku çirret lemëritëse si ato: “*Rushi Kosovu!*” (Rrëno Kosovën!) dhe “*Ubij shiftara!*” (Vrite shiftarin), krijonin kërcënim të drejtpërdrejtë jo vetëm për boksierin e ri Bashkim Kosova, por edhe për ekipin mysafir, në rrethanat kur masa e

përndezur mund të harbohej e t'u sulej. Andaj, ky ndërsim fanatik i masës dhe kërcënimet e saj ishin pjesë e një trysnie të jashtëzakonshme me të gjitha mjetet, me të cilën së pari duhej të arrihej që në kategorinë gjysmë të rëndë të ruhej “mbreti Benesh”, dhe pastaj, të pengohej edhe klubi “Prishtina” në Banja Llukë, ngaqë fitorja “Prishtinës” ia hapte rrugën drejt titullit të parë shtetëror. Madje, as barazimi “Prishtinës” nuk i ndihmonte, meqë ekipi i Beogradit “OBK Beograd” ruante epërsinë prej tri pikësh, të cilat i mundësonin ruajtjen e vendit të parë, edhe po qe se beogradasit në Prishtinë, pas dy javësh, do ta humbnin duelin. Meqë, “Prishtina” nga kategoria velter e deri te ajo super e rëndë, kishte boksierë më të mirë, dhe realisht, pos Marjan Beneshit, i cili edhe më tutje, me anën e marifeteve të gjyqtarëve, mund të arrinte fitore, ose barazim, vendësit ishin përqendruar te kategoritë e lehta, ku ata kishin përparësi dhe bënin hesap katër apo pesë fitore, gjë që duelit i jepte një kah të paparashikueshëm. Andaj, jo rastësisht publiku ishte përqendruar që të ndikojë që terezia midis “pikëve nga kategoritë e lehta”, që ishte në anën e vendësve dhe “pikëve nga kategoritë e rënda”, që ishte në anën e mysafirëve nga Prishtina, të marrë anën e vendësve. Se kjo ishte një strategji e suksesshme, do të tregohet në tri duelet e para, kur boksierët vendës, të mbështetur nga furia e jashtëzakonshme e publiku do t'ia dalin që të shënojë tri fitore radhas, kështu që atyre u duhej edhe fitorja në velter, në mënyrë që të krijojnë parakushtet edhe për fitore, pa marrë parasysh se çfarë do të bënte Marjan Beneshi, i cili në rast se ekipi vendës do të siguronte edhe fitoren e pestë, në duelin e kategorisë së mesme, atëherë mund të tërhiqej fare “për arsye shëndetësore”.

Këtë spekulim megjithatë e pengoi boksieri i ri i Prishtinës Metë Begu, i cili ishte aq superior në duel me boksierin vendës Karaxhiq, saqë as gjyqtari në ring, e as ata anësorët nuk ishin në gjendje që t'i ndihmojnë. Kështu që, kjo fitore, e cila kishte filluar që duelit t'ia jepte kthesën e pritur, doemos do ta nxjerrë në pah rëndësinë e Beneshit për epilogun e ndeshjes, sepse humbja e tij njëherësh do të thoshte humbje e vendësve, me të cilën ekipi “Prishtina” fitonte gjasat e mira edhe për titullin e parë të kampionit të shtetit, me çka përfundimisht legjitimohej fuqia e saj në përmasa jugosllave, të cilën nuk e donte kush.

Por, dueli në kategorinë e mesme ishte ai që nxori në pah gjithë dramatikën e kësaj ndeshje, ku u pa qartë se gjyqtarët do të jenë ata të cilët “Prishtinës” nuk do t'ia lejojnë fitoren. Kështu, në kategorinë e mesme, boksierit të talentuar Likë Shema, edhe pse ishte më i mirë se boksieri vendës, Markoviq (do ta hedhë në dysheme në raundin e parë), do t'i jepen dy vërejtje publike dhe, në raundin e tretë, me vërejtjen e tretë, do të diskualifikohet!

Ky vendim skandaloz elektrizoi atmosferën midis publikut edhe ashtu të ndezur, dhe mysafirëve, pasi që shtabi teknik i “Prishtinës” do të ankohet dhe do të protestojë haptas. Publiku, pos çirrjeve shfrenuese “*Rushite Kosovul!*” (Rrënoni Kosovën) dhe “*Ubijte shiftare*” (Vrisni shiftarët), filloi të gjuajë ekipin mysafir me çmos, pa përjashtuar edhe karriget, kështu që do të duhej edhe ndërhyrja e organeve të rendit, që dueli të mos ndërpritej, ngaqë “Prishtina”, sipas rregullave, do ta fitonte atë në tavolinën e gjelbër.

Në këtë atmosferë, kur kryesia e ekipit të Prishtinës po mendonte që të largohej nga dueli, Bashkim Kosova duhej të dilte në ring. Lis Mani ishte ai që hapi muhabetin që Bashkimi të mos dilte në ring. Këtë e bënte nga druajtja se në atë çmendi, boksierin duhej ta mbronte me çdo kusht, ngaqë ashtu siç shkonin punët, ai nuk mund të fitonte. Por, Bashkim Kosova nuk pranoi. Në ring kam punë me kundërshtarin dhe jo me publikun.

Lis Mani, nuk i mbetej tjetër, pos që djaloshit t'i uronte fat, ndërkohë që nga brenda po pushtohej nga një frikë e jashtëzakonshme. Mendja i shkonte te peshqiri, të cilin mund ta hidhte në ring, si masë të fundit të mbrojtjes së boksierit të vet.

Dalja në ring e Marjan Beneshit i ngjante një shpërthimit të një uragani. Bashkim Kosova nuk kishte përjetuar diçka të tillë dhe as që ia kishte marrë mendja se një ndeshje sportive mund të ngërthente në vete emocione dhe urrejtje, një gjendje shpirtërore të një transi kolektiv, së cilës do t'i mjaftonte një xixë e vogël që të kthehej në një përndezeje shfrenues ndër më të paparashikuarat.

Dhe është e habitshme si Bashkim Kosova anashkaloi gjithë atë zallahi kërcënuese që e rrethonte nga të katër anët e ringut bashkë me thirrjet për hakmarrjen, të cilat shkonin deri në dëlir, ndërkohë që para po i shfaqej Beneshi me një buzëqeshje të thartë në fytyrë, e cila ato çaste i dukej se pasqyronte një frikën të brendshme pikërisht që mund ta kishte nga sjellja e publikut nëse nuk do të ishte në gjendje që t'ua përmbushte pritjet. Ky është i dorëzuar, i tha vetit, Bashkim Kosova dhe iu vërsul sapo dëgjoji gongun, njësoj si para një viti kur e pat hedhur në dysheme. Këtë herë kishte parasysh se duhej të përjashtonte publikun, që kërkonte ta linçonte sy botës, duhej ta përjashtonte edhe gjyqtarin, i cili sikur i thoshte: kot e ke dhe, duhej të përjashtonte çdo gjë tjetër, pos kundërshtarit, të cilin duhej ta qëllonte pareshtur dhe pamëshirshëm. Kështu edhe veprimi. U ndal vetëm atëherë kur gjyqtari u hyri në mes, gjoja për ta penguar zvarritjen, ndërkohë që ai kërkonte që Beneshin ta mbronte nga nokauti klasik, por që në këtë ndërhyrje kërkohesh edhe ndonjë gjuajtje e palejueshme e Bashkimit, që pastaj të ndëshkohet me vërejtje publike dhe me diskualifikim madje. Këtë do t'ia bëjë me dije edhe Lis Mani gjatë pushimit pas përfundimit të raundit të parë, në të cilën ai kishte dominuar plotësisht dhe ishte për t'u habitur pse Beneshi, pasi gjithë atyre që kishte marrë në kokë dhe pleksus, nuk kishte përfunduar në dysheme. Më vonë, Bashkim Kosova, qëndresën e jashtëzakonshme të Beneshit, e kishte shpjeguar pikërisht me frikën që kishte ai nga hakmarrja e publikut, gjë që kjo ishte dëshmuar edhe me ndërhyrjen e shpejtë të rojeve të ringut dhe të organeve të rendit, të cilat thuajse e kishin kidnapuar çastin që, pas përfundimit të raundit të dytë, trajneri vendës dhe shtabi teknik kishin vendosur që Beneshi, serish me arsyetimin se kishte lënduar arkadën, të mos e vazhdonte duelin.

Fitorja e dytë radhas e Bashkim Kosovës ndaj Beneshit, megjithatë, nuk i kishte ndihmuar klubit "Prishtina" që të fitonte të dy pikët në Banjallukë. Vendësit dhe gjyqtarët e ringut, në pjesën tjetër të ndeshjes, në dy duelet e mbetura (në kategorinë e rëndë dhe atë super të rëndë), ku boksierët nga Prishtina ishin favorit, ia dalën që, në mungesë të nokautove klasike, ato t'i shpallin baras dhe kështu ajo të përfundojë dhjetë me dhjetë, me çka "Prishtinës" i humbën gjasat për ta fituar titullin e parë të kampionit shtetëror. Skandaloz ishte vendimi i gjyqtarëve që dueli të shpallet pa fitues në kategorinë super të rëndë, edhe pse boksieri i Prishtinës dy herë e hodhi në dysheme boksierin vendës. Edhe me këtë rast do të jenë vërejtjet teknike të shpifura (dy sosh) që iu dhanë boksierit nga Prishtina, ani pse me to do të duhej të ndëshkohej boksieri vendas, i cili qëllimisht i lidhej për trupi kundërshtarit dhe nuk i përmbahej urdhrin "brek" për t'u kthyer një hap prapa.

Por, edhe pse "Prishtinës" në Banjallukë iu pamundësua fitorja, e me këtë edhe titulli i parë i kampionit shtetëror, megjithatë, fitorja e Bashkim Kosovës ndaj Beneshit, kishte hequr dilemën e "mbretit" të ringut në kategorinë gjysmë të rëndë. Tani më, atë e pranonin edhe kundërshtarët e tij – shtypi i Beogradit, i cili doli haptas me qëndrimin se nëse Bashkim

Kosova ia kishte dalë që ta mund Beneshin, megjithatë kjo nuk do të thoshte se atij i binte vlera sa të mbetej jashtë Lojërave Olimpikë në Moskë. Beneshi është kampion i madh dhe i tillë mbete. Sepse, ai nuk është ngritur në pedestal për një ditë, e as që mund të bjerë prej andej brenda një dite.

“Politika” e Beogradit hodhi mendimin që Beneshi të përgatitej për olimpiadë, ndërsa Bashkim Kosova, meqë ishte i ri, të garonte në lojërat ballkanike dhe të shkonte në kampionatin europian, i cili mbahej pas dy vitesh në Madrid. Me këtë, pra pranohej fuqia e Bashkim Kosovës, ndërkohë që Beneshit i ruhej nami nga e kaluara. Ishte ky një hesap që më në fund, boksini kosovar e ngrehte në maje, por, së paku sy për sy e faqe, pa lejuar që kjo ngjitje të bëhej nëpërmes rrënimit të një miti jugosllav, siç ishte Beneshi.

Kështu, në vitin 1978 filloji karriera e suksesshme e Bashkim Kosovës në ringjet ndërkombëtare. Në Sofje fitoi titullin e parë të kampionit ballkanik, ndërsa një vit më vonë, në Athinë atë do ta mbrojë.

Në Sofje dhe në Athinë pati punë me boksierin bullgar, Dimitrov, njërin ndër boksierët më të suksesshëm të këtij vendi, i cili kishte nofkën “Goxilla”. Në Sofje, ndonëse para publikut të vet, i cili priste medaljen e artë, Bashkim Kosova nuk e kishte pasur të vështirë që ta gjunjëzojë atë. Kjo kishte ndodhur nga mesi i raundit të parë, kur me një të rënë në pleksus e kishte hedhur në dysheme prej nga ai nuk kishte qenë në gjendje të vazhdonte luftën. Ishte deshtë edhe ndërhyrja e mjekut të ringut që boksieri bullgar ta merrte veten. Publiku vendës, edhe përkundër humbjes së boksierit të tyre me nokaut klasik (gjë që askush nuk e kishte pritur këtë), me rastin e marrjes së medaljes së artë, Bashkim Kosovës i kishte duartrokitur.

Në Athinë, pas një viti kishte ndodhur e kundërta. Publiku grek, vazhdimisht kishte qenë kundër tij. Gjatë gjithë kohës ishte provokuar nga një grup i madh tifozësh, që demonstroi kundër tij me ikonografi ortodokse. Në finale, në pjesën balllore, kishte parë të hapur një karikaturë, në të cilën ishte paraqitur te falet para një xhamie. Seleksionuesi i reprezentacionit, kroati Bruno, ia kishte bërë me dije se për çfarë ishte fjala dhe kishte kërkuar që të mos ia vinte veshin atij ngacmimi. Bashkim Kosovës, ndonëse nuk i kishte bërë përshtypje kjo, megjithatë ishte habitur me atë përqeshje, me të cilën nuk e lidhte asgjë. Më vonë, kur do të ballafaqohet me gjithfarë ngacmimesh, veçmas me ato që edhe emrit (Bashkim) dhe mbiemrit (Kosova) do t’i jepen shpjegime ndër më të ndryshmet pa ngurrur që të lidhen edhe me “qëllime të propagandës nacionaliste dhe irredentiste”, do ta kuptojë se çfarë fshihej prapa përqeshjes në Athinë dhe cilat ishin përmasat e njëmendta të saj.

Andaj, ishte fare e pritshme që atyre ngacmimeve, në një mënyrë tjetër, t’u jepej “kundërpërgjigje” në Kosovë, ku titulli i kampionit të Ballkanit në Athinë do të bëhet shkas për një pritje madhështore Bashkim Kosovës me rastin e kthimit në Prishtinë.

Pritja kishte filluar thuajse spontanisht nga një grup simpatizantësh të flaktë të kampionit, të cilët kishin dalë në aeroportin e Sllatinës me e përshëndetë. Në ty hyrë të Fushës së Kosovës, tri-katër veturave që po e përcjellin Bashkim Kosovën, do t’u bashkohen edhe disa të tjera, por këtë herë në një kombi, kishte dhe dajre, ku një daulle pandalshëm nxirrte tam-tame, jehona e të cilave përhapej me të madhe.

Në Prishtinë, para hotelit “Grand”, një turmë e madhe kishte bllokuar sheshin dhe rrugët përreth. Nga të gjitha anët vinin klithjet:

“Bashkim! Bashkim!” dhe

“Kosova! Kosova!”

Ato përcilleshin me jehonën e daulles. Pas një qëndrimi të shkurtë, nga një eshalon, Kampioni do të bartet përgjatë rrugës që shpinte te “Rilindja”, prej nga pas pak moria e simpatizuesve dhe qytetarëve që iu kishin bashkuar gazmendit të rastit, do të drejtohen për në hallën e madhe të sporteve te pallatit “Boro-Ramizi”. Aty, në ringun e stolitur me flamuj shtetërorë, partiakë dhe atë kombëtar shqiptar, ishte e shkruar një pankartë e madhe me fjalët: “Përshëndetje kampionit Bashkim Kosova”. Ajo qëndronte si sfond në pjesën ballore dhe ambientit i jepte një pamje tepër solemne.

Shfaqja e Bashkim Kosovës në ring sakaq përndezi atmosferën festive, e cila zgjati deri në orët e vona të pasdites. Në orët e mërkurës aty do të mbahet një koncert i madh me pjesëmarrjen e ansambleve të ndryshme, nga “Shota”, “Ramiz Sadiku” si dhe këngëtarëve të njohur të Kosovës, e ku nuk do të mungojnë edhe ata nga Shkupi dhe Ulqini.

Nga viti 1980 e deri në vitin 1982, Bashkim Kosova do të arrijë kulmet e boksit europian. Titujve të kampionit të Ballkanit të fituar në Sofje dhe Athinë iu shtuan të edhe ai i kampionit të Evropës, i fituar dy herë radhas: më 1980 në Berlinin Lindor dhe në vitin 1982 në Madrid.

Në Berlinin Lindor, siç ishte pritur, deri në gjysmëfinale Bashkim Kosova nuk kishte pasur ndonjë kundërshtar të denjë, kur ishte përballuar me boksierin vendës, Gauk, të cilin nuk kishte dashtë ta nokautonte në raundin e dytë, edhe pse këtë mund ta bënte. Kishte pritur raundin e tretë që këtë ta bëjë gjyqtari i ringut, një rumun, i cili pas numërimit të tretë, e kishte ndërprerë luftën. Në finale, kur do ta nokautojë boksierin çekoslovak, Farkash, nga publiku gjerman do të përshëndetet për zemërsisht dhe kjo do të jetë hera e parë dhe e vetme që në ringjet europiane do të pritët si duhet.

Në kampionatin e ardhshëm europian në Madrid, Bashkim Kosova, që nga fillimi pati t dy kundërshtarë njëherësh: publikun vendës dhe ata në ring. Si ”shkas” për këtë acarim, sigurisht se publikut vendës i kishte shërbyer ndeshja me boksierin spanjoll, Ramos, me të cilin duhej të takohej në ndeshjen e parë. Ramos, i cili ishte shpresa e vetme e spanjollëve në këtë kampionat, mund ta kishte të qartë handikapin e shortit, por këtë nuk dëshironin ta kuptonin shikuesit e shumtë, të cilët shpresonin se ndihma e tyre do të mjaftonte për këtë. Dhe kur do të shihet se animi, sado që i fuqishëm që ishte me atë rast, nuk mund ta ndryshonte raportin e forcave, pra pasi që boksieri spanjoll të detyrohet ta lëshojë ringun qysh në raundin e parë, publiku spanjoll, i tëri do t’i kthehet në kundërshtar Bashkim Kosovës gjatë gjithë kohës madje. Më vonë mori vesh se spanjollët i kishte kundër jo vetëm për arsye sportive, por edhe për ato politike, meqë në shtypin e atjeshëm, ishte thënë haptas se fjala ishte për një boksier që vinte nga një milje me prirje nacionaliste dhe separatiste, ku Kosova krahasohej me Baskinë dhe Kataloninë.

Përballë këtyre rrethanave, Bashkim Kosova nuk e kishte mendjen gjithaq te sjellja e publikut, ngaqë ishte mësuar me gjëra të ngjashme nëpër ringjet jugosllave, por te ndeshja e mundshme me kamionin sovjetik, Medvedev. Arsyet që ta kishte përballë Medvedevin në finale, Bashkim Kosova i kishte në radhë të parë sportive, por tashmë edhe josp sportive. Natyrisht se arsyet sportive lidheshin me atë se fjala ishte për njërin ndër boksierët më të mirë në botë në atë kategori (pos tjerash kampion olimpiq nga olimpiada e Moskës), i cili po ashtu gjatë karrierës katërvjeçare nuk kishte humbur asnjë duel. Edhe bilanci i fitoreve ishte i jashtëzakonshëm dhe për adhurim ngaqë mbi gjysma e tyre ishin shënuar me nokaut klasik,

ose me ndërprerje para kohe. Arsyet josportive lidheshin me politizimin, që si shumëçka tjetër në sferën shoqërore të vendit, kishte përfshirë edhe sportin prej nga ishte më së lehti të sajoheshin ngacmimet e ndryshme, të cilat pastaj barteshin në opinion dhe tutje për qëllime politike. Ndjekjet dhe denoncimet e shumta që kishin filluar në Kosovë pas demonstratave të marsit të vitit të kaluar që kishin shpërthyer në Prishtinë, ishte e natyrshme që të mos anashkalonin edhe Bashkim Kosovën, meqë me sukseset e tij të jashtëzakonshme sportive, kundërshtarët e barazisë së Kosovës si dhe të kërkesës politike që kishte dalë për statusin e barabartë me njësitë tjera në federatë, identifikonin atë që quhej “frymëzim nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”.

Në vazhden e kësaj fushate ndaj shqiptarëve të suksesshëm në kulturë, arsim, shkencë por edhe sport, një pjesë e mirë e shtypit të Beogradit (e prirë nga gazeta “Politika” dhe botimet e saj, pastaj Radio Televizioni i Beogradit), pa ngurruar fare kishte vu në shenjtër Bashkim Kosovën dhe sukseset e tij të mëdha sportive. Fantazia denoncuese që vinte nga “Politika”, ndonjëherë shkonte aq larg, saqë emri *Bashkim* dhe mbiemri *Kosova* ishin parë në shërbim të asaj që tashmë politika ditore e niveleve më të larta, duke u mbështetur në Platformën Politike për Kosovën, që kishte aprovuar Kryesia e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në mbledhjen e 5 majti të vitit 1981 dhe njëzëri e kishte aprovuar edhe Kryesia e RSFJ-së, e kishte kualifikuar “kundërrevolucion nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”! Në emër të kësaj Platforme, kjo gazetë, madje, kishte qenë e parë, e cila kishte kërkuar që Bashkim Kosova të mos lejohej që të shkonte në Kampionatin Europian të Boksit në Madrid me arsyetimin se fitorja eventuale e tij në këtë kampionat (që ishte e mundshme) do t’u jepte mundësi të re shpërthimi nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë, që edhe më tutje, në emër të krenimit sportiv, me mbiemrin e tij ngojë, të manifestojnë parullën kundërrevolucionare për republikën e Kosovës. Kjo mundësi bëhet edhe më e madhe po qe se Bashkim Kosova rastësisht takohet në finale me boksierin sovjetik dhe ndaj tij korrë fitore.

“Nuk duhet lejuar që me anën e sportit, fjala Kosovë, të keqpërdoret për qëllime politike”.

Mbase kjo kishte bërë që vite më vonë, kampioni i madh, kur do t’i krijohen kushtet që t’i rrënohej karriera e mëtutjeshme sportive (dhe kjo do të ndodhë pas kthimit nga Kampionati Botëror i Boksit në Toronto të Kanadasë në vitin 1986), t’ia pranojë një mikut se, në përputhje me atë që kishte përjetuar brenda dhe jashtë ringut dhe, veçmas kur i kishte parë të lidhura me ato nëpër të cilat kishte kaluara familja e tij gjatë shekullit të fundit, kishte filluar të mendonte seriozisht rreth domethënies së emrit dhe mbiemrit të tij, pse mund të mos ishin të rastësishëm dhe të ngjashme, dhe se nuk përjashtohej mundësia që një ditë të dilte me një meditim rreth tyre ngaqë e gjitha e kthente te pika e qenies, prej nga nuk kishte të ikur edhe po qe se ndaj saj shtiresë...

Por, si do të shihet, “oguri i ligë” i shtypit të Beogradit, nuk do të përmbushet, jo pse Bashkim Kosova do ta fitojë titullin e kampionit të Europës, por pse duelin me boksierin sovjetik Medvedev e pengoi bullgari Todorov, i cili në duelin gjysmëfinale fitoi me fat, pasi që në raundin e dytë Medvedev, edhe pse gjatë gjithë kohës ishte bindshëm më i mirë, nxori krahun dhe u detyrua me e dorëzue ndeshjen.

Çastin që trajneri sovjetik u detyrua me e tërheqë boksierin, kur po i jepej ndihma mjekësore në ring dhe prej andej do të dërgohet në një klinikë të Madridit, telespektatorët që

përcillnin transmetimin e duelit të drejtpërdrejtë nëpërmes Televizionit të Beogradit, kishin vërejtur se komentuesi serb, së pari i ishte marrë goja nga ajo që po shihte në ring dhe pastaj, kur i ishte kthyer, të parën gjë që kishte thënë ishin fjalët dëshpëruese:

“Është për keqardhje që, në mungesë të sovjetikut Medvedev, *askush nuk do të jetë në gjendje ta ndalojë Bashkimin e Kosovës të fitojë në Europë...*”

Këto fjalë edhe të thëna kështu dhe në përputhje me një logjikë sportive, megjithatë, në Beograd ishin interpretuar me një konotacion tjetër fare, mbi të cilin do të ngrihen shumë e shumë spekulime politike, mbi të cilat do të mbështetet edhe e ashtuquajtura strategji kundër “irredentizmit shqiptar”, si një kërcënim i madh!

Në të vërtetë dueli final me bullgarin Todorov kishte qenë më shumë një stërvitje për Bashkim Kosovën, se sa një matje forcash në një nivel të tillë. I dëshpëruar pse nuk e kishte përballë boksierin sovjetik, ishte përpjekur që të demonstronte vallëzimin në ring, ngjashëm me atë që bënte dikur Kasius Kleji (Muhamed Ali) idhulli i tij i madh. Kështu, gjatë raundit të parë, duke e mbajtur në distancë kundërshtarin me të majtën, ndërkohë që e qëllonte me të djathtën, ia kishte dalë ta kthejë në lodër të thjeshtë, meqë boksieri bullgar nuk ia kishte arritur të shënonte asnjë gjuajtje drejt tij e lërë më që ta qëllonte. Në raundin e dytë, gjyqtari i kishte numëruar dy herë boksierit bullgar, ndërsa atë të tretin, sapo kishte filluar, e kishte ndërprerë peshqiri i trajnerit bullgar.

Dorëzimi i medaljes së fituesit si dhe ceremoniali, megjithatë ishin karakterizuar me një zhvillim, që “Politikës” së Beogradit i kishin dhënë shkase që Bashkim Kosovën dhe sukseset e mëdha sportive në ringjet e jashtme, t’i shohë të “ndërlidhura” drejtpërdrejt me “frymën e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”.

Në të vërtetë, gjatë kohës kur po ngrehej flamuri jugosllav bashkë me atë bullgar dhe spanjoll, të përcjellë me tingujt e himnit jugosllav “*Hej slloveni*”, një grup spektatorësh, ia kishte dalë që pranë ringut të shfaqet me parullën “*Kosova Republikë*”, të shkruar me shkronja të zeza dhe të mëdha në një sfond të bardhë, në një gjatësi prej disa metrash. Shoqërohej nga disa flamuj kombëtar shqiptar, në mesin e të cilëve kishte edhe flamuj të kuq, me drapër e çekan, që u rrinte sipër parulla e njohur internacionaliste:

“*Proletarë të gjitha vendeve bashkohuni!*”.

Bartësit e parullës si dhe flamujve ishin të qetë dhe të heshtur. Pas pak kishin ndërhyrë organet e rendit dhe parullën “*Kosova Republikë*” bashkë me bartësit e saj, i kishin hequr dhunshëm, edhe pse ata nuk u kundërvunë, por që e gjitha pastaj, nga një pjesë e publikut ishte përcjellë me fishkëllima, ku nuk dihej se a miratohej ndërhyrja e tillë policore, apo kundërshtohej?

Sidoqoftë, Bashkim Kosova, do të pranojë se për herë të parë ishte ballafaquar me një demonstrim të tillë dhe se në ato çaste, nuk kishte qenë në gjendje ta përcaktojë përmasën e atij ndijimi, siç do t’i ndodhë më vonë, kur jo vetëm që do të pajtohet me atë kërkesë, jo vetëm që do ta mbështesë nga çdo pikëpamje, por do të jetë ndër të parët, që pas rrënimit të autonomisë nga tanket e Beogradit në mars të vitit 1989, do t’i bashkohet lëvizjes kombëtare për jetësimin e Republikës së Kosovës, në përputhje me vullnetin e popullit. Ndaj jo rastësisht do të gjendet në mesin e njëqind e njëzet e katër pjesëmarrësit e Kuvendit Themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që ishte mbajtur më 23 dhjetor të vitit 1989 në Prishtinë, në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

Por, duhet thënë se edhe pse e gjitha e atij demonstrimi do të zgjatë pak çaste, edhe pse ajo ishte pika prej nga atij do të fillojë t'i shembej iluzioni për "barazinë jugosllave" me të cilën ishte ushqyer nga fëmijëria, Bashkim Kosova, atë ditë dhe edhe më vonë, në ring dhe pas tij, kishte ruajtur pusullën dhe ishte sjellë si sportist, i vetëdijshëm se edhe lufta sportive dhe sjellja prej fituesi në të, si frymëzim masash i shërbenin atij zhvillimi të pandalshëm në të cilin, herët a vonë, do të përfshiheshin që të gjithë

Në përputhje me këtë bindje nuk kishte deshtë të deklarohet rreth kërkesës për Republikën e Kosovës, me të cilën ballafaqohej gjithnjë e më shumë gjatë turnirëve jashtë vendit, kërkesë kjo që rëndom përcillej me demonstrata dhe manifestime të tjera të diasporës shqiptare jashtë.

Kishte thënë se i interesonte vetëm sporti dhe sukcesi në të, gjë që për këtë, edhe pse ishte kritikuar ashpër nga "Politika" Beogradit dhe mediet tjera serbe, megjithatë ishte mbrojtur nga Federata Europiane e Boksit (EBF) e më vonë edhe nga Komiteti Olimpik dhe Federata Botërore e Boksit (WBF), të cilat zyrtarisht i ishin drejtuar Qeverisë së Jugosllavisë të ndërpriste fushatën politike kundër sportistëve, në rastin konkret kundër kampionit të dyfishtë të Ballkanit dhe të Europës, Bashkim Kosovës. Në të kundërtën, Federata Europiane e Boksit do të përjashtonte Lidhjen e Boksit të Jugosllavisë nga garat e mëtutjeshme.

Ngjashëm kishte reaguar edhe Komiteti Olimpik, por me këtë qëndrim ishin solidarizuar edhe UEFA madje edhe FIFA, të cilat tashmë kishin njohuri të shumta që sporti dhe sportistët në Jugosllavi shfrytëzoheshin qoftë për diskriminim mbi baza nacionale (siç ngjiste me sportistët shqiptarë, boshnjak dhe kroatë), qoftë për manipulim me sportin dhe sportistët për qëllime të indoktrinimit nationalist (siç ngjiste me sportistët serbë dhe klubet serbe).

Kërcënimet e Federatës Europiane të Boksit dhe të organizatave ndërkombëtare të sportit, do të ndikojnë që sportistët kulmorë (boksierët e Prishtinës, mundësit shqiptarë nga Maqedoni me tituj të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare, e edhe futbollistët e "Prishtinës", që tashmë garonin në Ligën e Parë Federative të futbollit dhe vazhdimisht provokoheshin), sado pak të kursehen nga fushatat publike me karakter politik, ose që të mos diskriminohen në nivel të reprezentacioneve federative. Ndërhyrjet ndërkombëtare, po ashtu do të ndikojnë që lidhjet sportive të republikave dhe të krahinave në nivel të federatës (tetë sosh, ku bënte pjesë edhe Kosova), pak a shumë, të lirohen nga trysnia e Beogradit për të vendosur mbikëqyrje unitariste në federatë, trysni kjo që kishte dalë në pah dhe kishte marrë hov pas demonstratave të Kosovës të vitit 1981. Domethënëse në këtë drejtim ishin disa shkrime të shtypit të rëndësishëm europian (gazetës "*Frankfurter Allgemeine*", nga Frankurti, "*Die Presse*" nga Vjena si dhe "*Figaro*" nga Parisi), ku me shembuj të shumtë bëhej e ditur për trysninë e madhe politike që ushtronte Beogradi ndaj shumë sportistëve shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia, që të përfshiheshin në të ashtuquajturën fushatë diferencuese "kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar" si kusht për t'u përfshirë në reprezentacionet shtetërore të Jugosllavisë. Gazetari i njohur gjerman Viktor Majer, opinionit gjerman dhe atij europian ia kishte nxjerrë në shesh shkrimet e gazetës "Politika" të Beogradit (që quhej organ i nacionalkomunistëve serbë, të cilët, pas vdekjes së Titos, tashmë i ishin vërsulur konceptit titist-vetëqeverisës për një Jugosllavi të kombeve të kombësive të barabarta), ku thuhej se duke u sulmuar sportistët shqiptarë (zihej ngojë boksieri Bashkim Kosova dhe disa karateistë nga Maqedonia), kërkohet që shqiptarët e suksesshëm të futen në

konflikt me kërkesat e drejta të popullsisë shqiptare për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës jugosllave. Kristine von Kohl nga Vjena, po ashtu në “*Die Presse*” bënte të ditur për ndjekjet politike ndaj sportistëve tashmë të njohur në arenën ndërkombëtare, kampione ballkanik dhe europiane, të akuzuar “si frymëzues të irredentizmit shqiptar” në mënyrë që me këtë anatemë të përjashtohen nga aktivitetet sportive. Ajo shkruante se të njëjtës fushatë, prej kohësh, po i nënshtrohen intelektualë dhe krijues të njohur shqiptarë me renome kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë studiuar jashtë, ose që gjenden në studime pasuniversitare, me ç’rast përmenden rastet e marrjes së tyre nëpër të ashtuquajturat biseda informative nga hetues policor dhe ushtarak, pastaj të izolimeve të shumta (që paraqesin një masë të arrestit të përkohshëm të paafatizuar të paligjshëm) dhe të tjera.

Nga sporti kulmor përmendej rasti i fushatës politike ndaj kampionit europian Bashkim Kosova si dhe fushata kundër artistit të mirënjohur botëror Bekim Fehmiut, fitues i festivalit të Kanës dhe të shumë mirënjohjeve të tjera ndërkombëtare, i cili, në fillim të viteve të shtatëdhjeta, ishte i pari aktor nga Europa Juglindore që kishte arritur në Holivud.

“Beogradi mund ta rrënojë edhe Jugosllavinë vetëm e vetëm të mos u lejojë hapësirë shqiptarëve, që ata të pasqyrojnë kreativitetin e tyre shpirtëror, intelektual dhe talentin sportiv, ngaqë kjo bie në kundërshtim me paragjykimet serbomëdha, ku ata paraqiten si të egjër dhe jashtë çdo prirjeje qytetëruese”!

Nëse trysnia e asociacioneve meritore ndërkombëtare të sportit dhe shkrimet e disa gazetave të njohura europiane kishin ndikuar që sportistë kulmorë të kursehen sado pak nga fushatat e hapura diskriminuese, që i dirigjonte politika serbe dhe mediet e Beogradit, megjithatë realitet shoqërorë nëpër të cilat kalonin sportistët e Kosovës, jo vetëm që nuk ishin sportive, por ato, në shumë raste i përngjanin frustrimeve të skajshme primitive, ku kishte çmos, pos sportit dhe frymës së tij. Madje, tashmë sporti ishte kthyer në një arenë të hapur të urrejtjes, ku politika e Beogradit testonte më së miri konceptet e saj, që në emër të forcimit të shtetit ta vente nën mbikëqyrje federatën.

Në të tilla rrethana, edhe shqiptarët e Kosovës, do të përpiqen që sportin dhe manifestimet sportive dhe veçmas sukseset e mëdha të sportistëve të tyre kulmor (siç ishin ato të boksierëve të klubit “Prishtina” në arenën e vendit dhe atë ndërkombëtare dhe të klubit të futbollit “Prishtina”, që garonte në Ligën e Parë Federative dhe së fundit edhe të klubit të basketbollit të femrave “Universiteti”) t’i shfrytëzonin për demonstrime, që ishin në përputhje me frymën e kërkesave shoqërore dhe politike për barazinë në nivel të federatës. Sukseset e Bashkim Kosovës, në këtë drejtim ishin më domethënëse, jo vetëm pse ato ishin të një niveli ndërkombëtar, por pse manifestimi që u bëhej atyre, nga ata që sportit dëshironin t’ia shihnin “frymën e indoktrinimit nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, u jepnin “shkase” për trumbetime të tilla.

Dhe, ishte e natyrshme që këto “shkase” nisnin nga brohoritja që i bëhej emrit ose mbiemrit të Bashkim Kosovës nga tifozët, kur thirrjet “*Bashkim*” dekodoheshin si “kërkesa irredentiste për bashkim kombëtar”, ndërsa thirrja “*Kosova*” interpretohej “kërkesë kundërrevolucionare”, meqë ajo ishte, si thuhej në përputhje me platformën për Kosovën Republikë, të hedhur që nga demonstratat e vitit 1968 dhe të ripërsëritur në demonstratat e vitit 1981.

Meqë ky konotacion tashmë kishte fituar legjitimitet në mediet serbe të Beogradit dhe politika zyrtare e përdorte dendur për nevojat e veta, veçmas për diferencimet e pandalshme

në Kosovë në të cilat përfshiheshin thuajse që të gjitha shtresat shoqërore të shqiptarëve, pritja dhe përshëndetja që do t'i bëhet Bashkim Kosovës në Prishtinë pas të jetë kthyer nga Madridi, do të kalojë në një demonstrim të hapur për Kosovën. Atë ditë, e gjithë Prishtina do të jehojë nga thirrja “*Kosova*”, e cila në orët e pasdites dhe të mbrëmjes do të kthehet në një manifestim gjithpopullor, i cili do të përhapet në gjithë Kosovën. Me siguri se “festa” do të vazhdonte kush e di sa kohë, nëse nuk do të ndërpritej nga një ndërhyje e Njësisë Speciale Federative të stacionuar prej më shumë se një viti. Ajo ishte bërë me arsyetimin se “manifestimi kishte kaluar në një demonstratë irredentiste, ku ishin hedhur parullat për bashkim kombëtar dhe për Enver Hoxhën”.

Parullën “për bashkim kombëtar” shtypi i Beogradit e kishte arsyetuar “si moment të ri në strategjinë kundërrevolucionare”, ku manifestimet sportive shfaqen si një hapësirë e mirë për shfrime të tilla. Edhe pse në manifestimin e Prishtinës kishte dominuar thirrja për Kosovën si shprehje e një patriotizmi të natyrshëm (të shumtën ishte kënduar kënga “*Besa-besë*” me refrenin “*për Kosovë jetën kam me e dhanë*”), “Politika” e Beogradit, anashkalonte këtë dhe përqendrohej tek thirrja “*Bashkim*”, duke e parë “në një frymë të re” dhe, si thuhej, të ndërlidhur me “propagandën shqiptaromadhe të Tiranës enveriste”, edhe pse e njëjta gazetë, pra një viti, kur kishte filluar të “identifikonte nxitësit e ngjarjeve kundërrevolucionare nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar” dhe kërkesa për Republikën e Kosovës, Tiranën zyrtare e kishte paditur si mbështetëse kryesore e Republikës së Kosovës, e cila duhej të ishte staliniste! Madje, gjoja indoktrinimin e shqiptarëve të Kosovës me stalinizëm fanatik, që e mbronte vetëm Enver Hoxha, por që ai si model, me anën e një republike shqiptare, siç ishte ajo e Kosovës, duhej të bartej edhe në Jugosllavi dhe sajesa të ngjashme me të cilat duhej të frikësohej Perëndimi, Beogradi zyrtar do të mundohet ta inkriminojë me shfaqjen e saj edhe jashtë Kosove, pra në Beograd, kur opinionit jugosllav i ishte bërë me dije se me rastin e ndeshjes së futbollit midis klubit “*Prishtina*” dhe “*Crvena Zvezda*” në Beograd, të cilën prishtinasit e kishin fituar 3:1 me meritë, mijëra tifozë të Prishtinës, në stadium dhe pastaj nëpër rrugët e Beogradit kishin klithur për Enver Hoxhën! Radio Televizioni i Beogradit, si dëshmi për këtë “diversion stalinist në kryeqendrën e Jugosllavisë liberale” në Beograd kishte sjellë klithjen e rëndomtë “*Eho*” (jehonë), e cila, sipas “ekspertëve” që merreshin me dekodimin e “shenjave të nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, të cilët tashmë analizonin çdo fjalë dhe fjali të shqiptarëve, paraqiste një “kompozitë perfide”:

E = Enver

Ho = Hoxha

Pra, “*E-ho*” fshihte **Enver Hoxhën!**

Ky “zbulim” ishte arsyetuar me disa nga “dëshmitë” e pjesëmarrësve të pandehur, numri i të cilëve arrinte në dyqind e tridhjetë nga gjithsej gjashtë mijë sa ishin identifikuar nga organet policore, të cilët nga Gjykata për Kundërvajtje e Beogradit, me procedurë të shpjget, ishin dënuar me nga 30 ditë burgim. Të dënuarit, thuhej, jo vetëm që nuk pendoheshin por mburreshin pse ia kishin dalë që në Beograd të manifestonin “besnikërinë për Enver Hoxhën, që paraqiste përcaktim për bashkim kombëtar”!

Disa prej tyre, madje në një proces tjetër penal, me ç’rast ishin dënuar me shumë vjet burgim, ideologjinë enveriste e kishin identifikuar me ideologjinë e bashkimit kombëtar, ndërsa Enver Hoxhën me prijësin shpirtëror të të gjithë shqiptarëve.

Por, nga ballafaqimi me rrethana të tilla josportive, të cilat ishin të pashmangshme, Bashkim Kosovën, për një vjet do ta privojë një lëndim i krahut, që kishte marrë në shtator të vitit 1982 në Prokupje në ndeshje me ekipin vendës me të njëjtin emër, rival të fuqishëm të “Prishtinës” për kampionin shtetëror, e ku rëndom, krahas luftës me boksierët e papastër vendës dhe gjyqtarët që bënë çmos që klubi prishtinas të dëmtohej sa më shumë që ishte e mundur, dhe kjo madje të bëhej edhe haptas, ishte ballafaqimi me publikun vendor, i cili manifestimin sportiv e kthente në një arenë të shpërthimit nacionalist dhe shovinist ndër më shfrenueset. Të stolitur me flamuj serbë, aso të kishës ortodokse dhe ikonografi mesjetare serbe, salla e sporteve e mbushur plot e përlotë me tre-katër mijë veta, aq sa u kërcënohej sportistëve me fjalët se do t’i linçojë, po aq i kërcënohej edhe Kosovës dhe shqiptarëve, të cilët quheshin “vrasës të shpirtit mesjetar serb” dhe parulla të tjera të ngjashme nga arsenalit hegjemonist serbomadhi, që nuk do të vonojë dhe pas pak do të manifestohet haptas në Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave të Arteve.

Meqë Bashkim Kosova, pas kthimit nga Madridi, ishte në shënjestër të asaj orgjie, ishte fare e pritshme, që ai në ring ta jepte përgjigjen sportive, që duhej të ishte vetëm me nokaut klasik, sepse ndryshe rrezikohej nga gjyqtarët, të cilët mund t’i përdornin poenët, ose vërejtjet e shpifura publike, me të cilat mund të diskualifikohej, pa marrë parasysh epërsinë e poenëve.

Bashkim Kosova këtë e kishte të qartë në Prokupje edhe pse kishte të bënte me boksierin Gavrilloviq, një rival tjetër i fuqishëm, i cili ishte i talentuar dhe mund ta kishte konkurrent për vendin në reprezentacion. Edhe pse me këtë boksier ishte ndeshur para një viti dhe trajneri i tij e kishte kursyer nga nokauti klasik në raundin e dytë me anën e peshqirit, ishte përpjekur që të ruante raportet korrekte sportive edhe për faktin se ai ishte i përkatësisë rome, ndër të paktit në Serbi që këtë e pranonte, nga shumë sosh që kishte.

Këtë herë, Gavrilloviq, i përgatitur nga jashtë për ngacmime, gjatë përshëndetjes së zakonshme në ring, do t’i drejtohet me fjalët “*vrasës i Jugosllavisë!*” Edhe pse Bashkimi kishte buzëqeshur me ironi, ai serish ia kishte përsëritur të njëjtat, duke e vu theksin te fjala “*vrasës*”.

Natyrisht se ky ngacmim do ta detyrojë Bashkim Kosovën, që Gavrilloviqit t’ia tregojë sa më parë vendin në dysheme, prej nga do të ketë kohë të kthjellohet nga çështjet josportive. Kështu, i mbërthyer nga ndjenja që një kundërshtar ta shkatërronte fare pa ua vënë veshin pasojave, iu vërsul boksierit vendës, sikur të ishte në një arenë gladiatorësh. Në atë egërsim e sipër, kishte humbur mbikëqyrjen deri në atë masë, sa që nga e rëna e parë me të djathtë, e cila e kishte plandosur Gavrilloviqin në dysheme pa frymë fare (kishte marrë vetën pas një ore në spitalin vendor kur ishte dërguar me urgjencë), pas pak do të ndërë një krismë të brendshme, e cila do t’i kthehet në një dhembje të fortë. Trajneri Lis Mani dhe fizioteraperi i klubit hetuan se i kishte pëlcur krahun. Por, për ta përcaktuar lëndimin duhej të priste deri në Prishtinë, kur në Klinikën e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Kosovës do t’i shihet çarja e ashtit në frakturën e epërme të krahut të djathtë, gjë që kjo do t’i kushtojë me mbetje jashtë ringut për gjashtë muaj, ndërsa edhe dy muaj të tjerë do t’i kalojë me stërvitje rehabilituese.

Në ring u kthye në gjiron e fundit të kampionatit shtetëror, por vetëm sa për sy e faqe, meqë ekipi kundërshtar, “Radnički” i Nishit, me ta parë “debinë” e Bashkim Kosovës, kishte dorëzuar luftën në kategorinë gjysmë të mesme. Për një rikthim të njëmendtë Bashkim

Kosovës iu desh ta priste shtatorin e atij vit, kur duhej të jepte dëshmitë e duhura se ishte i gatshëm për Lojërat Olimpike, që mbaheshin në korrikun e vitit të ardhshëm në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në të vërtetë, kandidimi për olimpiadë, Bashkim Kosovës, me kurthet që kishte filluar t'ia vinte Beogradi, iu kthehen telashet e shumta, siç ishte ajo që të mos e merrte vizën, me arsyetimin e “shkaqeve shëndetësore”, të cilat lidheshin me mbetjen njëvjeçare jashtë ringut nga shkak i lëndimit të krahut. Madje, si do të merret vesh më vonë, edhe tërheqja e boksierit të “Radniçkit” të Nishit në gjiron e fundit të kampionatit të kaluar në Prishtinë, kishte qenë pjesë e kësaj strategjie, pra e eliminimit të tij. Sepse, si do të shihet, gjatë pjesës vjeshtore të kampionatit, Bashkim Kosova do të zhvillojë vetëm një duel nga nëntë sosh sa kishte pjesa e parë e kampionatit. Duelet me të, me arsytetime thuajse të shpifura (herë pse kundërshtarët ishin “të lënduar”, e herë pse “kishin tejkaluar peshën”), do t'i anulojnë që të gjitha ekipet e Serbisë që bënëin garë në Ligën e Parë (gjashtë sosh). Këtë do ta bëjë edhe ekipi nga Novi Sadi dhe ai nga Banjalluka. I vetmi kundërshtarë që i doli në ring ishte ai i ekipit “Borovo” nga Kroacia, të cilin e mundi në raundin e tretë me ndërprerje, ani pse këtë mund ta bënte me nokaut klasik qysh në fillim.

Edhe në pjesën e dytë të kampionatit, pra në atë pranveror të vitit 1984, Beogradi vazhdoi me strategjinë e lënies së Bashkim Kosovës pa kundërshtarë në ring dhe, mbase do të përsëritej vjeshta, kur kishte mbetur vetëm me një duel, po mos të ishte ndërhyrja e Seleksionuesit të reprezentacionit shtetëror të boksit, kroatit Bruno, i cili që më parë kishte deklaruar se nominimi i Bashkim Kosovës për në Lojërat Olimpike të Los Anxhelosit do të bëhet pa marrë parasysh bojkotin që po i bëhej në ring. Ai madje, kishte fajësuar haptas Lidhjen Serbe të Boksit për organizimin e këtij bojkoti, gjë që kjo kishte shtyrë edhe Komitetin Olimpik të reagoonte me një kërcënim drejtuar Komitetit Olimpik të Jugosllavisë, se po qe se do të hetohej diskriminimi i sportistëve mbi baza politike, atëherë Komiteti Olimpik do të detyrohej ta dënonte Jugosllavinë me përjashtim nga Lojërat e Olimpike.

Me gjithë kërcënimin e Komitetit Olimpik se do të marrë masa nëse ndonjë sportisti të merituar do t'i prehet rruga për në olimpiadë, Serbia do të ruajë përkushtimin që Bashkim Kosovës, t'i vështirësohet kjo rrugë me mjete të ndryshme. Këtë do ta dëshmojë strategjia e dorëzimit të dueleve sapo të fillojnë ato, që do të ndiqet nga klubet e Serbisë. Kështu, Bashkim Kosova edhe gjatë sezonit pranveror pati vetëm një duel të mirëfilltë (prapë me boksierin e “Borovos” në Prishtinë), ndërsa në të tjerët, sapo fillonin, dorëzoheshin nga trajnerët me anën e hedhjes së peshqirit. Kjo do ta detyrojë Seleksionuesin e reprezentacionit të Jugosllavisë Bruno, që boksieri i Prishtinës t'i nënshtrohet një programi të veçantë përgatitor, tejet intensiv, në mënyrë që në Olimpiadë të shkojë fizikisht me kondicionin e duhur.

Shtypi i Beogradit, duke parë se më nuk do të jetë në gjendje që t'ia presë rrugën Bashkim Kosovës për në Lojërat Olimpike në Los Anxhelos, regjimin për stërvitje të veçanta që kishte caktuar Bruno dhe ai po zhvillohej me sukses dhe, si do të shihet, do të tregohej shumë i dobishëm, do ta rrotullojë me hedhjen e tezës se Bashkim Kosova përkrahej “në mënyrë të veçantë”, gjë që kjo paraqiste diskriminim për të tjerët! Në përputhje me këtë “tezë”, Lidhja e Serbe e Boksit, do të kërkojë që edhe boksierëve të saj (pesë sosh të thirrur për Olimpiadë) t'u sigurohet regjim i veçantë përgatitor, i ngjashëm me atë të Bashkim Kosovës. Në të kundërtën, do t'i tërhiqte boksierët. Beogradi, madje, paralajmëroi se “nëse

do të vazhdojë diskriminimi ndaj boksierëve serbë”, si thuhej, në raport me Bashkim Kosovën, do të njoftonte Komitetin Olimpik.

Edhe përkundër këtyre frustrimeve midis Lidhjes Serbe të Boksit dhe Federatës Jugosllave të Boksit, që tashmë shihej qartë se kishin prapavijë politike, Bashkim Kosova shfrytëzoi stërvitjet e veçanta, që të përgatitej sa më mirë për Lojërat Olimpike të Los Anxhelosit. Me rastin e shkuarjes për në Olimpiadë, bashkë me dy boksierët tjerë nga Kosova, (Lik Agun në kategorinë e lehtë dhe Met Begun në kategorinë velter) të cilët do ta përfaqësonin reprezentacionin shtetëror të Jugosllavisë, në Prishtinë do t’u bëhet një përcjellje madhështore, thuajse spontane, në të cilën morën pjesë mijëra dashamirë të sportit, por edhe qytetarë të tjerë, të cilët pjesëmarrjen e parë të sportistëve nga Kosova në një garë të tillë botërore e shihnin si një mundësi të mirë për afirmim në përmasa ndërkombëtare, pa marrë parasysh pse kjo bëhej nën firmën e shtetit jugosllav, ku ata tashmë shfaqeshin si pjesë konstituive e tij. Atë ditë Prishtina serish jehoi nga thirrjet “*Bashkim*” dhe “*Kosovë*” dhe kënga “*Besa-besë*”, ku refreni “*për Kosovë jetën kemi me e dhanë*”, për herë të parë po ia krijonte ehon e një betimi për një çështje të madhe, që fitorja dhe vetëm fitorja duhej të ishte ajo që fatalitetin e deritanishëm të sakrificës ta zëvendësonte me triumfin e arritjes...

Dhe, paraqitja e parë dhe e fundit e Bashkim Kosovës në Lojërat Olimpike, që në shërbim të ndërtimit të vetëdijes së fitores, e cila mund të arrihet në një garë të madhe, të haptë dhe në kushte të barabarta. Kështu, i liruar nga trysnitë që e kishin përcjellë gjatë dy viteve të fundit në ringjet jugosllave, në të cilat më shumë duhej të humbte energji për çështjet josportive se sa për ato sportive dhe i gjendur në një garë të lirë ku në përmasa botërore sprovohet por edhe dëshmohet fuqia e madhështisë, Bashkim Kosova, me pesë fitore radhas, që të gjitha të përfunduara para kohe (tri me nokaut klasik dhe dy me ndërprerje), arriti deri te titulli i kampionit olimpik

Fitoren e parë e shënoi kundër boksierit polak Janushevski pa ndonjë mund të madh. Në raundin e parë dhe të dytë, ishte aq mbizotërues, saqë nuk mori asnjë të rënë nga kundërshtari, i cili, duke iu varur për trupi kërkonte mbrojtje. Në raundin e tretë, pas një vërejtjeje publike, duke parë se polaku nuk ishte i gatshëm për luftë të hapur, gjyqtari në ring ndërpreu duelin.

Në duelin e dytë Bashkim Kosova kishte të bënte me boksierin grek, Koliass, i cili, me rastin e përshëndetjes në ring, i foli shqip. E quajti “vëlla”. Kjo e befasoi për aq sa gjatë tre minutave të parë, më shumë do të mendojë për ato që kishte dëgjuar se sa për luftën në ring. Fjala “vëlla” i vinte edhe më e pabesueshme, meqë kohëve të fundit, në ringjet jugosllave (me përjashtim të atyre në Kroaci dhe Vojvodinë), jo vetëm që nuk do të ketë përshëndetje korrekte në frymën sportive, por nga publiku dhe rivalët, të shumtën, do t’i vinë fjalët “*vrasës*”. Andaj, me përshtypjen habitëse se në ring po ndeshesh me dike që e quante vëlla, nuk i jepej që ta qëllonte. Më me dëshirë do të haptë një bisedë miqësore me dikë, që i kishte munguar aq shumë. Me këto mendime në kokë po lëvizte, por assesi nuk po bënte boks. Këtë do ta hetojë edhe gjyqtari në ring, i cili kërkoi sjellje aktive prej boksierëve dhe, në vend se të shikoheshin në sy, të kryqëzonin dorëzat. Kjo sjellje e Bashkimit habiti edhe shtabin teknik dhe veçanërisht Seleksionuesin Bruno, i cili sapo ra gongu, me shqetësim e pyeti se mos kishte ndonjë telash. Ia kishte kthyer se ndjehej mirë dhe se çdo gjë do të përfundonte ashtu si duhej, ndonëse edhe më tutje nëpër kokë i silleshin fjalët që i kishin ardhur nga boksieri grek. Kur duhej të fillonte raundi i dytë, iu kishte afruar boksierit grek,

më afër seç lejohej, sikur të kërkonte sqarime për ato që kishte dëgjuar prej tij në fillim, por ishte gongu që u kishte hyrë në mes dhe aty duhej të bënin një hap prapa me e vazhdue luftën. Në ato rrethana të turbullta, kur tashmë nuk ishte i sigurt se mos kishte qenë ndonjë mashtrim që i ishte qepur për koke pas gjithë atyre me të cilat ishte sfiduar kohëve të fundit, u bëri përpjekje me iu kthye luftës sportive, por jashtë ashpërsisë. E mbante në distancë boksierin grek dhe vetëm herë pas herë e qëllonte me të majtën në kokë sa për të shënuar poenët e nevojshme. Gjatë pushimit kroati Bruno prapë e pyeti pse nuk e kishte përdorur të djathtën dhe kërkoi që këtë ta bënte sa më parë, në mënyrë që ta siguronte fitoren qoftë me pika.

Por, në raundin e tretë, kur paksa do të lirohet nga përshtypja e atyre që kishte dëgjuar, dhe i vetëdijshëm se duhej të vendoste për fitoren, Bashkim Kosova kishte parasysh betimin e fitores që i duhej Kosovës. Dhe, në atë këndellje e sipër, do të mjaftojnë dy-tri të qëlluara me të majtën, që e djathta e tij ta gjejë kokën e boksierit grek dhe ai sakaq të gjendet në dysheme. Trajneri grek, me hedhjen e peshqirit, pengoi numërimin.

Bashkim Kosova nuk shprehu kurrfarë ngazëllimi, edhe pse kjo ishte një fitore që ia hapte rrugën drejt finales. Boksierit grek iu afrua, që në përputhje me sjelljen fer, t'i kërkonte falje. Boksieri grek, i cili me të shpejtë e mori veten dhe, pasi që ta ketë liruar gojën nga proteza e dhëmbëve, i tha se ishte arvanitas dhe se ndjehej krenar për këtë.

Ato që po i dëgjonte, Bashkim Kosovës i kishin ardhur të jashtëzakonshme. Nuk ia kishte marrë mendja se fjalë shqipe do të dëgjonte nga një boksier grekë. Ai, madje, nuk e kishte pasur të qartë sa duhej as fjalën "arvanitas", e cila i shfaqej disi e mjegulluar.

Pas shpalljes zyrtare të fituesit, u ndanë me një përqaftim shumë të ngrohtë, që po ashtu nuk kishte qenë në gjendje t'ia shpjegonte dridhërimin që ia kishte lënë brenda, gjë që kjo Bashkim Kosovën do ta turbullojë edhe më, sa që do të harrojë që të pranojë urimin e trajnerit Bruno, i cili po e priste në këndin e tij, i brengosur. Ai edhe më tutje kishte frikën se mos ishte fjala për ndonjë lëndim, që do të mund ta kishte çrregulluar boksierin e tij sa ai të humbë përqendrimin?

Natyrisht, se Bashkim Kosova, pasi largimit nga ringu, nuk e kishte parë të udhës që Seleksionuesit Bruno t'ia shpjegonte gjithë ato që kishin ndikuar te sjellja e tij e tillë në ring. Gjithnjë i mbërthyer me përjetimet e atij takimi, nuk ua kishte vu veshin as atyre që trajneri ia kishte drejtuar si vërejtje që nuk duhej të përsëriteshin më.

Pak më vonë, çështjen do t'ia hapë fizioterapeutit të klubit "Prishtina", doktor Sokol Hoti, i cili përkujdesej për të edhe në Olimpiadë. Ai do të buzëqesh dhe shpejt e shpejt ia mbajti "një leksion" nga historia shqiptare dhe lashtësia e saj, me ç'rast ia bëri me dije gjithë ato që dinte arvanitasit e Greqisë dhe shtrirjen e tyre.

Jemi gjak i shprishur, që gjithmonë ka derdhur mundin e vet për perandoritë e huaja, i kishte thënë.

Pak kohë pasi që ishte kthyer në Prishtinë, Bashkim Kosovës do t'i vijë një dhuratë nga Athina. Boksieri Kosta Kolias, bashkë me një letër përshëndetëse të shkruar në gjuhën shqipe, ia dërgonte librin "*Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve*" nga Aristid Kolias si dhe një kalendar me piktura të piktorëve arvanitas. Ia bënte me dije se Aristid Koliasin e kishte xhaxha, për të cilin do të marrë vesh se ishte kryetar i Lidhjes Arvanite në Athinë, lidhje kjo që kishte një anëtarësi prej mbi dyqind mijë vetash. Aristid Kolias ia kishte nënshkruar librin me përkushtimin:

“Vëlla, të bëhesh edhe kampion bote! Këtë presim të gjithë ne.”

Në duelin e tretë, në të katërtën e finales, Bashkim Kosova kishte pasur të bëjë me boksierin nga Kuba, Alvares, një talent të madh, për të cilin i kishin thënë se kultivonte mënyrën e njëjtë të sjelljes në ring, pra të lëvizjeve të shpejta nga e majta në të djathtë, të cilat rëndom përfundojnë me direktet e fortë me të djathtë. Të përbashkët kishin mos humbjen në ring, kështu që njëri prej tyre, më në fund, duhej ta provonte humbjen. Kjo ishte theksuar edhe nga shtypi dhe kishte rritur deri në pikën më të lartë të interesimit dhe opinionit për këtë ndeshje. Madje, kjo kishte bërë që shumë nga analistët këtë duel ta shohin si finale para finales.

Për Bashkim Kosovën, kjo ndeshje ishte i mirëseardhur, meqë kjo e nxiste edhe më të dëshmonte aftësitë e tij si dhe përkushtimin që kishte për titullin e kampionit olimpik, të cilin tashmë e shihte edhe si detyrim ndaj Kosovës. Këtë madje, në prag të duelit, do t’ia deklarojë edhe reporterit të BBC-së, duke theksuar se “sukseset e tij ishin edhe të Kosovës”.

Si do të shihet, kjo deklaratë (theksimi i Kosovës jashtë Jugosllavisë), me të shpejtë do të shfrytëzohet nga shtypi i Beogradit, por edhe nga një pjesë e atij të Sarajevës dhe Shkupit, që Bashkim Kosova, në vend se të përgëzohet për fitoren, e cila ia hapte rrugën për në finale, aty për aty të sulmohet për “mungesë të patriotizmit jugosllav”, gjë që pas atyre që do të ndodhin në finale, të akuzohet për “nxitës të shpërthimit nationalist dhe irredentist nga pozitat e kundërrevolucionit shqiptaromadh”!

Ishin pra akuza tepër të ashpra që i vinin nga shumë anë, të cilat nuk mund të merreshin ndryshe pos një fushatë e përbashkët, që në vend se të përkrahej në luftë për titullin e kampionit olimpik dhe ajo të fitohej, atij po i dërgoheshin mesazhe të hapura frikësimi dhe kërcënimi, me anën e të cilave jo vetëm që mund t’i rrezikohej karriera, por edhe shumë më shumë.

Qentë lehin e karvani ecën, i kishte thënë dr. Sokol Hoti, që ta mbronte sado pak nga ato kërcënime, të cilat mund ta pengonin në duel me boksierin e Kubës, që vlerësohej njëra ndër sfidat më të rënda drejt titullit të kampionit.

Bashkim Kosova, megjithatë nuk ua kishte vu veshin atyre që kishin për qëllim ta pengonin për në finale.

Dhe, rruga për në finale, në duelin me boksierin nga Kuba, do të kalojë në një përballim të ashpër më pak me kundërshtarin, e më shumë me gjyqtarin në ring, sovjetikun Karajev dhe me një pjesë të publikut, të cilët bënin çmos që fitoren t’ia merrnin me mjete josportive.

Se një pjesë e publikut amerikan me mish e me shpirt do të ishte në anën e boksierit nga Kuba, këtë e kishte të qartë. Seleksionuesi i reprezentacionit ia kishte bërë të ditur se fjala ishte edhe për një demonstrim të natyrës politike, që aty bashkonte urrejtjen kundër diktaturës komuniste të Fidel Kastros në Kubë me përkrahjen e kubanëve amerikanë dhe vetë amerikanëve, që ajo të kundërshtohet dhe të rrënohet nga brenda. Ky demonstrim i kubanëve amerikanë kishte ndodhur edhe në dy ndeshjet e para të kubanit, gjë që ishte përcjellë me një protestë të ashpër të udhëheqjes së reprezentacionit shtetëror të Kubës, të cilët duke theksuar “dashurinë e tyre të përjetshme ndaj Fidel Kastros dhe komunizmit”, ishin distancuar nga “propaganda imperialiste amerikane”. Madje, ekipi kuban kishte kërkuar nga Komiteti Olimpik që të mos lejoheshin demonstrime të tilla që, si thuhej, “fyenin patriotizmin komunist kuban”!

Duket se përplasjet politike kubane-amerikane mbi këto baza, do ta elektrizojnë edhe më atmosferën në hallën e madhe të sporteve, ku ishin të pranishëm mbi 15 mijë shikues. Flamuj kubanë pa yll, të shoqëruar me ata amerikanë, pankarte kundër komunizmit të Fidel Kastros, thirrje për rrëzimin e Kastros dhe shumë të tjera kishin krijuar një temperaturë shpërthyesë të ngjashme me ato që Bashkim Kosova kishte parë kohëve të fundit nëpër ringjet e Serbisë.

Boksieri kuban, i cili dukej shumë i shqetësuar nga atmosfera, kërkonte sa më parë luftën në ring. Por, këtë po e ngadalësonte gjyqtari në ring, sovjetiku Karajev, i cili Bashkim Kosovës, thujse me fjalë kërcënuese, do t'i drejtohet se nuk do të toleronte boks të papastër. Madje, këtë do t'ia përsëritë ndërkohë që boksierit kuban miqësisht do t'ia ledhatojë fytyrën dhe do t'ia urojë sukses.

Bashkim Kosova kishte ruajtur qetësinë, sado që mendja i kishte shkuar se mos me atë sjellje gjyqtari sovjetik dëshironte t'ia bënte me dije se për në finalen e mundshme, sovjetiku Nataliev (i cili të nesërmen luftonte me boksierin amerikan Hamilton), më me dëshirë do ta shihte boksierin kuban në mënyrë që para amerikanëve të demonstrohej “realiteti dhe solidariteti komunist”?

Më vonë do të kuptojë se e gjitha kishte qenë pjesë e një komploti të natyrës politike të përmasave të mëdha, ku ishin përfshirë rryma të ndryshme nga Beogradi, Moska e deri te Kremli, rreth të cilit kishte premtuar se një ditë, kur të vinte koha, patjetër se do të deklarohet.

Sidoqoftë, Bashkim Kosova, shpejt e pa qëllimin e gjyqtarit sovjetik, me ia pamundësue fitoren me lejin e luftës së papastër kundërshtarit, me moslejimin me e nokautue atë dhe me çfarëdo marifeti tjetër. I ndërgjegjshëm për këto rreziqe, Bashkim Kosova u përcaktua për boks të pastër, që me anën e lëvizjeve të shpejta herë në njëren anë e herë në tjetrën, kundërshtari t'ia krijonte përshtypjen se po i ikte, që pastaj me kundër zbritje, gjithnjë nga distanca, ta qëllonte me të djathtë.

Në të vërtetë kështu edhe do të veprojë. Thujse pjesa më e mirë e raundit të parë kaloi në këtë “ikje”, ku boksieri kuban sulmonte, por pa ia dalë që ta qëllonte, sado që publiku fitonte përshtypjen e përparësisë, gjë që kjo do ta ndezë atë edhe më tepër që ta përkrahë. Pak para përfundimit të raundit, “në ikje” e sipër, pasi e kishte hetuar çastin e duhur, Bashkim Kosova përdori të djathtë me sa fuqi kishte për ta qëlluar kubanin në pjesën e majtë të mjekrës, nga e cila ai u plandos në dysheme. Ishte ky nokaut klasik, por që gjyqtari sovjetik shfrytëzoi gongun që të mos numërojë. Përkundrazi, ekipit të kubanit iu lejua që atë ta bartin në kënd dhe ta freskojnë. Edhe pse dukej se ai nuk ishte kthjellur nga e rëna që kishte marrë në çastet e fundit të raundit të parë, gjyqtari urdhëroi fillimin e raundit të dytë pa e testuar fare gjendjen e boksierit kuban, që dukej qartë se nuk e kishte tejkaluar tronditjen. Bashkim Kosova në njëfarë mënyre nisi t'ia bënte me dije këtë gjyqtarit, por ai dha shenjën se duhej filluar. Në këtë ndërkohë, boksieri kuban, që edhe më tutje nuk ishte liruar nga gjendja e grogit, iu vërsul në trup me kokë dhe duke gjuajtur pa qartësi.

Bashkim Kosova, i përballur me një sjellje të turbullt të kundërshtarit, prapë e shikoi gjyqtarin, me ia ba me ditje gjendjen e boksierit kuban, së paku për me e mbrojtë nga pasojat e mundshme, por në vend se të merreshin masa që kjo të ndërpritej, kur do të përpiqet ta largonte, pa një pa dy do të marrë vërejtje publike.

Kjo elektrizoi edhe më atmosferën në hallën e madhe të sporteve, sepse përkrahësit e shumtë të kubanit do ta kuptojnë ashtu si dëshironin, pra si shenjë e rikthimi të boksierit të tyre. Kështu që, atij nga të gjitha anët do t'i drejtohen thirrjet:

“Qëlllo!”

“Rrëzo!”

“Qëlllo!”

“Gati e ke!”

Këtyre thirrjeve shurdhuese, pas pak, do t'u bashkohen edhe ato të natyrës politike, që vinin nga pjesa më e madhe e shikuesve, ku në njërin anë me flamujt amerikanë dhe ata kubanë pa yllin e kuq, i skandohej Kubës, ndërkohë që, në tjetrën anë, nga një pakicë (nga pamja disa të rinjë latinoamerikanë), hidhte parulla për Fidel Kastron, komunizmin dhe madje miqësinë me sovjetikët!

Në këtë zallahi, boksieri kubanë edhe më tutje vazhdonte t'i ngjishej për trupi dhe, po qe se do ta largonte, druante se mund të ndëshkohej me vërejtjen e dytë nga gjyqtari dhe me këtë diskualifikohej. Në atë siklet, kur kubani po e shtynte dhe tashmë kishte arritur këndin e tij, gjyqtari do të ndërhyjë, por duke i numëruar Bashkimit. Ndonëse i shpifur, ishte ky numërimi i parë dhe i vetëm që Bashkim Kosovës do t'i bëhet në karrierën e tij dhjetëvjeçare në ring. Në një gjendje hamendjeje të ngjashme me labirintin do të largohet te këndi i vet, dhe aty do të shohë kroatin Bruno, që po i jepte shenjë që ta nokautonte menjëherë kundërshtarin. I bëhej se po i thoshte nuk ka sport këtu. Ka luftë për jeta a vdekje. Madje, një zë i brendshëm po i thoshte:

“Kosova kërkon fitore! Bëje këtë! Mjaft me kompromise!”

Dhe, me ta parë shenjën e gjyqtarit se mund të fillohet lufta, Bashkim Kosova e harroi mëshirën. Kubanin, Boksierin kuban, që po bëhej gati prapë t'i lidhej për trupi dhe ta qëllonte nga të gjitha papastër, e priti me të majtën, ndërsa e qëlloi me të djathtën në kokë, por jo me gjithë forcën, sepse kishte frikë se mund ta dëmtonte. Kubani i shkallmuar, sikur ta kishte pritur atë të rënë, me të shpejtë do të plandoset për dysHEME gjerë e gjatë. Ashtu i zgataraqur dukej i mbaruar. Gjyqtari sovjetik, i zënë në befasi, filloi t'i numërojë kubanit, por kjo do t'i ndërpritet nga ekipi i Kubës, që duke e parë gjendjen e boksierit të tyre, pa leje u futen në ring për ta ndihmuar që të mos ngulfatej nga proteza e nofullave që i kishte mbetur në gojë. Pastaj hyri edhe mjeku kujdestar bashkë me ekipin e emergjencës. Kështu, kubani i shkallmuar përfundoi në një lese, me të cilën e nxorën.

Në ato rrethana Bashkim Kosova, për herë të parë do të ndjehet fajtor. I shkoi mendja se a ia vlente një fitore që për çmim kishte shkatërrimin e kundërshtarit? Nga kjo dilemë e rëndë e nxori gjyqtari sovjetik, që pasi ia zuri krahun sikur të kishte kapur ndonjë fajtor, ia ngrehu dorën lartë.

Deshi me i thanë se ai ishte fajtor për këtë, por sovjetiku me të shpejtë lëshoi ringun, ndërkohë që ai edhe një copë herë mbeti aty si i ngrirë, pa ua vu veshin fishkëllimave të shumta dhe kërcënimeve që i vinin nga të gjitha anët dhe pa ua vu veshin atyre që po ia thoshte doktor Sokol Hoti rreth asaj se nuk kishte zgjidhje tjetër. Mendjen e kishte vetëm te boksieri kuban dhe gjendja e tij e mjerë, me të cilën ai kërkonte shpëtim, ndërkohë që ai me mbrojte duhej të fitonte ndaj një të humburi.

Në orët e vona të mbrëmjes mori vesh se boksieri kubanë kishte marrë veten. Njëri nga anëtarët e shtabit teknik kuban kishte kërkuar të takohej me të dhe, në praninë e kroatit

Bruno dhe doktor Sokol Hotit ishte falënderua për sjelljet e tij korrekte në ring. Nga ato pak fjalë që kishin ndërruar fitohej përshtypja se edhe kubani fajtor për të gjitha e shihte gjyqtarin sovjetik, i cili ashtu si ishte sjellë e kishte rrezikuar boksierin e tyre.

Por, drama rreth finales, që do të nisë atë ditë, nuk do mbarojë me aq. Për habinë e madhe, ajo vazhdoi të nesërmen në duelin tjetër gjysmëfinale midis boksierit amerikan Luis dhe sovjetikut Nataliev, që përcaktonte kundërshtarin e Bashkim Kosovës në luftë për medaljen e artë olimpikë.

Bashkë me Brunon dhe doktor Sokol Hotin kishin zënë vend në lozhën e veçantë për mysafirët, ku kishte emra të njohur të boksit botëror. Aty kishte edhe shumë menaxherë, që pikasin me vëmendje boksierët që duhej të kalonin nga boksi amator në atë profesionist, ku tashmë emri i Bashkim Kosovës gjendej në secilën listë dhe pritej epilogu i finales që të merrte ofertat e para. Shtypi amerikan, ia parashikonte një të ardhme të suksesshme duke e radhitur ndër ata që pas tri-katër vitesh, me kusht që ta ngjiste peshën, të bëhet kampion botëror në kategorinë e rëndë.

Por, nga ajo lozhë, Bashkim Kosova mendjen e kishte të kundërshtari i ardhshëm. Me dëshirë do ta takonte boksierin amerikan Luis, sepse ashtu sendërtonte ëndrrën e tij për një finale të madhe olimpikë me një boksier amerikan. Por, po ashtu, ishte një mllaf i brendshëm, që iu kishte zënë mulla nga dueli me kubanin dhe ikonografia serbo-ruse mbi bazat e ortodoksisë me të cilën ishte ballafaquar kohëve të fundit nëpër ringjet e Serbisë me fyerjet e pareshtura që i bëheshin atij dhe Kosovës, që gjithnjë e më shumë ia kërkonte rusin. Madje, një çast mendja ia tha se dashamirët e tij në Kosovë dhe gjetiu më shumë do t'i kënaqte një fitore ndaj rusit se gjithë tituj e botës. Më vonë Bashkim Kosova do të pranojë se jo me fajin e tij, shpirtin sportiv ia kishte vrarë politika, ndërkohë që ia kishte zgjuar vetëdijen se edhe sporti, çfarëdo qoftë, ishte pjesë e rëndësishme e rrjedhave shoqërore, ku frustrimet kolektive më shumë se kudo mund t'u prinin kthesave për të mirë apo për të keq.

Boksieri sovjetik Nataliev, kishte duar të gjata dhe shfaqej shumë i rrezikshëm pse ato i shfrytëzonte për të ndërlidhur me shumë mençuri mbrojtjen dhe sulmin. Në ring lëvizte me maturi, ndërkohë që të majtën e fuqishme e përdorte vetëm kur ishte i sigurt se ajo mund ta qëllonte kundërshtarin. Në tri duelet e para dy herë kishte fituar me nokaut klasik, madje në raundin e parë. Boksieri amerikan Luis, ishte më i shkurtër në trup, por shumë i lëvizshëm dhe gjithnjë kërkonte luftën nga afër. Ishte shumë i rrezikshëm kur kundërshtarin e detyronte të mbrohej i mbyllur, ngaqë atëherë i kthehej pleksusit për deri sa thyente gardin. Pra, fjala ishte për një boksier sulmues dhe shumë të qëndrueshëm, që merrte shumë të rëna, por që ato njëherësh i kthente me kamatë, gjë që fitoret, të shumtën i arrinte me pikë, por bindshëm. Në duelin paraprak, ndaj boksierit nga Portoriko, Valdes, kishte fituar me nokaut teknik në raundin e dytë. Andaj, me të drejtë, dueli midis amerikanit dhe rusit ishte vlerësuar si një ndeshje midis dy stileve të kundërta, duel ky që kishte edhe një rëndësi tjetër, meqë vendoste se kush nga trio e fuqishme botërore (SHBA-të, Kuba dhe Bashkimi Sovjetik), që kishin nga tre finalistë, do ta kishte të katërtin. Kështu, amerikanët dhe sovjetikët, pasi që boksieri kuban në duel me Bashkim Kosovën, nuk ia kishte dalë të siguronte finalistin e katërt, luftonin për prestigj në nivel botëror.

Nëse rivaliteteve sportive midis këtyre vendeve u shtohej edhe ai në planin politik, ku si superfuqi polarizonin botën mbi baza të ndarjeve të blloqeve dhe atyre ideologjike, atëherë ishte më se e qartë se dueli gjysmë final shfaqej si uverture e nxehtë për tri duelet në finale

midis boksierëve të këtyre vendeve (në kategorinë velter, gjysmë të mesme dhe të rëndë), të cilat priteshin me interesim të jashtëzakonshëm.

Në përputhje me këtë pritje, dueli midis amerikanit dhe sovjetikut filloi me ofensivën e amerikanit dhe mbrojtjen e mirë të sovjetikut, i cili sillej me shumë maturi dhe nuk do të lejojë që amerikanin ta detyrojë që ta pranojë luftën nga afër. Gjatë raundit të parë, boksieri sovjetik ia doli dy-tri herë ta qëllojë bukur mirë amerikanin me të majtën , gjë që në saje të tyre, mund të thuhej, se raundin e parë e kishte të vetin.

Por, drama do të fillojë në raundin e dytë, kur boksieri amerikan, megjithatë ia doli që t'i afrohet boksierit sovjetik dhe me një rrebesh të rënash në pleksus ia rrënoi mbrojtjen. Gjatë asaj ofensive, kur dukej se boksierit sovjetik i duhej numërimi i gjyqtarit në ring, por ai vetëm i ndante. Në njërën prej atyre situatave, kur boksieri amerikan, sipas urdhrit të gjyqtarit ishte në zmbropsje, pa e pritur shenjën “boks” dhe, siç e kërkonin rregullat në raste të tilla, pa i fshirë për trupi dorëzat e lagështa, sovjetiku e qëlloi amerikanin e pambrojtur në ballë me ç’rast atij i shpërtheu arkada. Në vend se ta ndëshkonte për këtë shkelje të rëndë të qëllimshme boksierin sovjetik (së paku me vërejte publike ose me diskualifikim), sikur çdo gjë të ishte në rregull, gjyqtari rumun Dimitru, kërkoi ndërhyrjen e mjekut kujdestar dhe mendimin e tij se a mund të vazhdohej lufta, ngaqë boksierit amerikan nuk po i ndalej gjaku. Meqë raundit të dytë nuk i kishin mbetur vetëm disa sekonda, mjeku lejoi vazhdimin e duelit, por boksieri sovjetik, që kishte mbetur i pa ndëshkuar për atë që kishte bërë, do të përqendrohet që të qëllojë arkadën e amerikanit, në mënyrë që të detyrojë ndërprerjen e duelit. Kjo sjellje tejet brutale dhe josportive nga ana e boksierit sovjetik dhe lejimi i saj nga gjyqtari rumun, nga publiku ishin kuptuar si “aleancë” ideologjike rumune-sovjetike kundër amerikanëve, kështu që gjatë pushimit, krahas kërcënimeve dhe çirrijeve nga të gjitha anët, në drejtim të ringut, ku gjyqtari rumun priste fillimin e raundit të tretë, ishin gjuajtur disa gjësende (shishe uji, shkrepsë, banane dhe monedha), ca prej të cilëve kishin qëlluar gjyqtarin. Gjyqtari rumun, sikur të kishte pritur diç të tillë, me të shpejtë, me disa prej tyre, i ishte drejtuar delegatit të duelit dhe kishte kërkuar që dueli të ndërpritej, meqë sipas tij publiku këtë nuk e lejonte. Por, pas ndërhyrjes së organeve të sigurisë dhe një vërejtje që publikut i kishte ardhur nga spikeri zyrtar, ato kishin pushuar, sado që gjestet kërcënuese nga publiku edhe më tutje vazhdonin. Kur duhej të vazhdonte raundi i tretë, doli në skenë trajneri sovjetik që po kërkonte ndërprerjen e duelit, meqë në afërsi të ringut dikush nga publiku kishte djegur flamurin sovjetik dhe ashtu të shkrumbuar e kishte përplasur në drejtim të këndit sovjetik. Edhe pse kujdestarët përreth ringut kishin penguar që flamuri i djegur të arrinte këndin sovjetik, shtabi teknik sovjetik kishte reaguar me panik, duke u larguar nga pjesa e tyre e ringut. Trajneri kishte kërkuar që këtë ta bënte dhe boksieri i tyre, i cili, megjithatë nuk e kishte lëshuar ringun, nga shkak se nuk ia kishte dalë që të vlerësonte si duhej mesazhin e marrë nga anash. Me gjithë që delegati i ndeshjes, një kanadez, kishte vlerësuar se ngacmimi me djegien e flamurit sovjetik nuk ishte shkas për ndërprerjen e duelit, shtabi teknik sovjetik, edhe më tutje nuk i afrohej ringut. Protestonin teatralisht dhe kjo provokonte edhe më shumë publikun, i cili edhe ashtu ishte shumë i tendosur. Pasi që do të ndërhynte edhe personat tjerë zyrtarë dhe gjyqtarit në ring do t'i jepet shenja që të fillojë raundi i tretë, sovjetikët do t'i afrohen këndit të tyre, por jo të gjithë. Një pjesë e tyre edhe më tutje mbetën para delegatit, të cilin e pengonin në punë. U desh ndërhyrja e kujdestarëve të rendit që ata të kthehen të këndi i tyre. Por edhe te këndi i tyre ata vazhduan të bënin zhurmë

pa qarë kokën se ashtu pengonin edhe gjyqtarët jashtë ringut (katër sosh), të cilët jepnin pikët vlerësuese.

Në këto rrethana vazhdoi raundi i tretë dhe vendimtar midis boksierit amerikan dhe atij sovjetik, ku në njërën anë, nga boksieri amerikan shihej një përkushtim i paparë që të fitojë sa më shumë pikë me anën e sulmeve të vazhdueshme, dhe në tjetrën anë, nga të boksieri sovjetik, do të shihet një përpjekje po ashtu e paparë që për cak të vetëm ta ketë arkadën e çarë të kundërshtarit në mënyrë që të detyrojë gjyqtarin në ring ta ndërpresë luftën para kohe.

Por, gjyqtari rumun, i cili kishte heshtur kur boksieri sovjetik e kishte qëlluar boksierin amerikan kur dueli ishte i ndërprerë, njësojë do të heshtë jo vetëm ndaj arkadës së çarë të amerikanit, e cila nxirrte gjak pareshtur, por ai do të heshtë edhe ndaj atyre sulmeve të papastra të amerikanit, kur ai do të qëllojë nga poshtë dhe nga prapa dhe do ta detyrojë boksierin sovjetik që të kërkojë shpëtim në kënd. Ofensiva e paparë e boksierit amerikan dhe sjelljet provokuese të trajnerit sovjetik që të ndërpritej dueli, jo vetëm që nuk do të ndikojnë te gjyqtari rumun, por ai, sikur ta kishte humbur mbikëqyrjen, nuk do të kërkojë as ndërhyrjen e mjekut kujdestar që amerikanit t'i mbyllet përkohësisht arkada. Madje, do të kalojnë edhe disa sekonda pas gongut dhe, këto do të kishin mundur të ishin fatale për njërin apo tjetrin boksier, për deri sa gjyqtari rumun, nga reagimet e boksierit amerikan, i cili i ishte drejtuar këndit të vet që t'ia pastronin fryrën nga gjaku, do ta ketë kuptuar se dueli kishte përfunduar.

Meqë fituesin do ta vendosnin pikët, shtabi teknik sovjetik edhe më tutje do të vazhdojë të reagojnë, duke bërë përpjekje që të ndikojnë gjyqtarët anësorë (gjermanolindorin, portorikanin, japonezin dhe turkun). Edhe këtu do të krijohet një tollovi, që për t'u qetësuar paksa do t'i duhej ndërhyrja e organeve të rendit. Kur kishin kuptuar se me pikë duelin e kishte fituar boksieri amerikan Luis (rezultati kishte qenë tre me dy: gjermanolindori dhe rumuni për sovjetikun, ndërsa portorikani, japonezi dhe turku për amerikanin), sovjetikët kishin tërhequr boksierin nga ringu dhe demonstrativisht ishin larguar nga salla. Ky veprim tepër provokues, ishte përcjellë me fishkëllima dhe fyerje të ndryshme që publiku ua kishte drejtuar sovjetikëve kur po largoheshin. Nuk kishin munguar edhe gjësendet e ndryshme me të cilat ishin gjuajtur.

Duke parë ato që kishin ndodhur gjatë dhe pas atij dueli, Bashkim Kosova për herë të parë kishte qenë në gjendje që të kuptonte se pse sporti dhe ngjarjet sportive në përgjithësi janë në gjendje që të nxjerrin në pah disponimet e caktuara shoqërore, por edhe t'u shërbejnë si paralajmërime të qarta disa zhvillimeve të cilave u duhen kthesat e ashpra. Në Los Anxhelos kishte fituar përshtypjen se ato që kishte përjetuar në dy-tri vitet e fundit në ringjet jugosllave (Serbi, Vojvodinë dhe Bosnje dhe Hercegovinë), e që do të vazhdojnë më me ashpërsi edhe gjatë katër-pesë viteve të ardhshme deri sa me dhunë do të rrënohet autonomia e Kosovës (në mars të viti 1989), nuk ishin tjetër pos pjesë e këtyre konfrontimeve të mëdha, ku Beogradi, pra Serbia, përkundër vullnetit të pjesës tjetër të Jugosllavisë (Kroacisë, Sllovenisë dhe Kosovës) qartas ishte rreshtuar në anën e hegjemonizmit ideologjik të mbështetur nga Moska dhe kundër demokracisë perëndimor me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye.

Natyrisht, se përvijimin e këtij përcaktimi të natyrës politike, me të cilën do të ushqehet atmosfera e konfrontimeve të mëvonshme në gjithë nivelin e vendit, me çka do të

dalin në pah përmasat e mëdha të krizës jugosllave edhe mbi bazat e ndarjes Lindje-Perëndim, Bashkim Kosova kishte pasur rastin ta nuhaste qysh në Los Anxhelos, kur pos trajnerit Bruno, pjesa tjetër e shtabit teknik dhe e reprezentacionit kishin manifestuar disponim të hapur prosovjetik. Ky disponim prosovjetik ishte parë gjatë duelit gjysmëfinale midis Luisit dhe Natalievit dhe menjëherë pas tij. Me këtë rast kallja e flamurit sovjetik nga disa shikues ishte përcjellë me një protestë të atypëratyshme nga shtabi teknik i ekipit jugosllav, i cili ishte solidarizuar me kërkesën e sovjetikëve që të ndërpritet dueli, ndërkohë që Kryetari i Komitetit Olimpik jugosllav, serbi Markoviq, krynevete, po atë natë, kishte protestuar te Komiteti Olimpik, duke kërkuar nga komisioni i garave që dueli të shpallej i ndërprerë nga publiku, gjë që kjo nënkuptonte shpalljen e boksierit sovjetik fitues në tryezën e gjelbër. Protestës jugosllave me të shpejtë i ishin bashkuar edhe Komitetet Olimpik nga Kuba, Gjermania Lindore, Rumunia, Bullgaria, të cilat kalljen e flamurit sovjetik si dhe demonstrimet e pareshtura kundër regjimit të Fidel Kastros, i kishin quajtur “pjesë e presioneve politike të natyrës imperialiste kundër vendeve socialiste dhe përcaktimit të tyre komunist”. Në disa biseda midis përfaqësuesve të vendeve socialiste (ku nuk kishin marrë pjesë polakët), nëse nuk do të merreshin masa ndaj ngacmimeve të rënda të publikut amerikan, ishte përmendur mundësia që Bashkimi Sovjetik dhe Kuba t’i tërhiqnin boksierët e tyre (gjashtë sosh) nga ndeshjet finale dhe me këtë Lojërave Olimpikë në Los Anxhelos t’u pamundësohej sukcesi sportiv, duke akuzuar amerikanët për këtë, gjë që do të paraqiste një hakmarrje të vogël ndaj tyre për bojkotin që ua kishin bërë Lojërave Paraprake Olimpikë të mbajtura në Moskë para katër vitesh. Serbi Markoviq, po ashtu krye në vete, kishte deklaruar se bojkotit të mundshëm të finales olimpikë do t’i bashkohej edhe Jugosllavia, duke mos lejuar boksierin e saj që të dalë në ring në finale me boksierin amerikan.

Kjo e kishte tmerruar seleksionuesin e reprezentacionit shtetëror të boksit, kroatin Bruno, i cili, po ashtu krye në vete, kishte organizuar një konferencë të veçantë për shtyp, ku kishte deklaruar se serbi Markoviq kishte folur i paautorizuar, dhe se, ai dhe boksieri i tij, (fjala ishte për Bashkim Kosovën si të vetmin që kishte arritur finalen olimpikë) do të dalin në ring, edhe po qe se Beogradi zyrtar, edhe pse këtë nuk e besonte, do të vendosë që t’i bashkohej bojkotit eventual të drejtuar nga sovjetikët.

Por, deri te bojkoti i paralajmëruar ideologjik nuk do të vijë. Si do të merret vesh Moska zyrtare, pasi që ta ketë parë se nuk do të përkrahej nga vende të tjera, siç ishin të painkuadruarat, pos nga një pjesë e aleatëve të bllokut socialist, madje jo prej të gjithëve, kishte kërkuar nga sportistët e saj “të vazhdohet gara sportive edhe përkundër ngacmimeve”. Komiteti Olimpik Sovjetik, kishte dalë me një deklaratë zyrtare, ku si thuhej, “gjykoheshin ngacmimet me prapavijë politike, por po ashtu nuk pranoheshin bojkotimet, meqë ato dëmtojnë frymën sportive që bashkon popujt”.

Edhe pse Kremlini zyrtar do të dështojë me komplotin e pjesshëm Lojërave Olimpikë, megjithatë, sjellja e kryetarit të Komitetit Olimpik jugosllav, Markoviq, kishte hapur të çarat e para dhe të papajtueshme në shtabin teknik të ekipit të boksit, të cilat, si do të shihet, pa përfunduar mirë Lojërat Olimpikë të Los Anxhelosit, do të barten në skenën e brendshme politike jugosllave, kur përfaqësuesit e Kroacisë, të Sllovenisë dhe të Kosovës në federatë do të kërkojnë sqarime si dhe pse kishte ardhur deri tek protesta e Komitetit Olimpik të Jugosllavisë drejtuar Komitetit Ndërkombëtar Olimpik pas djegie së flamurit sovjetik në Lojërat Olimpikë, kur ajo nuk kishte marrë miratim zyrtar, dhe pse përfaqësuesi serb ishte

solidarizur me bojkotin e ndeshjeve finale, po qe se këtë do ta kërkonte Komiteti Olimpik i Bashkimit Sovjetik?

Ndonëse pala serbe hapjes së kësaj teme i kishte bishtnuar me tërheqjen e Markoviçit nga Komiteti Olimpik dhe emërimin e një tjetri, me arsyetimin se kishte shprehur qëndrime personale, përçarjet në sportin jugosllav mbi këto baza, jo vetëm që nuk do të fashitën, por do të përshkallëzohen, sepse Beogradi edhe më tutje do të vazhdojë sportin ta shfrytëzojë në një rën anë për promovimin e frymës së populizmit në nivel shoqëror dhe në tjetrën që përfaqësimin sportiv federativ t'ia rrënojë parimin kushtetues të konsensusit, me çka pastaj do t'u hapet rruga pretendimeve politike unitariste për vënien e federatës nën mbikëqyrjen e Serbisë mbi këto baza, ku viktimitë e parë do të binte subjektiviteti i Kosovës në federatë njësi konstituive e saj që ia garantonte kushtetua e vitit 1974.

Bashkim Kosova, pasi që të kishte kaluar shqetësimin e një natë pa gjumë, që e kishte nga mundësia e bojkotit të ndeshjeve finale, siç kishte paralajmëruar Markoviç, as të nesërmen nuk ishte liruar nga trysnia e atyre që ndodhnin jashtë ringut, ani pse kroati Bruno i kishte thënë se deri te lufta në finale do të vinte edhe po qe se këtë do ta ndalonte politika jugosllave.

Ringun e kemi të hapur, i kishte thënë dhe nuk ka kush që na e ndalon.

Në një gjendje tendosëse që nuk e kishte përjetuar deri më atëherë, përkundër ngacmimeve tepër të rënda nëpër ringjet serbe, Bashkim Kosova, atë pasdite dhe të nesërmen e kishte kaluar me doktor Sokol Hotin, i cili më shumë ishte përkujdesur për anën psikike të tij se sa atë fizike. Kështu, nga ai për herë të parë do të dëgjojë pak më shumë pse sporti dhe politika në Jugosllavi ngatërroheshin mes veti për aq sa të mos ketë më kufij të qartë midis politikës sportive dhe sportit politik, që për çmim kishte politizimin e hapur të sportit për qëllime politike.

“Ti po lufton për Kosovën dhe për të ardhmen e saj. Fitorja jote në Olimpiadë do të thotë afirmim i madh ndërkombëtar për Kosovën. Kjo fitore njerëzitet tanë do t'i mbush me shpresa të mëdha...”

Ngjashëm do t'i flasë edhe seleksionuesi i reprezentacionit Bruno, i cili, duke e motivuar për duelin final me amerikanin, i kishte thënë se medalja e artë atë e ngjiste në elitën botërore, por njëherësh edhe Kosovën e bënte të njohur në gjithë botën.

“Ke një emër dhe mbiemër që secilës fitore i jep kuptim të veçantë”.

Por, edhe pa ato që do të dëgjojë nga doktor Sokol Hoti dhe seleksionuesi Bruno, Bashkim Kosova ishte i ndërgjegjshëm për rëndësinë e duelit final me amerikanin si sportist që lufton për suksese sa më të mëdha, sidomos në garat ndërkombëtare dhe, si qytetar i Kosovës, i cili desh a pa desh lidhej me problematikën e saj shoqërore që sfidohej nga politika ditore dhe raportet e saj kundërthënëse, me ç'rast atmosfera sportive tashmë shfrytëzohej për disponime të ndryshme politike, ku thirrja për “Kosovën”, në një rën anë manifestohej si patriotizëm shtetëror (Kosova Republikë) dhe në tjetrën anë si mit për qëllime hegjemoniste (Kosova – djep mesjetar serb), të cilat përplaseshin gjithnjë e më shumë mes vete dhe krijonin ringje në ringje.

Kështu do të ndodhë edhe në Los Anxhelos, ku për herë të parë, në një arenë të madhe ndërkombëtare do të ndeshen parulla “Kosova Republikë” me atë “Kosova – djep mesjetar serb”. Ato shpaloseshin në një ambient tepër të përshtatshëm, ku mundësohej promovimi para një spektakli botëror, me çka krizës në zhvillim e sipër, siç ishte ajo e Kosovës, i jepte

dimension ndërkombëtar. Megjithatë, siç kishte shkruar një ditë më parë “New York Times”, ato nuk ishin “konkurrese” për nga ngacjonalizmat (midis atij shqiptaromadhe dhe serb), ishte kërkesë për barazi dhe si e tillë e drejtë dhe aspak e dëmshme për federatën jugosllav, ndërsa ajo “për djepin mesjetar serb” ishte në përputhje me ikonografinë hegjemoniste serbomadhe, që Jugosllavinë mund ta qonte kah tabori sovjetik, që thuhej se tashmë, krahas kartës ideologjike, kishte filluar të luajë edhe me atë të hegjemonisë ortodokse, në mënyrë që Jugosllavinë, nëpërmes shpërthimit të një konflikti midis serbëve dhe shqiptarëve për Kosovën dhe statutin e saj të ardhshëm, ta kthejë në taborin sovjetik.

Rreth asaj që tashmë po ndodhte në hallën e madhe olimpike të Los Anxhelosit, të mbushur plot e përplot me mbi pesëmbëdhjetë mijë shikues, krahas shkrimit të “New York Times”, me përmbajtjen e të cilit ishin njoftuar të gjithë reprezentuesit, duke e cilësuar atë “pjesë të trysnisë së disa qarqeve imperialiste ndaj Jugosllavisë dhe rendit të saj kushtetues”, gjë që ky ishte një paralajmërim që kësaj fushate t’i jepej përgjigje “me demonstrimin e patriotizmit socialist jugosllav”, Bashkim Kosova ishte njoftuar gjatë paradites nga doktor Sokol Hoti, i cili ia kishte bërë me dije se para hallës së sporteve ishin shfaqur grupe të ndryshme demonstruesish që bartnin parullën “*Kosova Republikë*”, por edhe të tjerë me atë “*Kosova – djep mesjetar serb*”. Pak më vonë, por tash si shqetësim, kjo i ishte thënë edhe nga një anëtarë tjetër i shtabit teknik (një serb i Bosnjës), i cili kishte paralajmëruar se nëse atmosfera do të bartej gjatë ndeshjes, atëherë duhet menduar, si tha “një kundërpërgjigje”, që do të mund të ishte bojkotimi demonstrativ i duelit.

Fjalët e boshnjakut Bashkim Kosovës serish ia kthyen ankthin që kishte para dy ditësh, kur për herë të parë kishte dëgjuar fjalën “bojkot” të finales. Njëherë i shkoi mendja se boshnjaku, me urdhrin e dikuja kishte thënë me e ligështue para duelit final. Kishte heshtur, por në mendje kishte pasur ato që ia kishte thënë kroati Bruno se ai do të dilte në ring, pa marrë parasysh se çfarë do të jetë qëndrimi zyrtar.

Nuk ka kthim prapa, i kishte thënë Bruno. Erdhi koha që Bashkim Kosova të dëshmohej para gjithë botës se është i pandalshëm.

Fjalët se sytë e botës tashmë drejtoheshin kah Bashkim Kosova dhe fuqia e tij e pathyeshme ia kishte kur po niseshin për në hallën olimpike.

“Edhi koha e Bashkim Kosovës”.

Në të vërtetë Bashkim Kosova, i bindur se çfarë do të thoshte fitorja për të, por edhe për dashamirët e shumtë në Kosovë dhe pse jo edhe për çështjen e Kosovës në rrethanat kur mbi të thyheshin shpata të ndryshme (siç do ta tregojë edhe demonstrimi në Los Anxhelos me të cilin nxirrej në pah një konflikt historik, që nuk kishte përfunduar dhe mund të ngjiste që të kishte epilogun e një lufte të ngjashme me atë të ringut si një spektakël botëror me arbitër ndërkombëtar), do të përqendrohet te lufta sportive, por kjo nuk do ta lirojë nga emocionet, të cilat sa vinin e shtoheshin sa më shumë që afrohej koha e ndeshjes me amerikanin.

Meqë, dueli i tij ishte i shtati me radhë, nga gjithsej dhjetë, pjesën më të madhe të garës do ta përcjellë në dhomën e prirjes bashkë me Brunon dhe doktor Sokol Hotin. Aty kishin një ekran të madh televiziv prej nga barteshin luftimet, të cilat zhvilloheshin në rivalitetin midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës në njërën anë, që kishte katër boksier në finale dhe Bashkimit Sovjetik dhe Kubës, në anën tjetër, që kishin nga tre boksier në finale. Deri më atëherë, amerikanët kishin fituar dy medalje të arta (të parën në kategorinë mizë në

luftë me boksierin sovjetik dhe tjetrën në velter ndaj boksierit kubanë), u mbetej që për të artën të luftonin në kategorinë e mesme me të dhe në atë të rëndë me boksierin nga Kuba, Stivenson, që vlerësohej boksieri më i mirë në botë në këtë kategori dhe tashmë përpjekjet amerikanë nuk ishin përqendruar gjithaq në duelin final që atij t'i merrej titulli, por që ta përvetësonin për të kaluar në ligën profesionale të boksit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me apo pa lejen e Fidel Kastros, i cili prej tij tashmë ishte shpallur “pasuri kombëtare” e Kubës.

Nga ekrani televiziv, po ashtu, depërtonte edhe atmosfera tepër e zjarrtë që mbretëronte në hallën olimpikë të mbushur plot e përplot. Krahas rivalitetit sportiv amerikano-kuban, ku megjithatë ruhej solidariteti amerikan për kubanët, te publiku i pranishëm shihej aleanca e tyre kundër sovjetikëve, qoftë kur boksonin amerikanët kundër sovjetikëve qoftë kur kubanët luftonin kundër sovjetikëve.

Nga demonstrimet e shqiptaro-amerikanëve me parullën “*Kosova Republikë*” dhe atë të serbo-amerikanëve me “*Kosova – djep mesjetar serb*” për të cilën ishte alarmuar nga delegacioni jugosllav nuk vinte ndonjë pamje. Mbase ata ishin aty, por vëmendja e kamerave televizive i anashkalonte nga shkaku se çdo gjë ishte e përqendruar tek duelet e ndërsjella midis amerikanëve, sovjetikëve dhe kubanëve, ku deri më atëherë sovjetikët kishin humbur dy duele me amerikanët dhe një duel me kubanët.

Bashkim Kosova e dinte se atmosfera e zjarrtë e tifozëve amerikanë do ta përcillte edhe atë dhe, ishte e natyrshme, që ajo të fuste në hije të tjerat.

“Mendo vetëm për fitoren. Të tjerat janë pjesë përcjellëse e saj...Nëse të vjen ngushtë, mendo te Kosova...Sepse, aty gjen fuqi...”

Këto ia tha Bruno, kur po bëheshin gati që të niseshin për në ring. Zërin e kishte të shteruar, ndërsa fjalët i nxirrte si lutje.

Bashkim Kosova nuk ia ktheu pos që miratoi me kokë ato që kapi nga trajneri, pamja e të cilit iu shfaq tjetër nga ajo me të cilën ishte mësuar. Në ato çaste thuajse të papërshkrueshme, me një ndjesi ndër më të veçantat, ndjeu se mendja qëllimisht po ia rikthente një pjesë të atmosferës nga përcjellja në Prishtinë, ku thirrjet “Kosova” kishin një domethënie të veçantë dhe se jehona me të cilën po përballlej tashmë i vinte e tillë, dhe ajo çuditërisht po ia fashiste atë “U-S-A!”, e cilat deri më atëherë i kishte ardhur aq fuqishëm sikur të ishte mbi çdo gjë tjetër.

Me ehon e Kosovës në kokë, që i bëhej se edhe më tutje po i vinte nga thirrjet e mijëra e mijëra zërave të Prishtinës, si një mburojë që po ia përjashtonte të tjerat, do të përballojë ndeshjen e parë dhe tejet të ashpër me publikun vendës, që vazhdonte të trimëronte boksierin amerikan, i cili bashkë me përcjellësit e shumtë, disa hapa para tij çante rrugën për në ring, ku duhej të dilte i pari. Madje, ajo mburojë do t'i ndihmojë edhe gjatë daljes në ring, kur kishte ndodhur ai shpërthimi i çirrës “U-S-A”, i shoqëruar me valëvitjen e mijëra flamujve amerikanë, të madhësive të ndryshme, që lëshoheshin deri skaj ringut. Dhe në vend se atmosfera impozante ta bënte të ndjehej inferior dhe madje i frikësuar, hetoi se valëvitja e flamujve amerikanë po ia krijonte ndjenjën e çuditshme të afrisë me ta sikur ata ishin aty për të dhe në përkrahje të tij...

Kjo ndjenjë, pra e ndodhjes në një dilerium të jashtëzakonshëm, nuk do t'i largohet gjatë gjithë kohës së duelit dhe si të tillë do ta përjetojë edhe atëherë kur ai do ta mbyll para kohe me fitore në raundin e dytë. Kënaqësia e atij përjetimi, do t'i mbetet thuajse e paprekur

deri atëherë kur pasi të marrë medaljen do të hetojë ngritjen e flamurit jugosllav i shoqëruar nga të dy anët nga flamujt amerikanë.

Në atë ndërkohë, nga ai përqendrim i ngrirë, ku imazhi i flamujve amerikanë po i ngatërrohej me trengjyrëshin jugosllav, hetoi ndërhyrjen e atyre që tashmë në një rën anë dhe në tjetrën anë të ringut, po zhvilloheshin si demonstrime me parullën “*Kosova Republikë*” dhe “*Kosova – djep mesjetar serb*”.

Para se të vijë deri te ai demonstrim, i cili qëllimisht nga të dy anët ishte paraparë që të ishte i tillë, pra të përmbushte zbrazëtirën që krijohej me rastin e intonimit të himnit shtetëror, Bashkim Kosova do të ketë punë shumë më të lehtë me boksierin amerikan seç kishte menduar. Madje, kishte përshtypjen se boksieri amerikan kishte një lëndim në krahun e djathtë, që e kishte marrë nga dueli paraprak dramatik me sovjetikun Nataliev, gjë që kjo pasqyrohej me sjelljen e tij defensive, jashtë çdo parashikimi. Këtë do ta hetojnë edhe shikuesit, të cilët do të fillojnë të nxjerrin atë “*Goo!*”, që do t’u kthehej në çirrje dëshpëruese kur do të fillojë raundi i dytë dhe boksieri amerikan nga disa të rëna të fuqishme të marra në pleksus dhe në kokë u gjendet para nokautit klasik, që pengoi hedhja e peshqirit nga ana e trajnerit të tij.

I ndodhur përballë një gjendjeje ndër më të veçantat e jetës së tij, kur e dinte se do të mjaftonte vetëm një e qëlluar e fortë që ta vendoste fatin e atij dueli dhe me këtë edhe të përmbushjes së një ideali ndër më të mëdhenjtë, Bashkim Kosova, megjithatë hezitonte që këtë ta bënte. Diçka e brendshme, fare e pashpjegueshme, po e pengonte që çështjen ta zgjidhte në mënyrën më të thjeshtë të mundshme me çka parandaloheshin që të gjitha të papriturat që mund të jenë të pritshme në duelet e një rëndësie të tillë. Madje edhe kur trajneri Bruno, gjatë pushimit midis raundit të parë dhe të dytë, po i thoshte se nuk i duhej edhe shumë që e gjitha të merrte fund ashtu siç kishte ëndërruar, dhe se tashmë e kishte në dorë zogun që nuk duhej lëshuar, sikur i bëhej që kjo paraqiste fundin dhe me të humbjen e përhershme të asaj ëndrre të madhe, e cila e kishte shtyrë përpara... Mbase ishte frika se ndalja mund ta privonte nga diçka pa të cilën të tjerat nuk kishin kuptim, një çast, duart e tij iu dhanë një lëvizje të pambikëqyrrur fare prej nga disa të rëna të njëpasnjëshme, që do ta gjejnë kokën e boksierit amerikan, mjaftuan që atë ta sjellin para një gjendje kur ai mund të rrëzohej, dhe se kjo kishte bërë që trajneri i tij, me hedhjen e peshqirit, ta pengojë.

Dhe kur kishte ndodhur kjo dhe kundërshtari i tij ishte tërhequr në këndin e vet, i gjendur në përqafimin e Brunos dhe të doktor Sokol Hotit, çasti i shumëpritur, çuditërisht jo vetëm që nuk e kishte ngazëllyer, jo vetëm që nuk e kishte mbushur me shpërthim emocional të pambikëqyrrur, siç e kishte parafytyruar përherë, por sikur e kishte kthyer në një qenie të zbrazur fare, jashtë ndjenjave...

“Tash je kampion”, po i thoshte dikush, duke e përqafuar. Nga ai shtrëngim koka po ia kapte disa fjalë të shkëputura si ato “Bashkimi... Kosova... të pavdekshëm...”

Përgëzimet, që merrte nga të gjitha anët, kur po zbriste nga ringu nisen t’i ngatërrohen me një rrëmujë që ishte krijuar në pjesën prej nga duhej të largohej nga halla e madhe e sporteve, e cila ishte në pritje të duelit tjetër final, atij në kategorinë e rëndë, ku boksieri amerikan Xhekson për kundërshtarë kishte boksierin nga Kuba Stivenson.

Aty pa se disa që demonstironin me parullën “*Kosova Republikë*” po bënë përpjekje për t’iu afruar, por pjesëtarët e shumtë të sigurisë po i pengonin, madje me mjaft ashpërsi, ngaqë kjo paraprakisht ishte kërkuar nga udhëheqja e ekipit jugosllav, të cilët kishin

protestuar te Komiteti Olimpik që ai demonstrim të mos lejohej, por kjo ishte refuzuar me arsyetimin se shprehja e mendimit politik ishte e drejtë e secilit po qe se kjo bëhej në mënyrë që civilizuar.

Pas ndeshjes, nga doktor Sokol Hoti, Bashkim Kosova do të marrë vesh se kryetari i Komitetit Olimpik të Jugosllavisë, serbi Markoviq kishte kërkuar që në hallë demonstruesve t'u ndalohej hedhja e parullës "*Kosova Republikë*", meqë për të ajo ishte armiqësore, ndërkohë që nga organizatorët kishte marrë përgjigjen se ata nuk merreshin me vlerësime politike të parullave, të cilat mund të jenë gjithë fare, por ato nuk ndalohen nëse bartësit e tyre nuk prishin rendin publik të manifestimit. Ngjashëm u ishte thënë edhe sovjetikëve dhe kubanëve, kur kishin kërkuar që të mos lejohej futja e parullave të shumta, me anën e të cilave kërkohej liri në këto vende. E vetmja që gjë kishin arritur jugosllavët, sovjetikët dhe kubanët, kishte qenë ajo që gjatë transmetimit televiziv të dueleve, i cili bartej në gjithë rruzullin tokësor, kamerat të fokusoheshin vetëm te lufta në ring, ndërsa publiku të kapej vetëm nga plani i gjerë, gjë që kjo kishte bërë që në ekranet televizive të mos gjejë vend asgjë e demonstrimit me parullën "*Kosova Republikë*", as me atë "*Kosova – djep mesjetar serb*", gjë që për ekipin jugosllavë dhe ata që i dirigjonin nga Beogradi, kishte paraqitur një sukses.

Kjo megjithatë nuk i kishte penguar kompanitë e mëdha televizive botërore si CNN, BBC dhe të tjera, që monitoronin pareshtur çdo demonstrim politik, që në emisionet përcjellëse dhe veçmas në ato informative, t'u jepnin vend atyre që kishin bartur parullat "*Kosova Republikë*" dhe ato "*Kosova – djep mesjetar serb*". Për kompanitë e mëdha televizive dhe gazetatat amerikane, ata që atë ditë në Qendrën Olimpikë ishin shfaqur që nga mëngjesi duke shprehur pikëpamjet e tyre, ishin pjesë e rëndësishme e shprehjes së mendimit të lirë, që duhej t'i përcillej opinionit të gjerë brenda dhe jashtë vendit.

Bartësit e parullës "*Kosova Republikë*" ishin identifikuar si shqiptaro-amerikanë, Atyre u ishin bashkuar edhe grupe të ndryshme të përndjekurish politik shqiptar të shpërndarë në vende të ndryshme perëndimore. Ndërsa ata që demonstironin me parullën "*Kosova – djep mesjetar serb*" ishin një grup më i vogël, kryesisht nga komuniteti ortodoks serb amerikan, të cilët flisnin për të ashtuquajturën të drejtë historike serbe, që ta posedojnë Kosovën mbi baza religjioze. Këtë e tregonte më së miri edhe ikonografia kishtare që e demonstironin gjatë gjithë kohës, që lente përshtypjen e një meshe publike.

Shqiptarët, përkundrazi, shfaqeshin me kërkesa politike, ku ajo e Republikës së Kosovës, paraqitej si e drejtë politike e tyre që të jenë të barabartë me të tjerët në federatë. Aty nuk flitej për shkëputje e as për qëllime armiqësore ndaj Jugosllavisë nga pikëpamjet e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, siç thoshte kryetari i Komitetit Olimpik të Jugosllavisë, Markoviq, por bëhej thirrje për barazi dhe kjo për botën perëndimore ishte krejt në rregull dhe e pranueshme, andej ajo që nga delegacioni jugosllavë quhej "simpati për irredentistet", ishte çështje e një të drejtë demokratike.

Bashkim Kosova, gjatë atij parakalimi, shumë pak kishte nxënë nga ai demonstrim, sepse truprojat, që i shkonin para dhe pranë, thuajse e kishin shkëputur të tërin nga ato që po ndodhnin aty sado që, kishte kureshtje të madhe për to.

Por, diçka të atij demonstrimi, në një formë të hapur, kishte pasur rastin të përjetojë në Prishtinë, ditën që ishte kthyer, kur në qendër të qytetit ishte pritur nga mijëra e mijëra veta, kur para Hotelit "Grand Prishtina" i bënë një pritje madhështore. Para se të hyjë në "Grand",

ku duhej të merrte përgëzimet nga sportistët dhe Kryetari i Lidhjes Socialiste të Kosovës, i cili do t'ia transmetonte urimet e udhëheqjes më të lartë politike dhe shoqërore të Kosovës, Bashkim Kosova nuk do të dëgjojë tjetër pos brohoritjeve “*Kosovë*” dhe “*Fitore*”, jehona e të cilave depëronte në çdo skutë të kryeqytetit të Kosovës.

Ky demonstrim festiv i përmasave tepër të mëdha të papara deri më atëherë, megjithatë kishte bërë që atij t'i shihej “hilja” tek “pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”. Së paku kështu ishte interpretuar nga gazeta “*Jedinstvo*” e Prishtinës, “dyshim” ky që kishte mjaftuar që krenjtja të mos lejohej të përhapej edhe në pjesët tjera të Kosovës, dhe njëherësh të bëjë, që Bashkim Kosova, siç ishte paraparë, të mos pritej nga Kryetari i Kryesisë së Kosovës.

Nga Fushë Kosova, serbët e atjeshëm, si thuhej “të shqetësuar për format perfide që gjente nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar për të vepruar publikisht”, që sipas tyre “tashmë përkraheshin haptas nga qarqet imperialiste amerikane dhe emigracioni fashist”, kishin kërkuar që organizatat politiko-shoqërore të vendit, në përputhje me disa raporte policore, të dilnin me qëndrimin që pritja që i ishte bërë boksierit Bashkim Kosova me rastin e kthimit nga Lojërat Olimpikë (pa u përmendur këtu medalja e artë e fituar), që ishte e para dhe e vetmja deri më atëherë e Jugosllavisë në boks, kishte pasur “prapavijë armiqësore jnga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”.

Kishte pasur edhe shkrime të tjera në këtë frymë, të cilat Bashkim Kosovës ia krijuan bindjen se karriera e tij sportive tashmë hapur ndikonte disponimet shoqërore dhe politike në vend varësisht nga këndvështrimi ose si mund të thuhej më troç: për të mirë dhe për të keq, këndvështrimet e të cilave kishin në njërën anë ato që të shumtën vinin nga “*Rilindja*” dhe botimet e saj, dhe në tjetrën anë ato nga “*Politika*” e Beogradit dhe botimet e saj, e ku në të parën (“*Rilindjen*”) shpreheshin opinionet e shqiptarëve në të cilat sukseset e tij u shërbenin identifikimeve të natyrës shoqërore dhe politike që për moto kishin arritjet sa më të mëdha drejt barazisë me të tjerët, ndërsa në të dytën (“*Politikën*”) shpreheshin opinionet e serbëve të ngarkuar me nacionalizëm dhe unitarizëm, të cilët tek arritjet e shqiptarëve çfarëdo qofshin ato madje edhe sportive shihnin humbjen e Kosovës si mit nacional, që sipas tyre “ripushtohet nga ekspansioni etnik dhe biologjik i shqiptarëve”.

Kështu, gjatë atij viti dhe tjetrit imazhi i Bashkim Kosovës nëpër mediet e vendit, por edhe i atyre të jashtmeve që herë pas herë fokusoheshin tek dilema rreth të ardhmes së Jugosllavisë, nuk do të jetë më i një natyre sportive, por të shumtën i asaj politike dhe shoqërore, meqë emri *Bashkim* dhe mbiemri *Kosova* kishin hapur edhe çështje e të ardhmes së Kosovës por edhe asaj të shqiptarëve në rrethanat e shpërbërjes së asaj që merrej si trashëgimi e Titos, ku Beogradi pretendonte se duhej ta kishte fjalën kryesore jo vetëm të posedimi i asaj që e quante të drejtë të vetën për tapitë e saj, por edhe të ridefinimit i pozitës së të tjerëve në të (popujve shteformues: kroatëve dhe sllovenëve) në përputhje me interesat serbe, e ku shqiptarët duhej të përjashtoheshin nga çfarëdo mundësie që të trajtoheshin të barabartë në këtë hise, me arsyetimin se ata ishin “kombësi”, pra pakicë kombëtare, së cilës nuk i takonte tjetër pos, si thuhej, që të realizonin të drejtat njerëzore dhe ato qytetare në përputhje me konventat ndërkombëtare të pakicave.

Hapja e këtyre çështjeve në opinion si dhe orientimi i debatit në përputhje me qëndrimet e Beogradit se “përpyekjet e shqiptarëve për barazinë që nuk u takonte, kishin rrënuar unitetin e vendit, pse Serbia me konsensusin në federatë të krahinave ishte përjashtuar

nga krahinat e saj (Kosova dhe Vojvodina)”, në sport kishin gjetur hapësirën më të përshtatshme për shfrime, ku ishte sprovuar energjia populiste nga pozitat e nacionalizmit dhe hegjemonizmit serb, e cila së shpejti do të kthehet në një lëvizje të madhe prej nga i ashtuquajtur “revolucion i jogurtit”, nën parullën e “Serbisë unike” do të rrënojë udhëheqjen politike të Vojvodinës, pastaj atë të Malit të Zi, në mënyrë që në betejën përfundimtare për ta nënshtruar Jugosllavinë që ta kthente në një feud serb, t’i vërsulet edhe Kosovës.

Dhe, rruga deri te ky zhvillim tragjik, që do të çojë deri te ngjarjet e 23 marsit të vitit 1989, kur me anën e tankeve Kosovës do t’i rrënohet autonomia, do të jetë e njëjtë edhe për Bashkim Kosovën dhe karrierën e tij sportive gjatë atyre dy-tri vjetëve të ardhshme, së cilës do t’i vijë fundi me ndërhyrjen e Shtabit Teknik të Lidhjes së Boksit të Jugosllavisë që në Kampionin Botëror të Boksit në Toronto, në gushtin e vitit 1986, t’i pamundësohet që në finale, me boksierin sovjetik, të luftojë për titullin e kampionit botëror.

Para se të vijë deri te ndërhyrja brutale që të mos shfaqej në finalen botërore prej nga do të arrinte majën botërore, Bashkim Kosovës do t’i duhej që me titullin e kampionit olimpiq, gjatë gjithë vitit, të ndeshet jo vetëm me ngacmime të ashpra nëpër ringjet e vendit, ndaj të cilave megjithatë si përgjigje përfundimtare kishte grushtin e fortë, por edhe me ato të atyre të natyrës politike, që tashmë nuk reshtnin në shtypin e Beogradit, ku ai haptas akuzohej si frymëzues “i *separatizmit* shqiptar” (fjala *separatizëm*, pas pesë vitesh të përdorimit politik, kishte zëvendësuar atë *irredentizëm*, me arsyetimin se *irredentizmi* ishte lëvizje e drejtë e për bashkim e popujve të ndarë, ndërsa *separatizmi* paraqiste kërkesën e pakicave që t’i bashkoheshin shtetit amë, gjë që nuk gjente përkrahje ndërkombëtare dhe ishte në kundërshtim me të drejtën e sovranitetit shtetëror si parim ndërkombëtar i futur edhe në dokumentet e OKB-së dhe ato të Kartës së Helsinkit).

Në këtë fazë të fushatës, pra kur *separatizmi* do t’ia zërë vendin *irredentizmit*, Bashkim Kosovës i ra në sy se nëpër ringjet serbe, klithjet “*Rushite Kosovu!*” (*Rrënojeni Kosovën!*), aq të zëshme deri më atëherë, po ua lëshonin vendin çirrjeve shfrenuese: “*Ubijte Bashkima!*” (*Vritni Bashkimin!*). Ato gjithnjë e më shumë shoqëroheshin edhe me thirrjen: “*Bashkim u Albani*” (*Bashkimin në Shqipëri*), që si do të shihet, së fundi do, nga hallat e sporteve, të kalojnë nëpër tribunat e shkrimtarëve dhe akademikëve serbë dhe nëpër mitingjet e ndryshme nëpër Serbi, që kishin filluar të merrnin hov të paparë.

Ashpërsimi i atmosferës nëpër ringjet serbe, që tashmë si të orkestruara nga një qendër drejtuese ishin kthyer në demonstrime të mëdha politike mbi platformën e nacionalizmit dhe hegjemonizmit serb, bëri që politika për herë të parë drejtpërdrejt të ndërhyjë në karrierën sportive të Bashkim Kosovës, në mënyrë që, si do të shihet, një ditë ta ndikojë suksesin e tij që të mos kurorëzohet me medaljen e kampionit të botës pse një titull i tillë, qoftë sportiv, thuhej se motivonte shqiptarët që të luftonin për interesat e tyre, natyrisht irredentiste dhe kundërrivolucionare, ndërsa dëshpëronte serbët në rrugën e tyre, siç thuhej të drejtë, t’i kthenin ato që u ishin dhënë peshqesh shqiptarëve.

Kjo ndërhyrje në fillim do të jetë “qetësuese”, pra për hir të përgatitjes për kampionatin botëror, që mbahej pas një viti, ku thuhej se Bashkim Kosova duhej të kursehej nga paraqitjet e shumta, veçmas ato në ringun e Prishtinës, pa përjashtuar këtu edhe ndonjë jashtë, që do të mund të ishte provokuese.

Ky qëndrim do të aprovohet në një takim të përbashkët të Kryesisë së Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Kosovës me atë të Kryesisë së Lidhjes Socialiste të Popullit

Punonjës të Serbisë të mbajtur në Prishtinë. Në opinion doli një si “rekomandim”, që nxirrej në kuadër të masave të përbashkëta për t’u luftuar, si thuhej në një mënyrë të përgjithësuar, dukuritë e nacionalizmit në sport, por do të shihet se fjala ishte për strategjinë që Beogradi kishte filluar ta përdorte për të mbikëqyrur nga brenda autonominë e Kosovës, që ajo të rrënohej hap pas hapi, në mënyrë që një ditë, si do të ndodhë në marsin e vitit të kaluar, në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të përdorimit të tankeve që do të gjakosin demonstruesit e shumtë në Prishtinë dhe pjesët tjera të Kosovës, që nuk pajtoheshin me ripushtimin serb.

Kundruall këtyre rrethanave, Bashkim Kosova për herë të parë do të mendojë që të largohet fare nga sporti. Lis Matit i kishte thënë se meqë kishte arritur medaljen olimpikë do të ishte shumë më mirë që të gjente ndonjë arsye që të tërhiqej. Këtij nuk i thonë sport. Lis Mani ia kishte kthyer se këtë dëshironin kundërshtarët e Kosovës. Ata do të bëjnë çmos që të mos shkosh në kampionin botëror. Kështu po e humb vullnetin për boks, por edhe për të tjerat. Edhe unë jam njeri, i kishte thënë Bashkimi i thyer fare.

Lis Mati, i cili përherë kishte gjetur mënyrën më të përshtatshme me i ndihmë me u ba ballë atyre me të cilat ndeshje nëpër ringjet e vendit (frymës josportive, që i vinte nga publiku dhe shtypi i Beogradit, që e kishte në shënjestër sa më shumë që arrinte), ia përkujtoi ato që xhaxha Arsimi ia kishte thënë si me shaka kur do të fillojë të përballohej me ato që i vinin nga prapa se kishte një emër (Bashkim) dhe kishte një mbiemër (Kosovë) që përherë do ta sfidojnë, luftoi apo nuk luftoi.

Kush arrin majat duhet të jetë i gatshëm që të përballohet me shigjetat që i gjuhen nga poshtë. Reja gjuan lisa e jo fshisa, i kishte thënë.

Bashkim Kosova mori edhe këshilla të tjera nga dashamirë të shumtë, por edhe personalitete të rëndësishme nga elita intelektuale dhe shoqërore e Kosovës me të cilët ndonjëherë i binte të takohej nëpër pritje apo manifestime të ndryshme, ku gjithnjë e më shpesh ftohej dhe nderohej.

Njëri prej tyre, poeti Fat Balla, një bohem i këndshëm, që e njihte nga bankat e gjimnazit të Prishtinës dhe ishte ndër ata me të cilët kishte ruajtur miqësinë e dikurshme, pasi që do të kthehet me titullin e kampionit olimpik, ia bëri me dije se tashmë nuk ishte vetëm sportist, por shenjë dalluese e një populli të tërë i cili synon arritjet edhe në kushtet e pabarabarta, pa marrë parasysh pengesat e shumta.

“Është një lëvizje e madhe, të cilës i duhen të vendosurit dhe të pathyeshmit”, do t’i thotë ai.

Në një poezi që do t’ia kushtojë me rastin e fitores së medaljes olimpikë, do ta quajë “rëndës shekullor dardan, që kthehet në Olimpion vet për ta kthyer flakën e ruajtur në Bjeshkët e Nemuna”.

Metafora e flakës së Olimpionit si dhe ato që do të thuheshin për të pas fitores në lojërat olimpikë, Bashkim Kosovës përfundimisht do t’ia krijojnë ndjenjën se me ato që kishte arritur nuk ishte më i vetvetes, por u takonte dhe të tjerëve, dhe se kjo e sillte para një përgjegjësie edhe më të madhe shoqërore, që nuk i kishte shkuar mendja se mund të ishte e tillë.

“Tash je kthyer në ideal të Kosovës”, i thoshte halla Shpresa, kur ai po i shfaqte shenjat e para të lodhjes shpirtërore dhe ajo nxitonte ta ndihmonte.

“Prej teje pritet lufta për më të mirin në botë...”

Me ato që ia kishte thënë halla Shpresa, Bashkim Kosova do t'i kthehet përgatitjeve për kampionatin botëror të boksit, që duhej të mbahej pas një viti në Toronto të Kanadasë, i vendosur që t'i përballojë që të gjitha vështirësitë që mund t'i shfaqen deri aty.

Në të vërtetë, gjatë asaj kohe, ai do të ndeshet me tepër me pengesa të natyrës josportive, siç ishin qëndrimet e forumeve të ndryshme shoqërore dhe politike rreth ruajtjes së frymë sportive nga “euforitë nacionaliste me prapavijë armiqësore”, që si “shqetësim i ngritur publik” do ta prekin më së shumti, ngaqë shtypi i Beogradit që moti e kishte shënjuar si një ikonë të nacionalizmit shqiptar, ku manifestimet sportive shfrytëzoheshin për shpalosjen e kësaj fryme.

Por, Bashkim Kosova, do t'ua mbyllë veshët atyre që thuheshin dhe shkruheshin në të katër anët dhe do t'i kthehet qëllimit të vetëm – pjesëmarrjes në Kampionatin Botëror të Boksit. Në këtë rrugë ai kishte përkrahjen e madhe të Lis Manit dhe seleksionuesit të reprezentacionit shtetëror, kroatit Bruno, i cili që më parë kishte deklaruar se forumet shoqërore dhe politike mund të marrin çfarëdo vendimesh (fjala ishte për ato me anën e të cilave disa sportistëve u kufizohej paraqitja publike gjoja për t'u parapenguar euforia nacionaliste në manifestimet sportive), por ato me asgjë nuk do të mund të ndikojnë vendimin që ai të marrë pjesë në kampionatin e ardhshëm botëror dhe atje të luftojë për medaljen e artë. Qëndrimin që Bashkim Kosovës t'i rrudhej kalendari sportiv në minimum (nga 20 duele në gjithsej 8), Bruno, do ta quajë skandaloz, por si zhdëmtim të kësaj, do të marrë masa që kampionit olimpiq, në bashkëpunim me klubin e boksit “Prishtina”, t'i krijohet një pako e veçantë e përgatitjes për kampionatin botëror, të cilën do ta mbikëqyrte personalisht, që atje të shkonte sa më i përgatitur.

“Bashkim Kosovën nuk mund ta ndalë kush që të shkojë në Toronto dhe atje të luftojë për titullin e më të mirit në botë”.

Këto do t'ia deklarojë Bruno vendosmërisht Televizionit të Beogradit, i cili ishte ndër të parët që kishte hedhur propozimin për “anashkalimin nga ana e medieve publike sportistëve dhe të estradistëve, që frymëzojnë nacionalizmat...”

Edhe në këto rrethana, në saje të përkushtimit të tij mos me u dorëzue dhe në saje të faktorëve të tjerë shoqërorë dhe politik në përthyerje e sipër që sportin e shihnin si një arenë të përshtatshme për matje dhe çmatje të ndryshme që duhej shfrytëzuar deri në pikë të fundit (veçmas atyre nga jashtë të cilëve federata jugosllave ua kishte frikën), Bashkim Kosova, do t'ia dalë që përfundimisht të marrë vizën për Kampionatin Botëror të Boksit Amator në Toronto të Kanadasë, që duhej të mbahej në korrik të vitit 1986.

Edhe pse forumet politike dhe ato sportive në Kosovë kishin vendosur që Bashkim Kosovës të mos i bëhej kurrfarë përcjellje e veçantë për në Kanada - dhe për këtë madje ishin marrë masat që pa kurrfarë jehone e medieve të nisej nga Beogradi - megjithatë, as mosprania e tij në Prishtinë e as heshtja e shtypit rreth çastit të nisej, nuk do të pengojnë që pjesëmarrja e tij në Kampionatin Botëror të Boksit në Toronto të kthehen në një manifestim të madh publik, i cili do të fillojë para pallatit “Boro e Ramizi” për të vazhduar pasta para hotelit “Grand Prishtina” për të përfunduar para “Teatrit Popullor Krahinor”.

Manifestimi sigurisht se do të zgjaste edhe më shumë dhe kishte të ngjarë që të kthehej në një festë pasi që ishte paralajmëruar edhe pjesëmarrja e ansambllit të këngëve dhe valleve “Shota” si dhe e një grupi rokerësh të kryeqytetit, por ishte shfaqja e njësitit speciale të policisë para Bankës Popullore të Kosovës, të cilave po u bashkoheshin edhe ato për

ndërhyrje të shpejtë, që tashmë shiheshin para Kuvendit të Kosovës, që atij i dhanë fund. Duke parë këtë gjendje, njëri nga drejtuesit e manifestimit, sakaq e shpalli tubimin të mbyllur me premtimin se serish do të mbliidhen kur Bashkim Kosova do të kthehej me medaljen e kampionit botëror, për të cilën tha se ishte i sigurt se ai do ta fitonte.

Masa e demonstruesve, që e kishte parë se ku mund të shkonin punët, nisi të shpërndahej me klithjet “*Kosova*”, jehona e të cilave po përhapej në të gjitha anët si një gjëzim. Nëpër rrugët dhe rrugicat që derdheshin në drejtim të Xhamisë së Llapit, të Gërmisë dhe Dragodanit edhe për një kohë të gjatë mbeti jehona e refrenit të këngës :

“Besa-besë besën ta kam dhanë, për Kosovë jetën kam me dhanë”.

Në Toronto të Kanadasë Bashkim Kosova qysh në fillim u ndesh me qëndrimet provokuese të shtabit teknik të reprezentacionit të Jugosllavisë, që udhëhiqej nga serbi Vlajkoviç, të cilat arritën pikën më të lartë me rastin e finales, kur nuk do t’i lejohet që të luftonte për titullin e kampionit të botës.

Se do të kishte telashe me Shtabin Teknik të reprezentacionit, Bashkim Kosova do ta kuptojë qysh në duelin e parë, atë me gjermanin Shulc, që ndonëse do ta fitojë me dorëzim në raundin e dytë, do të kritikohet ashpër me arsyetimin se gjoja kishte bërë boks pasiv, që ka mundur t’i kushtojë me humbje. Edhe pse trajneri Bruno sjelljen në ring të Bashkim Kosovës e kishte vlerësuar tejet të mençur (pse nuk kishte humbur fuqi më shumë seç i duhej, e cila i duhej për duelet tjera të vështira), megjithatë Shtabi Teknik, jashtë kompetencave, i kishte dhënë vërejtje. Kjo nuk e kishte brengosur gjithaq Bashkim Kosovën, i cili, nuk kishte bërë gjithaq që boksierin gjerman ta nokautonte. Më vonë, Bruno do të pranojë se Bashkim Kosova i kishte thënë se këdo mund ta shihte në dysheme, pos gjermanit.

Sidoqoftë, Bashkim Kosova, në duelin e dytë, me kampionin rumun Marinesku e tregoi gjithë ashpërsinë. E nokautoi në raundin e parë dhe, këtë madje e bëri me një ashpërsi, pasi që rumuni, me përdorimin e kokës jashtë rregullave, filloi me lojë të papastër që ta lëndonte. I vetëdijshëm për prirjen e njohur të boksierëve rumunë që të përdorin dredhitë e ndryshme dhe luftën e papastër, me të shpejtë do ia tregoi dyshemenë.

Ngjashëm veproi edhe me boksierin spanjoll Rodriges, trajneri i të cilit, para fillimit të duelit kishte deklaruar se me Bashkim Kosovën kishte edhe disa hesape të tjera për t’i lartë, edhe pse kjo ishte hera e parë që ndeshej me boksierin spanjoll. Kjo do ta motivojë edhe më shumë boksierin nga Prishtina për t’ia bërë me dije se për të ishte vetëm ringu ku lahej çfarëdo hesapi. Kështu, qysh në fillim e djathta e Bashkimit e gjeti kokën e spanjollit saqë ai pa një pa dy u plandos në dysheme. Megjithatë, gjyqtari në ring, nuk e ndërpreu duelin, por edhe jashtë numërimit, iu dha përpjekjeve për me sjellë në vete, gjë që kjo do ta trimërojë atë dhe, i udhëzuar nga këndi i vet, iu dha haptas luftës së papastër, duke iu lidhur për trupi Bashkimit prej nga përpiquej të përfundonte raundin e parë pa marrë ndonjë të rënë tjetër. Natyrisht se me ndihmën e gjyqtarit në ring kësaj disi ia dalë, por jo gjithnjë. Sepse, në raundin e dytë, Bashkim Kosova e mbajti larg vetes dhe pasi që me të majtën krijoi hapësirën e duhur, e qëlloi me të djathtën në kokën. Spanjollit nuk do të jetë në gjendje të marrë veten edhe pas numërimit të ngadalshëm të gjyqtarit. Iu desh ndihma e mjekut të vijë në vete.

Edhe në duelin e katër, atë për në gjysmëfinale, Bashkim Kosova nuk pati ndonjë vështirësi. Boksieri polak Jarushevski, pas një lufte të ashpër me boksierin amerikan Xhons, dukej fare i shkallmuar, kështu që nuk tregonte kurrfarë vullneti për luftë. Përkundrazi, përpiquej të ikte sa më shumë që të ishte e mundur. Këtë e hetoi edhe gjyqtari kryesor, i cili i

kërkoi qasje aktive dhe madje, nga fundi i raundit, ia tërhoqi vërejtjen se po vazhdoi ashtu do ta largonte nga ringu. Bashkim Kosovës do t'i vijë keq për boksierin polak dhe pos ndonjë të rënë te lehtë, nuk do t'i sjellë më shumë shqetësim. Trajneri Bruno kërkoi që ai ta kryente punën e vet sa më parë, por kjo nuk do t'i lejohet, meqë pa filluar raundi i dytë, trajneri polak hodhi peshqirin në ring.

Edhe me këtë rast, Bashkim Kosova, u gjend në shënjestër të kritikave të Shtabit Teknik të reprezentacionit të Jugosllavisë. Iu pa për të madhe sjellja pasive. Bashkim Kosova nuk do t'ua vërë veshin atyre që i vinin prej tyre, meqë tashmë kishte përshtypjen se ata nuk e kishin hallin e dështimit të tij, por të kundërtën, që ai të nxirrej prej binarëve në çastin e duhur, gjë që këtë mundësi do t'ua krijojë dueli gjysmëfinale me kubanin Martinez, kampionin aktual botëror dhe njërin ndër boksierët më të mirë në botë në kategorinë gjysmë të rëndë, të cilit tashmë tregu amerikan i boksit profesionist ia kishte vu syrin dhe priste që atje të bartej sapo të përfundonte Kampionati Botëror i Boksit Amator në Toronto të Kanadasë, natyrisht me medaljen e artë të fituar. Thuhej, madje, se edhe Fidel Kastro, i cili bashkë me boksierin Stivenson në kategorinë e rëndë, edhe Martinezin e kishte shpallur “pasuri kombëtare”, kishte ndarë mendjen që ta lejonte të kalonte në ligën e boksit profesional ngaqë ishte i bindur se atje do të arrinte titullin e më të mirit në botë, që kjo sipas tij, nga ringjet amerikane, pra të kundërshtarit të paepur ideologjik, do t'i shërbente afirmimit të komunizmit kuban në botë.

Duket se bindjen e Kastros rreth Martinezit dhe dominimit të tij në ringjet amerikane të boksit profesionist nuk ndanin vetëm dashamirët e shumtë të boksit që ai kishte në Toronto, të cilët përcillnin me shumë eufori duelet që deri më atëherë ai i fitonte me shumë lehtësi dhe rëndom me nokaut klasik, por këtë e kishin edhe menaxherët e shumtë, që përreth dhe prisnin që ta lidhin me kontrata tepër joshëse. Si do të shihet, të tillët, duke e ditur se Bashkim Kosova mund t'ia ndalte rrugën për në finale, do të marrin masat paraprake që nëse kubanit do t'i dështojnë grushtet, atëherë këtë ta bëjnë gjyqtarët. Kjo masë që për shumëkënd dukej teorike, në të vërtetë do të shihet se do të vihet në veprim që nga fillimi i duelit nga shkakun se Bashkim Kosova kubanit jo vetëm që nuk do t'i lejojë ta përdor ofensivën e njohur, por do ta detyrojë të mbrohet dhe pas pak t'i kthehet edhe boksit të papastër deri në atë masë, sa të ndikojë që për herë të parë të fitojë një duel me vendimin e gjyqtarëve tre me dy.

Në të vërtetë ai duel në vend që të ishte një kurorë e shkathtësisë fisnike (meqë të dy boksierët kultivonin boks të nivelit të lartë, ndër më të mirit në botë), ai do të kthehet në një përleshje, të ngjashme me rragbin dhe kjo do të ndodhë në saje të përcaktimit të boksierit kuban që në pamundësi t'ua bëjë ballë të rënave të pastra të Bashkim Kosovës, me të cilat do të ballafaqohet nga çastet e para, do t'i kthehet hyrjes në trup me shtyrje dhe gjuajtje të papastra nga poshtë. Natyrisht se boksieri kuban, për herë të parë i gjendur përballë një situatë të tillë, nuk kishte zgjidhje tjetër, por këtë sjellje do t'ia mundësojë edhe gjyqtari rumun në ring, i cili në vend se ta pengojë, do ta lejojë, ndërkohë që përpjekjet e Bashkim Kosovës për t'u shkëputur prej tij do t'i vlerësojë si shtyrje të qëllimshme, me ç'rast, në raundin e dytë do ta ndëshkojë me vërejtje të hapur publike. I ballafaquar me një sfidë të tillë që të lëndohej ose të diskualifikohej, Bashkim Kosova do të bëjë çmos që ta përdorë të djathtën, në mënyrë që duelin ta vendos para kohe. Por, do të shihet se edhe atëherë kur boksieri kuban ndodhej në gjendje grogi dhe atij doemos i duhej numërimi për të pushuar,

gjuqtari në ring, nuk do ta bëjë këtë. Madje, edhe atëherë kur kubani nga një e qëlluar e fuqishme në kokë do të gjendet në dysheme, jo vetëm që nuk do t'i numërojë, por atë do ta vlerësojë si rrëshqitje. Po të mos ishte gongu që sinjalizoi përfundimin e raundit të parë, kubani sigurisht se nuk do të mund të ngrihej.

Edhe në raundin e dytë boksieri kubanë vazhdoi me shtyrje, sulme me kokë dhe të rëna të papastra nga poshtë. Gjuqtari nuk do ta ndërpresë boksën e papastër, ndërsa edhe rrezimin e dytë do ta vlerësojë si rrëshqitje. Ndonëse ai ishte i paaftë që të luftonte, do t'i lejojë që t'i varej për trupi Bashkim Kosovës dhe ashtu të përfundonte edhe atë raund. Kjo pamje do të vazhdojë edhe në raundin e tretë dhe vendimtar, por në atë shtyrje e sipër, Bashkim Kosova do të ndjejë se kishte marrë një lëndim në krahun e majtë, i cili gjithnjë e më shumë po i mpihej, gjë që druante se mund t'i merrej fare. Në ato rrethana Bashkim Kosova nuk do të mendojë për tjetër pos ta hedhë sa më parë në tokë kubanin. Do ta shtyjë me të dy duart dhe sapo të krijojë një hapësirë, do ta qëllojë me të djathtën dhe kubani për të tretën herë do të gjendet në dysheme. Dhe për habinë e të gjithëve, në vend se t'i numërohet ose edhe ta ndërpriste duelin, gjuqtari do t'i kërcënohet me vërejtje publike Bashkim Kosovës me arsyetimin se kishte qëlluar kubanin kur ai kishte dhënë shenjën për ndarje. Nga ai çast e tutje, që të mos lejonte që të merrte edhe vërejtjen e dytë publike që do të thoshte diskualifikim, Bashkim Kosova përdori ashpërsinë e paparë. Edhe pse dora e majtë po i bëhej gjithnjë e më e pafuqishme, megjithatë atë do ta përdor sa për t'ia hapur gardin kubanin, të cilin do ta qëllojë së pari në pleksus, pastaj në kokë dhe, kur do të tentojë t'i afrohet prapë, do ta qëllojë në pleksus me sa fuqi kishte, sa që ai do të humbë baraspeshën, dhe duke u shalatur do të kalojë nga njëri litar në tjetrin duke u mbajtur me mundim që duelin ta përfundonte në këmbë. Pse ai gongun megjithatë do ta presë në këmbë, kësaj do t'i ndihmojë edhe Bashkim Kosova, i cili nga droja se kubani mund t'i ngjitej për trupi dhe kjo do t'i krijonte mundësi gjuqtarit në ring për ta ndëshkuar me vërejtje publike, do ta përcjell nga afër, por pa denjuar ta qëllonte.

Por, edhe pse publiku, që deri më atëherë kishte përkrahur aq fuqishëm boksierin kuban, tashmë po i duartrokiste Bashkim Kosovës dhe pritej vetëm shpallja formale me rezultat pesë me zero dhe kjo ishte fitorja e parë e tij me pikë në këtë kampionat botëror (dy me nokaut klasik dhe dy me ndërprerje), kjo po vononte. Bashkim Kosova nuk ia bëri të ditur lëndimin e krahut dhe dhembjeve që ndjente gjithnjë e më shumë trajnerit e as doktor Sokol Hotin, ani pse doktor Sokol Hoti hetoi se diçka nuk ishte në rregull me krahun e majtë, sapo ia tërhoqi dorëzën nga dora. Ia ofroi qesen me akull dhe kërkoi që përderisa të largoheshin, ta lëvizte sa më shumë atë.

Duket se vonesa e shpalljes së fituesit bëri që boksierit kuban, i cili mezi e priste gongun dhe tashmë e kishte pranuar humbjen e parë në karrierën e tij të boksit dhe me këtë mbase kishte humbur edhe gjasat për të kaluar në arenën e boksit profesionist siç shpresonte, t'i kthehej njëfarë shprese se mos mbetja në këmbë do të thoshte diç tjetër pos disfatës? Ndonëse i shkallmuar, do të ngrihet dhe do të fillojë të përshëndesë publikun. Publiku, që deri pak më parë kishte parë një boksier në një gjendje dëshpëruese, i cili në saje të gjuqtarit rumun ia kishte dalë që të mos lëshonte ringun me nokaut klasik, do t'u kthehet brohoritjeve, të ngjashme me ato para se të fillonte dueli.

Bashkim Kosova megjithatë mendjen e kishte te krahun e majtë, që gjithnjë e më shumë po i mpihej dhe kishte frikën se ashtu edhe mund t'i merrej.

Në atë ndërkohë trajneri Bruno nisi të sillej na këndi zyrtar, për të kuptuar pse po vonohej shpallja e fituesit kur çdo gjë ishte e qartë. Epërsia e Bashkimit ishte aq e madhe saqë vërejtja publike që kishte marrë, nuk çonte kandar. Por, do të shihet se pikërisht mbi atë ishte krijuar një si “ngatërrim”, sepse dy gjyqtarët anësorë (ai amerikan dhe turk) do t’ia japin fitoren Bashkim Kosovës me gjashtë pikë përparësi, ndërsa gjyqtari bullgar kishte vlerësuar duelin baras, siç kishte bërë edhe gjyqtari rumun në ring. Çështja ishte ngatërruar nga shkaku se gjyqtari i katër anësor, një portorikan po ashtu kishte votuar baras, por në raport nuk kishte shënuar përparësinë, e cila ishte e domosdoshme për t’u nxjerrë fituesi. Kjo kishte bërë që gjyqtari në ring krye ne vete atë ta interpretojë si përparësi boksierit kubanë, gjë që atij do t’i takonte fitorja tre me dy. Me ta hetuar këtë, gjyqtari portorikan, i cili përkundër asaj se duelin e kishte vlerësuar të barabartë në saje të vërejtjes publike që Bashkim Kosovës i ishte dhënë në ring, kishte ndërhyrë për t’ia dhënë përparësinë Bashkim Kosovës, me çka atij i sigurohej fitorja. Gjyqtari në ring nuk kishte lejuar që kjo të bëhej, me arsyetimin se ai kishte marrë raportet, dhe se në rrethanat kur nuk shënohej përparësia, atij i takonte që të vendoste për këtë. Çështja kishte shkuar deri aty saqë ishte deshtë ndërhyrja e Kryetarit të Komisionit të Garave, një finlandezi, i cili kishte kërkuar edhe dy anëtarët e komisionit, që të vendoste. Meqë njëri prej tyre, sillej andej pari, e gjitha kishte zgjatur mbi dhjetë minuta deri sa t’i bashkohej Komisionit. Sipas rregullores, finlandezi kishte kërkuar që gjyqtari portorikan të përcaktohej për përparësinë dhe këtë ta bënte para Komisionit të Garave. Portorikani, i cili edhe deri më atëherë kishte kundërshtuar qëndrimin e gjyqtarit në ring, aty për aty ishte deklaruar se përparësinë ia jepte Bashkim Kosovës, i cili për të ishte fitues i padiskutueshëm. Me këtë kishte marrë fund zvarritja dhe gjithë ngatërrimi i panevojshëm që ishte krijuar në hallë.

Bashkim Kosova nuk do t’i gëzohej gjithaq fitores, ngaqë dhembjet në krah i kishte gjithnjë e më të mëdha dhe me padurim priste që doktor Sokol Hoti me ndihmësit të fillonin me ngjeshjen dhe ato që i duheshin që të ishte i aftë për finalen e madhe, e cila mbahej pas dy ditësh.

Por, ende pa u kthyer mirë në pjesën ku duhej t’i jepej ndihma mjekësore, Bashkim Kosova do të hetojë se anëtarët e Shtabit Teknik të reprezentacionit, në vend se t’i uronin për fitoren dhe finalen, gjoja duke shprehur brengosje, më shumë flisnin për mundësinë që ajo të mos mbahej për shkaqe të lëndimit që kishte marrë. Dr. Rashkoviq, nga reprezentacioni shtetëror kishte kërkuar nga doktor Sokol Hoti që Bashkim Kosovës t’i jepej ndihma e duhur, por me këtë rast kishte urdhëruar edhe fotografimin e krahut për të parë shkallën e lëndimit dhe pasojat e mundshme. Fotografimi i krahut, që ishte bërë po atë mbrëmje në Qendrën Mjekësore të Kampionatit nuk kishte qitur në pah ndonjë thyerje apo nxjerrje të krahut, pos një devijimi të lehtë të frakturës së epërme, e cila nuk paraqiste ndonjë rrezik për ndonjë ndërlikim e aq më pak që të bëhej shkas për të mos boksuar pas dy ditësh.

Në të vërtet, si do të shihet, mbi këtë vlerësim do të fillojnë gjithë ato kurdisjet dhe prapaskenat që Bashkim Kosovës do t’ia pamundësojnë paraqiten në finale, ku duhej të luftonte për titullin e kampionit botëror. Kështu, të nesërmen, kur Bashkim Kosova, pas ngjeshjeve të krahut do të ndjehet mirë dhe do të kërkojë që të vazhdojë ushtrimet, do të paraqitet dr. Rashkoviq, i cili kishte kërkuar që gjatë njëzet e katër orëve të ardhshme të mbante krahun në një fashë, me arsyetimin se izolimi i tillë përjashtonte çfarëdo pasojë të padëshirueshme në frakturë. Edhe pse doktor Sokol Hoti kishte vlerësuar se izolimi i krahut

me fasha ishte i panevojshëm, dr. Rashkoviq, i cili me këtë rast kishte fjalën e fundit, kishte mbrojtur qëndrimin se izolimi njëzet e katër orësh i krahut, mundësonte një pushim të mirë dhe rehabilitim nga i cili nuk duhej pasur frikë.

Bashkim Kosova kishte kërkuar që ta mbante krahun e hapur dhe të vazhdohej me ngjeshjet që i kishin bërë mirë, por fjala e mjekut të reprezentacionit në ato raste ishte ligj. Madje, as qëndrimi i trajnerit Bruno, nuk do të përfilllet.

Sikur dikush ka për qëllim që të ma marrë luftën për medaljen e më të mirit në botë, do t'i ankohet doktor Sokol Hotit.

Doktor Hoti, edhe pse me ato që ia kishte thënë se nuk kishte arsye për ndonjë shqetësim, megjithatë kishte dyshimin se diçka po zihej kundër. Më vonë, do të merret vesh, se dr. Sokol Hoti, si mjek i klubit që përkujdesej për gjendjen shëndetësore të Bashkim Kosovës prej katër vitesh dhe njihte më së miri aftësitë psiko-fizike të tij, ia kishte bërë me dije dr. Rashkoviqit dhe Shtabit Teknik të reprezentacionit të Jugosllavisë se terapia e izolimit njëzet e katër orësh të krahut të Bashkim Kosovës, jo vetëm që nuk ishte masë e përshtatshme, por ajo mund të çonte edhe deri te ndërlikimet e paparapara, që si do të shihet edhe do të shfaqen dhe do të bëhen shkas që atij t'i ndalohej paraqitja në finale me arsyetimin se “lëndimi i krahut këtë nuk e lejonte”.

Edhe pse me heqjen e fashës izoluese, pasi që të kalojë njëzet e katërorëshi, sipas mjekut dr. Rashkoviq, gjendja do t'i përkeqësohet, megjithatë Bashkim Kosova dhe mjeku Sokol Hoti vlerësonin se ajo nuk ishte e tillë që ta pengonte mbajtjen e duelit final për medaljen e kampionit botëror, të nesërmen në mbrëmje në palestrën olimpikë para 16 mijë shikuesve. Doktor Sokol Hoti, bashkë me trajnerin Bruno kërkuan nga dr. Rashkoviq të mos nxitonte me deklaratën për dorëzimin e duelit, meqë kishin mbi tridhjetë orë për ta sanuar plotësisht ënjtën e dorës, të cilën ai e shihte si shkas për këtë. Trajneri Bruno, ia përkujtoi atij se në përputhje me rregulloren e përgjithshme vendimi përfundimtar për ose kundër daljes në ring të Bashkim Kosovës, mund të merrej vetëm dy orë para duelit nga na e Shtabit Teknik dhe assesi ndryshe.

Si do të shihet, edhe përkundër përmirësimit të dukshëm të gjendjes së krahut nga lëndimi dhe përkushtimit të Bashkim Kosovës, që të shfaqej në ring, Shtabi Teknik, nuk do t'ia lejojë këtë. Dr. Rashkoviq do të referojë se ishte rrezik i madh që Bashkim Kosova të paraqitej në ring, pa marrë parasysh gatishmërinë e tij për të.

“Kosovës i duhet mbikëqyrje e gjatë nga ana jonë...”

Shtabi Teknik miratoi qëndrimin e dr. Rashkoviqit dhe urdhëroi sekretarin e përgjithshëm të federatës së boksit që t'i drejtojë Komitetit të garave shkresën përkatëse për dorëzimin e luftës finale.

Ky ishte dueli i vetëm që Bashkim Kosova do ta humbë pa luftë. Ishte ky po ashtu edhe dueli i fundit në karrierën e tij dhjetëvjeçare të boksit, ku ai do të fitojë që të gjithë titujt e mundur: atë të kampionit të Kosovës, të kampionit të Jugosllavisë, të kampionit të Ballkanit, të Kampionit të Evropës dhe të kampionit të Lojërave Olimpikë. Kishte përpara edhe një hap të vetëm për ta bërë për ta arritur kurorën botërore të boksit, por kjo nuk do t'i lejohet nga mjeku i Beogradit dr. Rashkoviq dhe Shtabi Teknik i reprezentacionit të Jugosllavisë me arsyetimin se ishte i lënduar, edhe pse ishte i gatshëm për të.

Në shenjë proteste për atë që në një bisedë me BBC-në po atë ditë do ta quajë “komplot i paramenduar që Bashkim Kosova të mos e arrijë fronin e më të mirit në botë”, nuk do të shfaqet në ceremonialin e dorëzimit të medaljeve.

Kjo deklaratë dhe mosprania në ceremonialin e dorëzimit të medaljeve bëri që shumë nga menaxherët e njohur botëror t’i ofrohen për të nënshkruar kontrata profesionale. BBC do të spekulojë me mundësinë që Bashkim Kosova të mos kthehet fare në Jugosllavi, meqë atje mund t’i dalin telashe.

“Kosova mund të ndëshkohet në Jugosllavi. I duhet ndihma ndërkombëtare për t’u mbrojtur nga Beogradi...”

Por, Bashkim Kosova, edhe përkundër mundësisë që të përballej me pasoja, të cilat tashmë edhe mund të ishin të konvertuara, do të kthehet në vend.

Në Prishtinë u prit si heroi i vërtetë. Para turmës së entuziazmuar por edhe të revoltuar pse i ishte pamundësuar që të luftojë për titullin e kampionit të botës me boksierin sovjetik, Bashkim Kosova deklaroi se Shtabi Teknik i reprezentacionit të Jugosllavisë, më shumë ishte i preokupuar që boksierit sovjetik t’i sigurohej medalja pa luftë se sa, siç thuhej, ta mbronte atë nga ndonjë lëndim i mundshëm.

“Në Toronto, megjithatë, fitoi Kosova...”

Këto, pra ishin Vitet e Kampionit të madh Bashkim Kosova, që mund të kuptohen vetëm po qe se shihen të lidhura me ato nëpër të cilat kaloi Kosova si shoqëri pikërisht nga koha kur ai do të shfaqet në arenën e boksit, në atë të vendit dhe ndërkombëtare (nga mesi i viteve të shtatëdhjeta kur Kosova me kushtetutën e re fitoi statusin e barabartë në federatën jugosllave) për t’u ngritur në to si sportisti më i suksesshëm shqiptar i të gjitha kohëve, që edhe më të devotshëm do ta bëjë mënyra se si ajo do t’i ndërpritet dhunshëm nga Beogradi, veprim ky që do të përkojë edhe me fatin e Kosovës ku nga fundi i viteve të tetëdhjeta me dhunë do t’i rrënohet autonomia, por nuk do t’i ndalet fitorja përfundimtare...

“DOSJA E URREJTJES”

(*Shkrime dhe komente të ndryshme nga gazetat e Beogradit dhe “Jedinstvo” e Prishtinës kundër shkuarjes së Bashkim Kosovës në Olimpiadën e Los Anxhelosit në vitin 1984, në të cilat do të shpalosën oguret kundër Kosovës dhe shqiptarëve, të cilat do të dalin në pah pas pak me rastin e shfaqjes së Memorandumit të akademikëve serbë, kur ai do të pranohet nga politika e Beogradit si platformë vepruese shtetërore*)

“**Bashkimi**” që përçanë!

Pas shfaqjes së demonstratave armiqësore të vitit 1981 e tutje, shoqëria jonë edhe më tutje po përballohet me pasojat e rënda të kësaj tronditjeje përçarëse. Edhe përkundër proceseve të vazhdueshme të diferencimeve mbi bazat e patriotizmit socialist jugosllav, ajo nuk po mund të lirohet nga faktorët që po e ushqejnë atë. Njëri prej tyre padyshim se është indoktrinimi i të rinjve me idetë irredentiste shqiptaro-mëdha, të cilat manifestohen përherë aty ku gjejnë hapësirë dhe mundësi.

Dhe, një hapësirë të mirë për këtë pa mëdyshje se paraqesin manifestimet kulturore dhe ato sportive.

Këtë herë, megjithatë, vëmendja jonë do të përqendrohet te sporti. Aty mundësitë për shpërthime nacionaliste janë të mëdha dhe thuajse të pashtershme, meqë masa e ndezur me emocione sportive shumë lehtë mund të manipulohet me çështje të tjera nga ato të shprehjes së primitivizmit, të urrejtjes e deri te ato të natyrës shoqërore dhe politike.

Këto të fundit madje, sportin dhe ndeshjet sportive kanë zënë t'i shfrytëzojnë për t'u kthyer në tribuna të nacionalizmit, ku fryma e përçarjes dhe e urrejtjes mbi baza nacionale, me të cilat synohet shkatërrimi i Jugosllavisë nga brenda, ka zënë të bëhet dominuese.

Shembulli më eklatant këtu shfaqet boksieri i mirënjohur Bashkim Kosova, i cili ka filluar të kthehet në një ikonë përçarëse.

Sukseset e kampionit të Kosovës, të Jugosllavisë, si dhe fituesit të titullit të Kampionit të Ballkanit dhe atij të Evropës, pa mëdyshje se gëzojnë secilin prej nesh dhe ato si të tilla edhe janë përjetuar dhe duhet të përjetojnë. Por, ato kanë filluar të keqpërdoren nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptar në mënyrën më të hapur për qëllime politike, të cilat dihet se çfarë janë.

Çuditërisht emri i boksierit tonë të njohur dhe të nderuara (*Bashkim*) dhe mbiemri (*Kosova*) janë inkuadruar aq mirë në kombinatorikën propaganduese të nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar, saqë ato tashmë paraqesin mjetin më të përshtatshëm dhe më të lehtë, që gjuha sportive të përdoret për qëllime politike.

Kështu, nuk është e rastit pse gjatë ndeshjeve sportive në palestrën e sporteve “Boro e Ramizi” njëra anë brohorit:

“Bashkim!Bashkim!”

Tjera anë: *“Kosovë!Kosovë!”*

Ndërkohë që tribuna qendrore, i kthehet këngës:

“Besa-besë, besën ta kam dhanë, për Kosovë jetën kam me e dhanë”...

Çfarë do të thotë në të vërtetë brohoritja:

“Bashkim”?

Çfarë do të thotë brohoritja:

“Kosovë”?

Dhe pastaj, çfarë domethënie ka kënga:

*“Besa-besë, besën ta kam dhanë,
për Kosovë jetën kam me e dhanë...”?*

Janë këto vetëm thirrje sportive, apo diç më shumë?

Në të vërtetë ato edhe pse duken si thirrje sportive, pra mbështetje për boksierin që ka emrin simbolik *Bashkim + Kosova*, ashtu si po shfaqen, manifestojnë mesazhe të qarta politike nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, që do të thotë janë në përputhje me përpjekjet e këtij nacionalizmi që të gjejë hapësirë për t'u shfaqur kudo dhe për ta mbushur atë me përmbajtjen e vet.

T'ia nisim nga thirrja *“Bashkim”*.

Çfarë paraqet ajo?

Dikush mund të thotë se kjo ka të bëjë me emrin e boksierit dhe aq, gjë po qe se gjërat shikohen të shkëputura nga çështjet tjera, mbase edhe mund të duket e drejtë.

Por, e vërteta është ndryshe. Sepse, thirrja “Bashkim” tejkalon emrin personal të boksierit për t’u lidhur me kërkesën irredentiste për *bashkim kombëtar* shqiptar.

Pra, brohoritja “*Bashkim*”, e nxjerrë nga mijëra veta, nga shqiptarët përjetohet si kërkesë politike.

Dhe si e tillë, por në kah të kundërt, ajo nuk ka si të mos përjetohet edhe nga joshqiptarët në Kosovë, me çka atyre u bëhet trysni e hapur që të pranojnë statusin e pakicës, ose të largohen nga Kosova.

Po thirrja “*Kosova*”? Çfarë paraqet ajo?

Dikush mund të thotë se edhe kjo ka të bëjë me mbiemrin e boksierit, për të cilin ai nuk mund të fajësohet, meqë nuk e ka zgjedhur vetë, dhe aq. E vërteta është ndryshe. Sepse, thirrja “*Kosova*” tejkalon mbiemrin personal të boksierit për t’u lidhur me kërkesën armiqësore për Republikën e Kosovës, e cila për herë të parë është hedhur në opinion në verën e vitit 1968 nga udhëheqja politike Kosovës (nga radhët e shqiptarëve) për t’u bartur pastaj në diskutimet publike nga inteligjencia e Kosovës, në mënyrë që pastaj, kur udhëheqjes politike të Kosovës “t’i tërhiqet” vërejtja nga udhëheqja më e lartë politike e vendit se nuk duhej të merrej më me të, ajo të përvetësohet nga studentët dhe rinia shqiptare e Kosovës, e cila në nëntor të atij viti do të organizojë demonstrata të mëdha, së pari në Prizren, pastaj në Pejë dhe vendet tjera, për t’u përmbyllur me ato të 27 nëntorit në Prishtinë, ku mbi njëqind mijë veta do t’u bashkohen thirrjes për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës jugosllave.

Kjo parullë do të rikthehet serish në vitin 1981, në demonstrata e mëdha të studentëve, që do të mbahen fillimisht më 11 mars në Prishtinë për të vazhduar pastaj në ato të prillit, ku do t’u bashkohen thujtse e gjithë Kosova, që ndonëse do të shuhet me gjak, fryma e tyre nuk do të pushojë asnjëherë.

Por, boksieri i mirënjohur *Bashkim+Kosova* nuk mund të fajësohet pse ka emrin *Bashkim* dhe mbiemrin *Kosovë*. Ai, po ashtu nuk mund të fajësohet, pse nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë shfrytëzojnë sukseset e tij sportive që ato të shfrytëzohen për qëllime të tilla.

Megjithatë, *Bashkim+Kosova* mund dhe duhet të fajësohet pse nuk diferencohet nga thirrjet e tilla dhe, po ashtu mund dhe duhet të fajësohet pse, duke mos u diferencuar, në njëfarë mënyre pajtohet me to.

Se ai, madje, po i ushqen këto ndjenja, kjo u pa fare mirë në kampionatin europian në Madrid, kur pasi që do të fitojë medaljen e artë, para kamerave televizive të të gjithë botës do të flasë në gjuhën shqipe (kur këtë duhej ta bënte në serbokroatisht meqë ajo është gjuhë shteti në raport me të tjerët) dhe do të sqarojë se mbiemri i tij *Kosova* (traditë e njohur e shqiptarëve që me antroponiminë të manifestonin dashurinë ndaj atdheut), lidhej me Kosovën njësi të barabartë të federatës jugosllave!

Edhe në disa raste të tjera *Bashkim+Kosova*, para se të flasë për Jugosllavinë si shtet që e përfaqëson, përherë do t’ia fillojë me Kosovën dhe sqarimet se çfarë paraqet ajo. Janë të njohura deklaratat e tij në Athinë: “*krenohem me Kosovën*”!

Kjo sjellje pra, trimëron nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar dhe frikëson patriotët e njëmendtë jugosllavë.

Andaj, është koha që sportisti *Bashkim* të bashkojë në përputhje me patriotizmin socialist jugosllav, në vend se të veprojë kundër tij. Në të kundërtën, duhet t’i ndalet që të

kthehet në përçarës dhe frymëzues të nacionalizmit shqiptar nga pozitat e irredentizmit dhe të kundërrevolucionit.

Po vazhdoi kështu, atëherë *Bashkim+Kosova* nuk duhet të ketë vend në lojërat e ardhshme olimpike që do të mbahen në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës pas dy vjetësh, sepse me këtë qëndrim do të prodhojë më shumë dëme se dobi për vendin.

(“*Jedinstvo*”, Prishtinë, 22 dhjetor 1982)

Zëdhënës i irredentës shqiptare

Irredenta shqiptare ka gjetur zëdhënësin e vet pa ndonjë mund të madh.

Ai quhet *Bashkim+Kosova*.

Është kampion i shumëfishtë i Kosovës, i Jugosllavisë, i Ballkanit dhe i Evropës në boks në kategorinë gjysmë të rëndë.

Mbase duket e rastësishme, që një qytetar yni i lirë me emrin - *Bashkim* dhe mbiemrin – *Kosova*, të identifikojë aq mirë një platformë irredentiste nga pozitat e nacionalizmit dhe kundërrevolucionit shqiptar, sa që *Bashkim+Kosova* të kthehet në një embleme të vetme.

Pra, emblema *Bashkim+Kosova*, nuk është vetëm një kompozitë e gjuhësore e sajuar formalisht, por ajo, e shikuar nga një këndvështrim edhe sipërfaqësor politik, pasqyron esencën e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, si shprehje e një bindjeje, e cila duhet të manifestohet kudo dhe, veçmas në emra dhe mbiemra, sepse ashtu fuqizohet edhe më shumë.

Andaj, ata që dinë historinë e këtyre lëvizjeve nuk e kanë të vështirë të kuptojnë se toponomastika dhe onomastika të shqiptarët është në shërbim të ruajtjes së identitetit nacional, por edhe të kujtesës historike në përputhje me pretendimet e tyre shqiptaro-mëdha. Kështu, që nga koha e Krizës Lindore e tutje, kur do të dalin në dritë aspiratat e tyre për krijimin e Shqipërisë së Madhe, familjet e rëndësishme shqiptare në Perandorinë e Osmane, do të marrin emërtimet *Kosova*, pastaj *Toska*, *Gega*, por nuk do të mungojnë edhe ato të pashallarëve të fuqishëm, mbrojtës të perandorisë, që lidhen me qytete të rëndësishme si Ohri, Prizreni, Dibra, Shkodra, Vlora, Tepelena, Gjakova, Gjlani, Gucia, Mitrovica, Boletini e të tjera. Personalitetet e njohura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila ishte shqiptaro-madhe për nga pretendimet, sikur e kishin të domosdoshme që emrave dhe mbiemrave t’u shtonin edhe ato nga onomastika ose toponomastika në mënyrë që edhe ashtu dhe në atë mënyrë të demonstrosin ide hegjemoniste. Kështu Mustafë Pasha do t’ia shtojë mbiemrit atë *Bushati* ose *Bushtaliu*, Ali Pasha *Tepelenën*, Ali Pasha *Gucinë*. Ngjashëm do të veprojë edhe Ismail Qemali me *Vlorën*, Hasan Berisha me *Prishtinën*, Isa bej me *Boletin*, Hoxha Kadria me *Prishtinën*, Bedri bej me *Pejën*, Myfid bej, me *Libohovën*, siç do të veprojnë edhe shkrimtarët e njohur Sami, Abdyl dhe Naim me *Frashërin*, pastaj Vaso Pasha me *Shkodrën* dhe shumë e shumë të tjerë.

Pas luftërave ballkanike e tutje, kur Serbia do të kthehet në qendrën e saj mesjetare në Kosovë, irredentistët shqiptarë do t’u kthehen emrave për të shprehur këtë ndjenjë, ku emri *Bashkim*, është ndër më të shpeshtit dhe më të theksuarit.

Andaj, as emri i Bashkim Kosovës nuk është i rastit.

Madje, po qe se vetëm pak shfletohet biografia e familjes së tij, atëherë del se mbiemri *Kosova*, që e mban Bashkimi është i shpifur, sepse ai i njëmendti, i familjes së tij, që nga koha e Perandorisë Osmane është *Alushi*. Kur Serbia do të kthejë Kosovën në vitin 1912 pas luftërave të përgjakshme kundër Turqisë, Ferid Alushi do të jetë njëri ndër anëtarët e parisë së Prishtinës, i cili do të zihet rob nga ushtria çlirimtare serbe në Merdare, duke luftuar në anën e ushtrisë osmane. Si rob luftime, bashkë me shumë të tjerë, do të dërgohet në Beograd, ku për gjashtë muaj do të mbetet në kampin e robërve të luftës në Kalemegdan. Me ndërmjetësimin e Kryqit të Kuq ndërkombëtar, do të kthehet në Kosovë, pasi që do të ketë nënshkruar deklaratën se pranonte lojalitetin e shtetit serb.

Ferid Alushit, do t'i kthehet pasuria (dy shtëpi të mëdha në Prishtinë) si dhe disa hektarë tokë në Hajvali. Do t'i lejohet ushtrimi i tregtisë, siç do t'u kthehet edhe të tjerëve që do t'ia deklarojnë lojalitetin shtetit serb.

Deri sa do të fillojë Lufta e Parë Botërore, familja Alushi do të përkujdeset për tregtinë. Po ashtu edhe farefisi i tij i gjerë në Hade dhe në Vuçitërnë, do të merren me bujqësi dhe me blegtori pa u përzier në çështjet tjera.

Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore, familja Alushi, me të shpejtë do të angazhohet kundër pushtimit bullgar. Shteti serb, edhe pse në një gjendje të rëndë, do të përpiqet që të mbështesë shqiptarët kundër pushtuesit bullgar. Por, krahas luftës kundër bullgarëve, ku shqiptarët ishin shumë veprues, Serbia do të bëjë çmos që kaçakët shqiptarë në zonën pushtuese bullgare (ku bënte pjesë edhe Prishtina deri në Mitrovicë dhe Gjilan e përfshinte edhe Shkupin bashkë me Tetovën dhe Dibrën), të kalonin në zonën e Austro-Hungarisë (Drenicë, Dukagjin e deri në Plavë e Guci) dhe atje të luftonin kundër tyre.

Edhe pse shumë nga kaçakët shqiptarë nga zona pushtuese bullgare Serbia do t'i joshë që të hedhën në pjesën që mbikëqyrte Austro-Hungaria, familja Alushi nuk do të pranojë këtë. Ferid Alushi do t'i deklarojë peshkopit Artemije nga Graçanica se për të pushtues ishin bullgarët dhe jo austro-hungarezët, të cilët në pjesën që mbikëqyrnin kishin hapur shkollat shqipe dhe kishin vendosur administratën shqiptare. Kur peshkopi Artemije i kishte thënë se austro-hungarezët këtë e kishin me sherr, ai ia kishte kthyer se ata që hapnin shkollat shqipe dhe lejonin administratën shqiptare në Kosovë nuk ishin armiq. Edhe ju do të fitoni shumë miq po qe se i hapnin shkollat shqipe.

Serbia dhe më vonë mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene (pas Luftës së Parë Botërore) edhe më tutje kishte qenë të interesuar që me familjet e njohura shqiptare në Kosovë të mbajë lidhje të mira dhe, gjithnjë duke bërë përpjekje që t'ua respektojë identitetin fetar (atë islam) në vend të atij kombëtar.

Por, si do të shihet, Familja Alushi, si shumë familje të tjera shqiptare, që sa për sy e faqe kishte pranuar lojalitetin e saj dhe madje rregullat që kishte vu Beogradi (pranimi i parlamentarizmit), nga ana tjetër vazhdimisht kishin bërë përpjekje të fshehura që të lidheshin me rrymat irredentiste në Shqipëri dhe jashtë vendit, veçmas me atë që udhëhiqte Hasan Prishtinën, familja e të cilit në Vuçitërnë mbante mbiemrin Berisha, me të cilën ata kishin edhe miqësi familjare. Në kohën e fashizmit kur Kosova dhe një pjesë e viseve të Maqedonisë do t'i bashkohet Shqipërisë së Madhe të krijuar nga Roma dhe Berlina, familja Alushi do të mirëpresë ardhjen e fashizmit. I vëllai i Feridit, Ferati do të futet në këshillin bashkiak, disa do të hynë në administratë, një në xhandarmeri (Mehdiu) ndërkohë që tregtinë do ta zgjerojnë, duke u shtrirë edhe në pjesët tjera në drejtim të Shkupit dhe Shkodrës.

Si rëndom, që në rrethana të turbullta shqiptarët i kanë ndarë rolet, që edhe kur të dalin humbës të fitojnë, do të jetë kushëriri i tyre Samiu, i shkolluar në Medresenë e Shkupit, që do t'i bashkohet Lëvizjes Nacional Çlirimtare, ku edhe do të mobilizohet në Brigadën e VII të Kosovës, e cila në mars të vitit 1945 do të shkojë në Srem për të marrë pjesë në luftimet përfundimtare kundër forcave fashiste dhe atje do të vritet dhe do të shpallet dëshmor i luftës antifashiste. Në Medresenë e Shkupit ai do të paraqitet me mbiemrin Kosova. Nga një shënim i OZNE-s i bërë pas çlirimit të Kosovës nga forcat nazi-fashiste, bëhet e ditur se mbiemrin Kosova e kishte marrë për t'u shkëputur nga kushërinjtë Alushi, të cilët kryesisht ishin vu në shërbim të fashizmit. Por, në dosjen e plotësuar nga i njëjti shërbim në vitet e pesëdhjeta, vlerësimi se mbiemrin e kishte ndryshuar për t'u shkëputur nga kushërinjtë, do të korrigjohet me qëndrimin e prerë se Sami Alushi kishte ndryshuar mbiemrin në Sami Kosova për qëllime irredentiste.

Madje, edhe emërtimi i fëmijëve *Naim* (i ati i Bashkimit, pilot i Armatës Popullore të Jugosllavisë), *Arsim* (arsimtar në Hade) dhe *Shpresa* (e martuar për nipin e Hasan Prishtinës, Njazi Berishën, jurist i njohur nga Vuçitërna), kur shihen mirë e mirë, lidhen me ide shqiptaro-mëdha. Sepse emri *Naim* duhej të shënonte lidhjen me mësimet e poetit nationalist shqiptar *Naim Frashëri*, emri *Arsim* pasqyrore përcaktimin e shqiptarëve për arsimim të domosdoshëm nationalist, ndërsa emri *Shpresa* duhej të ushqente shpresën se Kosova një ditë duhej doemos t'i bashkohej Shqipërisë.

Andaj, nuk është për t'u habitur pse edhe i biri Naim Kosova, i cili do të jetë ndër kadetët e parë shqiptarë që do të arrijë gradën e kapterit të aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë (pas vdekjes tragjike gjatë një fluturimi me aeroplanin ushtarak në vitin 1960, i dekoruar nga presidenti Tito me urdhrin e artë për merita për popull), i martuar me kroaten Maria, kur të birit do t'ia lërë emrin Bashkim, këtë mund ta ketë bërë nga bindjet irredentiste? Pse jo. Një fjalë e urtë e shqiptarëve thotë “ujku qimen e ndërron e adetin jo”. Sjellja historike e shqiptarëve është në përputhje me këtë maksimë, sidomos ajo mes dy luftërave botërore e këndej.

Edhe pse, gjatë një bisede me eprorët e lartë, kishte thënë se emri i të birit *Bashkim* do të fitonte kuptim të plotë, pra do të dëshmonte përkushtimin e tij për *bashkim-vëllazërimin*, meqë të dytin do ta pagëzonte *Vëllazërim*, e gjitha mund të dukej si mashtrim, sepse si do të shihet, Bashkim Kosova, i shkolluar dhe i edukuar nën përkujdesjen e Armatës Popullore të Jugosllavisë, siç pritej, jo vetëm që nuk do të ruajë frymën e bashkim-vëllazërimit dhe atë të patriotizmit jugosllav, por do të veprojë për të kundërtën. Rol të madh këtu nuk do të ketë vetëm fryma familjare dhe mbetja në rrethin e amanetit të saj të njohur nationalist-irredentist, por do të luajë edhe klima e njohur shoqërore dhe politike që në Kosovë do të shfaqet pas Plenumit të njohur të Brionëve të qershorit të vitit 1966, kur përcaktimet për ndryshimin e statutit të Kosovës në përputhje me amendamentet kushtetuese të cilat do të aprovohen në kushtetutën e vitit 1974, do të shfrytëzohen për t'i dhënë legjitimitet kursit të njohur nationalist shqiptar për krijimin e republikës së Kosovës në rrugë institucionale dhe ato joinstitucionale.

Rasti i *Bashkim+Kosovës* dhe sjellja e tij në Madrid me rastin e triumfit në Kampionatin European kur ai në të gjitha deklaratat për shtyp do ta theksojë Kosovën dhe do ta shmangë Jugosllavinë, tregoi më së miri pse ndodhja e shpërthimit të nacionalizmit shqiptar nga pozitë irredentiste dhe kundërrevolucionare në mars dhe prill të vitit 1981 ishte

e pritshme dhe e mundshme. Gjatë dy viteve të fundit, kur do të fillojë procesi i diferencimit nga nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar dhe, shumëçka e këtij thadrimi do të dalë në pah, përqendrimi i shqiptaro-mëdhenjve tek sporti dhe më konkretisht te *Bashkim+Kosova*, nuk do të jetë as i rastit e as pa qëllime të caktuara. Sepse, aty mrekullisht gjejnë mjetin më të përshtatshëm për të manifestuar pikëpamjet e tyre.

Heshtakët e shumtë nga radhët e intelektualëve, të nëpunësve dhe të të rinjve, që bëjnë çmos për t'i bishtnuar deklaratimeve diferencuese në mënyrë që të ruajnë pozitat nëpër institucionet shtetërore ato arsimore, kulturore dhe në ekonomi e administratë, nëpër stadione (në ndeshjet e boksit të klubit "Prishtina", ose në ato të futbollit), me parullat ngojë: "*Bashkim!Bashkim!*", pastaj ato "*Kosova!Kosova*" dhe "*Fitore!Fitore!*", të cilat përmbyllen me këngën "*Besa-besë...*", i bashkohen atij që quhet demonstrim publik nationalist i përmasave të mëdha.

Sporti, pra këtë ua mundëson. Ua mundëson edhe sportisti *Bashkim+Kosova*, si po shihet një investim i gabueshëm i projektit të vëllazërim-bashkimit ndër shqiptarët, që duhet të korrigohet para se të bëhet vonë.

Por, para se politika këtë ta bëjë, e duhet ta bëjë doemos, megjithatë sporti duhet të sillet në përputhje me rregullat e lojës, që do të thotë se ata që nuk i përfillin ato, ose i keqpërdorin, të përjashtohen prej saj sa më shpejt dhe përgjithmonë!

Kjo duhet të vlejë edhe për *Bashkim+Kosovën* si sportist dhe për përkrahësit e tij nationalistë...

(Pjesë nga fejtuni i botuar në "Politika" të Beogradit më 25 dhjetor 1982)

Bashkimi pa Kosovën (Bashkim minus Kosova) në vend të Bashkim plus Kosova

Një kohë të gjatë (nga Plenumi i Brioneve e tutje), një pjesë e gazetave të vendit (ato në gjuhën shqipe nga Prishtina, nga Zagrebi dhe Lubjana) do të bëjnë përpjekje që shqiptarët e Kosovës t'i paraqesin viktima të nacionalizmit dhe të të ashtuquajturit unitarizëm serb, ku ata shihen të shtypur në një vazhdimësi historike që nga viti 1912 e tutje. Ky përgjithësim madje do të përfshijë edhe kohët kur regjimet antipopullore, siç ishin ato gjatë mbretërisë jugosllave e deri te fitorja e revolucionit socialist, njësoj shtypëse dhe antipopullore do të jenë edhe kundër popujve të tjerë të Jugosllavisë, pasojat e të cilit më së shumti do t'i vuajë edhe populli lirishtë serb.

Por demonstratat kundërrevolucionare nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar të vitit 1981 në Prishtinë nxorën në pah të kundërtën: aspiratat shqiptaro-mëdha, të cilat tash shfaqen nën parullën të gjoja barazisë me të tjerët, ku republika e Kosovës me të drejtën e plotë të konsensusit në federatë, paraqet pikënisjen për shkatërrimin e Jugosllavisë, meqë hapi i ardhshëm i republikës së Kosovës do të ishte shkëputja dhe pastaj bashkimi me Shqipërinë enveriste-staliniste, që do të thoshte çrregullim gjeostrategjik dhe gjeopolitik në gjithë rajonin, i cili nuk mund të mbetet pa pasojat.

Se fjala është për një komplot të kësaj natyre, që tashmë nuk mund të fshihet, flasin të dhënat gjithnjë e më shqetësuese rreth veprimtarisë së grupeve marksiste-leniniste me përcaktim enverist-stalinist në vendet perëndimore, veçmas në Gjermaninë Federale, ku filiale të ndryshme tashmë po bashkohen. Ky bashkim përfshinë kryesisht të rinj nga

Kosova, të cilët kërkojnë strehim politik në vendet perëndimore, kanë krijuar jatakët e tyre nëpër klubet e punëtorëve shqiptarë nga Kosova dhe viset tjera të Jugosllavisë me punë të përkohshme në Gjermaninë Federale. Shumë prej tyre janë infiltruar në udhëheqjen e këtyre klubeve dhe përpiqen që punëtorëve t'u shpërndajnë sa më shumë literaturë propaganduese me përmbajtje ideologjike. Krahas veprave të Enver Hoxhës, aty gjenden edhe shkrimet e ndryshme pamfletistë për republikën e Kosovës. Shumë nga këto pamflete, fshehtas dërgohen në Kosovë dhe u shërbejnë grupeve të ndryshme marksiste-leniniste për ta mbajtur të gjallë kërkesën për republikën e Kosovës. Andaj, nuk është për t'u habitur pse organet e rendit gjithnjë e më shumë nëpër shkollat e Kosovës (fillore dhe të mesme) ndeshin pamflete të tilla, të cilat shpërndahen fshehtas, por diku-diku edhe haptas dhe mbi platformën e tyre pastaj shfaqen edhe organizatat e ndryshme armiqësore, të shumtën të përbërë nga të rinj dhe studentë me ide irredentiste, që veprojnë kundër rendit kushtetues të Jugosllavisë. Edhe pse ndaj organizatorëve merren masa ligjore (dënohen për kundërvajtje ose u nënshtrohen ndjekjeve penale), kërkesa për republikën e Kosovës jo vetëm që nuk hasë në kundërshtim, por ajo gjen përkrahje të hapur thuajse tek të gjitha shtresat shoqërore të shqiptarëve të Kosovës nga klasa punëtore, punonjësit e arsimit, ata të kulturës, të administratës e deri te sportistë. Te këta të fundit, madje, nacionalizmit pasqyrohet në një mënyrë të veçantë, meqë terrenet sportive si dhe atmosfera e stadiumeve shfrytëzohen për demonstrime të hapura, me shfrime të përmasave të mëdha, të cilat pastaj pa ndonjë vështirësi barten nëpër rrugë dhe sheshe.

Kështu, fitoret e klubit të futbollit "Prishtina", që garon në ligën e parë federative dhe ato të klubit të boksit "Prishtina", i cili po ashtu bën pjesë në ligën e parë federative dhe tashmë ka fituar dy tituj të kampionit shtetëror ndërsa boksierët e tij kanë fituar tituj kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithnjë e më shumë po shndërrohen në demonstrime nacionaliste, ku këndohen këngë nacionaliste (të shumtën me përmbajtje irredentiste) dhe hedhen parulla për Republikën e Kosovës, por ku nuk mungojnë edhe ato për bashkimin me Shqipërinë enveriste.

Edhe pse klasa politike e Kosovës mundohen që atë që po ngjet nëpër terrenet sportive t'i shikojnë si "eksese të shkëputura", të cilat nuk ndikojnë atë që quhet bashkëjetesë e harmonishme midis kombeve dhe kombësive tona, megjithatë tashmë mund të thuhet pa ndonjë hezitim se në Kosovë nuk mund të bëhet fjalë as për bashkëjetesë të harmonishme e as për perspektivë të vëllazërim-bashkimit, por për të kundërtën. Populli serb, ai malazias dhe joshqiptarët e shumtë (turqit, romët, goranët, hashkalinjtë dhe të tjerët që jetojnë aty) nga këto që po ndodhin prej vitesh, jo vetëm që kanë humbur besimin te lojaliteti i shqiptarëve ndaj Jugosllavisë me të cilin disa politikanë e kanë gojën plotë, por nuk shohin perspektivë për të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre këtu. Andaj, nuk është për t'u habitur pse shumë prej tyre tashmë po ikin nga Kosova siç u ka ndodhur mijëra e mijëra të tjerëve nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta e tutje. Kërkesa për republikën e Kosovës dhe përkushtimi i nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptar ndaj saj, kanë bërë që serbët t'i lëshojnë vatrat e tyre shekullore. Ata kanë të drejtë kur thonë se ndaj tyre po ushtrohet trysni e hapur që ta bëjnë këtë, ndërkohë që shteti, pos fjalëve boshe, nuk ndërmerr gjë që kjo të parandalohet disi. Madje, të ashtuquajturat procese të diferencimit, që vazhdojnë në planin politik dhe atë shoqëror, jo vetëm që nuk sjellin ndonjë dobi në këtë drejtim, por me anën e tyre nacionalistët dhe irredentistët shqiptar vetëm sa ia dalin t'i ngjeshin radhët e tyre, qoftë kur heshtin, qoftë

kur flasin, meqë në rastin e parë homogjenizohen nga brenda, ndërsa në rastin e dytë, duke manipuluar me të dhëna statistikore rreth prapambetjes ekonomike të Kosovës, gjithnjë e më shumë kalojnë në ofensivë me ç'rast, duke paraqitur pakënaqësinë e popullatës shqiptare si pasojë e moszhvillimit e jo si pjesë e nacionalizmi, ia dalin që t'i ndryshojnë tezat.

Por, kjo e keqe, e ka edhe të mirën e vet. Sepse, opinioni i brendshëm e edhe ai i jashtëm, tashmë e kanë të qartë se çfarë kërkojnë shqiptarët e Kosovës dhe cilat janë pikëpamjet e tyre, por edhe strategjia për arritjen e qëllimeve të tyre, të cilat janë të lidhura ngushtë me konceptin për shkatërrimin e Jugosllavisë në mënyrë që pastaj t'i bashkohen Shqipërisë pa qarë kokën për çmimin dhe pasojat.

Kështu, pra, Jugosllavia e me këtë edhe Serbia, e kanë shumë më lehtë që masat për mbrojtjen e integritetit territorial si dhe rregullimin e brendshëm të federatës, ku Serbisë duhet t'i kthehet sovraniteti i humbur në Kosovë, t'i arsyetojnë, por edhe t'i mbrojnë me anën e shtetit të ligjit.

Tashti pra, pasi që është ndarë shapi prej sheqerit, shteti nuk ka pse të hezitojë t'i qërojë hesapet me ata që duan ta shkatërrojnë.

Po ashtu, në këto rrethana, kur nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë kanë formuluar strategjinë e tyre që së pari të arrijnë Republikën e Kosovës dhe pastaj me të t'i bashkohen Shqipërisë (*pra sipas formulës: Bashkim+Kosova*), Jugosllavia duhet të dalë me kundërpërgjigjen: *Bashkim* (minus) *Kosova* (*Bashkim pa Kosovën*), që do të thotë shqiptarët, po qe se duan t'i mbeten besnik nacionalizmit dhe irredentizmit të tyre, mund "të bashkohen" me Shqipërinë, por pa Kosovën, që do të thotë se ata mund të shkojnë në Shqipëri, prej edhe nga kanë ardhur, kur të donë dhe atje ta krijojnë "*bashkimin e tyre kombëtar*".

Kjo duhet t'u mundësohet, qoftë edhe me mjetet e dhunës atyre shqiptarëve, që sot kërkojnë shkatërrimin e Jugosllavisë, por pa Kosovën, në mënyrë që të mbrohet jo vetëm Jugosllavia, por edhe paqja dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë...

("*Politika Ekspres*", Beograd, më 4 dhjetor 1982)

Ata që nuk e duan Jugosllavinë nuk mund ta përfaqësojnë atë...

Boksieri *Bashkim+Kosova* nuk mund ta përfaqësojë me Jugosllavinë në arenën ndërkombëtare.

Kjo duhet t'i ndalohe nga ana e Lidhjes së Boksit të Jugosllavisë.

Por, para se organizata e boksit ta bëjë këtë, është detyrë e Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë dhe e forumeve të tjera shoqërore-politike, veçmas e atyre nga Kosova, gjithë çështjen ta vlerësojnë në përputhje me rëndësinë që ka dhe t'i japin përgjigjen e duhur, në mënyrë që pastaj ai të zbatohet nga organet përgjegjëse të boksit.

Me këtë rast duhet të thuhet shkurt e trup se *Bashkim+Kosova* nuk e meriton nderin që të jetë i përzgjedhur i reprezentacionit tonë, meqë për të parësore është Kosova dhe jo Jugosllavia si shtet i përbashkët i të gjithëve.

Edhe më herët, por edhe së voni, për *Bashkim+Kosovën* arena ndërkombëtare e sportit paraqet një mundësi të mirë për deklarime nacionaliste. Kjo pasqyrohet nga ato që ai para shtypit botëror vazhdimisht i thotë: "*jam shqiptarë nga Kosova*" pa e përmendur fare

Jugosllavinë. Ose, duke përdorur sintagmën “*sporti në Jugosllavi*” në vend të sportit jugosllav, “*boksier shqiptar*” në vend të “*boksier jugosllav*” dhe të ngjashme.

Të njëjtin avaz e ka vazhduar edhe atëherë kur i është tërhequr vërejtja.

“Të jesh shqiptar dhe të deklaroresh si i tillë nuk është kundër kornizës shtetërore të Jugosllavisë. Përkundrazi, Jugosllavia përfaqësohet dhe mbrohet më së miri si bashkësi e barabartë e kombeve dhe kombësive të saj”.

Janë, pra këto, slogane demagogjike të huazuara nga fjalori i nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptar, me anën e të cilave duhet t’i përgatitet terreni minimi të unitetit brendshëm të Jugosllavisë të bazuar mbi parimet e vëllazërim-bashkimit në rrethanat e socializmit vetëqeverisës jugosllav.

Andaj, nuk është për t’u habitur pse ai është kthyer në idhull të rinisë shqiptare në Kosovë dhe në viset tjera të Jugosllavisë. Kështu që, nuk është për t’u habitur pse nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë demonstrimet armiqësore me thirrjet “*Kosova*” dhe “*Bashkim*” i fillojnë nëpër stadiume si tifozë të zjarrtë për t’u derdhur pastaj nëpër rrugë dhe sheshe të Prishtinës. Të tillët nuk po ngurrojnë që këtë disponim ta shprehin edhe nëpër qytetet serbe (Prokupje, Nish dhe Kragujevc), gjë që kjo pastaj po përcillet me reagime të ashpra të qytetarëve, të cilët me të drejtë po kërkojnë që t’u ndalet hovi ngacmimeve të nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë nëpër terrenet sportive anembanë vendit. Një reagim i tillë në Prokupje para pak ditësh kishte rrezik që të kthehej në një konflikt ndërnacional të përmasave të mëdha kur organet e rendit nuk lejuan që tifozët nga Prishtina (lexo: nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë) nuk u lejuan që në hallën sportive ku duhej të mbahej dueli midis ekipit vendës dhe “Prishtinës” të fusnin transparente me përmbajtje armiqësore siç ishin ato “*Kosova fiton*”, “*Bashkimi ynë i pathyeshëm*”, e të tjera.

Meqë në hyrje u krijua një tollovi, qytetarët kërkuan që forcat e rendit të mos i lejojnë fare tifozët e Prishtinës të përcjellin ndeshjen edhe pse ata më kohë kishin siguruar biletat. Çështja u ashpërsua edhe më kur dikush nga klubi “Prishtina” kërcënoi se po qe se tifozët që kishin ardhur nga Prishtina (rreth 200 sosh) nuk lejohen të hynë, atëherë boksierët e Prishtinës nuk do të dalin fare në ring. Kjo acaroi edhe më tepër qytetarët dhe tifozët vendës, të cilët filluan të kërcënohen se dueli duhej të mbahej medoemos. Në rrethana të tilla u dash të ndërhyjnë faktorët politikë nga nivelet më të larta të vendit, paçka pastaj ndeshja u zhvillua, por tifozët nga Prishtina (pa pankarte dhe flamuj të klubit) u mbajtën të skajuar në pjesën e fundme të hallës, të rrethuar nga forca të mëdha të policisë, një pjesë e të cilave ishin nga ato të njësisë speciale. Që zjarrit të mos i hidhej vaj, ekipi vendës tërhoqi boksierin e vet nga lufta me *Bashkim+Kosovën*, meqë aty mund të gjendej shkasi për shpërthim midis tifozëve nga Prishtina dhe atyre vendës.

Edhe përkundër kësaj, nacionalistët shqiptarë filluan të provokojnë me thirrjet “*Kosova*” dhe “*Fitore*” si dhe të këndojnë këngën “*Besa-besë...*”, së cilës tifozët vendës iu kundërvunë me klithjet “*Serbia*”, që përcilleshin me himnin “*Hej, slloveni*”.

Duhet thënë se nëse vazhdojnë ngacmimet e tilla, atëherë mund të ndodhë që disa klube të Serbisë të kushtëzojnë mbajtjen e dueleve sportive me boksierët nga Prishtina pa praninë e tifozëve të këtij klubi. Kjo masë josportive, në të vërtetë është një mjet mbrojtës nga provokatorët, të cilët sportin e shfrytëzojnë për qëllime nacionaliste dhe armiqësore...

(*Veçernje Novosti, Beograd, 19 mars 1983*)

Për ke bien kambanat?...

Bashkim+Kosova serish po e shqetëson opinion jugosllav dhe me të drejtë madje. Sepse, në kohën kur faktorët politiko-shoqëror të vendit të të gjitha niveleve, me anën e procesit të diferencimit politik, i cili me mjaft vështirësi po vazhdon prej më shumë se dy vitesh në Kosovës, po bëjnë një luftë të ashpër kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar dhe, kur duket se ia dalin që të rrënojnë ndonjë nga “kështjellat” e tij në arsim apo kulturë, sa ora shfaqet ai dhe “tifozyt” e tij dhe, gjendja kthehet te fillimi.

Kjo “kthesë” mbase është e lehtë pse sjellja e shumicës së shqiptarëve gjatë proceseve të diferencimit është e pasinqertë madje hipokrite, ndërkohë që sillen ashtu si mendojnë, pra me fytyrën e tyre të njëmendtë, nëpër stadione (gjatë ndeshjeve të futbollit, të boksit dhe të basketbollit) kur frustrohen kolektivisht me këngët “*Besa-besë...*” pasi që të jenë “mbushur” nga fitoret e Bashkim Kosovës dhe të shokëve të tij apo ato të futbollit, ku secila fitore e “Prishtinës” në Ligën e Parë përjetohet dhe kremtohet si fitore ndaj Jugosllavisë.

Kështu, sporti dhe “fuqia e tij magjike” për t’u liruar nga streset ditore, në Kosovë shfrytëzohet për të kundërtën.

Disa mendojnë se mbase kështu është më së miri. Sepse, kështu përditshmëria lirohet nga energjia e tepërt dhe mbushjet tjera, që vetëm sporti dhe atmosfera sportive është në gjendje që t’i zbrazë.

Ka madje mendime se Kosovës i duhen edhe më shumë sportistë të suksesshëm si Bashkim Kosova dhe boksierët tjerë të Prishtinës, pale si kremtohen ata, meqë kështu dhe në këtë mënyrë shqiptarët lirohen nga ndjenja e inferioritetit dhe e nënçmimit nëpër të cilën gjatë kohë kanë kaluar?

“Sporti le të mbetet sport”, thotë “Danasi” i Zagrebit.

“Mos e përzieni sportin me politikë”, thotë “Dello” e Lubjanës.

“Tifozyt kanë të drejtë që të jenë të lirë”, thotë “Vjesnik” i Zagrebit

Mbase kështu do të ishte më së miri, po të mos ishte pikërisht realiteti i ngatërruar kosovar ku çdo gjë përjetohet ndryshe nga e natyrshmja dhe, ajo që për dike duket “frustrim sportiv”, tjetri e merr si “trysni” dhe shpallje e luftës speciale, madje.

Andaj, nuk është për t’u habitur pse mbi këtë “ngatërrim” sot më shumë se kurrë luan nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar, i cili mezi pret që atë që duket se ndërtohet ditën, ta rrënojë natën.

Por, nacionalizmi dhe irredentizmit shqiptar, sigurisht se nuk do të ishte kaq shpërthyes po mos të kishte mbështetës edhe nga republikat e veriut (Kroacia dhe Sllovenia), të cilat janë kthyer në sekondantë të tyre sa herë që e kanë ngushtë.

Kështu, kroati Bruno, po e përdor autoritetin e vet si seleksionues i reprezentacionit të Jugosllavisë në boks, që Bashkim Kosova të mos qajë kokën për deklaratat e tij nacionaliste. Bruno thotë se Bashkim Kosova është sportist i një kalibri botërore dhe se për të e rëndësishme është ajo që ai tregon në ring.

Dhe në ring, përnjëmend boksieri nga Prishtina është klasë në vete, por njësoj “klasë në vete” shfaqet edhe jashtë ringut, kur jep deklarata me të cilat nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë trimërohen dhe ushqehen për të rikthyer atë që ua rrezikon politika gjatë diferencimeve.

Edhe për këtë Bruno dhe mbështetësit e tij në Zagreb, Lubjanë dhe gjetiu kanë një përgjigje kur thonë:

“Mos e bëni sportin politikë dhe politikën sport”.

Por, kush po e kthen sportin në politikë pos Bashkim Kosovës dhe disa sportistëve të tjerë nga Kosova (futbollistë të klubit “Prishtina” dhe së voni edhe të klubit të basketbollit të femrave “Universiteti”).

A nuk janë ata të cilët sportin po e shfrytëzojnë për qëllime politike pikërisht siç po u duhet nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë? A nuk janë ata të cilët çdo fitore nxisin tifozët që të brohorisin për Kosovën dhe të këndojnë këngën “*Besa-besë...*”, refreni i së cilës “*për Kosovë jetën kam me e dhanë...*” hap me të drejtë çështjen se kush po e kërcënuaka Kosovën, që u dashka të mbrohet? Cilët janë ata? Dhe, po që se është kështu, atëherë a nuk është detyrë e të gjithëve që ajo të mbrohet?

Këto dhe thirrje të ngjashme, janë parulla të nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë, të cilët Kosovën e konsiderojnë pronë të tyre, ndërkohë që të tjerët, sidomos serbët dhe malaziasit, të cilët po ashtu janë pjesë e historisë së saj dhe aty kanë djepin e qytetërimit mesjetar, duhet të largohen prej saj.

Në të vërtetë, betimi “*për Kosovë jetën kam me e dhanë*”, është thirrje kundër serbëve dhe pranisë së tyre në Kosovë, në mënyrë që ata të largohen prej saj. Populli serb, i cili disa herë gjatë historisë së vet ka përjetuar eksode nga djepi i vet, nuk ka si të mos shqetësohet kur dëgjon këto thirrje, që thuhën nga kore kolektive prej mijëra vetash. Populli serb, të cilit disa herë i janë rrënuar shenjtërit në Kosovë me qëllim që t’i humben gjurmët e kujtesës historike, druan me të drejtë se serish po krijohen rrethanat që t’i rikthehen kalvaret e tmerrshme nëpër të cilat ka kaluar. Nga frika se kjo mund të ndodhë, shumë familje serbe dhe malaziase tashmë kanë filluar të largohen nga Kosova.

Kambanat e alarmit tashmë kanë filluar të bien..

(“*NiN*”, *Beograd, mars 1983*)

Kosova nuk duhet të shkojë në Olimpiadë

Nuk është mirë kur politika ndërhyjë në sport, por nganjëherë është e domosdoshme, kur me sportin dëshirohet të bëhet politikë, madje politikë rrënuese, që prek interesat e shtetit.

Megjithatë, mund të thuhet se Jugosllavia, si bashkësi e kombeve dhe kombësive të barabarta, ka ardhur në një situatë kur për hir të ruajtjes së këtyre vlerave mbi të cilat ndërtohet e sotmja dhe ardhmëria jonë socialiste, duhet të tregojë se është në gjendje këtë ta bëjë edhe me anën e ndalesave “pozitive”.

Dhe, njëra prej këtyre, pa dyshim se duhet të jetë ajo që ka të bëjë me vendimin që *Bashkim+Kosova* të mos shkojë në Lojërat Olimpikë verore, që mbahen vitin e ardhshëm në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nëse trajneri i reprezentacionit shtetëror të boksit ngul këmbë që këtë ta bëjë, siç po deklaron, atëherë edhe atij, pse jo, t’i merret mandati i seleksionuesit.

Me siguri se nëse veprohet kështu do të ketë reagime të organizatave të ndryshme sportive dhe të forumeve ndërkombëtare, por shteti ynë, i cili prej vitesh po merret me

luftimin e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar në Kosovë dhe këtë po e bën edhe për të mirën e ruajtjes së paqes dhe të stabilitetit në rajon dhe më gjerë, ngaqë trimërimi trimërimi i tij rrezikon edhe vendet përreth, duhet ta ketë përgjigjen e gatshme për këtë, dhe kjo duhet të thuhet shkurt e trup.

Nëse Komitetit Olimpik do t'i ofrohen që të gjitha të dhënat rreth veprimtarisë nacionaliste të boksierit *Bashkim+Kosova* si dhe i bëhet me dije për mundësinë që me këtë rast lojërat olimpike të keqpërdorën nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptar për qëllime politike, atëherë edhe anëtarët e këtij forumi të nderuar do të kenë mirëkuptim për vendimin e shtetit tonë, i njohur në botë për politikë paqësore. Madje, qysh tash mund të thuhet se nënkryetari i Komitetit Olimpik, sovjetiku Kovalenko, ka shprehur qëndrimin e Komitetit Olimpik Sovjetik që në Lojërat Olimpike të Los Anxhelosit të mos ketë vend për shovinizëm, racizëm dhe për dukuni të tjera që bien ndesh me frymën sportive.

Ky qëndrim është pranuar edhe nga anëtarët tjerë të Komitetit Olimpik që vinë nga vendet socialiste dhe ata të botës së tretë (të pa inkuadruarve), ku vendi ynë gëzon autoritet të madh dhe kurdoherë është në gjendje që të mbështetet në qëndrimet e tyre parimore.

Se nikoqirit (Shteteve të Bashkuara të Amerikës) i është tërhequr vërejtja që të mos lejohet që sporti dhe fryma e tij sportive të keqpërdoret gjatë mbajtjes së Lojërave Olimpike, këtë e ka dëshmuar edhe paralajmërimi i Republikës së Kinës, që nëpër kuluaret e lojërave të mos lejohet kurrfarë pranie e përfaqësuesve të Tibetit, qofshin ato edhe të natyrës kulturore dhe shpirtërore, të cilat jo rrallë fshihen prapa formulave të demonstrimeve të lira të qytetarëve.

Nëse Izraelit i plotësohet çdo kërkesë që përfaqësuesve arabë të mos u lejohet çfarëdo shprehje solidariteti me popullin palestinez, meqë kjo bie ndesh me sigurinë e shtetit izraelit, atëherë pse të mos kërkohet që edhe nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë t'u ndalohen demonstrimet me përmbajtje armiqësore ndaj vendit tonë dhe të tjerave përreth (Greqisë dhe Bullgarisë)?

Por, para se të bëhet kjo, është e domosdoshme që nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë nga radhët e emigracionit kuisling-fashist, që ndodhet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa vende të tjera perëndimore nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e tutje dhe, aty gjen përkrahje, t'u merret mundësia për t'u shfaqur si "tifoze" të rëndomtë.

Në këtë pako duhet përfshirë edhe me grupet marksiste-leniniste që sot Shqipëria e Enver Hoxhës i financon në vende të ndryshme perëndimore, por edhe disa grupeve të tjera të ngjashme të lidhura me qendrat staliniste dhe shërbimet e tyre, që në disa vende europiane, veçmas në Gjermani, Belgjikë, Francë e gjetiu, fshihen prapa shoqatave të miqësisë me Shqipërinë.

Dhe kjo mund të bëhet vetëm po qe se boksieri *Bashkim+Kosova* nuk merr pjesë në Lojërat Olimpike në Los Anxhelos.

Në të kundërtën, demonstrimet nacionaliste dhe irredentiste të shqiptarëve do të jenë të pashmangshme. Prania e *Bashkim+Kosovës* do të jetë një shkas i mirë që nga ana e tyre atmosfera sportive të shfrytëzohet për qëllime politike. Natyrisht se këtë ata do ta bëjnë me perfiditet të madh, gjithnjë duke u shfaqur si "tifoze", të cilëve u mjafton vetëm dalldia me mbiemrin Kosova, që aq mirë futet në këtë kontekst, që e gjitha pastaj të kthehet në një demonstrim politik të përmasave ndërkombëtare, të tillë çfarë e kërkojnë sot ata, por jo vetëm ata.

(“Politika”, Beograd, 22 mars 1984)

(Shkrime dhe komente rreth sjelljes së Bashkim Kosovës në Los Anxhelos me rastin e marrjes së medaljes së artë kur nuk do të këndojë himnin jugosllav “Hej slloveni” si dhe shkrime nga manifestimet e shqiptarëve, të cilët do ta kremtojnë titullin e kampionit olimpiq në një rën anë me flamuj kombëtar shqiptar dhe në tjetrën anë me parullat për “Kosovën republikë”, e ku nuk do të mungojnë edhe fotografitë e Enver Hoxhës me ikonografi staliniste)

Medalja olimpique për Republikën e Kosovës!

Në Lojërat Olimpique në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndodhi ajo që pritej: *Bashkim+Kosova* fitoi medaljen olimpique, por prarimi i saj i artë u shfrytëzua nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë, e cila në botë njihet për standardet e larta të respektimit të të drejtave njerëzore, që i gëzojnë pakicat kombëtare, veçanërisht ajo shqiptarja, e cila krahas autonomisë kulturore posedon edhe atë administrative, që është e ngjashme me atë të njësive të tjera federative.

Siç u pa në Los Anxhelos, nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë , gjithnjë të shoqëruar edhe nga një grup enveristësh të ardhur enkas nga vendet europiane ku ata tashmë kanë degët e tyre si pjesë e agjenturave të hapura vendeve staliniste, demonstruan me parullën “*Kosova Republikë*”, jo që të kërkojnë barazi, si thonë, me të tjerët, por për t’ia hapur rrugën shpërndarjes nga Jugosllavia në mënyrë që pastaj të bashkohen me Shqipërinë enveriste, të njohur si bastion të fundit të stalinizmit më të egër në botë.

Edhe në Los Anxhelos, pjesa më e madhe e atyre që demonstruan dhe ishin tepër të zëshëm, nuk ishin shtetas amerikanë, por pjesëtarë të grupeve marksiste-leniniste, filiale të Partisë së Punës së Shqipërisë të shpërndarë në vendet europianoperëndimore, të shumtën refugjatë politikë nga Kosova, të strehuar në Gjermani, e ku nuk mungonin edhe bashkëmendimtarë të tyre nga Belgjika, Franca dhe Zvicra.

Këto grupe marksiste-leniniste-staliniste, të dirigjuar nga Shqipëria, po ku nuk mungojnë edhe rryma të infiltuara nga agjentët e shumë shërbimeve të ndryshme informative nga vendet e Lindjes, ku nuk duhet përjashtuar edhe duart e disa shërbimeve të vendeve perëndimore që janë të interesuar që brenda tyre të luajnë lojërat e tyre në përputhje me interesat të caktuara, në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikojnë jo vetëm stabilitetin e Jugosllavisë së painkuadruar, por ato kërcënojnë të pengojnë edhe zhvillimet pozitive në Lindje, që kohëve të fundit, me shfaqjen e “Solidariteti” në Poloni, mund të jenë të dobishme për përhapjen e mëtutjeshme të atyre zhvillimeve me të cilat do të mundësohet thyerja e “Perdes së hekurit”.

Andaj, demonstrimi i disa qindra shqiptarëve në Los Anxhelos gjatë mbajtjes së duelit final të *Bashkim+Kosovës* me thirrjet “*Përpara Kosovë!*” dhe “*Bashkimi bën fuqinë*”, të cilët gjatë ceremonialit të shpalljes së fituesit dhe dorëzimit të medaljes së artë, sapo të fillojë të këndohet himni jugosllav gjatë ngritjes së flamurit shtetëror të Jugosllavisë, hapën

parullën “Kosova Republikë” mu para fronit të fitimtarëve, nuk paraqet tjetër pos përhapjen e asaj shkëndije, që një ditë gjithë botën do ta vejë në telashe të madhe.

Këtë madje e dinë edhe ata që sot mundohen që demonstrimin e Los Anxhelosit ta shohin si një eksces të vogël. Sepse, minimizimi i çështjes, ose edhe barazimi i saj me demonstrimet e grupeve të ndryshme (shfaqja e tibetasve te Dalaj Lamës, ajo e baskëve, e katalonasve, e kurdëve të Oçallanit me draprin dhe çekanin në flamurin e tyre, e kirgizëve me çevre jeshile, e mongolëve me stemën e Xhingis Kanit e të tjera), jo vetëm që nuk e anashkalon atë, por përkundrazi e sforcon edhe më shumë nga jashtë dhe nga brenda. Nga jashtë, pse si kërkesë e shqiptarëve “për t’u barazuar me të tjerët”, jashtë qëllimeve të njëmendta siç janë ato që barazia pastaj të shfrytëzohet për t’u shkëputur nga Jugosllavia për t’iu bashkuar Shqipërisë, duket fare e natyrshme. Ndërsa, nga brenda, demonstrimi në arenën ndërkombëtare për republikën e Kosovës, trimëron nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë, që të forcojnë radhët edhe më shumë, përkundër asaj se haptas nuk e kundërshtojnë procesin e diferencimit, ndërkohë që midis tyre i shtrëngojnë radhët, që lodhjen ta ndjejnë të tjerët, ndërsa ata, duke pritur zhvillimet e gjithëmbarshme, të rirreshtohen në përputhje me rrethanat.

Andaj, duke u bazuar në ato që ndodhen jashtë ringut olimpike dhe nëpër kuluaret e manifestimit më të madh botëror të sportit, mund të thuhet fitues kryesor nga Los Anxhelosi është parulla për republikën e Kosovës. Medalja që fitoi *Bashkim+Kosova* në këto lojëra olimpike, në të vërtetë është medalje për Republikën e Kosovës. Ajo duhet parë si e tillë dhe duhet marrë për të tillë, bashkë me rreziqet që sjell ajo, të cilat mund të kenë pasoja të kobshme për rajonin dhe më gjerë...

(“Politika”, Beograd, më 15 gusht 1984)

(Shkrime dhe komente të shtypit të Beogradit dhe të “Jedinstvos” së Prishtinës rreth manifestimeve gjithëpopullore në Prishtinë dhe pjesët tjera të Kosovës me rastin e kthimit të Bashkim Kosovës nga Olimpiada e Los Anxhelosit, të cilat do të vlerësohen si armiqësore dhe irredentiste pse në to do të këndohen këngët “Oj, Kosovë, nëna jonë” dhe “Besa-Besë, besën ta kam dhënë për Kosovë jetën kam me e dhanë”, pse emrit Bashkim do të interpretohet si thirrje për bashkim kombëtar)

Medalja e kobit!...

Do të ishte e natyrshme që suksesit sportiv të *Bashkim+Kosovës* në Lojërat Olimprike në Los Anxhelos, që është më i madhi i ndonjë boksieri jugosllav që ka arritur deri më tani, t’i gëzoheshin që të gjithë.

Do të ishte e natyrshme që ai për këtë të përgëzohej dhe të nderohej me medaljet më të larta të vendit tonë.

Dhe, po ashtu, do të ishte e natyrshme që në Kosovë ky sukses i madh të kremtohej bashkërisht nga pjesëtarët e të gjitha kombeve dhe të kombësive, që të kthehej në një shkas për një festë të madhe të vëllazërim-bashkimit.

Por, ndodhi që ky sukses i madh sportiv të kthehet në një mollë të hapur sherri. Sepse, medalja, në njërën ana (nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë) zuri të shfrytëzohet për një kremte të madhe me prapavijë armiqësore, ndërsa në anën tjetër (nga serbët, malaziasit dhe pakicat joshqiptare) të përjetohet si një kërcënim tjetër, që ata të dëshpëruar se shteti i tyre nuk është në gjendje t'i mbrojtë e as t'u sigurojë mbrojtje nga veprimet gjithnjë e më agresive të nacionalistëve shqiptarë, të vetorganizohen për vetëmbrojtje, duke u kërcënuar, se në rast nevoje, pra kur vatrat e tyre do t'u rrezikohen, do të jenë të gatshëm edhe për kundërvënje me të gjitha mjetet.

Kështu, ndodhi për herë të parë, që pas demonstrimit vandalist të nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë në Prishtinë dhe qytetet tjera të Kosovës, me rastin e pritjes së *Bashkim+Kosovës* nga Lojërat Olimpikë, serbët dhe malaziasit në Fushë Kosovës dhe Graçanicë të përgjigjen me kundër demonstrata, ku thirrjeve nacionaliste dhe shoviniste shqiptaro-mëdha të shprehura me "himnin" "*Besa-besë*" t'u kundërpërgjigjen me thirrjen e përgjithshme: "*Kosova është Serbi!*"

Në Fushë-Kosovë serbët bartnin flamuj shtetëror jugosllavë dhe ata serbë, si dhe thërrisnin për Jugosllavinë dhe Serbinë, ndërsa në Graçanicë, në oborrin e kishës u mbajt një meshë e madhe, në të cilën morën pjesë mijëra veta, ku peshkopi Jeremije drejtoi thirrjen:

"T'i mbrojmë shenjtërit mesjetarë serbë nga rrënuesit fundamentalistë islamistë".

Peshkopi ortodoks tha se stalinistët dhe xhihadistët islamistë, për nga e keqja që mund t'i vijë perëndimit, janë nga i njëjti brumë dhe se gjuha e tyre është e përbashkët...

Mesha e madhe përfundoi me recitimin e vargjeve të poetit serb Rakiq nga ana e aktorit të njohur të Teatrit Serb të Beogradit, Tadiq, ku bëhet fjalë për vandalizmin e shqiptarëve ndaj Simonidës (afresk i shenjtore së krishterë në muret e Graçanicës). Me këtë rast, vargu i njohur i kësaj poezie, "*Simonidë, sytë t'i nxorën arbanasit*", u lexua i ndryshuar:

"*Simonidë, sytë po t'i nxjerrin arnautët...*"

Pas përfundimit të meshës, një pjesë e masës së zemëruar, për disa orë bllokoi rrugën Gjilan-Prishtinë që kalon nëpër Graçanicë dhe u kërcënuar se po që se nuk do të merren masa ndaj nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë (me këtë rast u shpërnda një listë me emrat e tridhjetë e gjashtë profesorëve shqiptarë të Universitetit të Kosovës dhe të Institutit të Historisë së Kosovës, që u tha se me të shpejtë duhej të largoheshin nga institucionet arsimore dhe shkencore dhe ndaj tyre të merreshin masa ligjore me ndjekje penale), atëherë serbët do të vetorganizohen.

Çështja e vetorganizimit doli edhe në mitingun protestues të Fushë Kosovës dhe u paraqit edhe në disa tubime të ngjashme protestuese (në Shtërpcë, Ranilluk, Hoçë të Madhe, Gjurakoc dhe disa vende të tjera). Nga një "Këshill nismëtar për mbrojtjen e serbëve dhe të malaziasve nga Kosova dhe Metohia", u tha se paraprakisht serbët e Kosovës duhet t'i drejtojnë peticione organeve më të larta shtetërore të vendit. Nëse gjendja do të vazhdojë, atëherë pason vetorganizimi i popullit serb.

Ja, pra se çfarë do të thotë për Kosovën dhe në përgjithësi për realitetin jugosllav kur një nacionalizmi (me këtë rast atij shqiptar nga pozitat irredentiste dhe armiqësore) nuk i jepet përgjigje e merituar, qoftë edhe me përdorimin e ndërhyrjes politike, siç do të ishte në rastin konkret që Bashkim Kosovës t'i ndalohej të shkonte në Lojërat Olimpikë në Los Anxhelos, prej nga ai do të kthehet me medalje, e cila po tregohet se ishte e padobishme dhe e dëmshme madje.

Mbetet për t'u parë se çfarë do të jenë dëmet e mëtutjeshme nga ky "sukses" i madh ndërkombëtar i sportit tonë. Por, po ashtu, mbetet për t'u parë se çfarë mësimesh do të nxirren nga ky pësim, meqë ai po kthehet në emërues të përbashkët të kundërthënies dhe fërkimeve të ashpra shoqërore mbi bazat nacionale?

Nëse edhe më tutje do të vazhdohet që politika të mos ndërhyjë në sport, ndërsa sporti të kthehet në instrument të politikës së caktuar (asaj nacionaliste dhe irredentiste), atëherë mund të pritët që në Kosovë, por jo vetëm në të, të shfaqet populli për të vu rregull...

("Politika ekspres", Beograd, 1 shtator 1984)

Separatizëm dhe jo bashkim kombëtar...

(Një koment i gazetës "Jedinstvo" të Prishtinës rreth asaj se çfarë fshihet prapa skadimit "Bashkim" dhe çfarë prapa skadimit "Kosova" dhe pse duhet ndryshuar vlerësimet e deritanishme rreth ngjarjeve armiqësore të vitit 1981 nga pozitat e nacionalizmit shqiptar si dhe disa shkrime të tjera rreth krijimit të Republikës Shqiptare në Jugosllavi)

Në qëndrimet e para politike (shih *Konkluzionet e Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhje së Komunistëve të Jugosllavisë* të datës 5 maj 1981 dhe një muaj më vonë edhe nxjerrjen e *Platformës për Kosovën* nga i njëjti organ) demonstrata e nacionalistëve shqiptarë të 11 marsit dhe të 4 e 5 prillit të vitit 1981 në Prishtinë dhe pjesët tjera të Kosovës u vlerësuan ngjarje kundërrevolucionare nga pozita e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Pas më shumë se katër vitesh, doli se që të dy vlerësimet: *kundërrevolucion në Kosovë* dhe *irredentizëm shqiptar* ishin të gabuara dhe në të vërtetë stimuluese për nacionalizmin shqiptar, meqë as njëri e as tjetri nuk i përgjigjen të vërtetës, pos interesave shqiptaromëdha.

Pa hy në atë si erdhi deri te ky kurth, që me siguri se ishte i matur mirë dhe jo jashtë qarqeve më të larta politike të vendit të cilave iu desh i tillë në mënyrë që me të të hapeshin edhe çështje të tjera që do ta dobësonin unitetin e vendit, megjithatë u desh një shkrim i akademikut tonë të nderuar Vasa Çubrilloviq, i botuar së voni në NiN, për t'u parë se i gjithë procesi i diferencimit politik në Kosovë ishte zhvilluar mbi baza të gabueshme dhe teza kontraproduktive, të cilat u shkuan për shtati nacionalistëve shqiptarë për të vazhduar rrugën e tyre të njohur, por edhe forcave staliniste, brenda dhe jashtë, të cilat sikur harrohen pa qenë të vetëdijshëm se edhe ato kanë hesapet e veta në gjithë këtë ngatërrim, duke luajtur me shumë karta shpesh edhe më të pabesueshmet siç është ajo e trimërimit të bashkimit kombëtar shqiptar që rëndom shihet njëanshëm – kartë perëndimore.

Edhe pse qëndrimet e akademikut të nderuar Çubrilloviq rreth skenarëve dhe prapaskenave që ngërthen kriza e Kosovës si dhe vazhdimi i saj kanë një paletë të gjerë, që gjithësi duhet t'i shërbejnë një të menduari të gjithanshëm politik, akademiku ynë, edhe vlerësimin *irredentizëm shqiptar në Kosovë*, po ashtu e vlerëson tepër të gabuar, sepse në njërin anë pranon se Kosova është shkëputur me dhunë nga Shqipëria, gjë që sjell te konstatimi sikur ajo të ketë qenë pjesë e një shteti (Shqipërisë), i cili historikisht asnjëherë nuk ka ekzistuar, ani pse dihet se fjala është për Kosovën si djep mesjetar serb, dhe në tjetrën

anë legjitimon kërkesën e shqiptarëve për republikën e Kosovës, që në të vërtetë nuk do të thotë tjetër pos një parakusht për rrënimin e Serbisë dhe të Jugosllavisë pastaj në përputhje me skenarët që u përmendën në lartë , ku përfundimi ka gisht, por Moska e ka fjalën kryesore.

Andaj, duke u nisur nga këto vlerësime të gabueshme, të cilat deri më tani i kanë sjellë poenë pozitive nacionalistëve shqiptar dhe lëvizjes së tyre armiqësore ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë Akademiku ynë mbron qëndrimin se duhet futur termët: *separatizëm shqiptar në Kosovë* - në vend të atij *irredentizëm shqiptar në Kosovë*, ndërsa vlerësimin: *ngjarje kundërrevolucionare në Kosovës* duhet zëvendësuar me - *lëvizje shqiptaro-mëdha në Kosovë*.

Meqë shtypi i Beogradit tashmë në vend të *irredentizmit shqiptar* flet për *separatizmin shqiptar* dhe në vend të *kundërrevolucionit shqiptar* flet për *lëvizjet shqiptaro-mëdha* dhe këto terme po i përvetëson edhe gjuha e politikës ditore, nuk është për t'u habitur pse edhe nacionalizmi shqiptar, në përputhje me këtë ndryshim, ka filluar të reagojë, në mënyrë që të mos e humb intensitetin e nisur e as përkushtimin indoktrinues tek të rinjtë dhe shtresat e gjera.

Kështu, bie në sy se nëse deri më tani, tifozët e Bashkim Kosovës, të shumtën kanë skaduar fjalën “*Kosova*”, tash po i kthehen fjalës “*Bashkim*”.

Jehona “*Bashkim*” mbetet refren i vetëm jo vetëm gjatë ndeshjeve të boksit, por ai është bartur edhe në ato të ndeshjeve të futbollit kur luan “Prishtina” (sidomos me ekipet e Serbisë: “Crvena Zvezda” dhe “Partizanin” e Beogradit). Thirrja “*Bashkim*” dëgjohet edhe në ndeshjen e basketbollit të femrave kur “Universiteti” i Prishtinës luan me rivalet nga Liga e Parë e Basketbollit.

Thirrjet “*Bashkim*”, pra për bashkim kombëtar shqiptar, tashmë përcillen me këngën “*Besa-besë*”, por ku fjala “*për Kosovë jetën kam me dhanë*”, zëvendësohet me atë “*për Shqipëri jetën kemi me e dhanë...*”

Ky ndryshim flet qartë për strategjinë e re të nacionalistëve shqiptarë që sloganet e barazisë (*Kosova Republikë*), të zëvendësohen me ato për bashkim kombëtar me çka nënkuptohet krijimi i një Shqipërie të Madhe, në të cilën nuk do të hynin vetëm ato që sipas tyre duhet t'i shkëputën Jugosllavisë (Kosova, Lugina e Preshevës, Sanxhaku, gjysma e Maqedonisë si dhe Plava e Gucia dhe Ulqini e Tivari me rrethin e Podgoricës), por do të përfshiheshin edhe Çamëria në Greqi dhe disa pjesë të Thesalisë!

Në të vërtetë këtu po dalin në shesh idetë shqiptaro-mëdha për bashkimin e gjoja territoreve etnike shqiptare, ngjashëm me hartat që u paraqitën në një simpozium shkencor në Prishtinë, të organizuar në vitin 1968 me rastin e përkujtimit të 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, kur gatishmëria dhe mirëkuptimi i Jugosllavisë që Tiranës zyrtare t'i ofrohet mundësia që me anën e një bashkëpunimi kulturor me Prishtinë t'i krijohen mundësi për t'u çliruar sado pak nga mbyllja e egër, u keqpërdor për përhapjen e propagandës shqiptaro-madhe.

Këto harta u shfaqen edhe nëpër pamfletet ilegale që u shpërndanë në Kosovë me rastin e demonstratave armiqësore të marsit dhe të prillit të vitit 1981, ku e ashtuquajtura Shqipëri etnike shtrihej në katër vilajetet e perandorisë osmane (atë të Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Janinës).

Madje, në këto harta, në tokat “shqiptare” futen edhe Nishi, Leskovci dhe Krusheci bashkë me Prokupje dhe Kurshumli!

Për shqiptaro-mëdhenjtë kufiri midis shqiptarëve dhe serbëve shfaqet te Molla e Kuqe, tutje Kurshumlisë, deri në Krushec.

Historianët në Prishtinë dhe Tiranë ka kohë që e rrahin këtë tel. Vjetari “Kosova” i Institutit të Historisë së Kosovës është plot e përplot “studime” të kësaj natyre, të cilat indoktrinojnë prej vitesh të rinjtë shqiptarë, të cilët pastaj nuk ngurrojnë të thonë se nuk ndjehen jugosllavë (as për nga përkatësia shtetërore), por vetëm shqiptarë. Për ta tashmë nuk vlen as kategoria “kombësi” as “krahinë”, por vetëm komb dhe republikë, meqë e para është diskriminuose, ndërsa e dyta paraqet parakusht për barazi.

Por, ndryshimi i vlerësimeve rreth veprimtarisë armiqësore nga pozitat e nacionalizmit shqiptaro-madh, edhe pse i vonuar por i drejtë, megjithatë nuk do të mbetet pa pasoja për vendin tonë në planin e brendshëm dhe veçmas në atë të jashtëm. Sepse, fjala është për një diskurs në të cilin prej vitesh është investuar, ndërkohë që ndërtimit të të riut i duhet bukur shumë kohë që të zhvlerësojë stereotipat mbi të cilat mbështetet propaganda e përbashkët antijugosllave e Prishtinës dhe e Tiranës.

(“Jedinstvo”, Prishtinë, 12 janar 1985)

Çubrilloviqi dhe skenarët sovjetikë?

(Një analizë e të përjavshmes së Zagrebit “VUS” rreth intervistës së akademikut serb Vasa Çubrilloviq, atentator i Sarajevës nga vitit 1914 ndaj princit Franc Ferdinand që u bë shkas për fillimin e lutës së parë botërore. Vasa Çubrilloviq, anëtar i organizatës terroriste serbe “Crna Ruka” njëherësh ishte edhe autor i Memorandumit të parë antishqiptar të vitit 1937 dhe atij të vitit 1944. Në këtë intervistë, akademiku Serb nuk flet më për zgjidhjen e çështjes shqiptare me anën e shpërnguljeve dhe të gjenocideve të hapura, por ndalet te skenarët e Moskës që çështjen e Kosovës gjoja me bashkim kombëtar ta shfrytëzojnë për futjen e Jugosllavisë dhe të Shqipërisë në një konflikt të armatosur, ku pastaj, do të ndërhyjnë për t’i kthyer të dy shtetet në Traktatin e Varshavës dhe në sferën ideologjike sovjetike)

Akademiku i njohur serb Vasa Çubrilloviq ishte shumë i qartë kur tha se vlerësimi kundërrevolucion në Kosovë u ndihmoi intelektualëve shqiptarë që të krijojnë një platformë të përshtatshme veprimi me të cilën ata fituan simpati dhe madje mbështetje në Perëndim, gjë që nuk është për t’u habitur pse një pjesë e mirë e medieve europiane dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkesat e tyre për Republikën e Kosovës t’i drejtojnë për ringjalljen e një lëvizjeje antikomuniste, të ngjashme me atë që fsheh “Solidarnosci” i Polonisë, ose edhe “Pranvera e Pragës”.

“Duke i quajtur kundërrevolucionarë shqiptarët, bëmë që një lëvizjeje të përhershme armiqësore ndaj Jugosllavisë si shtet, t’i jepen atributet antikomuniste, gjë që nuk përkon as me të vërtetën e as me realitetin, sepse në atë lëvizje fuqia kryesore vepruese si një amalgam është pikërisht ideologjia komuniste ndër më të egrat që sot shfaqet si enverizëm-stalinist, me të cilën kërkohet inkarnimi i formave të saj më fanatike, të ngjashme me ato që po ndodhin në Kinë dhe në Kampuçia me kmerët e kuq.”

Akademiku Çubrilloviq mendon se stalinistë shqiptarë, pas vdekjes së Enver Hoxhës, jo vetëm që gjenden në një izolimit të plotë, por janë të mbërthyer nga një frikë e madhe nga shkaku i përbashkët së mundshme me ndonjë mllef gjithëpopullorë, që e nxitur

nga jashtë, mund të kthehet në ndonjë kryengritje, me të cilën ata përfundimisht do të rrëzoheshin nga pushteti diktatorial. Andaj, ata nuk e kanë hallin e barazisë së shqiptarëve dhe as te republika e Kosovës, por kanë hallin e vet, meqë çfarëdo afirmimi i mëtutjeshëm i shqiptarëve në Jugosllavi, edhe më tutje vetëqeverisjen jugosllave dhe socializmin liberal me fytyrë njerëzore, e kthen në një model të Shqipërisë postenveriste. Të njëjtin preokupim dhe frikë, veçmas tash kur lindja pas shpallje së lëvizjes sindikaliste polake, e ka edhe Moska, e cila e di se reformat çfarëdo qofshin hapin procesin e rrënimit të diktaturës komuniste dhe konceptet e saj shoqërore mbi të cilat është ngritur. Pra, këtu dhe te kjo çështje duhet parë skenarin e destabilizimit të Jugosllavisë nëpërmes Kosovës, që do t'i përshtatej Moskës dhe pse jo edhe stalinistëve shqiptarë, të cilët, pas vdekjes së Enverit, më me dëshirë do ta pranonin rikthimin e Traktatit të Varshavës se sa shtrirjen e ndikimit të vetëqeverisjes jugosllave në Shqipëri. Moska, që e di këtë gjë do të bëjë çmos që të kthehet aty ku ka qenë. Destabilizimi i Jugosllavisë nga brenda, pra me Kosovën, si dhe implikimi i Shqipërisë në të, paraqet një mundësi historike për t'i arritur këto qëllime...

Akademiku serb thotë se Moska, tashmë mbështetet në dy faktorë, me anën e cilëve mund të krijojë “pretekste” për ndërhyrje ushtarake në Jugosllavi dhe Shqipëri.

Faktori i parë është ai i destabilizimit të Jugosllavisë nga brenda nëpërmes krizës së Kosovës dhe përdorimit të saj të mëtutjeshëm që ajo të kthehet në një vatër konflikti të hapur, që do të përfshinte në të edhe faktorët tjerë jugosllavë.

Ndërsa faktori i dytë është ai i një konflikti të armatosur midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë për shkak të Kosovës.

Faktori i parë, pra ai krizës së Kosovës dhe shfrytëzimit të saj për destabilizimin e Jugosllavisë nga brenda, nuk do të mbështetej më në kërkesën për Republikën e Kosovës, siç u shfaq në vitin 1968 dhe u rishfaq në demonstratat e vitit 1981, për të cilin Çubrilloviq thotë se ishte një kundërpërgjigje e Titos kartës sovjetike të bashkimit ideologjik, por do të jetë ai i kartës së bashkimit kombëtar shqiptar, me mjete revolucionare, që si kërkesë ideologjike ka qenë thuarje përherë e pranishme te enveristët e Kosovës.

Edhe këtu Moska, me anën e agjentëve të vetë, kryesisht informbyroistë dhe të tjerëve, mund të trimërojë organizatat ilegale të spektrit të majtë, që veprimtarinë e tyre ideologjike, ta dizajnojnë në kuadër të një platforme të bashkimit kombëtar me mjete revolucionare, që për moto do të kishte bashkimin me Shqipërinë enveriste, me ç'rast enverizmi edhe pa Enverin, do të mund shfrytëzohej si emblemë patriotike nacionaliste, e cila mbështetet në të menduarit e përhapur te një pjesë e mirë e shqiptarëve se më mirë bashkë qoftë edhe nën një Shqipëri enveriste dhe staliniste, se sa të ndarë në një Jugosllavi titiste. Madje, mund të thuhet se doktrinën e bashkimit kombëtar me mjete revolucionare sovjetikët ia kanë dalë ta kultivojnë te një pjesë e mirë e emigracionit shqiptar në vendet europiane, por edhe në SHBA, ku ata kanë depërtuar, kështu që nuk është e rastit pse disa grupe militante marksiste-leniniste në perëndim, vazhdimisht kërkesën për republikën e Kosovës, jo vetëm që nuk e kanë përkrahur, por e kanë quajtur karrem titist kundër Kosovës dhe Shqipërisë, me të cilën neutralizohet bashkimi kombëtar.

Faktori i dytë, pra ai i konfliktit të armatosur midis dy shteteve, ka të bëjë me provokimin e ndonjë kryengritje të armatosur të irredentistëve në Kosovë, së cilës Jugosllavia, në mbrojtje të rendit kushtetues dhe të integritetit territorial shtetëror të garantuar ndërkombëtarisht do t'i jepte përgjigje të armatosur, në të cilën doemos se do të

përfshihej edhe Shqipëria ngaqë këtë do t'ia impononin rrethanat e bartjes së kryengritjes në territorin e saj, siç u veprua edhe në vjeshtën-dimrin e vitit 1913 kur Beogradi shfrytëzoi kryengritjen e Dibrës dhe të Kosovës për t'u futur në Shqipërinë e mesme për ta ngritur të ashtuquajturën “zonë sigurie”.

Edhe pse duket paksa jashtë logjikës së gjërave që Moska dhe shërbimi i saj KGB të luajë me kartën e irredentizmit shqiptar, akademiku Çubrilloviq mendon se kjo është shumë e mundshme, meqë kështu politika sovjetike me një të rënë arrin dy qëllime njëherësh: së pari ta destabilizojë Jugosllavinë për ta larguar përfundimisht nga kursi i Titos dhe politika e tij e cila nga shkëputja nga Stalini e tutje (1949) i ka shkuar për shtati perëndimit e me këtë të krijojë rrethana ta kthejë në bllokun socialist, dhe së dyti, duke përdorur kartën gjoja të bashkimit kombëtar të shqiptarët, ku grupe të armatosura, të dirigjuara prej shërbimeve të fshehta sovjetike do t'i ktheheshin “luftës së mbikëqyrur çlirimtare”, hapin një konflikti të armatosur shqiptaro-jugosllav, që nuk do të mund të përfundonte ndryshe pos me ndonjë ndërhyrje ushtarake të Beogradit në veri të Shqipërisë, që si kundërpërgjigjen për pretekst do të kishte “shkatërrimin e çerdheve të kryengritësve irredentistë”, ndërhyje kjo që do të mund të merrte përmasa të rrezikshme rajonale, por që është afër mendsh që Bashkimi Sovjetik, me kutin internacionalist, serish të paraqitej si arbitër, që Jugosllavinë dhe tërësinë e saj territoriale ta mbrojë nga “irredentizmi shqiptar”, ndërsa shqiptarët mundësisht t'i kënaq me një kompromis: me atë të krijimit të një republike socialiste shqiptare në Jugosllavi, e cila, në përputhje me interesat e Moskës, do të mund të paraqiste pikënisjen e një projekti të federatës ballkanike socialiste në të cilën, krahas Jugosllavisë dhe Shqipërisë të gjendet edhe Republika e Shqiptare e Jugosllavisë, Bullgaria dhe Rumunia.

Akademiku Çubrilloviq bën të ditur se ofensiva e Bashkimit Sovjetik për ta destabilizuar Jugosllavinë pas vdekjes së Titos është e lidhur ngushtë me kartën shqiptare, ku Kosova dhe çështja e saj mund të futet më së miri në lojë me anën e bashkimit shqiptar si formulë joshëse për shqiptarët enveristë, me të cilën pastaj destabilizohet Jugosllavia po edhe rajoni, meqë aktivizimi i saj dhe përgjigjja çfarëdo qoftë hap domino efekt në rajon dhe më gjerë, për të cilën Perëndimi, duke ditur se çfarë synon Moska në rrethanat kur edhe asaj me lëvizjet sindikale në Poloni dhe vlimet tjera brenda për brenda Bashkimit Sovjetik, nuk është i interesuar.

Me këtë rast, akademiku serb thekson se Moska ka kohë që ka nisur të luajë lojëra të dyfishta ndaj Jugosllavisë dhe Shqipërisë: njërën anë në raport me Kosovën dhe Shqipërinë duke e futur në lojë kartën e irredentizmit me të cilën kërkohet bashkim kombëtar, dhe në tjetrën anë, në raport me Serbinë duke e përmendur kartën unitariste, me anën e të cilës të ndikohet që forcat konservative nga radhët e serbëve, të marrin pushtetin, që si kundërpërgjigje ndaj kursit vetëqeverisës dhe federalizmi i vendit, në emër të mbrojtjes së socializmit, të reflektonte kah Bashkimi Sovjetik. Akademiku Çubrilloviq përkujton rastin Dapçeviq (Vlado, vëllai i heroit Peko Dapçeviq bashkëpunëtor i ngushtë i Titos nga ditët e para), informbyroist i ikur në Shqipëri në vitin 1958 dhe prej andej në Moskë, i cili pas qëndrimit njëzet e sa vjeçar në Moskë, bashkë me shumë e shumë informbyroistë të tjerë, do të lejohet gjoja të emigrojë në Perëndim (Belgjikë), por që atje, me detyrë të Moskës filloi organizimin e një të majte “të moderuar” të cilët, pasi që të krijojnë organizata ilegale majtiste, kryesisht të mbikëqyrura nga Bashkimi Sovjetik, do të futen ilegalisht në Jugosllavi

për të krijuar “komitete vendore marksiste-leniniste” për ta marrë pushtetin pas vdekjes së Titos.

Gjithnjë sipas akademikut Çubrilloviq, Perëndimi që ka ditë hilen e Moskës me Vlado Dapçeviqin dhe lojën e tij gjoja me ikjen në perëndim për t'i shpëtuar stalinizmit sovjetik, siç deklaronte ai, me të shpejtë do të kuptojë lojërat e “disidentit” Dapçeviq dhe të organizimit të grupeve të shumta marksiste-leniniste në Gjermani, Belgjikë, Francë në të cilat do të përfshihen emigrantë, por edhe shumë të përndjekur të tjerë politik nga Kroacia, Kosova, Mali i Zi, të cilët do të fillojnë që aktivitetet e tyre t'i bartin në Jugosllavi me krijimin e “komiteteve vendore partiake” dhe madje edhe të “Komiteteve Qendrore”, të mbikëqyrura nga Moska. Grupi i tyre kryesor, ai i Tivarit, i burgosur në vitin 1974, udhëhiqej nga një profesor malazias dekan i njërit nga fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Me burgosjen dhe dënimin e Grupit të Tivarit, Tito do t'ia bëjë me dije Moskës se e ka kuptuar lojën e tyre të dyfishtë, ndërkohë që edhe Moska, duke u “distancuar” nga informbyroistët e shumë të jugosllavë (rreth dy mijë sosh, të cilët ishin lejuar që të kalonin në Perëndim) që për vite të tëra kishin gjetur strehim në Bashkimin Sovjetik, pra pas këtij dekonspirimi që u mundësua edhe nga shërbimet perëndimore me të cilat Tito përherë kishte lidhje të ngushta, do ta sakrifikojë kreun e informbyroistëve jugosllavë në Perëndim, Dapçeviqin, të cilin, mbi këto informacione, shërbimi i fshehtë jugosllavë “e kidnapoi” nga Rumunia dhe i bëri një proces të mbyllur në Beograd, por me këtë nuk u mbyll loja e dyfishtë sovjetike: në njërin anë me trimërimin e grupeve marksiste-leniniste shqiptare që të kërkojnë bashkim kombëtar, dhe në tjetrën anë, të veprimt gjithnjë e më të organizuar për krijimin e një strukture politike unitariste (nga radhët e intelektualëve dhe ushtarakëve prosovjetikë serb), që do ta merrte pushtetin në rrethanat e caktuara.

Duke paraqitur edhe fakte të tjera, me të cilat mbështetet teza se Moska tashmë po luan me këto karta në Jugosllavi dhe Shqipëri që ta përgatit rikthimin e saj në këto dy vende, qoftë edhe me anën e një konflikti “joshës” për nacionalistët shqiptarë dhe të tjerët që së voni janë ringjallur, tërheq vërejtjen Beogradit, pra udhëheqjes serbe dhe veçmas akademikëve serbë të prirë që me çdo kusht të ndryshojnë kursin e Titos, se në këtë mënyrë kanë karremin e Moskës me të cilin popullit serb jo vetëm që nuk do t'i kthehen “të drejtat e marra nga Tito dhe kursi i tij”, por atë do ta kthejnë në kampin socialist, pra në një kollhoz tjetër sovjetik në Ballkan, të cilin sigurisht se perëndimoret nuk do ta lejojnë, gjë që për pasojë do të ketë edhe shkatërrimin e Jugosllavisë, që akademiku serb thotë se nuk duhet lejuar nga që njëherë e përgjithmonë merr fund edhe ideja madhore e bashkimit të sllavëve të jugut në një shtet, që është e vetmja që atyre u mundëson civilizim perëndimor.

Në fund fare, akademiku serb Çubrilloviq, thotë se Tito për t'u mbrojtur nga skenari i rrezikshëm sovjetik për bashkimin kombëtar shqiptar si një karrem që do të mund t'i përshtatej për t'u kthyer prej nga ishte përzënë, përdori kartën e Republikës së Kosovës, si njësi e barabartë e federatës jugosllave, e papranueshme për serbët dhe e rrezikshme madje, por shpëtimtare, nëse kihet parasysh se cila mund të jetë alternativa që vjen nga rusët?!

Është interesant të thuhet me këtë rast se akademiku serb vlerëson se Enver Hoxha, ndonëse stalinist i përbetuar, që do të vdesë me atë bindje, nuk ishte përkras i idesë sovjetike të bashkimit kombëtar me mjete ideologjike. Edhe pse qarkullojnë disa pamflete me anën e të cilave ai kundërshtoi kërkesën për Republikën e Kosovës e të ngjashme, që u shpërndanë me të madhe nga grupet marksiste-leniniste në perëndim (që me të drejtë mund të

dyshohet se ato vinë nga Moska ose agjencitë e saj në Jugosllavi ose Shqipëri), megjithatë, pas vdekjes së Titos, përkrahi kërkesën e Republikës së Kosovës dhe madje atë e futi edhe në rezolutën e Kongresit të Partisë së Punës në vitin 1981, me ç'rast ajo u kthye edhe në një platformë të gjerë të një organizate majtiste në perëndim. Andaj, nuk është e rastit pse sovjetikët, pas vdekjes së Enverit, që mund të thuhet se me anatemën “revizionistë” i përzuri nga Shqipëria, do të fillojnë një ofensivë të madhe që me parullën kamuflluese të bashkimit kombëtar t'i bëjnë për vete stalinistët e njëmendtë në politikën e Shqipërisë bashkë me enveristët e Kosovës, me anën e të cilëve do t'ia hapnin rrugën rikthimit të tyre Shqipëri.

(VUS, Zagreb, dhjetor 1985)

Dallimi midis enveristëve dhe stalinistëve?...

(Një shkrim tjetër jo i rëndomtë për rrethanat dhe klimën e krijuar politike me klishetë e saj të njohura të anatemimit të kërkesave të shqiptarëve për barazi si armiqësore, kundërrevolucionare dhe shqiptaromëdha, ku elaborohet dallimi midis “enveristëve” dhe “stalinistëve” shqiptarë si dhe koncepteve mbi të cilat funksionojnë ato)

Duket paksa e pabesueshme dhe për shumëkënd madje edhe i paqartë dallimi midis “enveristëve” dhe “stalinistëve” shqiptarë, ngaqë ata merren për të njëjtë, mbase me të vetmin “ndryshim” se “enverist” shqiptar do të thotë më keq se keq, ndërsa “stalinist” më zi se zi e të ngjashme...

Por, ka dallim midis një enveristi dhe stalinisti, ngaqë një enverist, që është stalinist për nga ideologjia, nuk është hegjemonist as për nga bindja as për nga sjellja politike. Si i tillë, enveristi i beson internacionalizmit proletar si ide dhe është në gjendje që asaj doktrine t'ia nënshtrojë të gjitha madje, siç betohet, për të të hajë edhe barë...

Këtë më së miri e pasqyron edhe qëndrimi ndaj Kosovës kur mbi këtë parim është anuluar edhe rezoluta e Bujanit rreth bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, e nxjerrë nga antifashistët kosovarë më 31 dhjetor 1943 dhe 1 dhe 2 janar 1944, duke iu lënë vendi konceptit internacionalist se brenda familjes komuniste me marrëveshje ideologjike mund të zgjidhen të gjitha çështjet kontestuese qofshin ato edhe të një natyre të rëndë. Me këtë koncept, në vitin 1945, është pranuar edhe formula e autonomisë “oblastit” për Kosovën nën Serbi.

Pas rezolutës së Informbyrosë të vitit 1948 kur Jugosllavia e Titos, pasi që do t'i thotë jo Stalinit dhe stalinizmit, do të anatemohet nga familja internacionaliste dhe Moska do ta përjashtojë atë, Enveri do të marrë anën e sovjetikëve të Moskës, por në raport me Titon dhe Kosovën nuk do të ndryshojë qëndrimin. Do të kritikojë ashpër Jugosllavinë dhe politikën e saj ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të mbetur në kufijtë e Jugosllavisë, por vetëm mbi konceptet ideologjike, duke kërkuar që ata të “lirohen” nga titizmi dhe doktrina e vetëqeverisjes jugosllave që paraqet revizionizëm, por jo edhe çlirim nacional.

Edhe pas prishjes me sovjetikët, Enveri asnjëherë nuk kërkoi shkatërrimin e Jugosllavisë, ose destabilizimin e saj mbi baza nacionale, por vetëm ndërrimin e kursit nga vetëqeverisja në komunizëm të mirëfilltë, pra në stalinizëm, të cilin e kishte braktisur edhe Moska pas ardhjes së Hrushqovit...

Në vitin 1981, ai përkrahu kërkesën për Republikën e Kosovës me çka përfundimisht e hoqi nga rendi i ditës kërkesën irredentiste për bashkim kombëtar, e cila pati koniunkturë në programet e shumë grupeve ilegale në Kosovë.

Në të vërtetë këtu dhe te kjo çështje duhet parë dallimin midis enveristit, i cili i mbetet besnik fanatik dogmës ideologjike të internacionalizmit proletar, dhe stalinistit, i cili i mbetet besnik hegjemonizmit ideologjik, mbi të cilin ndërtohet “e drejta” për ndërhyrje ushtarake, siç ndodhi ajo sovjetike në Hungari dhe Çekosllovakia, dhe mbi të cilin po ashtu shfaqet edhe doktrina brezhnjeviane mbi sovranitetin e kufizuar.

Duke kundërshtuar këto parime, Enveri dhe Tito, kanë të përbashkët antihegjemonizmin ideologjik sovjetik, të cilin Tito nuk e pranoi dhe për këtë me anatemën “e revizionistit” u përjashtua në vitin 1949 nga “familja komuniste”, ndërsa Enveri e refuzoi në vitin 1968 kur doli nga Traktati i Varshavës pasi që Bashkimi Sovjetik dhe satelitet e saj i futen tanket në Çekosllovakia.

Këto merita i zuri ngojë edhe ish kancelari gjerman Helmut Shmit me rastin e vdekjes së Enver Hoxhës kur tha se E. Hoxha, si edhe Tito, me largimin nga diktati ideologjik i Moskës i bënë shërbim të madh Perëndimit. Kështu, Jugosllavia dhe Shqipëria u kthyen në digë mbrojtëse kundër depërtimit hegjemonist sovjetik në Europë.

Kjo është më se e vërtetë. Këto merita nuk mund t’u mohohen as Titos e as Enverit. Veçmas Enverit, i cili jo vetëm që pati guxim të dalë nga Traktati i Varshavës, por gjatë krizës së Çekosllovakisë, kur armata sovjetike ndodhej në kufijtë e Jugosllavisë dhe kërcënonte me ndërhyrje, deklaroi se do të vihet në anën e Jugosllavisë po qe se ajo sulmohet nga sovjetikët.

Këtë nuk duhet harruara Jugosllavia, as Europa, e as Perëndimi.

Sepse, një deklaratë të ngjashme Enveri e përsëriti edhe në vitin 1974, e edhe më vonë, duke bërë me dije se Jugosllavisë nuk i vjen rreziku nga Shqipëria, por nga lindja. Këto i tha duke bërë me dorë nga Moska dhe Bullgaria.

Por, veprimet e Enverit kundër hegjemonisë sovjetike, nuk e liruan atë nga kthetrat e stalinistëve shqiptarë e as nga frika e rikthimit të këtij hegjemonizmi.

Edhe këtu, çështja e Kosovës u kthye në një arenë të hapur midis enveristëve dhe stalinistëve, meqë stalinistët iu nënshtruan kurthit sovjetik që zgjidhja e saj të kërkohet gjoja me bashkim kombëtar, që Enveri e kupto drejtë, por u përpoq që atë ta mbajë nën plaf sa më shumë që të jetë e mundur.

Por, pas vdekjes së Titos në vitin 1980 dhe hapjes së pokerit jugosllav, Enveri haptas u vu kundër karremit sovjetik për destabilizimin e Jugosllavisë nëpërmes Kosovës. Kjo u pa edhe me rastin e demonstratave të Kosovës të vitit 1981, kur ai, në vend se t’i nënshtronte ndonjë aventure, siç ia sugjeronin stalinistët nga radhët e udhëheqjes politike shqiptare, që flisnin me direktivat e Moskës, mbështeti vetëm kërkesën e kosovarëve për Republikën e Kosovës për barazi me të tjerët në federatë, me çka ua mbylli gojën të gjitha spekulimeve dhe skenarëve të dyshimta që vinin nga Moska me anën e të cilave do të mund të krijoheshin pretekstet për ndërhyrjen e sovjetikëve në Jugosllavi dhe pastaj edhe në Shqipëri.

Mund të thuhet se te çështja e Kosovës dhe qëndrimi i saj në vitin 1981, enverizmi fitoi një betejë të brendshme dhe të jashtme tepër të rëndësishme, në njërën anë duke qeruar hesapet me njërin ndër bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, Mehmet Shehun dhe grupin e tij prosovjetik, të cilët thuhet se sipas udhëzimeve të Moskës, deshën që Shqipërinë ta futin në

një konflikt të armatosur me Jugosllavinë, dhe në tjetrën anë duke shkëputur lidhjet me grupet marksiste-leniniste në disa vende të perëndimit, që dirigjoheshin nga Moska dhe shërbimet e saj informative nga koha e Vlada Dapçeviqit e tutje.

Edhe kjo shkëputje nuk ishte pa pasoja, ngaqë , gjithnjë të dirigjuar nga shërbimet e shumta informative dhe në përputhje me hesapet e tyre në krizën jugosllave, në Perëndim filloi një qërim i ashpër hesapesh midis “enveristëve” dhe “stalinistëve” me pasoja tragjike, që u bart edhe në Kosovë në formën e një rivalizimi ideologjik, të cilit nuk i shihet fundi dhe as përmasat, por që duhet pasur kujdes që Moska të mos e shfrytëzojë për qëllimet e veta, të cilat dihet se çfarë janë...

(“Delo”, Lubjana, dhjetor 1985)

Teza për republikën shqiptare në Jugosllavi

Thirrjet “*Bashkim!Bashkim*”, që po i hedhin nacionalistët dhe separatistët shqiptarë nëpër stadiume sportive me të drejtë janë vlerësuar armiqësore, ngaqë ato bëjnë thirrje për bashkimin e shqiptarëve në një shtet etnik, që nënkupton shkatërrimin e Jugosllavisë. Por, si të tilla, ato duhet parë edhe nga një këndvështrim tjetër, meqë e ashtuquajtura Shqipëri e Madhe bëhet e mundshme vetëm me projektin e bashkimit të shqiptarëve në një republikë shqiptare në Jugosllavi, që do të quhet republika shqiptare në Jugosllavi. Sipas këtij projekti, shqiptarët që gjenden në Serbi, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, duhet të bashkohen në një njësi administrative dhe politike, meqë sipas nacionalistëve shqiptarë ata janë ndarë me dhunë gjatë Luftës së Parë Ballkanike, kur ushtritë serbe, malaziasë, bullgare dhe greke kanë pushtuar territoret etnike shqiptare, të cilat pastaj, Konferenca e Ambasadorëve në Londër në gusht të vitit 1913, pasi që do ta pranojë shtetin shqiptar të përgjysmuar, do t’ua japë Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Kjo tezë, me mjaft perfiditet u hodh këto ditë nga gazeta me frymë nacionaliste “*Rilindja*” e Prishtinës, e cila duke shfrytëzuar 80 vjetorin e Kongresit Themelues të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, të mbajtur në Dresden të Gjermanisë, krahas vlerësimit të asokohshëm të Kominternit si dhe në përgjithësi të të matjes se Jugosllavia e Versajës paraqet një krijesë artificiale që duhet të shkatërrohet në dobi të krijimit të shteteve nacionale në Ballkan, doli me qëndrimin e krijimit të një Republike të shqiptarëve të quajtur Katundare dhe Punëtore. Duke përpunuar tezën se Republika Shqiptare Katundare në Jugosllavi do të përthekonte që të gjitha viset shqiptare të pushtuara nga luftërat koloniale të Serbisë dhe të Malit të Zi, “*Rilindja*”, gjithnjë duke manipuluar me një ngjarje historike, qëndrimet e të cilës janë tejkualuar nga vetë sjellja e komunistëve jugosllavë gjatë luftës antifashiste e tutje, sjellë edhe projektin e të ashtuquajturës Republikë Shqiptare në Jugosllavi, të përpunuar nga Moshë Pijade në Konferencën e Parë Vendore të Partisë Komuniste të Jugosllavisë të mbajtur në Zagreb, në vitin 1940, projekt ky që në njëfarë mënyre do të bisedohet edhe midis Enverit dhe Titos në vitin 1946 gjatë vizitës së tij për të mbetur i hapur deri në vitin 1948 si opsion që do të duhej të rumbullakohej me bashkimin e Shqipërisë në Federatën Ballkanike, e cila planifikohej të lidhej midis Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, por që do të stopohet nga Stalini nga frika se kjo federatë mund t’ia rrezikonte Bashkimit Sovjetik pozitën strategjike në Ballkan të përcaktuar sipas marrëveshjes së Jaltës të vitit 1944 me Ruzvelltin dhe Çerçillin.

“*Rilindja*”, gjithnjë duke u mbështetur në librin më të ri të biografit të mirënjohur të Titos Vladimir Dedijer, shkruan se treshja jugosllave Tito-Kardel-Bakariq edhe në vitin 1953 zuri ngojë këtë çështje, por ajo u mbyll me ndërhyrjen e serbit Aleksandër Ranković, kur ai bëri me dije se populli serb nuk do të pranonte kurrë një “konstrukt të tillë”, meqë kjo do të paraqiste një bombë të kurdisur për shkatërrimin e Serbisë, por edhe të Jugosllavisë.

Nuk do mend se shqyrtimi i kësaj çështje, edhe pse nga një këndvështrim historik dhe gjoja për t’u pasqyruar qëndrimi parimor i komunistëve jugosllav për zgjidhjen e drejtë të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi në përputhje me qëndrimet e Kominternit, megjithatë, e gjithë kjo duhet kuptuar si hedhje e vajit në zjarr që po ia bëjnë nacionalistët shqiptarë hapjes së çështjes së Kosovës Republikës, që po qe se plotësohet si një kërkesë minimaliste, së shpejti duhet të zgjerohet me platformën për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, në të cilën do të përfshiheshin shqiptarët nga Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Natyrisht, që duke sjellë Jugosllavinë para zgjedhjes midis minimalizmit (Republikës së Kosovës) dhe maksimalizmit (Republikës Shqiptare në Jugosllavi), nacionalistët shqiptarë tashmë e kanë shpallur strategjinë për rrënimin e Jugosllavisë, duke ia bërë me dije asaj se i mbetet që të vendosë se nëpër cilat rrugë duhet të kalojë: me dëshirë, apo me dhunë.

Se nacionalistët shqiptarë tashmë janë bërë gati që kërkesën për Republikën e Kosovës ta zgjerojnë me atë për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, kjo u pa më së miri nga “përkujtimi” i Kongresit të Dresdenit dhe jehonës që iu dha kësaj ngjarje në gazetën “*Rilindja*”, por edhe në numrin më të ri të vjetarit “*Kosova-Kosovo*” të Institutit të Historisë së Kosovës në Prishtinë, i cili, ndonëse pa drejtuesin e saj nacionalist akademik Ali Hadri (në vitin 1981 i larguar nga ky Institut me kërkesën e disa “historianëve” shqiptarë, të cilët kanë fituar tituj “shkencor” sipas direktivave partiake për t’u kthyer në “kronikanë” të Partisë në pushtet), duke përkujtuar këtë ngjarje, tregoi se edhe më tutje midis historianëve të Kosovës ka aso që nuk e kanë vendin në shkencë e as në Universitetin e Prishtinës. Të tillët, pra, shfrytëzojnë çdo mundësi që t’i ushqejnë me nacionalizëm armiqtë e Jugosllavisë, të cilët pastaj me idetë e tilla demonstrojnë.

Kështu, frymë “e re” e nacionalistëve shqiptarë, e armatosur me kërkesën për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, u pa fare mirë gjatë ndeshjes së fundit të duelit të boksit midis “Prishtinës” dhe “Radniçkit” të Nishit, kur dalja në ring e *Bashkim+Kosovës* u prit me brohoritjet:

“*Të gjithë bashkë*” dhe “*Bashkimi bën fuqinë*”.

Të njëjtat parulla pastaj u dëgjuan edhe në Qendrën e Studentëve, pikërisht aty ku më 11 mars të vitit 1981 shpërthyen demonstratat me kërkesën për Republikën e Kosovës.

Katër vjet më pas kërkohet Republika Shqiptare në Jugosllavi...

Mbetet për t’u parë se çfarë do të kërkohet pas katër vitesh nga ky vend?...

(“*Politika*”, Beograd, 23 mars 1985)

“*Nuk jemi jugosllavë! Jemi shqiptarë!*”

Në demonstrata armiqësore të marsit dhe prillit të vitit 1981, njëra ndër parullat që u shfaq ishte edhe ajo:

“*Nuk jemi jugosllavë. Jemi shqiptarë*”.

Këtu nuk është fjala për t'u mbrojtur përkatësia e shqiptarëve si kombësi e barabartë me të tjerët në Jugosllavi, e as për t'u kundërshtuar ajo që shumëkush në këtë vend, shkakui i rrethanave, e sheh si identitet të ri me të cilin pasqyrohen realitetet e reja, kur një pjesë e gjeneratës së re, pjellë e martesave të përziera, nuk dëshiron të mbetet në kurthin e konventave të caktuara nacionale, por që prej tyre kërkon të lirohet me anën e një fryme të re identifikuese të quajtur jugosllavizëm.

Pra, të deklaroj se nuk je jugosllav, por shqiptar, për nacionalistët shqiptarë do të thotë apriori kundërshtim i përkatësisë shtetërore dhe i përbashkësisë së domosdoshme mbi të cilën ndërtohet bashkimi i brendshëm i një shoqërie socialiste shumetnike. Shqiptarët, pra, nuk dëshirojnë që të pranojnë një shtet, i cili tashmë që nga shembja e Perandorisë Osmane dhe asaj Austro-hungareze, është një realitet i krijuar nga synimet historike të popujve që kanë kundërshtuar pushtimet e huaja shumëshekullore në këtë pjesë dhe për të derdhën gjak.

Por, duket se shqiptarët edhe pas shtatë deceniesh, nuk pajtohen me këto realitete shtetërore, veçmas me Jugosllavinë, të krijuar mbi vullnetin e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, duke e parë shtrirjen e saj në kurriz të etnisë shqiptare, edhe pse kjo nuk është e vërtetë, por vetëm pjellë e fantazisë shqiptaro-madhe, e cila asnjëherë nuk ka dashtë ta pranojë faktin se shteti mesjetar serb, i cili në kohën e Dushanit ia doli që të kthehet në një mbretëri ndër më të fuqishmet e kohës, në Kosovë dhe në Maqedoni kanë pasur djepin dhe shpirtin e vet. Mjafton që sot të shfletohet sado pak historia Prizrenit apo e Shkupit për t'u parë se ato ishin qendra të fuqishme mesjetare serbe. Por, nacionalistët shqiptarë, duke anashkaluar këto dëshmi dhe shumë e shumë të tjera të kësaj natyre, me të cilat është plot e përplot kjo hapësirë, harrojnë se ajo që ata quajnë etni shqiptare, në të vërtetë paraqet pushtim të dhunshëm të tokave serbe të kryer në rrethanat e pushtimit pesëshekullor osman, ku ata, pasi që do ta pranojnë me vullnet islamin, ishin dorë e djathtë e sulltanëve për t'i nënshtruar popujt europianë dhe për të rrënuar krishterimin e tyre, viktimë e parë e të cilit ishin serbët dhe trashëgimia e tyre shpirtërore krishtere në këtë pjesë.

Edhe e ashtuquajtura Lidhje Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878 nuk ishte lëvizje për krijimin e shtetit autonom shqiptar, siç thotë propaganda shqiptaro-madhe në Tiranë dhe Prishtinë, por ishte një përpjekje që t'i vazhdohej jeta Perandorisë Osmane në themelet e shtetësisë serbe, në mënyrë që me anën e mbetjes së mëtutjeshme të osmanëve në pjesën europiane, të mbrohej dhe të vazhdohej hegjemonizmi shekullor shqiptarë ndaj qenies historike serbe. Se shqiptarët edhe më tutje dëshironin të mbeteshin në këtë kurs, pra të ruajtjes së osmanizmit në Ballkan, këtë e treguan më së miri edhe gjatë luftërave çlirimtare të Aleancës Ballkanike në vjeshtën e vitit 1912, kur ata mbajtën anën e Perandorisë Osmane dhe përfunduan si humbës. Po mos të ishin austro-hungarezët dhe gjermanët, armiq të përbetuar të Serbisë, me siguri se edhe ajo që u shpall Shqipëri në nëntor të vitit 1912 nuk do të ekzistonte fare, e me këtë edhe telashet e tanishme nuk do të shfaqeshin.

Sidoqoftë, shqiptarët ishin dhe mbetën armiq të shtetit serb, e më vonë edhe të asaj që nga Konferenca e Paqes në Paris në vitin 1919 doli si Mbretëri Serbo-Kroate-Sllovene që pas pak do të kthehet në Jugosllavi. Në vazhdimësi luftuan kundër shtetit serb dhe atij të përbashkët me kroatët dhe sllovenët, dhe se, nuk ngurruan që të lidhen me kundërshtarët e saj të përhershëm, qofshin ata edhe djaj. Andaj nuk është për t'u habitur pse sjellja dhe mentaliteti i shqiptarëve është i thadruar mbi këtë refuzim historik, që përherë i ka bashkuar me armiqtë e Jugosllavisë - me nazifashistët italianë dhe gjermanë me rastin e Luftës së Dytë

Botërore kur në dëm të Jugosllavisë u krijuar Shqipëria e Madhe, dhe i kishte bashkuar edhe me forcat reaksionare nga radhët e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, të cilat të ndihmuar nga anglo-amerikanët, pas Luftës së Dytë Botërore, me kundërrevolucionin në Kosovë, që u përqendrua në Drenicë me shpresën se aty do të zbarkonin anglo-amerikanët, u përpoqën ta rrëzonin pushtetin popullor antifashist të nacionalçlirimtarës.

Edhe pas dështimit të kundërrevolucionit, forcat e mundura nga radhët e kuislingëve dhe forcave të tjera antikomuniste, për vitet të tëra organizuan diversione kundër Jugosllavisë. Pjesëtarët e Kolonës së Pestë, të bashkuar nga grupime të ndryshme, do të stërviten nëpër kampe të ndryshme ushtarake (në bazën amerikane Ramshtat të Gjermanisë, në Sicili e Greqi) për të zbarkuar në Jugosllavi dhe Shqipëri. Militantët e shumtë shqiptarë përherë do të ushqehen me ëndrrën e krijimit të Shqipërisë së Madhe si një përmirësim i gabimeve historike që u janë bërë shqiptarëve, që në të vërtetë, nuk do të thotë tjetër pos përpjekje për t'u rrënuar linja e demarkacionit midis Lindjes dhe Perëndimit në dobi të së dytës dhe në dëm të Jugosllavisë socialiste të pavarur dhe të painkuadruar.

Duke refuzuar identitetin jugosllav me theksimin e të qenit shqiptar, që shteti jugosllav nuk e konteston, por që e shikon në kuadër të kornizave të përbashkëta të një barazie, nacionalistët shqiptarë dëshirojnë të hapin çështjen e mospranimin të shtetit jugosllav me arsyetimin se gjoja ai nuk e kaluar sprovën e bashkimit të brendshëm mbi të cilin edhe është ndërtuar, ngaqë ai nuk ka qenë vullnet politik i të gjithëve, veçse projekt hegjemonist serbomadhi i dalë nga "Naçertanja" e Garashaninit nga viti 1844 e tutje. Në këtë drejtim, ata jo rastësisht mbështeten edhe te nacionalistët kroatë, me të cilët, pas ngjarjeve kundërrevolucionare në Kosovë të vitit 1981, jo vetëm që bashkëpunojnë, por kanë lidhur edhe aleancë për copëtimin e Jugosllavisë, me ç'rast, shtetit të pavarur kroat, duhet t'i bashkohet Hercegovina, ndërkohë që Republika Shqiptare, krahas Kosovës do të përfshinte edhe Luginën e Preshevës, një pjesë të Sanxhakut, pastaj gjysmën e Maqedonisë dhe Plavën e Gucinë nga Mali i Zi.

Ndaj këtyre ogureve patriotët jugosllavë, të cilët nuk kanë atdhe tjetër pos Jugosllavisë, nuk mund të sillen sikur nuk po ndodh gjë, ose që të shtirën sikur ato që po ndodhin, nuk meritojnë vëmendje, ngaqë nuk kanë gjasa jetësimi.

Në rrethanat, kur projektet e tilla më së shumti e kërcënojnë Serbinë, si themeluese të Jugosllavisë dhe bartëse të idesë së jugosllavizmit, për të cilin populli serb ka derdhur shumë gjak që nga Kriza Lindore e tutje, është fare e arsyeshme që në mungesë të veprimit të mekanizmave shtetëror në nivel të federatës, këtyre kërcënimeve t'u jepet përgjigje e merituar, të shfaqen shenjat e para te formimit të një lëvizjeje mbi bazat e patriotizmit jugosllav. Në Vojvodinë, në Valevë, Çaçak dhe në Bosnje e Hercegovinë tashmë janë formuar klubet e para të *Patriotëve Jugosllavë*, me anën e të cilave duhet të bëhet me dije se askujt nuk do t'i lejohet pazar me Jugosllavinë. Atyre që nuk e duan, duhet t'u thuhet se mund të largohen prej saj, por assesi të marrin pjesët e saj më vete, siç mendojnë. Madje, një këshill nismëtar i mbrojtëseve të Jugosllavisë, që është në themelim e sipër në Mal të Zi, nacionalistëve shqiptarë u ka bërë thirrje të hapur që të shkojnë përtej Bjeshkëve të Nemuna dhe të mos ëndërrojnë për ndonjë krijesë siç ishte e ashtuquajtura Shqipëria e Madhe gjatë kohës së nazifashistëve, sepse mund të mbesin edhe pa Shqipërinë staliniste të Enver Hoxhës.

Po ky këshill nismëtar i mbrojtësve të Jugosllavisë, ka kërkuar nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë, që klubeve sportive të Kosovës, që bëjnë gara në Ligën e Parë Federative, në radhë të parë atij të boksit “Prishtina”, klubit të futbollit “Prishtina” si dhe klubit të femrave “Universiteti”, ndeshjet si vendas t’i luajnë pa pjesëmarrjen e publikut. Kjo masë duhet të vlejë për derisa të krijohen kushtet që sporti të mos shfrytëzohet për qëllime politike. Madje, kjo lëvizje në formim, kërkon që masa e ndalimit të merret edhe ndaj tifozëve të klubeve të Kosovës në Ligën e Parë Federative si mysafirë. Sepse, siç është parë, ata nuk ngurrojnë që për qëllimet e tyre nacionaliste dhe armiqësore të shfrytëzojnë edhe terren e kundërshtarëve, veçmas ato në jug të Serbisë (Prokupje, Kurshumli e Nish), pastaj ato në Maqedoni (Shkup e Tetovë), për të hedhur parulla nacionaliste shqiptaro-mëdha, që me të drejtë ngjallin reagimet e qytetarëve patriotë, të cilët kërkojnë që t u pritët rruga këtyre vandalizmave që synojnë rrënimin e shtetit tonë të përbashkët...

(“Jedinstvo”, Prishtinë, më 29 qershor 1985)

(Reagimet e shtypit të Beogradit dhe atij serb të Prishtinës gjatë dhe pas kthimit të Bashkim Kosovës nga Kampionati Botëror i Boksit Amator në Toronto të Kanadasë, ku boksierit të Prishtinës nuk do t’i lejohet që në finale të luftojë për medaljen e artë me ç’rast ai do të deklarojë se Shtabi Teknik i reprezentacionit jugosllav për shkaqe politike ishte i interesuar që ai të mos e fitojë titullin e kampionit botëror si dhe përshëndetja e vendimit të Lidhjes së Boksit të Jugosllavisë që Bashkim Kosova të suspendohet nga boksi)

Një shpërthim nationalist i Kosovës në Toronto

Bashkim+Kosova edhe një herë tregoi se sportin e sheh si trampolinë për qëllime nacionaliste dhe jo si një mjet për të dëshmuar shkathhtësitë fisnike.

Në Toronto të Kanadës, kur për arsye shëndetësore (pas ndërhyrjes së mjekut kujdestar të reprezentacionit), nga Shtabi Teknik nuk iu lejua që në duelin final të dilte në ring dhe në këtë rast të luftonte për medaljen e artë, ai para kamerave të kompanive më të mëdha televizive botërore shfryu me fjalët se “për shkaqe politike u pengua që të mos fitojë titullin e kampionit botëror”.

Deklaroi se “dikush kishte frikë që një shqiptar nga Kosova ta fitonte medaljen e artë!”

Kjo deklaratë, pastaj me të shpejtë u përvetësua nga nationalistët shqiptarë si dhe armiqtë tjerë të Jugosllavisë nga emigracioni fashist në Perëndim, të cilët, si rëndom fajësuan “unitarizmin serb”, që sipas tyre, “dominion Jugosllavinë” dhe bën çmos që joserbëve t’ua pamundësojë suksesin.

Në Toronto dhe në disa qytete të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nationalistët shqiptarë bashkë me emigracionin fashist, organizuan demonstrata para përfaqësive jugosllave në këto vende, duke kërkuar Republikën Shqiptare në Jugosllavi “si të vetmen garanci të mbrojtjes së shqiptarëve dhe të drejtave të tyre nga hegjemonizmi serbomadhi”! Me këtë rast, nationalistët shqiptarë dhe emigracioni fashist, derdhën shumë helm mbi Jugosllavinë dhe gjoja kursin e saj antishqiptar, duke “e ilustruar” këtë me burgosjet e

shumta të rinjve dhe dënimet e tyre me burgje shumëvjeçare pse kërkojnë që të jenë të barabartë me të tjerët dhe t'u mundësohet që lirisht të shprehin identitetin e tyre nacional. Atyre iu bashkua edhe Komiteti Amerikan për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe disa organizata të ngjashme që janë degë të Komitetit të Helsinkit. Këto të fundit dolën me lista të gjata të të burgosurve shqiptarë në Jugosllavi, të cilët mbahen në burgje nga viti 1981 e tutje pse kanë demonstruar në mënyrë paqësore me kërkesën për Republikën e Kosovës, ndërkohë që ndaj tyre është përdorur dhuna e ashpër shtetërore nga represioni policor e deri te ai ushtarak, me ç'rast sillen edhe emrat e disa të rinjve shqiptarë që kanë humbur jetën gjatë shërbimit ushtarak në Armatën Jugosllave, ose që janë burgosur nën akuzën e “bashkimi armiqësor”.

Këto protesta dhe demonstrata të inskenuara nuk mbetën pa jehonë në opinionin e këtyre vendeve, por edhe atë botëror. Sepse, që të gjitha u lidhen me deklaratën e nënkampionit botëror, *Bashkim+Kosova* dhe fjalët e tij se gjoja dikush nga Beogradi gjoja thuri një komplot që atij, si shqiptar, të mos i lejohej fitorja e kampionit botëror, aq më pak që ajo të sigurohej në luftë me boksierin rus!

Përnjëmend fantazia e sëmurë duket se nuk ka fund kur fillon të pushtohet nga insinuatat e mjegulluara, me anën e të cilave duhet të gjendet fajtori për diçka që nuk ka fare nevojë për të. Sepse, në këtë rast, Shtabi Teknik i Reprerentacionit të Jugosllavisë, ishte i detyruar ta bënte këtë, pra ta dorëzonte duelin pa luftë, pse *Bashkim+Kosova* ishte i lënduar seriozisht në krah dhe se me daljen në ring, jo vetëm që ai nuk do të ishte në gjendje të luftonte, por rrezikohej nga ndonjë lëndim më i rëndë, që do t'i kushtonte me karrierë. Shtabi Teknik dhe i gjithë reprerentacioni i Jugosllavisë, si dhe gjithë sportdashësit në Jugosllavi, ishin njësoj të dëshpëruar pse lëndimi e privoi *Bashkim+Kosovën* që të luftonte për medaljen e artë, sepse suksesi i tij njëherësh do të paraqiste njërin ndër sukseset më të mëdha të boksit jugosllav në histori.

Me këtë rast Shtabi Teknik i Reprerentacionit të Jugosllavisë si dhe gjithë sportdashësit në Jugosllavi njësoj shprehin keqardhje për shkaqet shëndetësore që penguan këtë duel, por njëherësh hedhin poshtë që të gjitha insinuatat e natyrave të ndryshme, veçmas ato me motive politike, të cilat mund të prodhojnë pasoja të rënda jo vetëm sportin jugosllav, por edhe për shoqërinë tonë në përgjithësi, e cila më të drejtë ndjehet e shqetësuar përballë zhvillimeve që mund ta shpijnë në konfrontime të brendshme.

Dhe *Bashkim+Kosova* me sjelljen e tij aspak sportive bëri që të trazohen jo vetëm strukturat sportive në vend, por edhe opinionin e përgjithshëm, i cili zuri të reagojë në mënyra të ndryshme, gjë që kjo kërkoi edhe ndërhyrjen e parë të strukturave politiko-shoqërore, me ç'rast, Kryesia e Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë, me anën e një kumtese për shtyp, deklarata e *Bashkim+Kosovës* i vlerësoi “jashtë frymës sportive”, duke i gjykuar politikisht të paqëndrueshme dhe të dëmshme. Me këtë rast me të drejtë u tha se me anën e tyre u bënë përpjekje që të lëndohet autoriteti i Jugosllavisë vetëqeverisëse dhe të painkuadruar pikërisht aty ku vendi ynë ka pse të mburret, dhe se vetë afirmimi i *Bashkim+Kosovës* dhe i shumë e shumë sportistëve të tjerë nga radhët e kombësive tona në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar këtë e dëshmon më së miri. Lidhur me këtë, me të drejtë u tha se gjatë viteve të fundit, kombësia shqiptare ka arritur suksese të mëdha në të gjitha lëmenjtë shoqëror, pa marrë parasysh se nacionalistët shqiptar dhe forcat tjera armiqësore nga brenda dhe nga jashtë, po mundohen që këtë ta pengojnë, ngaqë ata, ndonëse

flasin për barazinë që gjoja nuk e kanë, në të vërtetë dëshirojnë shkatërrimin e Jugosllavisë, sepse vetëm kështu shohin gjasat për sendërtimin e ëndrrës së tyre për krijimin e Shqipërisë së Madhe.

Deklarata e Kryesisë së Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës së Jugosllavisë ishte e duhur dhe erdhi në çastin e duhur, gjë që kjo i mundësoi federatës së boksit që përkohësisht ta largojë *Bashkim+Kosovën* nga boksi.

Ky suspendim, sigurisht se nuk është i lehtë për askënd, por ai ishte i domosdoshëm që më në fund edhe sportistët kulmorë, siç është *Bashkim+Kosova* ta kuptojnë se duhet të sillen në përputhje me të normat e shoqërisë, e cila u ka mundësuar hapësirë për ngritje dhe suksese të mëdha.

(*NiN, Beograd, 2 shtator 1996*)

Kosovës - vendi i duhur...

Suspendimi i *Bashkim+Kosovës* nga garat e mëtutjeshme duhet të pasojë edhe me masën e përjashtimit të përhershëm nga reprezentacioni i boksit të Jugosllavisë, pa marrë parasysh titujt e tij të shumtë (kamion i Ballkani, kampion olimpik dhe nënkampion botëror). Bruno dhe të tjerëve nga Zagrebi, të cilët prej vitesh e kanë përkrahur dhe mbrojtur *Bashkim+Kosovën* “me argumente sportive”, duhet t’u thuhet se interesi i vendit është më i rëndësishëm se të tjerat. Madje, me këtë rast, Bruno dhe të tjerëve në Zagreb, duhet t’u bëhet me dije se “argumentet sportive” kanë qenë ato që i kanë sjellë dëme të mëdha vendit qoftë jashtë qoftë brenda, sepse nacionalizmi dhe separatizmi shqiptar si dhe në përgjithësi propaganda armiqësore shqiptare kundër vendit tonë, është mbështetur mbi “sukseset” sportive të *Bashkim+Kosovës*, duke i shfrytëzuar ato për qëllime të veta. Këtu në të vërtetë shfaqet absurditeti i gjithë rastit *Bashkim+Kosova* dhe manipulimit me të, ngaqë të ashtuquajturat kërkesa për barazi të shqiptarëve nuk nisin nga shkalla e diskriminimit, ngaqë nuk ekziston, por nga pika më e lartë e arritjes, siç është me këtë rast.

Mbetët për t’u parë se si do të sillen tash e tutje *Bashkim+Kosova* jashtë oreolit që ia ka sjellë barazia?

(*“Politika”, Beograd, 3 shtator 1996*)

Festë e madhe në Fushë Kosovë

Lajmi për qerimin e parë të hesapeve me *Bashkim+Kosovën* u prit me miratim nga serbët e Fushë Kosovës, të cilët, me këtë rast, nga Klubi Sportiv “Kosovo Polje” i dërguan një telegram përshëndetës Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë si dhe forumeve të tjera shoqërore-politike të vendit, ku u jepet mbështetje përpjekjeve për t’u filluar lufta politike me bartësit e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar si dhe ideve shqiptaro-mëdha që vinë prej tyre.

Në orët e vona, Klubi Sportiv “Kosovo Polje” organizoi një mbrëmje argëtuese, ku morën pjesë edhe shumë të rinj nga pjesët tjera të Kosovës. Gazmendin e bëri edhe më të madh koncerti i grupit “Zaviçaj” nga Nishi, i cili u përkujdes që në këtë manifestim popullor

të kthejë një pjesë të melosit burimor serb, të përjashtuara nga ky ambient prej vitesh nga zhurma e folklorit shqiptar.

Manifestimi mori fund në orët e vona të natës me parakalimin e bandës frymore “Zaviçaj” nëpër rrugët e Fushë Kosovës.

Me këtë rast, para Shtëpisë së Kulturës një grup të rinjsh iu dha thirrjeve “Kosova është Serbi”!

(“Jedinstvo”, Prishtinë, 6 shtator 1986)

Kundërpërgjigjja nacionaliste e Prishtinës...

Siç është pritur, në Prishtinë, nacionalistët dhe separatistët shqiptarë, shfrytëzuan rastin që ndaj lajmit për suspendimin e *Bashkim+Kosovës*, të reagojnë me demonstrata armiqësore, të cilat filluan sikur ishte fjala për kremtimin e titullit të nënkampionit botëror në Toronto, por shpejt u pa se ato ishin në kuadër të strategjisë tashmë të njohur të demonstrimit për bashkim kombëtar, ku parulla për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës shfaqet si nismë e të gjitha kërkesave shqiptaro-mëdha.

Demonstratat nisën para lokaleve të Klubit të Boksit “Prishtina”, në afërsi të stadiumit të futbollit me thirrjet “*Bashkim jemi me ty!*” dhe “*Kosova mbi gjithë botën*” - që përkujton sloganin hegjemonist të himnit gjerman “*Deutschland über alle ind der Welt*”, (“*Gjermania mbi gjithë botën*”), aq të kobshëm jo vetëm për serbët, por edhe për shumë popuj të tjerë gjatë Luftës së Parë Botërore – për të vazhduar pastaj për pak para Pallatit të Rinisë “Boro-Ramizi” në mënyrë që pastaj masa e madhe të bartet para Hotelit “Grand” dhe në rrugën kryesore “Marshali Tito” deri para Teatrit Popullor Krahinor.

Shenjën *për bashkim*, që e ndoqën mijëra e mijëra veta, e dhanë disa çallgaxhinjë, të cilët me daulle dhe gërnëtë parakaluan rrugës kryesore disa herë dhe ndiqeshin nga disa valltarë “të rastit”, të cilët me shamitë e kuqe që i valëvitnin pareshtur kërkonin t’u bashkoheshin kalimtarët “e rastit”. Atyre me të shpejt iu përgjigjen nxënësit e shkollave të mesme (të gjimnazit “Ivo Lolla Ribar” dhe të Qendrës Teknike), që mbushën rrugën kryesore nga Teatri deri te “Grandi”.

Që çdo gjë të duket si “kremte popullore” për hir të medaljes më të re të *Bashkim+Kosovës*, për këtë u përkujdesën shitësit e rrugëve, të cilët filluan të shpërndajnë fara, kikirikë dhe ëmbëlsira falas. Të mësuar nga dikush ata thoshin se “për Bashkimin jetën e japim”.

Kjo nxiti edhe më shumë të rinjtë që t’i sulen qendrës prej nga pastaj do t’u bashkohen atyre që tashmë kishin filluar që të nxirrnin thirrjet: “*Bashkim jemi me ty*” dhe “*Kosova! Kosova*”, e cila nga një grup i caktuar do të kthehet në thirrjen “*Kosova mbi gjithë botën*”, që ishte dëgjuar fillimisht.

Kur masa do të përndizej, siç pritej, në shkalloren e Teatrit dolën dy veta me megafon, me qëndrimin se ai manifestim duhej të shfrytëzohej për të protestuar së pari pse *Bashkim+Kosovës* nuk i ishte lejuar që të luftonte për titullin e kampionit botëror, që u tha se ai do ta fitonte pa ndonjë mund, dhe pastaj për të protestuar ndaj suspendimit që i është bërë *Bashkim+Kosovës* në vend se kjo masë t’u shqiptohej atyre që kanë penguar duelin final.

Se nuk ishte fjala për sport, por për një shkas për demonstrim armiqësor nga pozitat e njohura të nacionalizmit dhe separatizmit, më së miri këtë e tregon retorika që u përdor me

këtë rast nga folësit, nga e cila kemi shkëputur vetëm një pjesë, që ilustron se si shfrytëzohen “gazmendet” e tilla popullore për t’u shpaluar idetë shqiptaro-mëdha, sado që ato përpiqen të kamuflon:

“Bashkimi ynë është i pathyeshëm”!

“Bashkimi ynë nuk ndalet...”

“Bashkimi ynë do të vazhdojë...”

“Rroftë Bashkimi!”

“Rroftë Bashkimi ynë!”

“Bashkim Kosova”!

Masa i pranoi këto thirrje dhe i përsëriti me një zë.

Pastaj filluan të përhapen edhe parulla të tjera të njohura me përmbajtje armiqësore, të cilat do të përcillen me këngën:

“Kosovë, nana jonë...” dhe

“Besa-besë, besën ta kam dhanë,

për Kosovës jetën kam me e dhanë...”

Para “Grandit”, një pjesë e militantëve, filluan të ngacmojnë forcat e rendit, të cilat kishin krijuar kordonin e sigurisë që të mos hyhet në këtë objekt dhe po ashtu që të mos lejohej shkuarja e demonstruesve në drejtim të Radio Prishtinës dhe hapësirës para Fakultetit Filozofik, nga rreziku që i gjithë qyteti të mos përfshihej në turbullira të paparashikuara.

Militantët shqiptarë filluan të shtirën sikur “mllefin” e kishin ndaj Federatës së Jugosllave të Boksit, pse kishte suspenduar *Bashkim+Kosovën*, dhe si thuhej, me këtë u ishte marrë e drejta si “tifoze” që edhe më tutje të ushqeheshin me sukseset e tij në ring, por shpejt do të dalin aty ku edhe synonin – te manifestimi i qëndrimit armiqësor ndaj Jugosllavisë.

Kështu thirrja “*Poshtë Federata e boksit*” me të shpejt do të mbetet vetëm “*Poshtë federata!*” dhe parulla të ngjashme, ndaj të cilave, kur kulmuan, u dash ndërhyrja e forcave të rendit, që militantët nacionalist të shpërndaheshin.

Natyrisht, siç ndodh në raste të tilla, kur janë të domosdoshme ngacmimet që policia të përdor forcën, edhe këtë herë, militantët nacionalist në disa vende gjuajtën forcat e rendit me gur dhe shufra hekuri me ç’rast disa u lënduan, tre prej tyre morën plagë të rëndë dhe u mbajtën për trajtim mjekësor në Qendrën Emergjente të Klinikës së Universitetit të Prishtinës...

(“Večernje Novosti”, Beograd, 7 shtator 1986)

PJESA E TRETË

Çfarë tha Bashkim Kosova?

LUFTA IME E MADHE

Në valixhen time, që e kisha me vete që nga mosha gjashtëvjeçare, pra kur hyra në klasën e parë fillore, dhe nga kujtimi i saj nuk do të ndahem (pasi që do ta kryejë gjimnazin në Prishtinë “Ivo Lola Ribar”, do ta dërgoj te halla Shpresa në Vushtrri bashkë me disa gjëra të çmueshme që të ruhen), është një fotografi e tim atë, i veshur si pilot pranë aeroplanit luftarak “Mig” 49, që mban datën katër prill 1960. Im atë aty rri me njëren dorë në krahun e aeroplanit, ndërsa në tjetrën mban helmetën që e vente në kokë kur drejtonte aeroplanin. Nuk e di nëse ajo fotografi ishte bërë para se të nisej për në fluturim, apo pasi që ishte kthyer? Kjo mbase edhe nuk mund të kishte rëndësi për një kujtim të vetëm të ngjitur në pjesën e epërme të valixhes, me të cilën ndeshësh çdo ditë, po mos të ishte kureshtja për atë shikimin tejet përgjues kah një pikë e qiellit, që përherë krijon përshtypjen se ai megjithatë mund ta kishte ditur atë fundin tragjik që do t’i vijë pas pak ditësh, por që kurrë nuk do të kishte hequr dorë nga fluturimi i tij i fundit dhe lartësitë pse ashtu mund të ndahej nga përmbushja e një ideali, që jetës së tij, ndonëse të shkurtër, i ka dhënë kuptim. Gjithnjë në përputhje me këtë qëndrim, më bëhej se aty ishte të ma bënte me dije porosinë e përhershme se duhej t’i nënshtrohesha vullnetit për fuqi dhe arritjes së majave.

“Nëse të mungon e para, mbetesh i rëndomtë, e nëse të mungon e dyta, kthehesh në hiq...”

Fillimisht vullnetin për fuqi e ndjeja si sfidë të asaj që të barazon me të tjerët, ndërsa me majat parafytyroja arritjen e saj, që paraqet kulmin e dëshirave.

Se duhej me qenë i barabartë me të tjetër dhe aty duhej të plotësoja dëshirat e mija në përputhje me të, këtë e kisha të qartë qysh atëherë kur fillova me i ba hapat e parë të jetës, meqë jetoja në një shoqëri, ku deklarimi për barazi paraqiste një parullë të përgjithshme shoqërore me të cilën duhej të ushqeheshin që të gjithë njësoj.

Megjithatë, me kalimin e kohës, kur kreu klasën e katërt në Karllovc dhe, të pestën e vazhdova në Zagreb ku edhe do ta kryej shkollën fillore, pak nga pak do të kuptoj se ndjenja e vullnetit për fuqi, rreth të cilës më dukej se përherë më fliste fotografia e vetme e tim atë, e ngjitur në valixhe, nuk do të thoshte barazi, por largim nga barazia, dhe se kjo mund të bëhej me anën e një lufte të përhershme, e cila mund të jetë e kuptimshme vetëm po qe se arrihen majat, pra suksesi më i madh dhe assesi ndryshe. Më vonë, madje e kuptova se në këtë rrugë pengesën më të madhe paraqisnin kriteret me të cilat përcaktohej hapësira dhe vetë përmbajtja e barazisë, e cila kthehej në një kufizim të hapur pse binte ndesh mbi parimet mbi të cilat qëndron.

Natyrisht, se për mua, në ato rrethana, largimi nga barazia si peng i shumicës, mategj me masën e suksesit në mësim, ku isha ndër më të mirët e klasës, por që as kjo nuk më kënaqte, meqë e gjitha përfundonte në mesin e të dalluarve, të cilët kishin arritur të përvetësonin ato që shfaqeshin dije të caktuara tutje të cilave nuk mund të shkohej. Kishte, pra, një kufi, i cili ishte i dhënë dhe ai të dallonte nga të tjerët nga aftësia e arritjes së tij dhe asgjë më shumë. Kjo nuk po më kënaqte, sado që, nga viti në vit, përvetësimin e dijes, qoftë edhe si vijë ku mund të shkohej, përpiqesha të mos e kuptoja si pikë të fundit, por për të kundërtën, që disi të dilej prej saj, së paku aty ku kishte mundësi dhe këtë mund ta bëja të shumtën në letërsi, kur në vend të një libri të një shkrimtari, që na jepej si lekturë shkollore, unë lexoja dy-apo tri të tjera prej të njëjtit autor, e nëse nuk kishte të tjera, ose këtë e bëja

duke lexuar veprat e shkrimtarëve që parashiheshin për më vonë. Por, edhe këtu kishte vija kufizuese, sepse biblioteka e shkollës kishte aq libra, sa parashihnin plan-programet shkollorë dhe leximi mbikëqyrej në përputhje me ato që parashiheshin për moshën e caktuar.

Megjithatë, e vëmja fushë, ku nuk kishte vija kufizuese dhe ndalesa të tjera më shfaqej sporti. Fillimisht ishte atletika, ku pa ndonjë mund të madh i arrija që të gjitha rezultatet më të mira dhe madje i kaloja ato, dhe më vonë, në kuadër të aktiviteteve të lira ishte boksi, ai që më së shumti më joshte dhe thujse pas pak kohësh më bëri për vete për aq sa të mos i ndahem më.

Dhe lidhja ime me boksingun filloi thujse papritmas me rastin e një turniri sportiv i cili mbahej në Karllovc, për nder të ditës së 29 Nëntorit (festë shtetërore ndër më të rëndësishme, që lidhej me kremtimin e ditës që thuhet se në Jajce në vitin 1943 kishte lindur Jugosllavia federative), e ku kadetët e Armatës Popullore të Jugosllavisë nga ky qytet ftonin të rinjtë që t'i vinin dorëzat dhe të qëllonin për pak thesin e mbushur me rërë, i cili rrinte i varur në litar si “kundërshtar”.

Më kujtohet se ringu dhe litari në mes aty për aty ma krijuan përfytyrimin e rrënimin të përkufizimit të barazisë, ku mund të gjendej hapësira dhe mjeti më i përshtatshëm për të. Duke parë hapësirën e ringut brenda katër litarëve, se si më shkoi mendja se aty mund të çlirohesh ose të biesh përgjithmonë, se po fitove mund të bëhesh kampion dhe të arrish një majë, në të kundërtën mbetesh pjesë e shumicës së rëndomtë, që kënaqen me pak ose sa u jepet. Por, kampionë mund të bëhen vetëm fitimtarët. Fitimtarë ose humbës? Lartë ose poshtë? Një zë i panjohur po më thoshte se nuk kisha rrugë tjetër...

Dhe, me atë mendim, i cili gjithë trupin po ma përmbushte me një dridhërimë përçuese të panjohur deri më atëherë, iu afrova ringut dhe kërkova me i vu dorëzat, që sapo i vura, hetova se ishin shumë të papërshtatshme, pse ishin të mëdha dhe me të çara nga brenda, ku gishtat ngatërroheshin në vend se të bashkoheshin në shërbim të fuqisë, e cila duhej të drejtohej për të thesi i mbushur me rërë, prapa të cilit përfytyrohej kundërshtari apo diç e tillë, që varej nga kredhjet e mendjes.

Sidoqoftë, në atë dehje çasti, që mund të shpjegohet si ballafaqim me një sfidë të panjohur, ndjeva dorën e njërit që po më afronte te thesi dhe po më thoshte se mund të qëllonja si të doja, por që duhej të kisha kujdes nga kundërshtari (thesi) që nuk ta kthen, por pikërisht pse është i fortë, shkallmon dhe madje edhe lëndon. Ai më tha se për këtë arsye boksi quhet “dhunti fisnike”, meqë është i vetmi vend ku fiton më i forti, edhe pse ndonjëherë ndodhë që fituesin ta përcaktojnë nuancat, ose gjyqtarët, por këto janë më shumë çështje që kanë të bëjnë me përjashtimet se sa me rregullat.

Ato që m'u thanë e që m'u duken sikur vërejtje, nuk më penguan që t'i nënshtrohem sprovës së parë të derdhjes së fuqisë me anën e të rënave një thesi, që në ato çaste dëshiroja ta ndjeja si matje me vetveten. Mbase kjo bëri me ia fillue kujdesshëm dhe pak nga pak me e rritë ritmin e të rënave, të cilat sa më shumë që i shtoja më bëhej se po më bartnin në një gjendje jashtë vetes, në një hapësirë ku lëvizjet krijojnë përshtypjen e ndodhjes së një fluturimi të qetë përhumbës, që të merr me vete pa ditë se ku.

Natyrisht, se nga kjo gjendje më nxori ai që m'i kishte vu dorëzat dhe m'i kishte thënë ato udhëzimet e para kur më kishte folur për “dhuntinë fisnike”.

“Boksit i duhen ata që e përjetojnë luftën. Këtë e hetova te ti. Shoh se ke lindur për me u ba boksier, por jo çfarëdo.”

Këto m'i tha kur po më përcillte te arsimtari kujdestar, të cilit i foli diçka dhe pastaj u kthyer te unë dhe më përkëdheli.

“Ke lindur me u ba kampion dhe do të bëhesh.”

Atë ditë dhe në mbrëmje nuk m'u shqitën nga koka fjalët se kisha lindur me u ba kampion dhe do të bëhesha. Kishte këtu diçka mashtrimtare, që u thuhet ëndërrimtarëve të shumtë, ose fjala ishte për diçka që duhej të më bëhej me dije nga dikush në mënyrë që pastaj t'i jepesha kërkimit të saj?

Këtë nuk isha në gjendje me e sqarue, por kur ra ora e gjumit dhe terri zëvendësoi dritat e zbehta të dhomës së fjetjes, fjalët për boksën dhe dhuntinë që kisha për të po më tingëllonin ndryshe nga ajo ndjenja e përhumbjes që e kisha përjetuar gjatë të rënave që ia kisha bërë thesit të mbushur me rërë, që rrinte i varur në litar. Thesi po më kthehej në një bashkëbisedues të çuditshëm prej nga më dukej se po dëgjoja diçka nga ato që i përfytyroja të m'i thoshte im atë në atë fotografinë e vetme rreth vullnetit për fuqi dhe arritjes së majave, që e kisha të ngjitur në pjesën e brendshme të valixhes, me të cilën takohesha çdo ditë në mëngjes dhe në mbrëmje.

Kështu, vazhdoi edhe dy-tri ditët e ardhshme dhe, duhet të pranoj se ato çapitje me vetveten mbase mund të fashiteshin shpejt, po mos të ndodhte që të shfaqej ai që m'i kishte vu dorëzat e boksit në dorë dhe më kishte drejtuar te thesi i mbushur me rërë, që sapo më pa më tha se kishte ardhur ta takonte kampionin e ardhshëm.

“Ata që lindin për boks bëhen kampion”, i tha arsimtarit kujdestar.”I tillë është djaloshi ynë.”

Të nesërmen erdhi prapë dhe më mori më vete. Më tha se nga ajo ditë e tutje, do të ushtrroja dy herë në javë në ekipin e pionierëve të klubit “Partizan” të boksit në Karllovc, i cili asokohe bënte gara në ligën e dytë të Kroacisë.

Ai quhej Josip dhe ushtronte dy kategoritë e pionierëve: fillestarët, si unë, që ishin shumë dhe, ata me përvojë, që merrnin pjesë në gara në kuadër të programit të klubit, por një pjesë prej tyre, më të dalluarit, përfaqësonin ekipin e juniorëve në ligën vendore. Josipi kishte më vete edhe ndihmës si dhe trajnerë, që merreshin me ushtrimet e ndryshme fizike dhe trupore, të cilat i duheshin përgatitjes sa më të mirë atij që ishte në rrugë e sipër të bëhej boksier. Kështu, që në fillim iu nënshtrova ushtrimeve trupore, ndërsa ato në ring ishin të rralla dhe fare të shkurtra. Mbikëqyrësi Josipi, përcillte shtrimet tona me vëmendje të madhe dhe shënonte pareshtur ato që shihte, ndërsa në ring, shfaqej vetëm dhe na jepte udhëzime me një gjuhë të qetë si duhej mbajtur këmbët në ring, ku rregulla të veçanta vlenin për sulmin, për mbrojtjen, për largimin ose ikjen si dhe lëvizjet e tjera, të cilat thoshte se ishin pjesa më e rëndësishme e luftës. Por, kur na fliste kështu, përherë na bënte me dije se edhe këmba, edhe dora dhe secila pjesë e trupit që i nënshtrohet lëvizjes, duhet të nis dhe të sos nga koka.

“Koka është ajo që drejton të gjitha.”

Dhe ato që dëgjoja për kokën që drejton të gjitha, më kthenin te fotografia e tim atë në valixhe dhe shikimi i tij drejt lartësisë, që më bëhej se gjithnjë e më shumë më nxiste që të vazhdoja, sepse vetëm me përkushtim mund të arrija majat. Në lartësi përjetohet madhështia. Kur gjendesh në lartësi shkëputesh nga vogëlsia dhe smira e saj.

“Nga atje pamja dhe të menduarit është ndryshe, jashtë kufizimeve, jashtë urrejtjes...”

Se maja dhe lartësia arrihen me mund të madh, këtë do ta kem parasysh dhe, asaj sfide do t'i nënshtrohem përherë, por po ashtu, në këtë rrugë, do të ballafaqohem edhe me fuqinë e smirës së vogëlsisë dhe përpjekjeve të përhershme me dështue në atë ngritje, rreth të cilave më bëhej se më fliste pareshtur im atë dhe ma tërhiqte vëmendjen.

“Ata që mbesin poshtë, dhe janë të shumtë, pra si shumicë, ngaqë nuk kanë preokupim ngritjen, pengojnë ata që synojnë të shkëputen prej saj... Fluturimin dhe ngritjen nuk e pengon liria, por robëria...Prirjen e lirisë e kanë të paktët, ndërsa atë robërisë të shumtët...”

Edhe përkundër kësaj, gjatë jetës sime dhjetëvjeçare në ring, ia dola që në rrugë e sipër kah lartësitë, ose majat, të mposht smirën e vogëlsisë si dhe përpjekjet që kishin për qëllim dështimin tim. Në këtë ngritje, një pas një fitova titujt nga ai i Kosovës, i Jugosllavisë, pastaj titujt e kampionit të Ballkanit, atij të Europës e deri te ai Olimpik, sado që nuk do ia dola me e fitue fronin e boksit, pra titullin e kampionit botëror, ngaqë kjo m'u pamundësua kur nuk m'u lejua që të zhvilloj duelin e fundit me arsyetimin se gjendja ime shëndetësore (lëndim i krahut) këtë nuk e lejonte!

Sigurisht se edhe arritja e një titulli të vetëm për shumëkënd do të paraqiste sukses. Por, për mua, që kisha vullnetin e pashtershëm për fuqi dhe idealin e majës, të ndërjer si urdhër nga shikimi i tim atë nga fotografia e vetme që e mbaja në valixhe, të jesh i suksesshëm do të thoshte të përvetësoje fronin e më të mirit, dhe se, pas atyre që i kisha fituar, ishte titulli i kampionit botëror, por që çështje ishte se a mund ta arrije kur përreth ke kundër ata që nga smira e vogëlsisë, urrejnë lartësinë, por jo vetëm aq, sepse si do të shihet ata urrenin qenien time dhe çdo gjë tjetër që lidhej me të.

Këtu dhe të kjo çështje, do të fillojnë përsiatjet e mia rreth asaj, që do ta quaj “lufta ime e fundit”, që sado që duket personale (dhe si e tillë edhe duhet të merret, meqë fjala është për një karrierë të hapur sportive), në të vërtetë, shpалosin jo vetëm ndeshjen e përhershme midis të mirës dhe të ligës, të cilat janë pjesë e pandashme e një të qeni, por ato nxirrnin në pah përmasat e një përmëshje të thellë me urrejtje të pëbashkët kundër një populli, që shkonin deri aty saqë, në emër të mbrojtjes së një “të drejte historike” të ndërtuar mbi mite të rreme, t'i parashihej edhe shfarosja! Sepse, si do të shihet, shumë nga ata të cilët nëpër stadiumet sportive shfaqeshin me pankartat “*Poshtë Kosova*”, të cilat më vonë do t'i zëvendësojnë me ato “*Vdekje Kosovës*” dhe nga shtypi i Beogradit quheshin “tifos të papërgjegjshëm” dhe ngjashëm, në të vërtetë do të jenë të parët që si vullnetarë do të radhiten në aradhet e militantëve, të cilët në fundvitet e nëntëdhjeta do të nisen në kryqëzatat kundër Kosovës, siç kishin bërë paraprakisht në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë, për të vrrarë popullatën e pambrojtur.

Natyrisht se në këto përsiatje, që u ngjanin anktheve të rënda, pashmangshëm ndërhynte fotografia e tim atë para aeroplanit M-49 me atë shikimin e përhumbur drejt lartësisë, të cilën e mbaja në valixhe dhe, sa më shumë që arrija suksese dhe ngjitesha përpjetë, sikur ishte aty me ma ba me dije ngjashmëritë midis “luftës sime të fundit” dhe “fluturimit të tij të fundit”, ku ai “fundit” ishte paraparë të ishte i ngjashëm për ne: të pengohej arritja e majës (për të, të jetë pilot i parë, i cili do të fluturonte në aeroplanin amerikan dhe për mua, që të jetë i pari që do të arrijë titullin e kampionit botëror në boks), por njëherësh që të lidhej edhe me atë vërejtjen rreth fundit tonë.

“Ne kemi të njëjtin fat, të luftojmë, por edhe të pengohemi... Kjo nuk duhet të na dëshpërojë. Sepse, jeta si luftë dhe lufta si jetë, vazhdojnë... Por, atyre u duhet edhe dashuria e përhershme, që çështjeve t’u japë kuptimin e duhur shpirtëror...”

Por, për çfarë *jete si luftë* dhe *luftë si jetë* fliste im atë, që thoshte se vazhdojnë? Dhe, cila ishte ajo dashuria e përhershme që atyre u jep kuptimin shpirtëror?

Ishte vallë fjala për vullnetin e përhershëm për fuqi, që duhej ndjerë dhe nënshtruar sfidës së tij nga brenda, apo bëhej fjalë për një ballafaqim të përhershëm me atë që kërkon ta pengojnë atë?

Këto dhe hamendje të ngjashme, që më lidheshin për kokë dhe bëheshin gjithnjë e më rropatëse sa më shumë që arrija, ma krijonin përshtypjen se përnjëmend vullneti për fuqi, ishte shtysë e luftës së përhershme, prej nga nuk kishte kthim prapa, por që edhe ajo që arrihej duhej të mbrohej me çdo kusht nga fuqia e së ligës, e cila po ashtu ishte e përhershme dhe përherë e gatshme që të vepronte për ta shtrirë pushtetin e së keqes. Madje, më dukej se këtu kishte një shpërputhje midis njërës dhe tjetrës, ngaqë arritja kishte kufij dhe jashtë dëshmimit të vazhdueshëm nuk ishte e qëndrueshme, ndërsa e keqja nuk kishte kufij dhe ishte e përhershme dhe e pandalshme madje. Andaj, jo rastësisht më bëhej se kur im atë fliste për të njëjtin fat pasqyronte përmasat e kësaj të vërtete, që jo gjithnjë kuptohet si duhet...

Ajo që aq gjatë e kisha dëgjuar *për të njëjtin fat*, si të pashmangshëm, bënë që meditimi im rreth “*luftës së fundit*”, të ndërlidhet me “*fluturimin e fundit*” të tim atë për t’u parë pjesë e një rënieje pikërisht pse ngritja kah lartësitë kishte pikën e fundit, prej nga nuk lejohej të shkohej, por që edhe në këtë shihej mbështetësi i fuqisë.

Megjithatë, kur dukej se i nënshtroheshja fatalitetit, ndërhynte im atë që ma bënte me dije se fundin nuk duhet parë jashtë fillimit siç nuk duhet parë edhe fillimin jashtë fundit...Ai, po ashtu, më paralajmëronte për dashurinë dhe fuqinë e saj që çështjeve t’u japë kuptimin e duhur.

“Është kjo një ndërlidhje e përhershme, që çështjet i mban të hapura pikërisht pse vullneti për pushtet dhe vullneti për rrënim varen nga fuqia e dashurisë, e cila është në gjendje që t’ua përcaktojë përmasat të mirës dhe të keqes...”

Por, edhe në kuadër të këtyre përsiatjeve, “*lufta ime e fundit*” dhe “*fluturimi i fundit*” i tim atë, nuk mund të mbeteshin vetëm përjetime personale e as të shikoheshin si çështje të shkëputura (e para si “fatkeqësi” teknike, ndërsa e dyta “fatkeqësi” sportive), sepse ato domosdoshmërisht barteshin edhe në suazat e një konflikti të hapur shoqëror, ku tashmë thyheshin shpatat rreth çështjeve të natyrës politike, siç ishte e drejta e Kosovës për të qenë e barabartë me njësitë tjera të federatës, e shprehur si kërkesë e hapur në demonstratat e vitit 1981 (gjë që kjo që përkonte me pasqyrimin e vullnetin shoqëror për ngritje), ndërkohë që ajo kundërshtohej dhe luftohej madje nga Beogradi, me arsyetimin se republika e Kosovës, siç kërkohej nga shqiptarët, rrëronte baraspeshën politike të vendit dhe në këtë hapeshin rrugët shpërbërjes së shtetit të përbashkët (gjë që kjo përkonte me pasqyrimin e një vullnetit shoqëror për shtypje).

Meqë e gjithë çështja trajtohej në këtë mënyrë, pra anatemohej njëanshëm, edhe pse thuhej se shoqëria vetëqeverisëse jugosllave ishte e hapur, ishte fare e pritshme që mbyllja e saj e dhunshme, të gjente hapësirë shpërthyesë gjetiu, ku sporti ishte vendi më i përshtatshmi, meqë aty, sukcesi apo dështimi, varen nga fuqia individuale ose ekipore. Andaj, ishte e natyrshme që sukseset e mia në ring, ku nuk dija për humbje, zunë të

përjetohen si një kundërvënie klimës shoqërore dhe politike, e cila kërkesave të shqiptarëve për barazi jo vetëm që ua kishte vu limitet, por ato trajtoheshin si armiqësore dhe ndryshe-ndryshe, që ata i kthente në armiq me çka hapej fronti me një popull të tërë, i cili duhej të kërkonte mbështetje diku, që në qoftë se nuk bën punë barazia me të tjerët, pra ngritja e statusit të Kosovës në republikë, atëherë të kërkohej edhe bashkimi kombëtar, kërkesë kjo e kamotshme (që nga ndarja e dhunshme me rastin e Luftërave Ballkanike), e cila për arsye të rrethanave të brendshme dhe të jashtme, pa hequr dorë prej saj, sado pak ishte “anashkaluar” çastin kur në vitet e gjashtëdhjeta ideali i barazisë me të tjerët në federatën jugosllave ishte parë si një parakusht drejt arritjes së këtij qëllimi historik.

Natyrisht se në këtë zhvillimi, emri im (*Bashkim*) dhe mbiemri (*Kosova*), do të kenë domethënie të veçantë, meqë me anën e tyre “pajtoheshin” dy rrymimet shqiptare: ai i *bashkimit* dhe i *Kosovës republikë*, të cilat gjenin mundësi të mëdha pasqyrimi në sport, prej nga pastaj barteshin në sferën shoqërore dhe politike.

Ç’është e vërteta simbolikën e mundshme të emrit dhe mbiemrit tim dhe ndërlidhjen e tyre me idealet e shqiptarëve, e kam hetuar qysh herët, kur për herë të parë nga Zagrebi do të vij në Prishtinë, gjatë pushimeve verore dhe për disa ditë do të kaloj në Vushtrri te halla Shpresa.

“Ke një emër dhe një mbiemër tepër domethënëse, që nuk mund ta ketë çdokush”, me thoshte ajo gjithë qesëndi.

Pa dashtë të më ngarkonte me ato që mendja ia thoshte se në ato rrethana nuk isha në gjendje t’i kuptoja si duhej, më tha se emri im shprehte dashuri të pakufishme, meqë ishte parakusht i saj, ndërsa mbiemri pasqyronte një realitet etnik, kulturor dhe historik ndër më të veçantit. Pa hy te “realiteti historik” dhe ajo pse ai ishte i veçantë, që nuk do të vonojë dhe do ta kuptoj se ato lidheshin me të kaluarën tonë, tha se si i tillë, mbiemri *Kosova*, paraqiste një përgjegjësi të jashtëzakonshme.

Kështu, hetova se mbiemri im filloi të zgjojë në njërën anë kërshëri dhe huti, sidomos gjatë shkollimit tim në Karllovc dhe Zagreb, kur jo rrallë shprehej habia pse dikush ashtu “përvetësonte” një toponimi të përbashkët që nuk ishte rasti në gjuhët sllave, dhe në tjetrën anë, shqiptarëve u shërbente që të identifikohej me një realitet shoqëror dhe politik në rritje e sipër, i cili nëpërmes barazisë, duhej të kthehej në atë shtetëror?

Kur do të kthehem në Kosovë dhe karriera ime sportive në boks u vu në binarët e sukseseve të njëpasnjëshme, emri dhe mbiemri im do të jenë një faktor tjetër, që luftës sime me fitue dhe për me u ngritë deri te maja, ia dhanë konotacionet e caktuara të konfrontimeve shoqërore dhe politike, ku në njërën anë, nga shqiptarët, *Kosova* përjetohej si pjesë e identitetit të tyre shpirtëror shqiptar, të cilit i kishte munguar pasqyrimi në saje të pengesave ndër më të ndryshme që i ishin bërë nga ana e politikës zyrtare serbe, ndërsa në tjetrën, po nga serbët, të cilët nga vdekja e Josip Borz Titos e tutje filluan përpjekjet e tyre të hapura për ta mbizotëruar politikën jugosllave dhe për t’ua nënshtruar interesave të veta, shihej si ngacmim që drejtohej kundër asaj që quhej qenie historike mesjetare serbe, që gjoja rrezikohej të rrënohej nga nacionalizmi shqiptar dhe të ngjashme, sajesa këto që nuk do të vonojë dhe do të fitojnë “legjitimitetin” intelektual me shfaqjen e Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, që pas pak, nga udhëheqja serbe, të pranohet si kornizë për politikën e saj unitariste dhe hegjemoniste, me të cilën do të përgatitet terreni për shkatërrimin e Jugosllavisë së Titos.

Ky veprim fillimisht duhej të promovohet në Kosovë me rrënimin e autonomisë së saj – të cilin Beogradi do ta bëjë më 23 mars të vitit 1989 me përdorimin e tankeve dhe një gjakderdhje ndaj shqiptarëve të cilët këtë e përjetuan si ripushtim tjetër të Kosovës nga ana e Serbisë (pas atij të vitit 1913, 1918 dhe 1944), prej nga pastaj serbët, me ndezjen e luftës, do t'i vërsulen Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës me synimin që të krijojnë një Serbi të Madhe, në mënyrë që në fund, pasi që t'i kenë arritur synimet e caktuara, t'i rikthehen Kosovës, për me i qerue përfundimisht hesapet me “shqiptarët pushtues”, siç do të ndodhë në të vërtetë kur në fillimet e vitit 1998 do të fillohet me ofensivën ushtarake, ndaj së cilës në mars të vitit 1999 u desh ndërhyrja ajrore e Aleancës Veriatlantike për me e parandaluar gjenocidin ndaj popullatës shqiptare.

Fillimisht mendoja se ato mund të ishin vetëm fërkime të natyrshme, të cilat mund të ishin pjesë e frustrimeve të ndryshme “nga e kaluara”, si thuhej, ku sporti mundëson lirimin nga streset e caktuara, me të cilat ballafaqohen shoqëritë në zhvillim, të cilave u duhen kohë për t'i baraspeshuar raportet e brendshme.

Sporti çliron...

Kështu flisnin drejtuesit e sportit, por këtë gjuhë e përdornin edhe mediumet, të cilat përpiqeshin që edhe aty ku kishte demonstrime të hapura antishqiptare, çështjet të rrudheshin duke u parë si “eksese” dhe ndonjëherë edhe ngacmime huliganësh.

Madje, edhe atëherë kur nëpër ringjet e Serbisë dëgjoheshin thirrjet fyese kundër shqiptarëve dhe mbiemri im fshkëllehej me të madhe dhe, me parullat “*Smrt Kosovu*” (*Vdekje Kosovës*), kthehej në kërcënim të hapur, bëheshin përpjekje që këto të zbuteshin ose të anashkaloheshin disi me formulime tepër të buta.

Kështu do të ndodhë deri në marsin dhe prillin e vitit 1981, kur do të shpërthejnë demonstratat në Prishtinë dhe pjesët tjera të Kosovës, me kërkesën për republikën e Kosovës, si të barabartë me të tjerat në federatë, kërkesë kjo që për mua do të duket fare e natyrshme, meqë lidhej me parimet e barazisë rreth të cilave kisha dëgjuar të flitej që nga jetimorja, ku kisha bërë hapat e parë të jetës, për të vazhduar pastaj me të njëjtat predikime edhe gjatë shkollimit fillore dhe atij të mesëm. Madje, parulla se të gjithë duhej të ishim të barabartë ishte bazë e atij mësimi dhe edukate që merrnim për vëllazërim-bashkimin midis kombeve dhe kombësive si parakusht për përparimin dhe mirëqenien e bashkësisë jugosllave.

Përse, atëherë kërkesa për barazinë që Kosova të njësohej me të tjerët duhej të ishte shqetësuese sa të vlerësohej “si shkatërruese për Jugosllavinë”? A nuk ishte kjo në frymën e parimeve mbi të cilat thuhej se shteti ishte ndërtuar dhe duhej të mbahej?

Kokën e kisha me këto dhe dilema të ngjashme, që duhej të shtroheshin në mënyrë që t'u jepej përgjigje e drejtë pa qenë nevoja që të shpallej si të rrezikshme.

Por, ç'e do që në kundërshtim me parimet me të cilat ishim edukuar, atyre u ishin mbyllur dyert me anën e një anateme diferencuese, të cilën kreu i shtetit jugosllav, nën trysinë e udhëheqjes politike serbe, ku me dëshirë e ku me anën e kompromiseve, e kishte pranuar, me çka shqiptarët do të ndahen në shtetas besnikë - nëse e dënojnë kërkesën për republikën e Kosovës, dhe në armiq - nëse nuk e bëjnë këtë. Ata që gjatë procesit diferencues heshtnin, vlerësoheshin oportunistë, që i afronte me armiq të shtetit.

Natyrisht se kundruall këtyre rrethanave ku rrënohej besimi në barazinë si vlerë të përbashkët, askush nuk mund të ndjehej i qetë, aq më pak dikush si unë, me emrin dhe mbiemrin e të cilit identifikoheshin zëshëm këto kërkesa dhe, në mungesë të të drejtës që ato

të shpreheshin shlirshëm dhe në frymën e një trajtimi tolerant, sporti dhe atmosfera sportive shfrytëzoheshin për këto qëllim. Sa për vete ndjehesha i emocionuar kur ato shpreheshin në këtë mënyrë, por njëherësh ndjeja përgjegjësi edhe më të madhe që me anën e fitoreve dhe sukseseve në arenën ndërkombëtare, t'ua ruaja ison atyre, çështje kjo që nuk ishte aspak e lehtë nga shkakut se politika ditore ato tashmë i kishte identifikuar, siç thuhej në shtypin e Beogradit, “frymëzime për nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar”, gjë që kështu, desh a pa dashje, nga pikëpamja e idesë, më jepej roli i një lëvizësi të çështjeve, i cili gjërat jo vetëm që i mbante në një veprim të përhershëm, por bënte që ato të ushqeheshin me frymën mbi të cilën mbështeteshin.

Andaj, nuk është për t'u habitur pse pak më vonë, madje, nga i njëjti shtyp do të cilësohem “nxitës i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar” dhe të ngjashme, që do t'ua hapin rrugën kërkesave të njohura për largimin tim nga reprezentacioni shtetëror, po që se nuk do të deklarohesha haptas kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar dhe trysni të tjera të ngjashme që vinin nga të gjitha anët, të cilat pastaj do të zgjerohen edhe me kërkesat që të më ndalohej fare boksi. Në pamundësi që kjo të arrihej me anën e një vendimi politik që do ta pranonte sporti, disa klube nga Serbia, duke u thirrur në “patriotizmin jugosllav” dhe “mbrojtjes së sportit nga nacionalizmi”, filluan praktikën e tërheqjes së boksierëve nga lufta me mua, edhe pse kjo nuk ishte në përputhje me frymën sportive, gjë që kështu “tërthorazi” do t'ia dilnin që të më largonin nga gara sportive po mos të ishin klubet nga Kroacia dhe Sllovenia që kësaj fushate nuk do t'i bashkohen, dhe po mos të ishte ndërhyrja e vendosur e trajnerit të reprezentacionit jugosllav të boksit, kroatit Bruno, i cili u tregua i pamposhtur ndaj trysnisë së Serbisë. Të mos thyhet para trysnisë së Beogradit, seleksionuesi i reprezentacionit jugosllav pati ndihmë të madhe edhe nga asociacionet ndërkombëtare të sportit, të cilat Jugosllavisë që në planin ndërkombëtar, edhe më tutje, ruante rolin e liderit të lëvizjes së të painkuadruarve, iu kërcënuan me përjashtim nga garat ndërkombëtare, përjashtim ky që nuk do të mbetej vetëm te boksi, por do të përfshinte edhe sportistët tjerë jugosllav në të gjitha disiplinat e lojërave të ardhshme olimpike.

Mendja ma thotë se ato që do të ndodhin nëpër ringjet ballkanike, europiane dhe botërore nga Athina, Madridi, Bukureshti e deri te Los Anxhelosi, ishin pjesë e përkushtimit tim që sportin ta shfrytëzoj të arrij majat e tij, pikërisht siç e ndjeja nga ajo fryma që thithja pareshtur nga fotografia e tim Atë në valixhen, por fitoret njëherësh shfaqeshin edhe si detyrime që kishin të bënin me çështjen e përhapjes së kërkesës për republikën e Kosovës, peshën dhe rëndësinë e së cilës po e ndjeja gjithnjë e më shumë, jo vetëm pse ajo tashmë ishte kthyer në një përkushtim të përgjithshëm për të cilën demonstrohej haptas me një fanatizëm të madh, pale se ndaj të rinjve dhe të tjerëve që rreshtoheshin pas saj ushtroheshin masa të rënda të represionit shtetëror, që pasqyroheshin me shqiptimin e dënimeve në masë me burgime të gjata, po edhe pse ajo në raport me të tjerët gjithnjë e më shumë shfaqej formulë identiteti e brezit tim, që si të tillë po e përjetoja gjithnjë e më shumë në mënyrë që arritjen e saj një ditë ta identifikoj me majën, siç ishte titulli i kampionit botëror.

Njësimi i plotë i fronit të më të mirit në botë me Kosovën republikë, do të më fiksohet gjatë ceremonialit të marrjes së medaljes olimpike. Kur po ngrihej flamuri jugosllav, ndërkohë që intonohej himni shtetëror “*Hej slloveni*”, në mendjen time tashmë kishte zënë vend përfytyrimi i flamurit të Kosovës dhe himni i saj, ndonëse nuk e kisha idenë si do të dukej.

Ajo zhvendosje flamujsh dhe himnesh nuk ndodhte vetëm në përfytyrimet e mia. Në kokën time tashmë ideali sportiv shihej i ndërlidhur me atë shoqëror, ku i pari shfaqej në shërbim të të dytit, pa të cilin mendja ma thoshte se nuk mund të kishte as sport, nuk mund të kishte as suksese sportive, nuk mund të kishte as tituj, nuk mund të kishte as dinjitet njerëzor... Ishte pra fjala për një vetëdijesim rreth asaj se arritjet e njerëzve të suksesshëm maten me arritjet shoqërore, dhe ndikimin që mund të kenë në to, duke u bërë bartës i tyre.

Dhe si do të shihet, te unë, koha nga Lojërat Olimpike të Los Anxhelosit (1984) deri te ajo e Kampionatit Botëror në Toronto të Kanadasë (1986), shpirtërisht dhe fizikisht, do t'i nënshtrohen synimit për arritjen e titullit të kampionit botëror, i cili barasvlerësohej me idealin e Kosovës Republikë. Andaj, gjithë ato vështirësi dhe pengesa ndër më të nduarduarta me të cilat do të ballafaqohem gjatë atyre njëzet e katër muajve të ardhshëm, ku ato politike tashmë ishin shumë më të rënda se sportivet, u përpoqa me i përballue dhe i përballova, jo më me logjikën sportive, kur në ring ke të bëjë me kundërshtarin e vetëm, por me bindjen se isha pjesë e një vullneti të përgjithshëm për fuqi, që ishte kthyer në një vullkan të pandalshëm për barazi. Kjo ndjenjë dhe kjo bindje, më forcohej edhe më shumë sa herë shikoja fotografinë e tim Atë në valixhen time dhe më bëhej se edhe shikimi i tij kah lartësitë dhe fluturimi i tij i fundit lidheshin me idealin e Kosovës, i ideal ky që përherë kishte qenë te ai dhe aty, por që unë nuk kisha qenë në gjendje ta hetoja ashtu si duhej.

”Jemi në kërkim të Kosovës sonë...Kosova dashuri! Kosova na thërret!...”

Se Kosova thërriste dhe thirrja e saj për secilin shkonte deri në sakrificë këtë do ta kuptoj nga ato që do të ndodhin në vazhdimësi nga demonstrimet e atëhershme që nuk kishin të ndalur e deri te gatishmëria për të e mijëra e mijëra të rinjve për me u sakrifikue, që do të pasqyrohet pak më vonë gjatë asaj që do të shfaqet si lëvizje gjithpopullore në të cilën do të përfshihen të gjithë.

Kjo lëvizje e madhe, do të bëhet e tillë pse në të do të derdhen përpjekjet dhe mundi i secilit, pa dallim, që për moto mund të kishte vetëm thirrjen “*Kosova dashuri*”, e cila mbështetej mbi parullën “*Kosova jonë*”, si pronësi shpirtërore e atyre që e ndjenin të tillë dhe dëshironin të mbetej e tillë, ku do të kishte vend për të gjithë për ata që jetonin në të, si të barabartë, por që nuk duhej përjashtuar edhe atë “*Kosova Shqipëri*”, si vetëdije e përgjithshme historike, e cila lidhej me të drejtën e shqiptarëve, që të ndarë dhunshëm, të jetonin bashkë, jetësimi i së cilës shfaqej si opsion i hapur politik, që për parakusht të domosdoshëm kishte Kosovën Republikë.

Por, ishte pikërisht parulla “*Kosova jonë*”, si metaforë mbi të cilën mund të mbështeteshin që të gjitha shikimet rreth të tashmes dhe të ardhmes së saj, që kthehej në një mollë sherri midis shqiptarëve dhe serbëve, pikërisht pse të parët dëshironin që ajo në çdo pikëpamje të ishte e barabartë me të tjerët në përputhje me identitetin e shumicës shqiptare, ndërsa të dytët, si pakicë që ishin, kundërshtonin këtë me të gjitha forcat, me arsyetimin se ajo ishte “*djepi mesjetar serb*”, e cila ishte “*pushtuar nga shqiptarët ardhacakë gjatë Perandorisë Osmane*” dhe broçkulla të ngjashme nga e ashtuquajtura “*e drejtë historike*”, e sajuar me mashtrime gjithë fare, që kishin për qëllim të arsyetonin “*tapitë*” serbe ndaj saj, me anën e të cilave pastaj do të arsyetohej edhe ajo që pak më vonë do të kthehet në luftë të hapur për ta pastruar etnikisht nga shqiptarët...

Në këto rrethana thirrjen “*Kosova jonë*” do ta përjetoj si “*Kosova, dashuria ime*”, që pak nga pak do të më kthehet në një betim të përjetshëm me të cilin do të lidhen që të gjitha

preokupimet e mia jetësore, ku ato sportivet do të luajnë një rëndësi të veçantë, meqë aty ndjehesha vetvetja. Me këtë rast, duhet të pranoj se kapërcimi të “*Kosova, dashuria ime*”, nuk ishte çështje emocionale, e as përcaktim që të mbrohej diçka nga kërcënimi i humbjes së saj, siç mund të shihej nga pretendimet serbe, që bëheshin gjithnjë e më të zëshme dhe përkujtonin kohët e pushtimeve në të kaluarën dhe terrori që ishte ushtruar ndaj popullatës së saj, duke bërë me dije se ato nuk kishin përfunduar. Përkundrazi, te unë e gjitha vinte si identifikim me diçka të brendshme, shpirtërore, së cilës në fillim i kishte munguar afria e domosdoshme dhe ngrrohtësia pse kisha qenë larg saj (vitet e fëmijërisë dhe të shkollimit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci), por edhe pse përkushtimi im ndaj sportit dhe suksesit, i cili kërkonte hapësirat e dëshimit, më kishin privuar nga ato që shfaqeshin si “realitet të veçanta” shoqërore dhe përvijimet që lidheshin me to, të cilat, si do të shihet, do të kthehen në kundërshtime dhe më vonë në konflikte të hapura, të cilat do t’ia ndezin fitilin luftës së përgjakshme dhe gjithë atyre që do të lidhen me shkatërrimin e Jugosllavisë.

Në të vërtetë, gjatë edukimit tim në jetimore, por edhe në shkollën fillore dhe atë të mesme, që zhvillohej nën përkujdesjen e Armatës Popullore të Jugosllavisë, për Kosovën nuk dija tjetër pos që ishte një krahinë autonome me shumicë shqiptare, por ku kishte edhe serbë, dhe se më vonë, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, i ishte dhënë statusi i dyfishtë (e përfaqësuar në federatë, me të drejtën e konsensusit, që njëherësh mbetej edhe në përbërje të Serbisë), kompromis ky që duhej “të pajtonte” kërkesat e shqiptarëve si kombësi për barazi në federatë dhe ato të serbëve, që ajo, edhe në rrethana të tilla, mbetej në përbërje të saj, por që në kontekstet politiko-shoqërore ajo duhej të shihej si “*Kosova e të gjithëve*”.

Natyrisht se në ato rrethana përkufizimi “*Kosovë e të gjithëve*”, pra me përcaktim jugosllav, për mua bëhej edhe më i pranueshëm, jo vetëm pse e shihja si vendlindje të tim Atë dhe familjes së tij të gjerë, por edhe për atë se mbiemri Kosova, që e mbaja, duhej të shprehte një realitet pajtues mbi të cilin ndërtohej qëndrimi i cili përjashtonte përvetësimet e njëanshme të saj, siç ishin ato që vinin nga Beogradi, të cilave shqiptarët do t’u kundërpërgjigjen me kërkesën për barazi me të tjerët në federatë, prej nga thirrja “*Kosova jonë*”, ishte formulë mbrojtëse, të cilën pak më vonë jo vetëm që do ta pranoj, por pas pak do ta ndjejë ndryshe, kur ajo “*e jona*”, te unë do të bëhet “*e imja*”, si dashuri, me çka për herë të parë qenia ime do të përmbushet me një identitet të caktuar mbrojtës.

Por, ky zhvillim shumë domethënëse, nuk do të kishte kahun e tillë, (sado që rrethanat që do të shfaqen në vitet e tetëdhjeta assesi nuk do ta parandalonin e lërë më ta përjashtonin), po mos të ishin lidhjet familjare dhe përkujdesja e xhaxha Arsimit që të më vizitonte dy herë në vit, me çka unë liroheshja nga bindja se isha fëmijë jetim, i shkëputur nga lidhjet tjera familjare, për të cilin përkujdesej vetëm shteti, gjë që nënkuptonte edhe “edukatën shtetërore”, që dihej se çfarë mund të ishte. Xhaxha Arsimi ishte aty të ma bënte me dije se kisha trung familjar, se kisha vendlindje dhe kisha diçka që mbetej pjesë e identitetit tim pa marrë parasysh rrethanat.

“Ti ke familje, e cila të pret dhe duhet t’i takosh”, më thoshte kur vinte në Zagreb. “Ke edhe një gjuhë, *gjuhën e shpirtit*, e cila përherë thërret, edhe kur kjo nuk dëgjohet gjithaq, por që sëmbimi i saj ndjehet qoftë edhe pavetëdijshëm...”

Dhe *gjuhën e shpirtit* si ngacim të parë e hetova sapo erdha në Prishtinë. Ndodhi kjo gjatë pushimeve verore, pasi që të kem kryer klasën e dytë të gjimnazit në Zagreb, kur m’u dha leja që për një muaj të qëndroj në Kosovë. “Garantues” ishte xhaxha Arsimi, i cili

kishte luftuar aq shumë për lejen, që si do të shihet do t'ua hapë udhën afrive të tjera me Kosovën deri sa t'i kthehem i tëri.

Qëndrimi im i parë në Prishtinë dhe, në veçanti, ditët që kalova te halla Shpresë në Vushtrri, ma bënë me dije rëndësinë e ngrohtësisë familjare pikërisht asaj që më kishte munguar gjatë viteve në jetimore dhe më vonë, por njëherësh ato më lidhën shpirtërisht me Kosovën, meqë aty do të ndjejë dridhërimat e para të dashurisë, që do të thotë se ndijimi im i parë për Kosovën vinte nga ndjenja e dashurisë. Ishte pra dashuria ajo që më kishte afruar, më kishte lidhur dhe me kishte mbajtur të lidhur përgjithmonë për Kosovën.

Dua të them se te halla Shpresë për herë të parë do ta përjetoj afrinë familjare, si diçka që i duhet secilit për t'u ndjerë si qenie e plotë shoqërore...Bisedat me fëmijët e saj, djemtë Mendimin dhe Fisnikun dhe vajzat Teuta dhe Blerta dhe me rrethin e tyre shoqëror para meje hapën përmasat e një bote shumë të afër dhe të dashur, që më kishte munguar së cilës ndjeja se i takoja. Kjo ndjenjë m'u ngulit edhe më dhe nuk do të më hiqet dot çastin që do të ndjejë shqetësimet që sjellë dashuria e parë prej nga pastaj do ta kuptoj domethënien midis vullnetit për fuqi, arritjes dhe dashurisë, e cila u jep kuptim të gjithave, që më vinte si porosi nga ballafaqimi me fotografinë e tim Atë në valixhen time.

Në të vërtetë ajo nuk ishte dashuri, e cila duhej të bëhej e prekshme dhe kështu të jetësohej. Përkundrazi, ajo ishte shumë më shumë se aq, pse nisi si ndjenjë e veçantë dhe mbeti e tillë përgjithmonë, diçka që jetës sime i dha një kthesë të jashtëzakonshme, që mund të thuhet se pati ndikim vendimtar që kapërcimi "*Kosova e të gjithëve*" tek "*Kosova jonë*" e deri te "*Kosova, dashuria ime*" të bëhet me një shpejtësi të madhe dhe të jetë i një natyre shpirtërore ndër më domethënësit e jetës sime.

Fjala pra ishte për njohjen me Nora Bardhin, një shoqe klase të vajzës së hallës Shpresë, Teutës. Ishte nga Vushtrria, nga një familje intelektuale (nënë mjeke dhe të atin jurist), të cilët kishin lidhje të miqësore me familjen e hallës Shpresë.

Nora Bardhi, ishte një vajzë skofiare, ndër të parat që kishin prekur zemrën time në atë mënyrë për të mbetur e tillë gjithmonë pa marrë parasysh ato që do të vijnë më vonë (njohja dhe martesja me Drita Rracin). Kjo ndodhi ditën që bashkë me Teutën shkuam në kinemanë e qytetit. Sapo u njoftuam, Nora më pa qetë dhe, meqë duhej t'i flisja në serbokroatisht, u mundua që të ma heqë mundimin që ndjeja në ato rrethana...

"Gjuha e shpirtit është më e kuptueshmja. Asaj nuk i duhen as fjalët..."

Fjalët e saj më sollën një dridhërimë të jashtëzakonshme, të pa hetuar deri më atëherë...Zura ta shikoj dhe në atë shikim e sipër, m'u bë se pikasja m'u kishte ngrirë pikërisht te kaltërsia e syve të saj, që ishte e thellë dhe e gjerë, ku humbësh...

Por, nga ajo përumbje joshëse, ndër më të veçantat e jetës sime, më nxori pikërisht Nora e cila nisi të më fliste për filmin ("*Shkretëtira e kuqe*", e Felinit), që e kishte përjetuar si një romancë midis vetmisë individuale dhe ftohtësisë shoqërore, ku tha se hapësira e shpirtërores mbetet e vetmja mburojë...

Ndërsa ajo po fliste për metaforën e shkretëtirës së kuqe dhe ftohtësinë shoqërore së cilës jo rrallë i nënshtrohemi, unë edhe më tutje kisha mbetur i kredhur në kaltërinë e syve të saj, prej nga më dukej se tashmë pak nga pak po tërhiqej ajo velloja magjepse për t'ia lëshuar vendin ballafaqimit me ato që shprehte ajo si përshtypje, ku duhej të ndërldheshja, meqë m'u bë se theksimi i ftohtësisë shoqërore kishte të bënte me mua, meqë më mungonte ngrohtësia familjare...

Edhe pse duhej të thosha diçka, së paku që të lirohem nga përshtypja e zënies në kurth dhe, madje këtë desha ta bëj, hetova se hë për hë kësaj nuk ia dola, nga shkaku se ende nuk isha liruar nga mbërthimi i ndjenjave, të cilat nuk isha në gjendje që t'i mbikëqyrja. Mbase këtë e hetoi edhe kushërira ime Teuta, e cila, ma futi krahun dhe zuri të fliste diçka për një këngë më të re të Elvis Prislit (“Jeta ime”), që tashmë ishte radhitur ndër hitet botërore. Ah, Elvise i shpirtit, tha Nora.

Përmendja e Elvise, si dhe klithja e veçantë e Norës për të, sakaq më nxori nga turbullimi në të cilën ndodhesha. Thashë se ishte i veçantë pse muzika e tij përjetohet si një tingull që vjen nga një thellësi magjike për të kaluar në amshueshmëri... Ajo është një dehje e përhershme, thashë. Dehjet, janë çështje të shpirtit që nuk përfundojnë, ma ktheu ajo me një zë fare të butë, sikur të lironte një dhembje të përhershme...

Në të vërtetë e tillë ishte edhe ajo dashuri: e cila do të më kthehet në një dhembje të përhershme shpirti, nga shkaku se ishte sëmundje e rëndë e saj (leukemia), që do ta pamundësojë të marrë kahun e duhur.

Duhet thënë se edhe pse ajo dashuri mbeti në gjysmë - Teuta u sëmur sapo u ktheva përgjithmonë në Prishtinë dhe pas një viti do t'i nënshtrohet asaj - kujtimi i saj mbushi shpirtin tim me një fuqi të jashtëzakonshme në formën e një përkushtim të përhershëm asaj. Dashuria që ndjeja për të dhe prej të cilës nuk do të ndahem kurrë edhe kur do të martohem me Drita Rracin, me të cilën do të nis një jetë të mbarë bashkëshortore, por pas pak, nga rrethanat e jashtme, edhe ajo do të përfundojë me një ndarje të përhershme. Pra, lidhja e përhershme shpirtërore me Teutën të unë do të kenë një fuqi të dyfishtë nxitëse: në kërkim të suksesit në sport dhe në përgjithësi në jetë, që ishte në përputhje me thirrjen për vullnetin për fuqi që e kisha nga fotografia e tim atë që e mbaja në valixhen time, si dhe ndaj Kosovës, që ndjenjën “*e jona*” ta ktheja “*në imja*”, *imja përgjithmonë*.

Kështu, pra “*Kosova, dashuria ime*”, paraqiste vullnetin tim për fuqi dhe vullnetin për dashuri, të ndërlidhura mes veti të ngritura në ideal, që do t'i përkushtohem gjithnjë. Vendi dhe roli i Nora Bardhit këtu ishte i jashtëzakonshëm, i pazëvendësueshëm dhe i përhershëm. Sepse, do të vinë kohë, kur pas humbjes së saj, dashuria për të do të kthehet në një ndjenjë të fuqishme për jetën, frymëzimi i së cilës do të bëjë që gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme të më ushqejë me një frymë të paparë shpirtërore, hap pas hapi t'i afrohem pikës më të lartë të suksesit, që do të duhej të kurorëzohej në Kampionatin Botëror të Boksit në Toronto me kurorën e më të mirit në botë. Sepse, titulli i kampionit të botës përmbushte idealin e arritjes në sport, por njëherësh përmbushte edhe premtimin që ia kisha dhënë Nora Bardhit se lufta ime ishte pjesë e dashurisë së përhershme për të dhe kujtimin e saj, që njëherësh lidhej edhe me dashurinë për Kosovën...

”Fitoret e mia të kushtohen ty”, i thashë ditën që fitova titullin e parë të kampionit të Kosovës dhe me të nxitova për në spital, ku ia lash pranë kupën e fituesit.

“E di se nuk do të ndalesh...E di se do të fitosh edhe shumë e shumë tituj tjerë...Kjo më bën të lumtur...Do të dëshiroja që të jem pranë teje kur ta fitosh medaljen e më të mirit në botë...”

I thashë se përherë do të ishte pranë meje, i thashë se nuk do të na ndante as koha e as hapësira, meqë ishim bashkuar me betimin e dashurisë së përhershme... Dhe kur po ia thosha këto nuk isha në gjendje të përmbaja lotët që më shpërthyen.

“Jeta ime dhe lufta ime të kushtohen ty...Titujt e fituar të kushtohen ty...”

“E di, kampioni im i të gjitha kohëve, por ato janë edhe të Kosovës, si shpërblim që na bashkoi...Pa Kosovën, dashuria jonë nuk do të ishte, më tha, duke më përkëdhelur... Kosova na bashkoi...Lufta për këtë... Kjo mund të bëhet vetëm në një luftë të madhe, në një luftë që e udhëheq fuqia e dashurisë së jashtëzakonshme...Ajo luftë nuk bën të humbet...”

Fjalët e Nora Bardhit u bënë amaneti im...Jehona e tyre përçonte shpirtin tim për ta mbushur me vullnet me fuqi edhe atëherë kur sfidohesha në mënyra të ndryshme...

Por, amaneti i saj kërcënohej të mos përmbushej çastin që kisha arritur shumë afër kurorës së më të mirit në botë, pikërisht siç kishte parashikuar ajo gjatë takimit tonë të fundit. Siç ishte fati që punonte kundër meje, kishte edhe diçka, që prej vitesh bënte çmos që t'i vinte prita rrugës sime të sukseseve, me çka kërkohet pamundësimi i përmbushjes së këtij ideali.

Në Toronto, pra, kur duhej të luftoja për titullin e më të mirit në botë, nuk ishte lufta në ring ajo që mund të më pengonte ta fitoja kurorën e artë atë që ia kisha premtuar dashurisë së Norës dhe Kosovës, por ishin prapaskenat jashtë tij, të cilat duhej ta pamundësonin këtë.

Se kjo mund të ndodhë në Toronto, këtë e kisha të qartë prej kohësh, veçmas pas triumfit në Lojërat Olimpikë të Los Anxhelosit, kur kisha fituar titullin e kampionit olimpik, titull ky që në njëfarë mënyre përmbushte idealin tim për të qenë më i miri, por që kjo gjithsesi duhej të përlligjej në Kampionatin Botëror. Medalja olimpikë kërkonte edhe atë të kampionit botëror për t'u fituar fronti i më të mirit në botë, sepse vetëm ashtu ndërlihdeshin, siç ndërlihdte te unë dashuria Norën me Kosovën. Mënyra se si do të pritet medalja olimpikë, ku në Kosovë do të kremtohet si fitore historike, ndërsa në Serbi do të përjetohet si “fitore e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptarë” si dhe fushata që do të ndezë ajo, lenin për të kuptuar se nëse rruga ime për në Toronto, përkundër shumë e shumë prapaskenave të natyrës jospportive, nuk mund të ndalohej, atëherë mbetej që ajo të mos kurorëzohej me sukses. Shtypi i Beogradit, do të tërheq vërejtjen dhe madje do të kërcënohet se “medalja e artë në Toronto do të thotë medalje për Kosovën republikë, me të cilën Jugosllavisë së Titos fillon t'i hapet varri”!

Peshën e këtij kërcënimi do ta hetoj qysh gjatë stërvitjeve të përbashkëta në Qendrën Sportive në Tashmajdan te Beogradit, kur hiq trajnerin Bruno, pjesa tjetër e shtabit teknik, që kryesohej nga serbi dr. Rashkoviç, do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që ta pamundësojnë një përgatitje të mirë teknike çfarë e kërkonte kampionati botëror, ndërkohë që kësaj do t'i shtohet trysnia e vazhdueshme psikike me anën e shkrimeve të gazetave serbe, të cilat thuajse çdo ditë sillnin “opinione” të ndryshme të cilat pjesëmarrjen time në Toronto e shihnin si “afirmim të nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar”, ndërkohë që suksesin eventual e vlerësonin “humbje për Jugosllavinë titiste”, pale se ata më së shumti e sulmonin Jugosllavinë titiste dhe përpiqeshin ta ndryshonin sipas kutit të tyre ose ta rrënonin po qe se kësaj nuk ia dalin.

Edhe pse nga trajneri Bruno më trimëronte të mos ua vë veshin atyre që më hidheshin përpara, megjithatë e gjithë ajo trysni nuk mund të përballohej aq lehtë, veçmas kur përpara kisha vetëm një shkallë, pra një hap të vetëm, por vendimtar, që të arrija përmbushjen e idealit tim.

Megjithatë, në ato rrethana tepër sfiduese, ishte fryma e Nora Bardhit dhe amaneti i saj që më bënë t'i përballoja të gjitha. Nuk do të ndalëm, thosha. Nuk do të ndalëm, Nora, dashuria ime e vetme...Nuk do të ndalëm...

Në atë dehje shpirtërore, si rëndom, ndërhynte edhe porosia e tim Atë rreth vullnetit për fuqi, që e kisha nga ai shikimi i fotografisë së tij që e mbaja në valixhen time të vjetër. Edhe ai më thoshte se lufta e fundit duhet të fitohet meqë ajo siguron fitoren e përhershme dhe kurorëzon suksesin...

Në Los Anxhelos, me anën e fiksimit të përfytyrimi i Nora Bardhit dhe shikimit të tim Atë, ia dola t'i përjashtoj të gjitha. Dhe kështu, nga dueli në duel, që i fitoja, lufta ime e madhe po i afrohej pikës vendimtare. Kur ajo do të arrinte shkallën e fundit, më bëhej se kisha arritur përballë një gjendje tallandie, në të cilën duhej të mbetesha jo që ta përballoj duelin e fundit, por pengesën që do t'i vihej luftës sime të madhe, asaj që shfaqej si betim ndaj Nora Bardhit dhe tim Atë, që në të vërtetë ishin kthyer në atë që e ndjeja si dashuri të veçantë edhe për Kosovën dhe çdo gjë tjetër që lidhej me të, qofshin ato edhe vuajtje, fatkeqësi dhe madje kobe që do t'i zbrazën nga të gjitha anët me synimin që ta zhduknin...

Në atë gjendje, si në mjegull do të shohë hijet e zeza që më rrethonin dhe më pengonin t'i afrohesha ringut...Ato hije ndërthureshin mes vete dhe krijonin një rreth të pakalueshëm prej nga nuk më lejohej të dilja...

Aty hetova të më copëtohen pjesët e trupit: kush mbante njëren dorë timen të thyer dhe fliste sikur ajo nuk ishte imja; kush çirrej me nofullat e mia të shkëputura, e kush mbante kokën time të çarë prej nga nxirrte lule të zeza me gjemba, të cilat përhapeshin në të gjitha anët dhe krijonin një pyll të pakalueshëm, ku kishte viktima të masakruara, të cilat kërkonin shpëtim...

Hetova se nga gjendja e makthit nisa të lirohem paksa vetëm pasi të jenë tërhequr hijet e zeza, të cilat prapa lanë jehonën lemëritëse të një talljeje, që përplasej në të gjitha anët... Rikthimi i pjesshëm më ballafaqoi me një kthesë të çuditshme, ku ata që më bëhej se pak më parë i kisha parë si hije, tash sikur shpalosnin keqardhjen e tyre pse nuk ishte mbajtur dueli im i fundit, pra finalja me sovjetikun, nga shkaku i lëndimit, duke theksuar se ishte shëndeti im më i rëndësishëm se të tjerat...

Ato që dëgjoja po ma kthenin hidhërimin dhe urrejtjen saqë filloja të çirresha me sa zë kisha:

“Largohuni!”

“Lufta ime e madhe nuk ka përfunduar!”

“Nora Bardhi jeton!...”

“Kosova ime nuk ka humbur!”

Thashë edhe shumëçka që lidhej me luftën time të madhe dhe të tjera që nuk i mbikëqyrja, por që kur nuk pranova të paraqitem në ceremonialin e dorëzimit të medaljeve (të artës, të argjendtës, që më takonte, dhe të bronztave), thashë se “kjo ishte një luftë kundër Kosovës si dashuri, që nuk mund të vritet, sepse ajo është pjesë shpirti...”

Mendjen e kisha të betimi dhënë Nora Bardhit se lufta ime e madhe nuk do të përfundonte kurrë ...

DASHURIA NË KOHËN E SHTETRRETHIMIT

(Bashkim Kosova flet për njohjen me Drita Rracin, gjatë kohës së terapisë në Klinikën Psikiatrike të Universitetit të Kosovë, me të cilën do të martohet pas pak si dhe për ndihmën e saj, jeta e tij të arrijë atë kthesën e madhe, të cilën do ta quajë dhe do ta përjetojë si dashuri për jetën pikërisht pse do të jetë me sprovë të rënda, të ngjashme me atë duelin e fundit, që ndonëse nuk do ta fitojë, pse nuk do t'i lejohet të luftojë, megjithatë nuk do të ndahet si humbës...)

Fluturimin nga Toronto deri në Beograd e përjetova si një endje nëpër mjegull brenda një hapësire të ngjashme me një skenë të madhe, ku një perde lëvizte herë djathtas, herë majtas, herë lartë e herë poshtë dhe në atë lëvizje e sipër ndryshonin edhe gjendjet e mija ku ndjehesha herë perandor, herë i vrrarë, e herë vrasës, e herë qenie e papërcaktuar që herë dukej e herë nuk dukej dhe çmos...

Sidoqoftë, në atë zhvendosje me shumë e shumë shpërftyryrime, nga rrënimi i ndryshimeve që nuk mund t'i mbikëqyrja përpiqesha të mbrohesha me përftyryrimin e tim Atë, të cilin me mund të madh dhe jo gjithherë mundohesha ta riprodhoja nga fotografia e vetme që mbaja në valixhe në të cilën ai rrinte para aeroplanit Mig-49. Mbrojtjen përpiqesha ta bëja edhe me ato mbetjet e shikimit të Nora Bardhi nga çastet e takimit tonë të parë, kur ishim në kinemanë e Vushtrrisë dhe pastaj ajo më fliste për filmin e Felinit "Shkretëtira e Kuqe", ku gjejnë prehje ata që bëhen pjesë e *dikundjes* brenda *askundjes*...

Me zhvendosjen nga njëra skenë te tjetra, pra kur ndryshonin rolet dhe ndjehesha herë perandor, herë vrasës ose i vrrarë, herë dikush si askush dhe ndryshe-ndryshe, në këto gjendje ndodhte të ndryshonte edhe qëndrimi im ndaj tim Atë dhe ndaj Nora Bardhit, gjë që gjatë mesokohës nga kalimi në kalim kur për pak ndjehesha jashtë roleve nëpër të cilat futesha dhunshëm, kjo zuri të më trishtonte pa masë dhe të dyshoj mos vallë kisha shkalluar?...

Në të vërtetë, pasi të merr fund fluturimi dhe nga aeroporti me autoambulancë më dërguan në Klinikën Psikiatrike të Akademisë Ushtarake të Beogradit, ku mbeta edhe dy ditë të tjera, mjekët specialistë te unë hetuan simptomat e një thyerje të rëndë psikike që mund ta kisha nga stresi i madh me të cilin isha përballuar gjatë kohës sa kishte zgjatur kampionati botëror i boksit në Toronto, që kishte kulmuar në prag të duelit final. Klinika Psikiatrike e Akademisë Ushtarake të Beogradit doli në opinion me vlerësimin se më pak ishte lëndimi i krahut e më shumë gjendja ime psikike që kishin penguar paraqitjen time në finale. Dr. Antonijeviq kishte deklaruar se çrregullimi im psikik, që ishte akut, mund të kthehej në kronik, po qe se nuk do të pushoja për një kohë, me largimin jo vetëm nga sporti, por edhe nga shfaqjet në opinion dhe takimet tjera, meqë ngarkesat me të cilat isha ballafaquar kohëve të fundit kishin rrënuar rëndë gjendjen time psikike, e cila ndodhej buzë shpërthimit...

Para se të largohesha nga spitali, gjatë bisedës që kisha me doktor Antonijeviqin, ai u mundura të m'i shpjegojë që të gjitha ato që kishin prodhuar atë që ai e quante thyerje të rëndë psikike në mënyrë që të më përgatiste, si tha "për një betejë tjetër të brendshme me vetveten", për një "si shkëputje të domosdoshme nga diçka mbi të cilën kisha ndërtuar një si tempull të paarritshëm", që sipas tij nuk do të ishte e lehtë, meqë nga brenda lidhte shumë faktorë kundërthënës të natyrave të ndryshme, që kishin sjellë deri te ajo gjendje.

Dr. Antonijeviq, ishte mjaft i përzemërt, dhe krahasuar me mjekun e shtabit teknik të reprezentacionit të Jugosllavisë dr. Rashkoviq, me të cilin kisha pasur punë kohëve të fundit kur ai kishte marrë vendime pa më pyetur fare, siç ishte dorëzimi i duelit final me boksierin sovjetik - vendim ky që ma kishte forcuar bindjen se ishte pjesë e komplotit me të cilin duhej të më pamundësohej titulli i kampionit të më të mirit në botë – ai ma bëri me dije se nga të kuptuarit e drejtë të këtij problemi dhe sjellja ime e mëtutjeshme ndaj gjithë çështjes varej jo vetëm karriera sportive, por edhe normaliteti i jetës sime...

“Keni qenë i ngarkuar së tepërmi. Fizikisht keni qenë në gjendje me u ba ballë të gjitha sfidave, por shpirtërisht jo. Kjo shpërputhje ka arritur kulmin kur po i afroheshit pikës më të lartë në mendjen tuaj të projektuar si ideal, por kanë qenë emocionet e struktura dhe shqetësimet tjera ato që kanë vërshuar dhe kanë krijuar atë shpërthimin vërshues. Lëndimi i krahut ka qenë shenjë e parë që ka alarmuar se ju po i nënshtroheni kësaj gjendjeje...”

Mendja ma thoshte se kishte diçka nga ato që m’i kishte thënë dr. Antonijeviqi, pra që isha i ngarkuar së tepërmi psikikisht - meqë fjala ishte për arritjen e asaj maje, e cila paraqiste betim ndaj tim Atë sa herë përballohesha me fotografinë e tij ku ndeshja shikimin e përhumbur që më bëhej se më fliste për vullnetin për fuqi, dhe po ashtu betimi shfaqej edhe ndaj Nora Bardhit dhe asaj dashurie të veçantë për të nga e cila nuk do të ndahem kurrë, i dhënë çastet kur po ikte dhe prapa po e lente frymën e lidhjes sonë të përhershme shpirtërore të më mbante.

Por, në vlerësimin e psikiatrit të njohur rreth ngarkesave psikike, me të cilat isha rënduar së tepërmi dhe ato kishin luajtur rol të madh në gjithë atë zhvillim shpërthyes, kishte edhe diçka tjetër, që lidhej me mbrojtjen që ai dëshironte të ma bënte nga politika ditore dhe fushata e shtypit të Beogradit rreth atyre që i kisha deklaruar reporterit të BBC-së se ishin forca të caktuara në Jugosllavi të cilat nuk dëshironin dhe nuk do të lejonin që Bashkim Kosova ta fitojë titullin e kampionit botëror nga shkakun se kjo trimëronte “nacionalistët dhe separatistët shqiptarë”, të cilët me kërkesat e tyre për barazi thuhej se “kërkonin shkatërrimin e Jugosllavisë”, qëndrim ky të cilin e kisha quajtur “komplot të organizuar, që shkonte edhe në dëm të prestigjit shtetëror të vendit”.

Siç do të shihet pas pak, vlerësimi i dr. Antonijeviqit rreth gjendjes sime të çrregulluar psikike, do të bëjë jehonë në pjesët tjera të vendit (Kroaci, Slloveni, Vojvodinë dhe pjesërisht në Bosnje dhe Hercegovinë), që deklarata ime BBC-së të mos trajtohej si “komplot kundër shtetit”, siç kërkonte shtypi i Beogradit, Lidhja Socialiste e Serbisë dhe Lidhja e Boksit të Serbisë, që për pasojë do të kishte ndjekjen time penale. Kjo deklaratë dhe alibia e mbrojtjes nga inskenimet politike, megjithatë nuk do të pengojë Beogradin që, së paku në planin sportiv të arrijnë atë që përherë e kërkonin përfaqësuesit e saj, të ndikojë që ndaj meje të hapej procedura disiplinore, me çka do të pasojë suspendimi im i përkohshëm, me të cilën masë, në të vërtetë, njëherë e përgjithmonë, do të përfundojë karriera ime sportive në njërën anë me hipotekën e “frymëzuesit të nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar” dhe në tjetrën anë “të përfaqësuesit më të denjë të vullnetit të shqiptarëve për të luftuar për prosperitet shoqëror dhe barazi politike edhe në rrethanat kur nga Beogradi pengoheshin me të gjitha mjetet”.

Nuk dua të ndalem te ato zhvillime të cilat do të rrjedhin në Prishtinë dhe Beograd dhe kryekreje morën kah politik: në Prishtinë do të ketë demonstrata të mëdha, së pari pro suksesit tim të jashtëzakonshëm, veçmas pse ai kundërshtar kishte pasur Beogradin, dhe

pastaj kundër suspendimit tim, të cilat do të kthehen në demonstrime politike, ndërsa në Beograd për herë të parë serbët e Kosovës do të mbajnë një “marsh protestues kundër egërsimit të veprimtarisë armiqësore të shqiptarëve, që ua rrezikonte ekzistencën si komb dhe si njerëz”. Por, duhet thënë se te kjo një megjithatë përfundonte ëndrra ime për titullin e më të mirit në botë, ndërkohë që fillonte lufta ime e brendshme, të cilën duhej ta fitoja në mënyrë që të bëhesha vetvetja ime, ai që do të ishte në gjendje që vullnetin për fuqi ta kthente në vullnet për jetën e dinjitetshme pa marrë parasysh si dhe sa lejonin rrethanat nëpër të cilat kalohej.

Dhe, rrethanat nëpër të cilat kalohej për mua ishin më të rënda se rëndom, ngaqë nisja ime fillonte nga gjendja e një traume shpirtërore, përballimi i së cilës shfaqej si parakusht për ecjen e mëtutjeshme, ndërkohë që realitetet shoqërore shfaqeshin të traumatizuara skajshmërisht nga zhvillimet në të cilat ishte përfshirë vendi prej vitesh (veçmas ato nga vdekja e Titos e tutje kur do të dalin në pah përpjekjet e Serbisë për ta mbikëqyrur federatën jugosllave), të cilat për cak të parë do ta kenë Kosovën dhe përpjekjet e saj që të lirohej nga tutela e mbikëqyrjes serbe, çështje këto që si do të shihet do t’u hapin udhë krizave të ardhshme të përmasave të rrezikshme.

I ndodhur midis sfidës së faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm, lufta ime për jetën për pikënisje kishte kohën e terapisë psikike në Klinikën e Psikiatrisë së Universitetit të Kosovës në Prishtinë, ku do të shtrohem pasi të lirohem nga Spitali i Akademisë Ushtarake të Beogradit, me rekomandimin e doktor Antonijeviqit, që terapia të zgjasë më së paku gjashtë javë.

Në të vërtetë, në Klinikën e Psikiatrisë së Universiteti të Prishtinës do të ndjehem paksa më i qetë se në Beograd, meqë ajo drejtohej nga miku im, doktor Afrim Bega, afërsia e të cilit ishte e një rëndësie të veçantë, që t’i kthehesha jetës jashtë famës dhe sfidës së luftës për suksesin e domosdoshëm.

“Për dhjetë vjet mendja jote ka ushqyer trupin tënd për t’u bërë kampion. Tash radhën e ka dëshmimi i fuqisë shpirtërore për t’u kthyer në jetë. Sepse, titujt e jetës janë më të rëndësishmit, ngaqë aty përcaktohet fituesi ose humbësi i përhershëm...”

Shtoi se nuk e kisha të lehtë këtë kapërcimi, i cili ishte i domosdoshëm, por shprehu bindjen se më kohë vullneti im për fuqi do të kthehej në vullnet për jetë.

“Për vite të tëra ke qenë i përqendruar tek arritja në ring ku, në fund, fituesin e ka përcaktuar fuqia. Tash e tutje jeta është hapësirë e ringut, ku lufta që të përballohen disfatat është e vazhdueshme...Ia del vetëm ai që nuk dorëzohet...”

Doktor Afrim Bega, me të cilin njiheshim qysh nga bankat e gjimnazit të Prishtinës, që dinte edhe historinë e dashurisë sime me Nora Bardhin dhe e kishte të qartë se çfarë kishte qenë edhe roli i asaj ndjenje në karrierën time sportive, fillimisht do të mundohet që të më lirojë nga mbërthimi i saj, jo që të mbetem jashtë emocionit, por që atë ta kthej në një shtysë për jetën.

“Nëse deri më dje në çdo fitore tënden ke parë njëfarë shpagimi ndaj premtimi të bërë ndaj dashurisë së Nora Bardhit, tash e tutje çdo hap të kthimit kah normaliteti duhet parë si pjesë e dashurisë ndaj jetës. Kështu, një ideal dashurie, kthehet në ideal jetësor, pa të cilin nuk mund të bëhet gjë.”

Fillimisht ishte e vështirë për mua ato që i thoshte doktor Afrim Bega t’i lidhja me realitetin nga shkaku i vetëm se për dhjetë vjet isha mësuar me atë fiksim, i cili kishte vepruar

në rrethanat e luftës për sukses dhe të ngarendjes për atë që e shihja si majë, por jashtë saj, kishte rrezik që të më kthehej në peng të dështimit, në një tëhujësim jetësor.

Megjithatë, në gjithë këtë zhvillim, thuajse befas, do të shfaqet një person tjetër, vendimtar “për të zbritur në tokë”, siç thoshte doktor Afrim Bega, në mënyrë që prej andej me anën e një lidhjeje të pandashme midis nesh, që do të kthehet në bashkim të përhershëm, “të filloja luftën për jetën”, me shumë e shumë beteja dhe me lloj-lloj sfidash që nuk kishin fund.

Fjala është për Drita Rracin, e cila që nga çasti i parë i njohjes ma bëri me dije se ishte pranë meje të më ndihmonte, si tha, ta merrja veten, por që në të vërtetë, ajo “marrje e vetes” do të kthehet në “dorëzim të vetes” te ajo, siç kishte ndodhur para shumë vitesh kur isha takuar me Nora Bardhin në kinemanë e qytetit të Vushtrisë dhe, në saje të një ndijimi të veçantë dhe shpërthyes, ajo kishte pushtuar gjithë qenien time.

Por, ndjenja e dorëzimit para Drita Rracit, nuk kishte qenë nënshtruese siç pandehja e as pa ndjenja siç e merrja. Përkundrazi, ajo kishte qenë nxitëse, deri në atë masë sa që vullnetin tim të brendshëm, që deri më atëherë ishte pasqyruar drejt ngritjes dhe sukseseve e kishte kthyer në vullnet për përballim me jetën dhe gjithë ato që sjell ajo, e cila ishte e pamundur pa një motivim të tillë.

Këtu, megjithatë, kishte një dallim të madh midis dy gjendjeve. Sepse, në rastin e parë, dashuria për Nora Bardhin, veçmas pas vdekjes së saj të hershme, ishte kthyer në diçka të përhershme, e cila pos që nuk mund të zëvendësohej e as të kërkohet gjetiu qoftë si ngushëllim, ishte kthyer në një engjëll mbrojtës, të cilit i detyroheshin që të gjitha të arriturat e mia. Ndërsa në rastin e dytë, lidhja me Drita Rracin baraspeshohej me jetën dhe të kuptuarit e saj të drejtë, ku ajo nuk shfaqej si ideal, por si pjesë e domosdoshme e asaj që lidh qeniet njerëzore dhe i bashkon fort drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët, siç është familja si bërthamë e domosdoshme e njeriut si qenie shoqërore.

“Të shëruar merren ata që vinë vetëm dhe dalin me dike...”

Pra, ajo po ma bënte me dije se gjendje ime ishte e tillë nga shkak i vetmisë, të cilën edhe më të rëndë e kishte bërë trysnia e vazhdueshme e opinionit për suksesin. Andaj, ishte e ashtuquajtura terapi shoqërore, e cila mund ta ndryshonte gjendjen time me kusht që të pranoheshin rregullat e saj.

Por, për çfarë rregullash ishte fjala?

Mos do të thoshte se duhej të hiqja dorë nga idealet më të larta, të cilat deri më atëherë, së paku sa i përket arritjes së sukseseve, që ia kisha përcaktuar vetes si qëllim dhe ato lidheshin me betimin ndaj dashurisë së Nora Bardhit, jetës sime i kishin dhënë kuptim të veçantë?

Mos do të thoshte se ajo “dalja me dike” nënkuptonte praninë e domosdoshme të dikujt për të qenë i gatshëm për t’u ballafaquar me humbjet e betejave, të cilat ishin pjesë e jetës, por prania e dikujt i bënte më të durueshme dhe të natyrshme madje?...

Hamendjet e mia mund të ishin pa fund dhe do të më fushnin në ndonjë rrugë qorre, po mos të ishte Drita Rraci, e cila ma bëri të ditur se aty ishte që bashkërisht të ushtronim të mësuarit e kapërcimit të vetmisë.

“Të jesh bashkë me dike nuk do të thotë që të mos jesh i vetmuar. Përkundrazi, prania e dikujt pa një lidhje të brendshme është më e keqe se vetmia...”

Pra, nga unë kërkohej që Drita Rracin ta pranoja si bashkëbiseduese ose të ngjashme, e cila kishte për detyrë që gjendjes sime t'ia ndryshonte kuptimin.

Por, çfarë do të thoshte bashkëbisedim?

Nënkuptonte kjo një hapje shpirtërore “për tjetrin” në mënyrë që ashtu të përjashtohet “i vetmuari”? Apo, fjala mund të ishte për diçka tjetër, që unë nuk isha në gjendje ta sheshoja ngaqë deri më atëherë më kishte udhëhequr vetëm vullneti për sukses, që përjashtonte të tjerat dhe kishte kufirin e vet?...

Sikur t'i kuptonte fare mirë hamendjet e mia dhe ato t'i merrte edhe të natyrshme për rrethanat kur ato shfaqen, Drita Rraci do t'u shmanget përgjigjeve me anën e sqarimeve me fjalë, për t'iu kthyer një veprimi jashtë tyre, që si do të shihet, pati ndikim të jashtëzakonshëm, që jeta ime të marrë një kthesë të re, prej nga ndonëse nuk do të dal fitues, megjithatë nuk do të përfundoj si humbës i përhershëm...

Kështu, po atë ditë, kur në mendje edhe më tutje po më silleshin fjalët e saj rreth daljes nga ajo gjendje “me dike”, më kapi për dore dhe ashtu më nxori në pjesën e jashtme të spitalit, ku gjendej parku që shkonte kah kodrina përballë.

“Nuk do të dëshiroja të kthehem ndaras...”

Dhe ishte ajo një ditë shtatori me diell të shndritshëm, por të butë, rrezet e të cilit tashmë vinin pjerrtas nga ana e perëndimit dhe po m'i miklonin sytë me pamjet e shumta, të pavërejtura deri më atëherë, të cilat bënë që sa ora të fitoj përshtypjen e lirimit nga një mbërthim i brendshëm, i cili më kishte mbajtur të ndryrë, sikur të mos kishte tjetër...

Por, ai përjetim i veçantë i natyrës, nuk do të ishte i tillë dhe mbase do të përfundonte shpejt, po mos të ishte prania e Drita Rracit, që më kishte zënë krahun dhe po më shoqëronte heshtas drejt një të panjohure, dhe se në atë lëvizje e sipër, po hetoja përmbushjen me diçka, që mbase mund të ishte pjesë e asaj të përbashkëtës, rreth të cilës ajo më kishte folur kur ma kishte bërë me dije se daljes nga ajo gjendje i duhej “dikush”.

Pasi ecëm një copë herë dhe prapa nesh kishin mbetur pamjet e spitalit, gjithnjë i udhëhequr prej saj, u ndalem te një ulëse e drunjtë. Rrezet e diellit tashmë kishin kaluar në pjesën tjetër të kodrinës dhe ne, nga ai vend, po shihnim një hapësirë të përparë nga një dritë në lëvizje, e cila sa vinte dhe bëhej më e butë. Duke ndjekur atë lojë të natyrës me ngjyrat, hetova dorën e Drita Rracit, që po i afrohej sime me shumë kujdes, sikur të kërkonte leje për diçka që do të ndodhte midis nesh, papritmas, ashtu dhe në atë mënyrë. Dikur, dora e saj kapi timen dhe po e mbante fort. Një copë herë ndjeva shtrëngimin e saj, ndaj të cilit nuk kisha përgjigje, jo pse këtë nuk e dëshiroja, po pse nuk isha në gjendje ta përcaktoja nga shkaku i vetëm se diç të asaj ndjenje kisha përjetuar para katërmëdhjetë vjetësh në kinemanë e qytetit në Vushtrri kur dora ime për pak, hamendshëm, kishte prekur atë të Nora Bardhit, së cilës, po ashtu për pak, i ishte përgjigjur edhe ajo dhe me këtë kishte filluar lidhja e jashtëzakonshme shpirtërore midis nesh, të cilën nuk kishte qenë në gjendje ta shuajë as vdekja e saj e hershme, një vit pasi do të kthehem përgjithmonë në Prishtinë, as koha dhe asgjë tjetër...

Edhe pse prekja dhe mbajtja e dorësi sime nga Drita Rraci do të vazhdojë gjatë gjithë kohës sa do të rrimë ashtu ulur, dhe ato çaste kjo do të ma krijojë përshtypjen se e gjitha mund të ishte pjesë e terapisë, megjithatë dikur do t'i përgjigjem asaj, së pari duke e shtrënguar dhe, pas pak, i bartur nga një shtytje e çuditshme jashtë mbikëqyrjes, t'i afrohem dhe ta shtrëngoj fort, sikur të njiheshim moti...

Ishte ky një veprim çasti ndër më të paparashikuarit, një përzierje midis frikës dhe ngushëllimit, ndaj të cilit Drita Rraci, fillimisht nuk kishte reaguar fare pse mund ta kishte pritur, ose pse kishte qenë jashtë asaj që ajo e kishte parashikuar?

Sidoqoftë, në atë shtrëngim çasti, Drita Rraci mund t'i kishte hetuar shenjat e afrisë sonë, por as asaj nuk ia kishte marrë mendja se ajo do të jetë aq e shpejtë dhe aq e papërmbajtshme, për t'u kthyer në një lidhje të përhershme jetësore, në bashkim tonë, siç do të ndodhë në të vërtetë, pa marrë parasysh ato që pas pak do t'u hynë në mes dhe do ta kthejnë në një vuajtje të dyanshme, ndër më të veçantat, që mund ta prodhojnë vetëm rrethanat e tilla po ashtu ndër më të veçantat, nëpër të cilat kalohej dhe ato përcaktonin kahun e lundrimit të varkës sonë jashtë dëshirës sonë...

Sikur ta kisha parandjerë këtë zhvillim, që pak më vonë lundrimit të varkës sonë do t'i japë kahun jashtë dëshirës sonë, kur u ngritëm dhe morëm drejtimin prej nga kishim ardhur, thashë se “nuk më pëlqente udhëtimi vetëm”, dhe se “kisha frikë nga vetmia që mund ta kisha fat...”

Më shikoi e heshtur sikur të ma bënte me dije se kishte të njëjtën frikë. Meqë rrezet e diellit kaheër kishin ikur, hija nuk më lejoi që në fytyrë t'ia lexoja shprehjen e qëndrimit prej drejtuesit tim, që e kishte kur më nxori jashtë dhe më zuri për krahu. Përkundrazi, kisha përshtypjen se sjelljet e mia mund të kishin shkuar tutje parashikimeve. Madje, edhe ajo që ia kisha thënë se “nuk më pëlqente udhëtimi vetëm” nga shkakun se “kisha frikë nga vetmia që e kisha fat”, iu kishte dukur e panatyrshme dhe mund t'i kishte krijuar frikë se midis nesh kishte ndodhur diç që shkonte në një drejtim të kundërt?

Dhe, këto hamendje, bënë që të mos heqja dorë nga dorëzimi asaj, pale se ajo mund ta kishte kuptuar “si mbrojtje nga frika e vetmisë”, që i kisha thënë “se e kisha fat...” E zura për krahu dhe fillova të varem për të, sikur të kërkoja të më mbronte nga ecja nëpër mugëtirë dhe të parashikuarat.

Duke parë këtë varësi dhe nga përshtypja se pas gjithë asaj që kishte ndodhur kisha nevojë për njëfarë mbrojtjeje, tha se mbeteshim bashkë. Foli sikur të më merrte në mbrojtje dhe kjo nuk më pëlqeu, edhe pse nuk isha në gjendje ta sqaroja ndjenjën e pakënaqësisë.

Prapë i thashë se nuk më pëlqente udhëtimi vetëm dhe ajo prapë ma ktheu se do të ktheheshim bashkë, gjë që fitova përshtypjen se e gjitha ishte kthyer në një moskuptim, që për pasojë mund të kishte mbylljen time të përhershme. Madje, për ta parandaluar këtë, isha në gjendje që t'i kërkoja falje për veprimet e mia të pamatura, në mënyrë që të mbeteshim te ajo gjendja e fillimit. Por, ndodhi që sapo hymë brenda dhe drita e neonit na ra para, ajo ma kapi dorën dhe më tha se ishte e kënaqur pse kishim kaluar çaste mirëkuptimi, të cilat janë të domosdoshme për hapat e mëtutjeshëm.

Por, hapat e mëtutjeshëm, për të cilat foli ajo, nuk ndryshuan diç nga ata të shëtisë sonë të parë nëpër lulishten e spitalit në drejtim të kodrinës përballë kur ajo më zuri për dore dhe unë pastaj ia ktheva me marrjen ngryk dhe mbështetjen e trupit tim për të, sikur të kërkonte që ta merrte në mbrojtje.

Të kapur dorë për dore dhe të shumtën të heshtur mbeteshim jo vetëm gjatë shëtisë nëpër lulishten e spitalit dhe pjesën e parkut që shpinte në drejtim të kodrinës, por edhe në dhomën e spitalit, gjë që, për mua, e gjitha merrte përmasat e një lidhjeje së cilës kuptimin ia përcaktonte prania e njëri-tjetri, mundja e frikës së vetmisë dhe jo ato që ndodhnin midis nesh.

Se ishte kështu këtë do ta tregojë mungesa e saj disa ditësh (mund të ishte edhe e qëllimshme) kur zura të ndjehem keq dhe në atë përkeqësim të hetoja shenjat e një frike nga ndjekja e vetmisë, që nuk e kisha hetuar deri më atëherë. Por, doktor Afrim Bega më tha se te unë po ndodhte një ndryshim i dobishëm, që tregonte shenjat e para te kapërcimit të krizës.

Kjo më habiti. Desha t'i thosha se po i jepesha një shqetësimi të pashpjegueshëm nga brenda pse pikërisht po më mungonte prania e Drita Rracit. Këtë nuk e bëra nga druajtja se mund të merrja një përgjigje asi soji ku do të më bëhej me dije se ajo ishte përjashtuar nga terapia nga shkaku i atij zhvillimi midis nesh, meqë ishin tejkuluar raportet e lejuara pacient-terapeist për t'u kthyer në një lidhjeje të palejueshme dhe të ngjashme.

“E rëndësishme është se po heton se po të mungon diçka...”

Desha t'i thosha se kishte të drejtë, se ajo që po më mungonte ishte prania e Drita Rracit, e cila mund të ishte larguar me fajin tim, pse iu kisha afruar dhe e kisha marrë ngryk kur ma kishte kapur dorën dhe të ngjashme, por hoqa dorë nga frika se ashtu mund të gaboja edhe më shumë dhe gjërat do të përkeqësoheshin në dëm timin.

Doktor Afrim Bega, në vend se të priste t'i sqarohesha dhe, sikur t'i kishte lexuar përposhjet e mia nga brenda, më tha se meqë ishim miq, mund të flisja çfarë të doja dhe se kjo ishte në të mirë timen.

Por, për çfarë do të flisja? T'i thosha ndonjë gjë rreth ndjenjës se më mungonte diçka e pashpjegueshme deri në atë masë sa ndjehesha i zbrazur fare nga qenia ime, apo t'ia pranoja se shqetësimin e kisha nga mosprania e dikujt, që mund të rrudhej vetëm te prania e Drita Rracit, që një ditë, si e tillë, mund të kthehej në monotoni?

Ndonëse ndjenja se më mungonte diçka nuk ishte e njëjtë me atë të mospranisë së dikujt, megjithatë ato sikur ndërlidheshin dhe te unë diçka po vepronte jashtë mbikëqyrjes sime, se në mua po lëvizte diçka për t'u liruar nga pika e ngrirjes në të cilën gjendesha, kishte bërë që doktor Afrim Bega të shihte një zhvillim të mirë.

“Duhet të shprehësh rreth asaj që po heton se të mungon, sepse vetëm ashtu do të fillosh të ndërlidhësh me vetveten, pra me atë që ndjenë dhe të duhet...”

Prapë më shikoi miqësisht, duke kërkuar nga unë që sado pak të hapesha, dhe mbase kjo edhe do të ndodhte, që të them diçka rreth Drita Rracit dhe atyre që kishin ndodhur mes nesh në bankën e lulishtes së parkut kur më kishte zënë për dore dhe unë pastaj e kisha shtrënguar dhe ashtu kishim mbetur një copë herë, po mos të hetoja se të menduarit për to befash po ma largonte përfytyrimin e saj, saqë ndodhte se kjo vinte nga shkaku se isha marrë me të njëanshëm ose pa të drejtë në mënyrë që pas pak të fitoj përshtypjen se ato as që kishin ndodhur por ishin pjesë e ndonjë sajese që si përfitim kishte kaluar nëpër kokën time dhe të ngjashme...

Dhe, kur m'u lidh të menduarit se e gjitha as që kishte ndodhur dhe madje edhe Drita Rraci mund të kishte qenë pjesë e ngatërimit me të cilin po përballesha, pra ku po fitoja përshtypjen se ishin halucinacionet ato që edhe më tutje më mbikëqyrnin dhe këtë disi do të duhej ta thosha pa hezitim në mënyrë që doktor Afrim Bega ta shihte gjendjen time ashtu si ishte, çuditërisht hetova praninë e Drita Rracit. Se si u shfaq ajo midis meje dhe doktor Afrim Begës, këtë nuk e kisha të qartë, por me atë që tha se nuk më linte vetëm, e që m'u duk se u përcollën edhe me pandehmën se ishim bashkë, la për të kuptuar se nuk ishte pjesë e ndonjë sajese të kokës sime. Për të qenë edhe më bindëse, m'u afrua dhe më zuri për krahu njësoj si herën e parë kur më kishte nxjerrë jashtë dhe, nëpër lulishten e spitalit ishim drejtuar në

pjesën e parkut në drejtim të kodrinës përballë, kur na kishin shoqëruar ato rrezet e ndritshme të atij dielli të butë, i cili po shkonte kah perëndimi por që në atë rënie e sipër hapësirës i jepnin një ngjyrim joshës.

“Do të vazhdojmë aty ku kemi mbetur”, tha dhe pa marrë leje nga doktor Afrim Bega, i cili nuk bëri fare, sikur ta priste atë zhvillim, me drejtoi nga dera e jashtme.

“Tash do ta kemi përballë diellin e paradites me rrezet e shndritshme dhe të forta. Apo jo?”

Desha t’i thosha se kishim mbetur kur dielli kishte perënduar dhe pastaj hija gjithë hapësirës i kishte dhënë një qetësi të frikshme; dhe desha t’i thosha se pastaj një dritë e brendshme gjërave u kishte shpërndarë një ndriçim të veçantë dhe të ngjashme, gjë që te unë kishte vu në lëvizje diçka, por ishte dora e saj që më zuri për krahu dhe po më drejtonte jashtë dhe unë po i nënshtroheshja me një përlulesi të paparë, të cilën nuk isha në gjendje ta shpjegoja se a ishte pjesë e kënaqësisë që ajo ishte shfaqur apo pse ato që pak më parë m’u duken si halucinacione, nuk ishin të tilla? Sidoqoftë, ishte një gjendje ku nuk mund të bëja dallimin midis mungesës dhe pranisë së dikujt, që për çastin nuk kishte rëndësi fare, meqë në mua po vlonte diçka e brendshme, që për herë të parë po më cyste t’i ndërlihd kapërcimet midis asaj nëpër të cilën kisha kaluar, të tashmes shurdhe dhe të ardhmes së megjulluar, dhe se ky zhvillim mund të ecte si duhet vetëm me praninë e Drita Rracit. Madje, fiksimi i Drita Rracit në të, nuk e dija se a ishte çështje e çastit dhe fiton domethënie të jashtëzakonshme pikërisht pse i duhet asaj lëvizjeje, apo pse ajo mund të ishte pjesë e të parapërcaktuarës së domosdoshme dhe të pashmangshmes, që shfaqet në kohë dhe rrethana të duhura që të marrë përsipër ndodhjen e diçkaje, si me rastin e shfaqjes së Nora Bardhit, që vullnetit tim do t’ia japë shtysën më të fuqishme për të luftuar për një qëllim të caktuar dhe çështje është se pa të a do të merrte at kah?...

Meqë hapësira e të menduarit tim edhe më tutje shfaqej e ngushtuar dhe e çrregulluar, ndërsa mundësitë për ta tejkaluar atë gjendje nuk vareshin prej meje, por prej atyre jashtë meje, të cilave duhej t’u nënshtroheshja, nuk kisha kurrfarë arsyeje që shfaqjen e Drita Rracit të mos e merrja pjesë të së parapërcaktuarës, ku ajo duhej të vinte në veprim vullnetin tim për jetë në mënyrë që gjërat t’i pranoja ashtu si ishin dhe në përputhje me pushtetin e tyre të sillesha.

Por, si do të shihet pas pak dhe do të dëshmohet më vonë, përshtypja se Drita Rraci ishte e parapërcaktuar ta merrte përsipër drejtimin nëpër të cilin duhej të shkoja dhe, pse të mos i jepeshja asaj, nuk ishte si thuhet, rrugë një kahesh, por me dy kahe, ku varësia ishte e ndërsjellë, madje me role të njëjta dhe peshë të barabartë të marre-dhënieve tona në krejt atë që do të shfaqet si betejë e përbashkët për jetën, sado që fillimisht për këtë nuk isha i vetëdijshëm.

Në të vërtetë, Drita Rraci, nuk ishte terapeute, siç pandeha në fillim, por një paciente si unë, që si do të kuptohet, kishte kaluar nëpër të njëjtën gjendje kur humbja e një dashurie nga më të veçantat, të cilat shfaqen një herë në jetë dhe të kthejnë në peng të saj, siç kishte qenë edhe për mua ajo për Nora Bardhin, edhe te ajo kishte pasur të njëjtin rol, me të vetmin ndryshim se dashuria ime ishte qëlluar nga sëmundja dhe humbja e saj do të frymëzojë vullnetin tim për suksese drejt arritjes së majave botërore, ndërsa dashuria e saj, ishte qëlluar nga dhuna shtetërore e Beogradit, kur ajo do t’i vritet, por që fryma e saj do ta kthejë në një militante të Kosovës republikë, nga bindja se ashtu mbante të gjallë kujtimin dhe kuptimin e

asaj dashurie, e cila kishte filluar dhe ishte ndërtuar mbi betimin se nuk mund të kishte dashuri pa Kosovën dhe, po ashtu, nuk mund të kishte Kosovë pa dashuri.

Fjala, pra ishte për Valon Drinin, djaloshin e ëndrrave të saj, që e njihte qysh nga vitet e shkollës së mesme në Gjinnazin e Prizrenit dhe pastaj ishin regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Kosovës në vitin 1980, por që bashkërisht ishin përfshirë në demonstratat e studentëve që shpërthyen më 11 mars të vitit 1981 dhe do të vazhdojnë edhe me 4 dhe 5 prill, kur ai më 5 prill, duke dëshiruar që ta kalonte kordonin policor që kishte rrethuar Qendrën e Studentëve për t'u takuar me Drita Rracin, e cila ndodhej në pjesën e Ulpianës me shumë e shumë demonstrues të tjerë, ishte plagosur nga njësitë e forcave speciale të policisë federative dhe sapo kishte arritur në Qendrën Emergjente të Klinikës së Universitetit të Kosovës në Prishtinë kishte vdekur. Njëri nga mjekët e kësaj Qendre, i cili kishte marrë pjesë në pranimin e tij dhe pastaj në obduksion, kishte parë se Valon Drini 21 vjeçar ishte qëlluar nga prapa dhe nga afërsia me një plumb dum-dum (të ndaluar për përdorim), që ia kishte çarë kraharorin. Me anën e lidhjeve që mbaheshin nga ata pak mjekë shqiptarë që punonin në Qendrën Emergjente (pjesa më e madhe e tyre ishin larguar, meqë ato ditë, ishin zëvendësuar me ato të ardhura nga Akademia Ushtarake e Beogradi), Drita Rraci po atë mbrëmje kuptoi për vrasjen tragjike të Valon Drinit, dashuria e të cilëve kishte qenë e veçantë pse lidhja dhe forcimi i saj kishte përkuar me atë që tashmë për gjeneratën e re dashuria për Kosovën shfaqej si një patriotizëm shpirtëror i një natyre të veçantë, që ua kishte përcaktuar fatin që të gjitha dashurive, përmbushja e të cilave shihej e lidhur ngushtë me arritjen e Kosovës Republikë.

“Kosova republikë është dashuria jonë e përhershme”.

“Të luftosh për republikën e Kosovës do të thotë të luftosh për dashurinë e dashurisë...”

“Kosova dashuri”.

“Kosova jonë”.

“Kosova...”

“Dashuria....”

“Dashuria Kosovë...”

Në të vërtetë Valon Drini kishte dhënë jetën për republikën e Kosovës, si edhe shumë të rinj të tjerë që ato ditë e edhe më vonë, kishin demonstruar me atë kërkesë, të cilën e kishin shprehur me guxim dhe fanatizëm të jashtëzakonshëm. Drita Rraci kishte marrë vesh se në çastet e fundit, Valon Drini kishte nxjerrë fjalët:

“Drita ime, Kosova ime, dashuria jonë e amshueshme...”

Por, edhe pa këto fjalë, që asaj i kishin mbetur si amanet i shenjtë, Drita Rraci e kishte pasur të qartë se ishte dashuria për Kosovën ajo që e kishte lidhur me Valon Drinin, që kishte mbetur e përhershme dhe pjesë e idealit, për të cilin duhej luftuar deri në fund, sepse vetëm ashtu ajo dashuri fitonte fuqinë e përjetshme dhe përmbushte amanetin e saj.

“Kosova republikë është dashuria ime që nuk falet...”

Kështu u kishte thënë hetuesve, kur ata e kishin marrë në pyetje pas torturës së tmerrshme nëpër të cilën kishte kaluar çastin që do të kapet nga policët e njësisë federative dhe ata për orë të tëra e kishin mbajtur në një vend të panjohur në pjesën e Graçanicës.

Kur hetuesit e kishin pyetur se pse e ngatërronte dashurinë me një kërkesë politike, që ata e kishin quajtur armiqësore dhe kundërrevolucionare, ajo u kishte thënë se fjala ishte për

një betim dashurie ndër më të veçantit për të cilin ato ditë në Kosovë vdisej me dëshirë dhe edhe më tutje do të vdisej, ata e kishin quajtur të marrë.

“Një ditë do të kuptoni se e keni ngatërruar dashurinë me një parullë nga e cila do të dëshpëroheni...”

“Përkundrazi, do të krenohemi...”

Ata ishin tallur.

Të njëjtën pyetje ia kishin shtruar edhe në atë procesin shkel e shko, që ishte mbajtur në Prishtinë dhe ajo bashkë me dymbëdhjetë të tjerë (kryesisht studentë të Universitetit të Kosovës), pjesëmarrës të demonstratave ku ishte kërkuar republika e Kosovës, ishin dënuar me heqje lirie nga tri deri në nëntë vjet. Qe dënimet të jenë të rënda, prokurori kishte sajuar një organizatë ilegale të quajtur armiqësore, ku ajo ishte vendosur në qendër të organizimit, edhe pse shumë nga studentët as që i njihte, por që të gjithë kishin demonstruar gjatë prillit dhe majit, pasi që në Qendrën e Studentëve kishin ndërhyrë njësitë speciale të policisë federative me ç’rast nga përdorimi i dhunës së paparë disa studentë ishin vrarë (ndër ta edhe Valon Drini), dhe shumë të tjerë ishin burgosur.

Drita Rraci, duke menduar te Valon Drini dhe ata që ishin vrarë me atë kërkesë, jo vetëm që nuk e kishte mohuar padinë rreth “organizatës ilegale armiqësore” së cilës pastaj i ishte ngjitur një epitete marksist-leninist, (siç nuk e kishin mohuar edhe të tjerët), por kishte thënë se i vinte mirë që ishte pjesë e asaj lëvizjeje që ka për qëllim arritjen e Kosovës republikë, të cilën e kishte arsyetuar se ishte e drejtë e popullit të saj për barazi dhe liri dhe fjalë të tjera, me anën e të cilave, ajo do të hetojë se ashtu i ishte afruar dashurisë dhe betimit të saj se përherë do të mbetej e tillë. Çastin që do të shpallet aktgjykimi dhe ajo do të marrë dënimin me heqje lirie prej nëntë vitesh kishte ndjerë se me atë veprim jo vetëm që kishte bërë diçka për atë dashuri, por edhe i ishte afruar disi asaj, që të kthehej në ideal. Madje, duke marrë mbi vete rolin e “organizatores marksiste-leniniste”, ku ishin përfshirë edhe të tjerët, shumë prej të cilëve për herë të parë i kishte parë në Gjykatë, jo vetëm që nuk e kishte brejtur ndërgjegjja se ashtu dhe në atë mënyrë kishte tumirë një sajesë të policisë me të cilën duhej që të dënoheshin sa më shumë të rinj, të cilët kishin shprehur vetëm një mendim të lirë, por mendja ia kishte thënë se ashtu i kishte shërbyer zgjerimit të betimit të dashurisë ndaj Kosovës republikë, si ndjenjë e veçantë shpirti, pa të cilën asnjë dashuri nuk do të kishte kuptim...

Vitet e burgut (në Nish dhe Pozharevc), nuk kishin qenë të lehta, por ato i kishte përballuar me kujtimin e Valon Drinit dhe dashurinë për të, e kthyer në idealin e bërjes së Kosovës republikë. Në çastet më të vështira, kur malli përvëlues për Valon Drinin dukej se tejkalonte çdo gjë sa ta rrëzonte, ishin parafytyrimet rreth përkëdheljeve dhe përqafimeve të ngrohta dikur në Prizren dhe pastaj në Prishtinë, që përcilleshin me pëshpëritjet rreth dashurisë së quajtur Kosovë, një si mbidashuri, që ia kthenin fuqinë. I bëhej se ai i thoshte se çdo gjë ishte e përkohshme dhe kalimtare pa dashurinë për Kosovën.

“Kosova është dashuri shpirti...”

“Kosova është besim...”

“Kosova është jetë e jetëve....”

“Dashuria është Kosovë...”

Por, diku nga fundi i vitit të pestë të burgut, ajo që i shfaqej dashuri shpirti, besim dhe jetë, befaz zuri t'i trazohej e madje edhe t'i kërcënohej nga ato që thuheshin për Kosovë djep mesjetar serb!...

Nuk ishte kjo vetëm parullë që err e terr e dëgjonin nga provokatorët e ndryshëm, me të cilën ishin mësuar që nga fillimi. Ajo, tashmë, si zabullimë e vazhdueshme vinte me anën e gazetave dhe të broshurave, që ua linin pranë dhe në orët e mbrëmjes edhe ua lexonin në kuadër të atyre që quheshin “orë të riedukimit”.

“Kosova Serbi...”

“Serbia Serbi...”

“Serbia e bashkuar...”

“Kosova serbe...”

“Kosova shenjtëri mesjetare...”

“Kosova djep i shtetit serb...”

“Kosova serbe...”

Dhe, ato që thuheshin gjatë “orëve të riedukimit” rreth “Kosovës Serbi” dhe të ngjashme, Drita Rraci i përjetonte si thirrje të urrejtjes kundër dashurisë për të cilën ajo ishte në gjendje që të sakrifikonte çdo gjë. Një çast madje, krijoi bindjen se më në fund i ishte vrarë dashuria, i ishte rivrarë Valon Drini dhe bashkë me të kuptimi dhe ndjenja e të jetuarit.

E mbërthyer në atë gjendje të rëndë psikike prej nga nuk shihte rrugëdalje, kishte tentuar të bënte vetëvrasje, duke prerë venet e duarve, por kishte shpëtuar në saje të ndihmës së shpejtë mjekësore, prej nga, pasi që kishte marrë paksa veten, e kishin dërguar në spitalin psikiatrik, ku kishte qëndruar për më shumë se një vit në një repart të mbyllur.

Qëndrimi në spitalin psikiatrik të Nishit i kishte ngjarë një rikthimi të ngadalshëm në botën e përmasave të rrudhura, ku ajo ndonëse ia kishte dalë që të tejkalonte gjendjen e krizës së rëndë, megjithatë kishte mbetur në mbërthimin e një ndjenje zhvlerësuese ndër më të ulëtat, ngaqë kishte fituar bindjen se meqë për të Kosova nuk ekzistonte më (i ishte zëvendësuar dhunshëm me Serbinë), ashtu i ishte vrarë edhe dashuria për Valon Drinin e bashkë me të edhe ideali i dashurisë dhe çdo gjë tjetër...

Me atë përshtypje kishte kaluar edhe disa muaj, për deri sa një ditë, nga pavijoni i mbyllur i psikiatrisë, e kishte vizituar një ekip i jashtëm i Komitetit të Helsinkit dhe po atë ditë, pasi që ia kishin kumtuar vendimin se i ishte zbritur dënimi prej dy vitesh, e kishin marrë me vete dhe i kishin thënë se po e kthenin për në Kosovë.

Ekipit të Komitetit të Helsinkit u kishte thënë se atë fjalë nuk e njihte, siç nuk njihte asgjë tjetër pos Serbisë.

“Çdo gjë është Serbi...”

“Serbi kudo...”

“Serbi ngado...”

“Serbi në tokë...”

“Serbi në qiell...”

“Serbi...”

“Vetëm Serbi...”

“Nuk ka tjetër...”

“Serbi dhe vetëm Serbi...”

“Serbiiii...”

Gjatë gjithë rrugës kishte përsëritur vetëm fjalën Serbi, sikur në mendjen e saj të mos kishte tjetër. Madje, fjalën Serbi do ta shohë edhe te gjësendet dhe gjithë ato që e rrethonin. Kështu, për të edhe uji quhej Serbi, edhe buka quhej Serbi, edhe shurra quhej Serbi, edhe muti quhej Serbi...

Me të arritur në Prishtinë, Ekipi i Komitetit të Helsinkit Drita Rracin e kishte drejtuar në klinikën psikiatrike të Universitetit të Prishtinës. Doktor Afrim Bega ishte përkujdesur që ajo të kalonte një natë të qetë në pjesën e mbyllur të pavijonit. Përfaqësuesit të Komitetit të Helsinkit ia kishte bërë me dije se ajo duhej të mbetej në klinikë edhe për një kohë të caktuar meqë, si shumë të dënuar të tjerë politikë që kishin kaluar vite të tëra në burgjet serbe, e kishte të vështirë të lirohej nga traumat e shumta me të cilat ishte ngarkuar nga shkakun e përditshmëria në Kosovë (e ngarkuar me dhunë shtetërore serbe që për qëllim ka rrënimin e çdo gjëje shqiptare) ua krijonte bindjen se Kosova nuk ekzistonte më, se ishte kthyer në një Serbi, të tillë që kishte dëgjuar gjatë viteve të burgut...

“Për fat të keq, sindroma Serbi, sikur është bërë gjithëpërfshirës. Te shumë kush mbetet i pashërueshëm...”

Drita Rraci, megjithëqë, ishte liruar nga sindroma Serbi, nuk kishte qenë në gjendje që të rikthejë Kosovën aty ku kishte qenë, sepse dashuria për të fund e krye ndërli dhej me atë që kishte për Valon Drinin. Edhe pa tretmanin e pacientit me terapi të mbyllur, në fillim, pjesën më të madhe të kohës e kishte kaluar në pavijonin e skajshëm, e vetmuar në një dhomë me shikim kah parku që shkonte kah pjesa e kodrinës dhe krijonte përshtypjen e një pjese të shkëputur nga mjedisi, ku përfundonin lidhjet me botën përreth. E zhytur në një apati të thellë, shikimi i saj rrinte i ngrirë te degët e një mani të gërmuqur që vareshin deri te dritaret.

Në atë gjendje përhumbe, fillimisht nuk kishte reaguuar as ndaj pranisë së doktor Afrim Begës, që me disa lëvizje monotone përpiquej t’ia tërhiqte vërejtjen, e nuk kishte reaguuar as ndaj muzikës klasike, të shumtën me tingujt e Bramsit, që përhapej nga një kasetofon, i lënë në pjesën e dritares, ku ajo derdhte shikimin te degët e manit të gërmuqur.

Kështu kishte zgjatur për ditë të tëra. Ajo e ngrirë para dritares, ndërsa doktor Afrim Bega duke lëvizur nga njëra pjesë e dhomës në tjetrën, ndërkohë që muzika e Bramsit nuk kishte të ndalur.

Kur një ditë muzika e Bramsit nuk ishte dëgjuar (e kishte ndalur doktor Afrim Bega), Drita Rraci, për herë të parë kishte reaguuar sikur t’i mungonte diçka. Shikimi i saj i ngrirë nga dritarja dhe degët e gërmuqura të manit, befasisht kishte kaluar nga njëra pjesë e dhomës në tjetrën në kërkim të diçkahes. Dikur, shikimi i saj i ftohtë ishte ndalur te kasetofoni i heshtur, që i rrinte pranë. Një copë herë e kishte shikuar frikshëm kutinë e heshtur, që deri pak më parë padiktueshëm ia kishte tërhequr vëmendjen. Do t’i afrohet me shumë druajtje dhe do të përpiket që prej saj të nxjerrë muzikën me të cilën për ditë të tëra ishte mësuar. Dhe kur nuk ia kishte dalë që ta vente në veprim (pasi që ngatërrueshëm ia kishte prekur që të gjitha sustat), e kishte përplasur furishëm për muri. Kutia e heshtur kishte lëshuar një krismë të ashpër, ndërkohë që pjesët e thyera ishin shpërndarë në dysheme, që t’ia bënë me dije se i mungonte fryma asaj që lironte ajo. Në atë habi, për pak kishte mbyllur sytë me duar dhe pastaj pjesët e thyera të shpërndara në dysheme i kishte shqelmuar me hidhërim. Një copë herë kishte nxjerrë çirrje shfrenuese dhe pasi që ishte liruar prej tyre, e heshtur dhe me shikimin e ngrirë ishte kthyer te dritarja ku varej dega e manit të kërrusur.

Doktor Afrim Bega ishte shfaqur me një kasetafon tjetër, prej nga dhoma ishte mbushur me tingujt e muzikës së Bramsit. Ajo kishte kthyer shikimin nga ai dhe kishte filluar të qante. Doktor Afrim Bega i ishte afruar dhe kishte zënë ta përkëdhelte butësisht. Në atë gjendje thujse melankolike, ajo për herë të parë, turbullueshëm, kishte folur diçka për Bramsin, Verdin, Shopenin dhe shpirtin. Fjalët i kishte të mbytura me dënësje dhe psherëtimë, por që atij i kishin mjaftuar të hetonte shenjat e para të atij ndryshimi të rëndësishëm që do të çonte te kapërcimi i krizës së thellë shpirtërore në të cilën ishte futur. I kishte thënë se Bramsi, Verdi, Shopeni dhe të tjerët nuk do ta tradhtonin, ndërsa ajo, si fëmija që mashtrohet me premtimin e dhënë, ishte mbështetur për të dhe kishte mbyllur sytë sikur të flinte. Doktor Afrim Bega që e kuptonte atë gjendje, e kishte bartur në dhomën e saj dhe e kishte lëshuar qetas në shtrat. Ia kishte lënë pranë kasetofonin të hapur me tingujt e muzikës së Bramsit dhe ishte larguar me përshtypjen se ajo kishte bërë një hap të rëndësishëm për t'u liruar nga sindroma Serbi, por e dinte se vinte një fazë tjetër, tepër e vështirë, ajo e ballafaqimit me vetveten, kur mungesa e idealit dhe mburoja e tij, të shumtën bëhet pengesë që të kuptohet, por edhe të pranohet realiteti i vrazhdë, i cili shfaqet si parakusht për t'u kthyer në jetë qoftë edhe pjesërisht...

Duket se te Drita Rraci, rruga e ballafaqimit me vetveten si dhe të kuptuarit e realitetit të vrazhdë dhe pranimi i tij, kishte qenë më i lehtë dhe më i shkurtër pse në atë ndërkohë kishte krijuar bindjen se edhe disfatat, edhe humbjet dhe rëniet madje, janë pjesë e ndjenjës së dashurisë në mënyrë të veçantë, dhe se ato, atë e bëjnë të fuqishme dhe të përhershme madje sa më të rënda që janë.

“Po mos të ishin humbjet, dashuria do të fikej fare...”

Për Afrim Begën, të menduarit se humbja e ushqen dashurinë, duke e mbajtur të ndezur ndjenjën e saj, me të cilën kërkohet zhdëmtim për të gjitha çështjet, nuk ishte i panjohur. Në ato rrethana, te një pjesë e madhe e të rinjve, që kishin marrë pjesë në demonstratat e vitit 1981 dhe zhvillimet tjera që do të ndjekin ato, kur shumë prej tyre do të përjetojnë dhunën e ashpër shtetërore (burgosjet, dënimet e rënda, pastaj përjashtimet nga studimet dhe ndjekjet tjera policore, që nuk do të kenë të ndalur), fiksimi i humbjeve si pjesë e sakrificës së domosdoshme do të bëjë që edhe dashuria të shihet në këtë frymë, gjë që karshi realiteteve të rënda dhe në dukje të pashpresa fare, për pasojë do të ketë kthimin e saj në iluzion, prej nga pastaj do të kenë burimin krizat e mëdha shpirtërore.

Dhe si do të shihet, shfaqja ime Drita Rracit, megjithatë do t'i ndihmojë që të mbrohet nga rreziku që kriza e vetmisë dhe gjithë ato që kishte përjetuar në burg t'i kthehet në traumë, siç do të më ndihmojë edhe mua, që mungesën e Nora Bardhit dhe çdo gjë tjetër që lidhej me të, ta përballoj me praninë e Drita Rracit.

Në të vërtetë, ne ishim dy krijesa të njëjta, që u kishin bërë ballë humbjes së dashurive tona (unë humbjes së hershme të Nora Bardhit, ndërsa ajo vrasjes së Valon Drinit në demonstratat e prillit të vitit 1981), por që rëniet tona shpirtërore kishin qenë të pashmangshme kur na ishin rrënuar idealet: mua titulli i kampionit botëror, ndërsa Drita Rracit kur, nga propaganda e madhe, i ishte krijuar bindja se Kosova ishte kthyer dhunshëm në Serbi.

Të qëlluar njëjtë, thujse kishim pranuar rolin e viktimës së përhershme në luftë me një fuqi të mbinatyrshme, dhe kjo mbase do të ndodhte, po mos të ishte spitali psikiatrik, që

rastësisht na kishte bashkuar dhe po mos të ishte doktor Afrim Bega, që tashmë kishte përvojë me të tillët, kur do t'i lërë të hapura mundësitë që anasjelltas t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, ani pse e gjitha do të fillojë me përshtypjen se ndodhemi në vartësi të plotë: unë te asaj dhe e asaj te unë, kur unë do të mendoj se ajo ishte terapeutja ime dhe duhej t'i nënshtrohesha, ndërsa ajo do të mendojë të njëjtën për mua.

Kjo do të pasqyrohet më së miri kur takoheshim dhe pas pak ajo do të më zërë për krahu dhe do të më nxjerrë në lulishten e parkut të spitalit që shkonte nga pjesa e kodrinës përballë dhe do të më thoshte se nuk do të dëshironte të ktheheshim ndaras, ndërsa unë do t'i ngjitëm për trupi pasi që do të ma kapë dorën dhe do të ma mbajë për të sajën prej nga do të ndjeja përçimin e diçkaje që më kishte munguar, gjë që sjellja ime thuajse e pambikëqyrur njëjtë kishte ndikuar edhe te ajo që të krijojë përshtypjen se dashuria ishte e përhershme dhe e pashtershme pse mund të bartej e njëjtë dhe të zhvendosej nga qenia në qenie, ndërkohë që humbjet sado të rënda qofshin mbeteshin kalimtare pse mund të përballoheshin ose që plagët e tyre mund të shëroheshin.

Mungesa e saj prej disa ditësh dhe rikthimi i mbylljes sime, të cilën doktor Afrim Bega e kishte vlerësuar si shenjë të mirë, këtë e kishte dëshmuar më së miri.

Dhe çastin që ajo do të shfaqet dhe do të më thotë se do të vazhdojmë ku kishim mbetur, pra do të më kapë për krahu dhe do të më nxjerrë jashtë në lulishten e parkut në drejtim të kodrinës përballë, do të përfundojë koha e të menduarit se drejtonim njëri-tjetrin për t'iu kthyer bindjes se ishim ta ndihmonim njëri-tjetrin, dhe se ajo ndihmë, nuk do të thoshte tjetër pos mundësi e pashmangshme që të bashkohemi, edhe pse, si do të shihet këtij bashkimi do t'i hyjë në mes një ndarje e përhershme, që megjithatë nuk do ta përjashtojë lidhjen tonë jetësore dhe kuptimin e asaj që na kishte bashkuar dhe do të na mbajë të lidhur për të...

Në të vërtetë bashkimi ynë ndodhi çastin që Drita Rraci u shfaq befas pas mungesës disa ditësh dhe unë do të ndjehem i liruar pse tashmë isha në vartësi të plotë të saj, ndërkohë që edhe ajo do ta ndjejë të njëjtën. Ato që m'i kishte thënë se do të vazhdonim aty ku e kishim lënë, por në rrethana të reja (kishte zënë ngojë diellin e para ditës për ndryshim nga ai i pas ditës, i cili krijonte disponime të tjera), kishin qenë pjesë e atij veprimi thuajse të vetvetishëm, që do t'i nënshtrohemi dhe ai do të kthehet në një marrëveshjes të heshtur jetësore, që do të sfidohet së pari nga mungesa e diçkahes dhe pastaj nga nevoja e plotësismit të saj me anën e pranisë së dikujt, ecuri kjo që mund të shpjegohet me atë se dashuria mbetet e përhershme pikërisht kur është në gjendje që të bartet nga qenia në qenie dhe të zhvendoset nga koha në kohë.

Doktor Afrim Bega, siç do të pranojë pak më vonë, kishte paraparë se shëtitja jonë e dytë në lulishten e parkut të spitalit që shpinte kah kodrina përballë, do të sillte një afri me dobi të dyanshme, së paku që ne t'i ktheheshim realitetit jetësor në mënyrë që aty të mateshim me sfidat e tij, por nuk ia kishte marrë mendja se e gjitha do të kthehej në një lidhje jetësore ndër më të dobishmet dhe ndër më të fuqishmet, ku ishin pajtuar dy pole të ndryshme dikur të mbushura me fuqinë e vullnetit të dashurisë, të cilat ishin zbrazur dhunshëm, por që në realitetet e reja vullneti për jetë i kishte rimbushur me diçka të përhershme, që as ndarja që një ditë do t'iu hyjë në mes dhe madje ajo do t'iu kthehet në fatalitet, nuk do të jetë në gjendje t'i mposhtë.

Natyrisht se doktor Afrim Bega, ishte shumë i merituar që lidhja jonë e shpejtë përnjëmend të kthehej në diçka thellësisht jetësore, ndaj asaj ia krijojë atmosferën si dhe kushtet të domosdoshme për atë ndryshim.

“Kohët vrastare nuk mund të përballohen pa detyrimin dashurisë-jetë...”

Duke dëshiruar që të na mbante të lidhur për sfidën jetë në kohë vrastare së cilës i duhej dashuria, që ne në njëfarë mënyre e kishim pranuar, doktor Afrim Bega, na kishte bërë me dije se edhe për një kohë do të mbeteshim në pjesën e jashtme të pavijonit, për deri sa të gjendej një strehim i përshtatshëm, të cilin e kishte marrë përsipër shoqata humanitare “Nena Terezë”.

Por, ne e dinim se “çështja e strehimit të përkohshëm” në pjesën e pavijonit të jashtëm (ishte një barakë e shkëputur, me dy dhoma të ndara, me pajisjet elementare) nuk ishte e “natyrës sociale”, por pjesë e terapisë së mbikëqyrur, nëpër të cilin kalonin edhe më tutje ata që kishin nevojë për njëri-tjetrin. Ajo ishte një hapësirë “e përbashkët” por njëherësh e ndarë që mund të bashkonte, por edhe të ndante përfundimisht shpirtrat e sëmurë me të cilët bota jonë ishte plot e përplot...

Kështu, baraka e shkëputur, qysh nga çasti në të cilën u futëm na u kthye në strehë të përbashkët jetësore. Dhe kjo do të ndodhë fare thjeshtë pse në atë kohë vrastare, siç ishte ajo e shtetrrëthimit, jetën ishim të detyruar ta kuptojmë si detyrim dashurie, sepse vetëm ashtu përmbushej kuptimi i dashurisë, që për ne kishte domethënie të veçantë me iu kthye jetës. Andaj, që jeta-dashuri të kthehej në dashuri jetësore, në ato rrethana ishte e gjuar të kalonte nëpër testin e egër të shtetrrëthimit, që erdhi pas gjendjeve të kohë pas kohshme të jashtëzakonshme, të cilat filluan të vendoseshin nga demonstratat e vitit 1981 e tutje për të arritur shkallën e një dhune të ashpër shtetërore kur do të fillojnë protestat gjithpopullore anembanë Kosovës pas grevës së madhe të minatorëve në “Trepçë”, të cilat jo vetëm që nuk do të çojnë te përmbushja e kërkesave të tyre (ruajtja e gjendjes kushtetuese, që Kosova të mos kthehej në Serbi, siç kërkonte Beogradi prej kohësh), por ato do të shfrytëzohen për vendosjen e shtetrrëthimit bashkë me atë të gjendjes së jashtëzakonshme që, si dihet, më 23 mars të vitit 1989, për pasojë do të ketë rrënimin me dhunë të autonomisë së Kosovës dhe ripushtimin e tretë të Kosovës nga Serbia nga viti 1912 e tutje (i pari më 1918, i dytë më 1944) kundër të cilit anembanë Kosovës u derdh gjak, me çka përfundimisht do t’i hapen dyert lëvizjes kombëtare dhjetëvjeçare për nxjerrjen e Serbisë nga Kosova.

Por, për deri sa të vijë deri te ky përshkallëzim, në të cilin, si gjithë të tjerët do përfshihem edhe ne, duhet thënë se krahas shtetrrëthimit që i ishte vendosur Kosovës, ne kishim “shtetrrëthimin” e Klinikës së Psikiatrisë së Universitetit të Prishtinës, që duhej kapërcyer. Qëndrimi në barakën e vogël do të thoshte shumëçka për ne, por jo edhe lirim nga ajo gjendje, meqë ne ishim të kushtëzuar dhe të mbikëqyrur. Që kjo varësi të kalohej, më shumë se kushdo, do të përkujdeset gazeta “*Rilindja*”, më konkretisht redaktori i rubrikës së sportit Ali Bala, i cili një ditë, fare papritmas u shfaq në barakë dhe ma bëri me dije të qëndrimin e redaksisë së gazetës që të më punësohesha aty.

“Kush e njeh boksën më mirë se kampioni i kampionëve”.

I zënë në befasi ia ktheva se çarë mund t’u ndihmonte një boksier i dështuar, i cili nuk ka shkruar asnjë fjalë për boksën.

Fjala “boksier i dështuar” atij i erdhi e rëndë, pse mund ta pasqyronte gjendjen time të rëndë shpirtërore, andaj me të shpejtë ma ktheu se mund ta kuptonte modestinë time, por assesi nuk mund të pajtohej se isha boksier i dështuar.

“Bashkim Kosova mbetet boksieri më i madh i të gjitha kohëve, jo vetëm pse ka arritur në fronin e më të mirit në botë, por edhe pse deri aty ka shkuar pa asnjë humbje...”

Pasi që nxori edhe shumë e shumë lëvdata të tjera, të cilat më vinin sikur gjëra të ngrira, ma tha se fillimisht do të “jepja këshilla dhe sugjerime”, e pastaj mund të përpunoja ndonjë lajm nga boksi.

“Nuk presim të bëhesh sa ora komentator”.

Në të vërtetë, redaktori i nderuar i “Rilindjes”, që ishte marrë shumë e shumë me karrierën time sportive dhe së fundi do të shkruajë edhe një fejtton të gjatë për jetën time, (“*Vitet e kampionit*”, që do të fillojë të botohet më një korrik 1990 por do të ndërpritet më 5 korrik, kur Serbia do ta mbyllë dhunshëm gazetën “Rilindja” dhe mediumet tjera shqiptare në Kosovës), kur kishte ardhur dhe ma kishte shtrirë dorën të më nxirrte nga rrethimi psikiatrik, kishte përfaqësuar pëlqimin e gjithë atyre, që me brengosje kishin përcjellë gjendjen time dhe kishin qenë të interesuar sa më shpejtë ta tejkaloja, meqë vlerësonin se kthimi im në jetë do të thoshte ndërlidhje me përpjekjet e gjithëmbarshme të të gjitha shtresave shoqërore që bëheshin për afirmimin e Kosovës si njësi e barabartë federative, në rrethanat kur Serbia po bënte çmos që me dhunë ta rikthente serish në tutelën e vetë.

Sidoqoftë, Ali Bala, bëri që ta kaloja rrethimin psikiatrik për të më futur në atë të shtetrrrethimit, në të cilin ishin vendosur që të gjithë dhe paraqiste realitetin e pashmangshëm, ku fillonte ballafaqimi ynë me të dhe, kush më shumë e kush më pak, do t i kundërvihet në mënyrën e vet.

Po atë ditë, me Drita Rracin dhe të shoqëruar nga doktor Afrim Bega, u nisëm për në redaksinë e gazetës “Rilindja”. Rrugën nga spitali deri te Pallati i Shtypit e bëmë në këmbë (kjo ishte dëshira ime) rrugë që m’u duk shumë e gjatë, thuajse e pafundmë dhe mbi të gjitha e anktshme edhe për atë se duhej të kalonim nëpër dy postblloqe policore (njëri në të dalë prej spitalit dhe tjetri në udhëkryqin përballë Fakultetit Filozofik), e mbi të gjitha, në atë ecje e sipër, domosdoshmërisht duhej të ndërlidheshim me përfytyrimin e ngjarjeve të kaluara, si pjesëza të shkëputura ose të mjegulluara fare, që jetës sonë i kishin dhënë vulë të veçantë.

Doktor Afrim Bega, që kishte marrë përsipër rolin e “prijësit” dhe e dinte rëndësinë e rikthimit të kujtimeve në një formë të tillë si dhe rrezikun e përjetimit të tyre si trauma, rrinte midis nesh dhe përkujdesej që postblloqet t’i kalonim pa ndonjë shqetësim, ndërkohë që të tjerat të merreshin si pjesë të rikthimit kah realiteti jetësor. Kështu, postbllokun e parë, atë në hyrjen kryesore te spitalit, e kaluam pa na legjitimuar, meqë mund të merrej me mend se rojet i njihnin mjekët, ndërsa postbllokun e dytë, atë përballë Fakultetit Filozofik, nuk kishim si ta anashkalonim, meqë ai ishte i detyrueshëm për të gjithë. Edhe përkundër kalimit të heshtur para kordonit policor, nuk u legjitimua. Madje, sa kaluam ne nuk u legjitimua askush. Por, me apo pa të, ai kalim ishte i anktshëm pse duhej përshkohej nëpër një hapësirë, e cila krahas forcave të shumta të armatosura, që mbanin tytat kah kalimtarët, mbikëqyrej dhe nga dy tanke, sipër të cilave qëndronin mitralozat e ngrehur në drejtim të masës.

Megjithatë, sfidën e parë të ballafaqimit me atmosferën e shtetrrrethimit dhe të gjendjes së jashtëzakonshme e kaluam pa ndonjë shqetësim të veçantë, dhe si duket, kjo e

liroi doktor Afrim Begën nga druajtja që mund ta kishte për ne. Madje, këtë e hetuam nga ato që tha se tashmë e kishim shumë afër Pallatin e “Rilindjes”.

Por, para se të arrinim Pallatin e “Rilindjes”, duhej të kalonim përpara Radio Prishtinës, e cila ishte e rrethuar me tela me gjemba. Pikërisht në pjesën ku telat gjembor përkufizonin hapësirën e Radio Prishtinës me atë të Fakultetit Filozofik, Drita Rraci ndaloi. U gjunjësua dhe puthi tokën. Një copë herë mbeti në atë gjendje. Në fillim më shkoi mendja se mund të ishte ndonjë shqetësim nga ndryshimi me të cilin nuk ishim mësuar, por doktor Afrim Bega, që e dinte se për çarë është puna, edhe ai u gjunjësua, gjë që këtë e bëra edhe unë.

Ashtu të gjunjësuar me fytyrë kah toka mbetëm një copë herë, por kur u ngritëm, m’u bë se ishim të vetmuar fare, edhe pse nga të dy anët kishte kalimtarë që ecnin të heshtur dhe përpiqeshin sa më parë të kalonin në pjesën ku përfundonin telat me gjemba.

Vetëm kur në sytë e Drita Rracit pashë lotët, m’u kujtua se ashtu ajo kishte nderuar kujtimin e Valon Drinit të vrarë më pesë prill të vitit 1981 dhe, po ashtu, kishte nderuar vendin ku më 11 mars kishin filluar demonstratat e studentëve, në të cilat kishte marrë pjesë edhe ajo bashkë me shumë e shumë të tjerë për të vazhduar pastaj me ato prillit, ku do të burgoset për t’u dënuar me nëntë vjet heqje lirie.

“Çudi! Nuk ndjehem e shqetësuar, as e dëshpëruar...”

Doktor Afrim Bega e zuri për krahu dhe dukej se nuk po gjente fjalët e duhura. Sigurisht se nuk do t’i pëlqente që ajo t’i thoshte se ndjehej e zbrazur, meqë ashtu dyshohej se shenjat e krizës te ajo edhe më tutje ishin të pranishëm dhe çdo çast mund të rikthenin gjendjen e rëndë nëpër të cilën kishte kaluar gjatë shfaqjes së sindromës Serbi.

Edhe pse nuk tha gjë, Drita Rraci megjithatë dukej si e zbrazur. Heshtja e saj e akullt dhe ecja shkallmuese tregonin qartë për gjendjen në të cilën ndodhej. Doktor Afrim Bega, i cili tashmë e kishte të qartë se Drita Rraci ndodhej para një sprove tepër të vështirë, nisi të fliste për hotel Grandin, që do t’i vihej sipër një tarracë me lule gjithë fare, ku do të kishte aso tropikale, por edhe lloje të ndryshme të kaktuseve, që rriten vetëm në shkretëtirën e Gobit. Tha se kjo ishte ide e një ambientisti të huaj, i cili kishte ardhur te mendimi se klima e Prishtinës, pikërisht ku ndodhej Grandi, ishte ndër më të veçantat e globit tokësor, meqë aty takoheshin rrymat më kundërtë: e thata dhe e lagështa, të cilat, jashtë ligjeve të njohura të natyrës, në vend se të kondensoheshin, çuditërisht ruanin veçoritë fizike.

Ato që thoshte doktor Afrim Bega, edhe pse nuk ishin tjetër pos mbllaçitje për tallje, të cilat ai i kishte paraparë se t’i përdorte në rrethana të ngjashme, megjithatë Drita Rracit zunë me ia tërheqë vëmendjen sa të pyesë edhe për disa lloje lulesh tropikale, për të cilat ajo kishte mësuar nga vitet e burgut kur parafytyronte hapësirën e lirë si një oazë të gjelbër dhe të ngjashme që mundëson fantazia, të cilat do të mund të gjendeshin aty. Doktor Afrim Bega jo vetëm që ia pranoi se kjo ishte e mundshme, por tha se tashmë ishte i sigurt se emrat e atyre luleve që i zu ngojë Drita Rraci, i kishte parë në listën e lulishtes së Grandit.

Por, shfaqja e Grandit si dhe atmosfera e zyrtë që mbretëronte përpara (vendosja e një autoblinde në pjesën që lidhte tavernën me Shtëpinë e Armatës Jugosllave, pastaj parakalimi i pjesëtarëve të njërive speciale të policisë si dhe shumë e shumë personave që u takonin shërbimeve policore dhe ushtarake serbe dhe njërive paramilitare, që thuhej se aty kishin qendrën e komandimit), aty për aty përpara ma nxori pamjen e njërit ndër tubimet më madhështore, që ishte mbajtur me rastin e kthimit tim nga Lojërat Olimpikë të Los

Anxhelosit, kur isha kthyer me medaljen e artë. Sigurisht se ky kishte qenë refleks i ndërdijës sime, të më mbronte nga atmosfera e ankthshme me të cilën po ballafaqohesha. Sidoqoftë, mendja ime tashmë kishte zhvendosur pamjen trishtuese para Grandit me atë të një turmë të madhe të qytetarëve (thuhej se atë ditë në atë pjesë të qytetit ishin mbledhur rreth njëqind mijë veta), e cila ishte shfaqur në mesditë para Pallatit të Sporteve “Boro-Ramizi” për me vazhdue pastaj para Grandit. Grupet e ndryshme muzikore dhe ato të estradave (që nga Shoqëria “Ramiz Sadiku” e studentëve të Universitetit të Prishtinës, Rokerat, Dardanët e deri te Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Shota”), kishin krijuar një festë të madhe gjithpopullore, e cila do të kthehet në një demonstrim të fuqishëm kur para turmës do të shfaqem me medaljen olimpikë. Nga ai çast e deri sa do të fillojë ndërhyrja policore e njësive speciale, jo vetëm hapësira para “Grandit” dhe rruga kryesore “Mareshali Tito” deri te Teatri Popullor Krahinor, por e gjithë Prishtina, kishte jehuar nga thirrjet “*Bashkim*” dhe “*Kosovë*”, që do të kthehen në “*Kosova Republikë*”, thirrje kjo që ishte bërë edhe më e fuqishme dhe gjithëpërfshirëse sa më shumë që kishte ndërhyrë policia ndaj demonstruesve. Në pjesët lindore dhe perëndimore të qytetit (në drejtim të Vranjevcit dhe Gërmisë si dhe në drejtim të Qendrës së Studentëve dhe Ulpianës dhe të Dardanisë), kishin filluar edhe përleshjet e ashpra të policisë me demonstruesit pasi që këta të parët kishin hedhur gaze lotsjellës dhe kishin përdorur forcën kundër tyre pa kursyer edhe armët e zjarrit.

Por, edhe përkundër rikthimit të tablove të dhunës, siç ishin ato të përdorimit të forcës ndaj demonstruesve nga ana e njësive policore në pjesët e ndryshme të Prishtinës, në mendjen e time, tubimi madhështor nuk kishte as fund e as epilog tragjik, siç e kishte pasur në të vërtetë në orët e vonshme kur në lagjen e Dardanisë si pasojë e dhunës së ushtruar ishin plagosur shumë veta dhe kishin mbetur të dy demonstrues (një student dhe një punëtor i Kombinatit Ndërtimor “Ramiz Sadiku”), për të cilët, në një kumtesë zyrtare ishte thënë se “kishin humbur jetën në një aksident tragjik komunikacioni”. Ai rikthim i ngjarjeve përpara Grandit serish po m’i rishfaqte estradistët e shumtë me këngët “*Kosovë, nana jonë...*” dhe “*Besa-besë*”. Kjo e fundit përqafohej nga masa dhe kthehej në një himn përmasash antike.

Ndjenja e këtij himni çuditërisht m’u lidh për goje dhe thuajse papërmbajtshëm zura të nxjerr jashtë pjesë të shkëputura të melodisë, por edhe disa fjalë, të cilat duket se më shumë kishin shqetësuar se sa befasuar doktor Afrim Begën, i cili deri më atëherë ishte marrë me Drita Rracin dhe atë sajësën për lulet gjithë fare në tarracën e hotelit “Grand” me anën e së cilës përpiqej që ta tërhiqte nga trauma e ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe të prillit të vitit 1981.

Që t’i mbulonte disi ato që nga unë vinin si krrokatë dhe të parandalonte kthimin e tyre në çirrje publike, siç mund t’u ndodhë atyre që befas zënë të zbrazën prej tyre që u përzihen brenda dhe nuk mund ta mbikëqyrin kahun e derdhjes, doktor Afrim Bega nisi të qeshte të madhe pse gjoja, dikush para tyre, fluturimin e një sorre të madhe që kishte kaluar nga “Grandi” në drejtim të shtëpive përballë, e kishte parë si fluturim të një kali, dhe se këtë e kishte përsëritur disa herë, pale se askush nuk ia kishte vu veshin, pse e kishin marrë për të krisur ose shakaxhi.

Natyrisht se e qeshura me zor e doktor Afrim Begës rreth atij që sorrën e kishte krahasuar me kalë fluturues dhe ndërhyrja e Drita Rracit me fjalët se “njerëzit mund ta shohin edhe mizën për buall dhe buallin për mizë” pa përjashtuar këtu edhe ngatërrimin në fluturim midis sorrës dhe kalit dhe të ngjashme, më nxorën nga përfytyrimi i demonstratës

para “Grandit” si dhe ndjenjës së këndimit të himnit në të cilin isha përfshirë dhe po e shprehja ndonëse si krrokatë.

Doktor Afrim Bega, i cili kishte dashur këndelljen time, me të shpejtë kishte flakur të qeshurat e dhunshme që gjoja i kishte nga ai që kishte thënë se e kishte parë kalin që fluturonte. Gjithnjë duke më mbajtur për krahu, më kishte pyetur se mos kisha të ftohtë, meqë ai këtë e ndjente. Në vend se t’ia ktheja përgjigjen rreth të ftohti, që nuk e ndjeja, si një klithmë nxora fjalën “Rilindja”, e cila mund të jetë shpërndarë si thekamë në pjesën e rrugës që shkonte nga “Grandi” për te Pallati i Shtypit.

“Ah, ke të drejtë! Ja ku është pingu më i lartë në botë!”

Doktor Afrim Bega, foli të madhe duke bërë me dorë nga pjesa ku tashmë pamja e imponante e Pallatit të Shtypit me mbishkrimin “Rilindja” mbizotëronte hapësirën që kishim përpara. Por, vërehej se zërin e kishte shkallmues, gjë që linte për të kuptuar se kishte një shqetësim të brendshëm dhe kjo kishte të bënte me brengën se mos sjelljet tona në ato rrethana do të ishin në shpërputhje me parashikimet e tij rreth tejkalimit të krizës shpirtërore me çka rrezikohej ajo që ai e shihte si mundësi të rikthimit tonë në jetë nëpërmes sprovës së vështirë në rrethanat e kohës së shtetrrëthimit.

Drita Rraci pyeti se a kishte lule edhe në tarracën e Pallatit të Shtypit, dhe nëse jo, a do të kishte vend aty edhe për to kur dihej se ajo ishte tarraca më e lartë jo vetëm në Kosovë, por në përgjithësi në rajon dhe më gjerë dhe, si e tillë, pingu i saj përherë përfshihej nga një rrymë e fortë ajri. Doktor Afrim Bega ia ktheu se Pallati i “Rilindjes” kishte një domethënie shumë më të madhe nga pikëpamja kulturore dhe shpirtërore, por u pajtua edhe me vlerësimin se aty kishte kushte edhe më të mira për lule, se kishte edhe më shumë diell dhe erëra të forta.

Ndonëse edhe më tutje do të përpiqet që të plotësonte kureshtjen e Drita Rracit rreth luleve, doktor Afrim Bega megjithatë bënte përpjekje që të përcillte edhe reagimet e mia rreth ballafaqimit me “Rilindjen”, jo vetëm pse aty, siç më kishte thënë redaktori i sportit, duhej të punësohesha, dhe kjo paraqiste një sprovë të mirë për t’u kthyer në jetë, por për më tepër, që të matej lidhja emocionale me atë pjesë të jetës sime, siç ishte karriera sportive dhe kujtimi për Nora Bardhin si shtysë e madhe e gjithë asaj që kishte paraqitur ideal dhe pastaj ishte rrënuar dhunshëm.

Ato çaste nuk isha në gjendje me gjykye rreth “pingut më të lartë në botë”, siç e quajti doktor Afrim Bega Pallatin e “Rilindjes”, nëse ajo mund të ishte një sajesë e ngjashme me atë që pak më parë kishte thënë rreth “sorrës që shihej si kalë që fluturon”, ngaqë koka ime edhe më tutje vlonte nga pjesët e shkëputura të demonstratës së madhe që ishte zhvilluar në Prishtinë me rastin e kthimit nga Lojërat Olimpike të Los Anxhelosit kur isha kthyer me medaljen e artë, e cila kishte filluar me brohoritjet “*Bashkim*” dhe “*Kosova*” dhe në orët e vona të natës kishin përfunduar me gjakderdhje.

Në atë përmendje, m’u bë se pingu i ndërtesës bashkë me shkronjat “Rilindja”, po luhatej, dhe në pamjen time mbase shpejt edhe do të shembej, po mos të kisha hetuar praninë e redaktorit Ali Bala, i cili bashkë me gazetarët e sportit dhe të tjerë po na uronte mirëseardhje.

I qetësuar pse ajo shembje nuk kishte ndodhur, hetova se dikush më dha lule, se po më merrnin ngryk, ku kishte përgëzime gjithë fare që nuk isha në gjendje që t’i kapja si

duhej, nga shkak se ai ballafaqim aq dramatik me aq shumë veta nga një afërsi e tillë, më kishte turbulluar fare.

Doktor Afrim Bega, i cili e dinte fare mirë se çfarë do të thoshte për mua kjo gjendje dhe çfarë mund të prodhonte ajo, nxitoi të më merrte në mbrojtje, duke kërkuar që të ecnim tutje në drejtim të hyrjes kryesore pa lejuar që të kisha kontakte me ata që kishin dalë të më përshëndesnin.

Mbaj mend se pjesa e rrugës nga hyrja në Pallat e deri në katin e katërt, ku ishte zyra e kryeredaktorit të “Rilindjes”, që po na priste, i kishte ngjarë një zallahie, që po të kishte zgjatur edhe pak, me siguri se do të më shkallmonte fare. Doktor Afrim Bega, që i kishte hetuar shenjat e hutesës sime dhe ato madje edhe mund t’i kishte paraparë, u përkujdes që te kryeredaktori i “Rilindjes” të mos ketë të tjerë pos tij dhe redaktorit të sportit Ali Bala, i cili kishte marrë përsipër që “dita ime e parë e punës” në gazetë, të kishte vetëm karakter njoftues dhe asgjë më shumë. Andaj, më pak fjalë më uroi mirëseardhje dhe premtoi se aty kisha përkrahjen tonë të plotë.

Ngjashëm u shpreh edhe Kryeredaktori, i cili më tha se “Rilindja” ishte dhe do të mbetet shtëpia e tij e përhershme.

Fjalët e Kryeredaktorit më liruan nga mbetjet e zallahisë, që deri më atëherë sikletshëm mbërthenin kokën time. Desha t’i thosha se kjo më nderonte dhe desha t’i falënderohem edhe për të tjerat që kjo gazetë kishte bërë për mua, por hetova se këtë nuk mund ta bëja, ngaqë më mungonin fjalët e duhura. Por, për habi timen, e madje edhe te doktor Afrim Begës, i cili rëndom ndërhynte në raste të tilla, ishte Drita Rraci ajo që u falënderua me shumë mirësjellje dhe dinjitet. Fjalët i kishte aq të matura dhe aq domethënëse, saqë m’u bë se ato që pak më parë kishte biseduar me doktor Afrim Begën nga “Grandi” e deri te “Rilindja” rreth sajësës së tarracës me lule dhe fantazive të ngjashme, nuk kishin qenë tjetër pos pjesë e një farse, që edhe asaj i ishte dashur me e përballue kapërcimin nga njëra gjendje në tjetrën.

Kur u larguam nga “Rilindja”, ajo më zuri për dore dhe kishte qëndrimin e njeriut që ishte pjesë e asaj përditshmërie, që nuk mund të thosha se kjo vlente edhe për mua, veçmas pas atyre që kisha përjetuar para dhe gjatë pritjes në “Rilindje”.

Se ishte të më drejtonte, siç kishte ndodhur edhe me rastin e takimit tonë të parë në Klinikën e Psikiatrisë, kur më kishte nxjerrë jashtë në lulishten e parkut që shkonte nga kodrina përballë dhe më kishte zënë për krahu dhe pastaj, sikur të isha një fëmijë i frikësuar, ma kishte shtrënguar dorën, Drita Rraci, prapë më kishte zënë për krahu dhe po më drejtonte në drejtim të Spitalit, ku na priste baraka jonë në pjesën e skajshme ngjit me Klinikën e Psikiatrisë prej nga në mëngjesin e asaj dite kishim thyer rrethin e psikiatrisë, gjë që kjo paraqiste një fitore të madhe, dhe ishim futur në atë të shtetrrëthimit.

Në atë kthim nga hapësira e shtetrrëthimit te rrethi ynë i psikiatrisë, doktor Afrim Bega, thau se nuk u vërejt, ndonëse isha i bindur se ecte i heshtur pas nesh, gjithnjë duke përcjellë me vëmendje veprimet tona. Dhe, me siguri se do të ketë qenë njeriu më i lumtur çastin që ne po i afrohem barakës sonë në pjesën e skajshme ngjit me Klinikën e Psikiatrisë kur kishte parë si Drita Rraci, që deri më atëherë më kishte mbajtur për krahu, kishte kërkuar që pragun e saj bashkërisht ta kapërcenim symbyllas, gjë që këtë e kisha bërë me kënaqësi të madhe, pse ashtu po shkëputesha nga një ditë shumë e gjatë për t’u ballafaquar me një realitet tjetër, atë të ndodhjes në përfaqimin e Drita Rracit, që kishte qenë i pari dhe i fundit i

një lloji të tillë në jetën time dhe të sajën, por që duhet pranuar se me ato që atë natë kishin ndodhur, ne ishim bashkuar shpirtërisht përgjithmonë pa dëmtuar të kaluarën dhe pa e ngarkuar të ardhmen. Ky bashkim ishte edhe më domethënës pse zjarri i dashurisë, që atë natë kishte shpërthyer midis nesh dhe, si përjetim, kishte arritur thuajse shkallën e një ekstaze shkallmuese ndër më të jashtëzakonshmet e jetës sonë, ishte nxitur nga fuqia e ndjenjave të veçanta, siç ishin ato që unë ruaja për Nora Bardhin dhe ajo ruante për Valon Drinin. Flaka e asaj dashurie në të cilën ishim përfshirë atë natë dhe prore do të na ngrohte shpirtin, jo vetëm që nuk përjashtonte ndjenjat e së kaluarës sonë për të cilat kishim qenë të fiksuar me fanatizëm, por ajo i bënte pjesë të pandashme të atij zjarri, ku Nora Bardhi dhe Valon Drini shfaqeshin si ushqyes dhe njëherësh mbrojtës të tij që ai të mos shuhej kurrë...

Madje, fuqinë e atyre dashurive në jetën tonë të përbashkët, do ta pasqyrojë më së miri emri i djalit tonë *Valnor* (një kompozitë midis *Valon* dhe *Nora*), i lindur nëntë muaj dhe nëntë ditë pas asaj nate të jashtëzakonshme, e cila na kishte bashkuar përgjithmonë në një dashuri të përbashkët ku dashuritë e tona të veçanta të ngritura në ideale, ishin derdhur në të dhe asaj ia kishin dhënë fuqinë e brendshme. Ndjenjën e këtij bashkimi të përhershëm nuk e kishte zbehur as ndarja që pas tri vitesh do të na hyjë në mes dhe na prapë kishim ardhur në një situatë jetësore kur mungesën e njëri tjetrit, si dhe vetminë me to që sjell ajo, ta përballonim me kujtimin e saj...

Por, para se të lindë Valnori ynë, dhe para se të vijë deri te ajo ndarja jonë e përhershme, e cila po ashtu kishte qenë e dhunshme, gjë që flet se jeta jonë kishte një mallkim që ia përcaktonte atë fat, duhet thënë se ia kishim dalë të thyenim rrethin e brendshëm, atë psikiatrik për t'u bërë pjesë e atij të jashtëmit, si shtetrrëhim. Dhe, deri te kjo erdhi - së pari në saje të betimit ndaj dashurisë jetësore, të bërë natën që do të bashkohemi, dhe së dyti, nga shtatzënia e Dritës, që erdhi shumë shpejt dhe ndryshoi rrënjësisht qëndrimet tona dhe madje edhe të menduarit tonë rreth shumë çështjeve, meqë ne nuk kishim më preokupim frikën nga shqetësimet e të kaluarës (mundësia e rikthimit të krizës shpirtërore), e nuk kishim preokupim as frikën nga ballafaqimi me gjendjen e shtetrrëhimit në të cilën ndodheshim bashkë me të tjerët. Për ne, pra, preokupim kryesor befas shfaqej fëmija ynë dhe mundësia që atij t'i ofrohej një ngrohtësi prindore dhe familjare, që unë nuk e kisha pasur dhe, si do të shihet, as ai nuk do ta ketë...

Në të tilla rrethana, jeta jonë iu kthye një normaliteti, edhe pse realitetet ishin tepër shqetësuese dhe me përkeqësime të shpejta, të cilat flisnin qartë se dhuna e deri atëherëshme shtetërore do të përshkallëzohet edhe më tutje, ngaqë Beogradi zyrtar tashmë kishte shpallur programin për rrënimin e autonomisë së Kosovës me anën e ndryshimeve kushtetuese, sipas të cilave mbijetesa e mëtutjeshme e Jugosllavisë federative dhe vetëqeverisëse kushtëzohej me “Serbisë unike”, pra Serbinë pa njësitë autonome, që nënkuptonte sakrifikimin e Kosovës, pa marrë parasysh, se ky kurban nuk do ta shpëtojë askënd nga tragjedia që do të përhapet në gjithë vendin dhe madje, të parët do të përfshijë ata që bënin hesape në kurriz të fatkeqësisë së shqiptarëve.

Dhe, si për habi, dhënia e kësaj shenje, pra e procesit të “bashkimit të Serbisë”, që njëherësh do të jetë edhe paralajmërim për shkatërrimin e Jugosllavisë nga ana e politikës serbe, do të përkojë me ditën time të parë të punës në “Rilindje” (fillimisht do të merrem vetëm me ndarjen e lajmeve të sportit nga shiriti i Tanjugut - Agjencisë Jugosllave të lajmeve), me ç’rast në Fushë të Kosovës do të vijë Slobodan Millosheviqi për të vu në veprim

të ashtuquajturën “Lëvizje gjithpopullore serbe për bashkim”, të filluar gjoja spontanisht nga një “komitet i serbeve të rrezikuar të Kosovës”, që udhëhiqte Sholleviq dhe politikanë vendorë serbë nga Kosova, të cilët ndër të parët ishin vu në shërbim të këtij procesi.

Atë ditë, jo vetëm “Rilindja”, por e gjithë Prishtinën ishte në një ankth të madh, ngaqë qysh në mëngjes serbët e Prishtinës, por edhe të ardhurit prej pjesëve të tjera, në shenjë të pritjes “së liderit të madh” dhe të solidarizimit me “Lëvizjen gjithëpopullore serbe për bashkim”, kishin ngulfatur sheshet dhe rrugët e qytetit. Kështu do të zgjatë deri nga mesdita, prej nga pastaj, të organizuar (me autobusë dhe vetura zyrtare) do të drejtohen për në Fushë të Kosovë, ku tashmë ndodhej, si thuhej, “shtabi i serbëve të rrezikuar nga nacionalizmi dhe separatizmi shqiptar”.

Meqë turmat e mëdha të qytetarëve serbë mbroheshin nga policia dhe njësitë speciale nga forcat federative të stacionuara prej vitësh në Kosovë, kalimin për në Fushë të Kosovës e kthyen në një demonstratë serbomadhe, ku kërkesave të njohura politike rreth “bashkimit të Serbisë”, u ishin shtuar edhe ato të natyrës hegjemoniste dhe shoviniste (“*Kosova – djep mesjetar serb*”, “*Shqiptarët përtej Bjeshkëve të Nemuna*” dhe të ngjashme), të cilat spikateshin të shkruara në shumë anë, që edhe thuheshin si në kor nga turma, së cilës i prinin disa banda muzikore frymore romësh, të stolisura me simbole nacionaliste serbe dhe flamuj kishtar.

Që të bëhej me dije se tubimi i Fushë Kosovës ishte vetëm nisma e asaj që do të derdhej kundër institucioneve kulturore dhe arsimore të Kosovës dhe inteligjencies shqiptare, e cila, së paku në planin intelektual, që nga shfaqja e Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave, kishte filluar t’u kundërvihej fushatës hegjemoniste të Beogradi, kreu i demonstruesve serbë (Sholleviqi, Trajkoviqi bashkë me disa shkrimtarë serbë të Kosovës) ndaluan një copë herë para “Rilindjes” për të vjellë vrerin e tyre të njohur kundër botimeve të saj të shumta në gjuhën shqipe nga letërsia, kultura, arti dhe historiografia, për të cilat ajo fajësohej se, në këtë mënyrë, për vite të tëra “kishte indoktrinuuar me nacionalizëm dhe irredentizëm rininë shkollore dhe studentore shqiptare”, e cila pastaj, kishte filluar të demonstronte me “kërkesa shqiptaro-mëdha”!

Prijësit e demonstruesve serbë, krahas “Rilindjes”, me “fajësi” të ngjashme kishin ngarkuar edhe Universitetin e Prishtinës si dhe kuadrot e gjithëmbarshme shqiptare në të (pedagogët, profesorët dhe akademikët), me ç’rast për herë të parë ishte hedhur kërkesa që ai të mbyllej.

Masa kishte përshëndetur me çirrije frenetike kërkesën për mbylljen e Universitetit të Prishtinës në gjuhën shqipe.

“Le të mbyllet fabrika e shovinizmit!”

“Le të mbyllet çerdhja e irredentizmit!”

“Kundërrevolucionarët në burg!”

Kulmi i kësaj histerie kishte arritur kur njëri ndër shkrimtarët serbë të shtëpisë botuese “Jedinstvo” nga Prishtina, recitoi një poezi për “thikën shqiptare”, që serbëve “u ngulitet pas shpine që nga mesjeta e tutje”!

“Vazhdojnë vuajtjet e Simonidës sonë

Shenjtëreshës po i nxirren sytë nga arnautët

Shenjtëresha jonë vajton

Kërkon mbrojtje nga arnautët e egjër

Shenjtëresha jonë e gjorë...

Ky shkrimtar mediokër, i cili deri para pak kohe, për t'u dëshmuar si "partizan i bashkëjetesës me shqiptarët" - që i atij i kishin sjellë poste dhe shpërblime letrare jashtë meritave - kishte shkruar edhe vargje shqip, për t'u larë nga kjo hipokrizi, kishte paditur "klikën politike shqiptare", e cila ia kishte bërë që krijuesit serb "ta humbin dinjitetin" sa t'u vardiseshin shqiptarëve edhe në atë mënyrë!

Vargjeve për "vuajtjet e Simonidës", që edhe më tutje "po i nxirren sytë nga arnautët", të thëna në vajë, do t'u bashkohen edhe oratorë të tjerë nga radhët e "përfaqësuesve të popullit të shtypur serbë" nga pjesët e ndryshme të Kosovës, ndërkohë që "ndalimi i rastit aty", me paralajmërimin se do të kthehet "në një tubim gjithëpopullor serb" po qe se nuk do të plotësohen kërkesat ultimative "që të rrënohet pushteti i nacionalistëve shqiptarë", përfundoi me një liturgji, ku peshkopi serb bëri të ditur se nga ai çast e tutje Kosova quhet *Kosovë e Metohi, ose Kosmet*.

"Aty ku janë kishat serbe, edhe toka është serbe"!

"Shenjtërit serbë ruajnë shpirtin serb..."

"Amen!"

"Amen!"

"Kosmeti shpirti ynë!"

"Kosmeti gjyku ynë që nuk falet!"

"Amen!"

"Amen!"

Masa e dalldisur iu kishte bashkuar liturgjisë dhe shumë prej atyre që i rrinin në krye, po e puthin kryqin në duart e peshkopit, që në atë puthje e sipër, kaloi në duart e atyre që po i prinin marshimit "martirizues" për në tubimin e madh gjithëpopullor serb në Fushë të Kosovës.

Edhe pas largimit të turmës në drejtim të Fushë Kosovës, në hapësirën para "Rilindjes", dukej sikur fryma e liturgjisë serbe edhe më tutje kërcënonte. Pjesa e parkut vazhdonte të mbikëqyrej nga pjesëtarët e shumtë të policisë të vendosur në një autoblinde mu para hyrjes së Pallatit të Shtypit.

Përballë atij shkrimi, pjesa më e madhe e gazetarëve të "Rilindjes" dhe e shkrimtarëve shqiptarë nga redaksitë e ndryshme që ishin pjesë e saj u larguan, meqë druanin nga ngacmimet e ndryshme, që u vinin nga kolegët e tyre të deridjeshëm nga gazeta "Jedinstvo" si dhe shkrimtarët serbë që tubonte kjo shtëpia botuese, shumë prej të cilëve kishte kohë që ishin rreshtuar në anën e asaj që do të kthehet në falangë politike serb e më vonë edhe në atë ushtarake, e cila fillimisht do të sulet kundër autonomisë së Kosovës e më pas do të përfshihet edhe në njësitë paramilitare ushtarake serbe, të cilat do të angazhohen jo vetëm kundër shqiptarëve dhe organizimit të tyre në "shtetin paralel", por edhe për pastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët me mjetet e luftës, që për ta parandaluar do të nevojitej edhe ndërhyrja e NATO-s, e cila erdhi më në fund pikërisht kur Beogradi ndodhej në fazën përfundimtare të sendërtimit të këtij plani morbid.

Për habi, atë demonstrim ndër më frustuesit që ishte shfaqur deri më atëherë kundër "Rilindjes" e kisha përjetuar pa ndonjë shqetësim të veçantë, edhe pse doktor Afrim Bega kishte nxituar që të më gjendej pranë, nga druajtja se kjo do të kishte ndikim te unë. Mbase ndodhte kështu sepse tashmë kisha bindjen se ai bëhej qëllimisht që të frikësohej inteligjencia

shqiptare, e cila kishte filluar të vihej në mbrojtje të interesave të shqiptarëve, ngaqë klasa e saj politike e shpenzuar prej vitesh me kompromise të ndryshme në dëm të vetes, nuk ishte në gjendje që ta bënte këtë.

Ali Bala bashkë me gazetarët tjerë të sportit, më kishin marrë më vete dhe kishim zënë vend në kafenenë “Elida, ku rëndom “gjenin strehim” pjesa më e madhe e gazetarëve, shkrimtarëve dhe intelektualëve të tjerë shqiptarë, të cilët, në saje të aktivizimit të serbëve vendorë dhe të mbështetësve të tyre nga Beogradi (që u vinin si përforcime), pak nga pak kishin filluar ta humbnin edhe hapësirën e tyre në Pallatin e Shtypit, por edhe nëpër shoqata dhe madje edhe në Universitet, ku shumica e dekanëve nëpër fakultete, me arsyetimin “e përforcimeve” me “ekspertë dhe shkencëtarë” ose edhe “të vendosjes së masave të dhunshme” nëpër institucione, ishin zëvendësuar me “të ardhur” nga Beogradi ose me militantë vendorë.

Megjithatë, ndonëse në pjesën tjetër, dhe së paku jashtë trysnisë së drejtpërdrejt të demonstrimit të turmës, njëri nga bashkëpunëtorët e redaktorit të sportit (Bekim Shpati, një gazetar me përvojë që komentonte futbollin dhe gjatë kohë kishte qenë përfaqësues i sportit të Kosovës në forumet federative), kishte treguar shenjat e një shqetësimi të madh. Për fat, aty ishte doktor Afrim Bega, i cili kishte ndërhyrë me të shpejtë dhe, pasi që i ishte bërë një vend në pjesën e skajshme të kafenesë, i kishte ndihmuar ta përballonte krizën e çastit.

Por, puna nuk kishte mbaruar me aq, meqë gazetari Bekim Shpati, sipas vlerësimeve të doktor Afrim Begës, edhe më tutje kishte pasur nevojë për një trajtim tjetër mjekësor në Klinikën e Psikiatrisë të Spitalit të Prishtinës. Kështu, pasi që rrugët ishin liruar nga turmat e mëdha të demonstruesve serbë, që tashmë ndodheshin në tubimin e Fushës së Kosovës, me një veturë të njërit prej gazetarëve të “Rilindjes”, bashkë me doktor Afrim Begën dhe me gazetarin e sportit, iu drejtuam Spitalit të Prishtinës. Në hyrje të Klinikës po na priste redaktori Ali Bala, me një tjetër. Ishte i vëllai i gazetarit Bekim Shpati, të cilit disi i kishte shkuar lajmi dhe kishte nxituar t’i vinte në ndihmë.

Doktor Afrim Bega, ia kishte bërë me dije se nuk kishte arsye për ndonjë shqetësim, pasi që bëhej fjalë për një gjendje stresi që ishte e natyrshme në ato rrethana. Por, parashikimet optimiste të doktor Afrim Begës, do të përmbysen po atë natë, meqë gjendja shëndetësore e gazetarit Bekim Shpati, jo vetëm që nuk ishte qetësuar, por ajo ishte përkeqësuar dukshëm nga mesnata dhe me të shpejtë ishte dërguar në Stacionin e Emergjencës, ku nga mëngjesi, nga një infarkt i rëndë, kishte vdekur...

Lajmin për vdekjen e gazetarit të njohur të “Rilindjes” Bekim Shpati e mësova nga doktor Afrim Bega. Ishte shumë i prekur kur ma bëri me dije se çfarë kishte ngjarë nga mesnata deri në mëngjes.

“Dukej se ishte një shqetësim kalimtar, por u pa që ai ishte një paralajmërim i më të keqes...Ç’ e do që po jetojmë në një kohë vrastare...”

Vdekja e gazetarit të “Rilindjes” Bekim Shpati nuk kishte qenë as e para e as e fundit e asaj natyre. Kisha njohuri se ato, si të kurdisura ose si pjesë e reprezaljeve ndaj çdo përpjekjeje që lidhej me përhapjen e gjuhës shqipe dhe të mendimit shqiptar, kishin filluar moti, qysh atëherë kur kjo gazetë e vetme në gjuhën shqipe, kishte filluar të bëjë shkitje nga koncepti socrealist i informimit me ç’rast i ashtuquajturit shtyp në gjuhën amtare, që u takonte “pakicave”, duhej të mbetej në kornizat e propagandës së përkthyer nga qendra, pra nga Beogradi dhe asgjë tjetër. Kështu, viktimë e parë, që do t’u prijë edhe shumë e shumë të

tjerave deri te kjo e fundit, do të jetë vetë drejtori i parë i saj, Xheladin Hana, pjesëmarrës i Kuvendit të Bujanit dhe njëri ndër hartuesit e dokumenteve të saj, një intelektual i njohur nga radha e atyre që midis dy luftërave ishin shkolluar në Shqipëri, që sipas të gjitha gjasave do të vritet në vitin 1949, edhe pse propaganda partiake e kohës këtë do ta tregojë si vetëvrasje “nga shkaqe shëndetësore”.

Por, ndjekjet dhe burgosjet e shumta që do t’u nënshtrohen gazetarët e edhe bashkëpunëtorët e saj të shumtë (shkrimtarë, historianë dhe artistë), nuk do ta pengojnë që kjo gazetë, në fushën e kulturës dhe të krijimtarisë të ndiqte kursin e afirmimit kombëtar. Andaj, nuk është e rastit se nga shtojca javore e kulturës për herë të parë të shtrohet edhe kërkesa për unifikimin e gjuhës shqipe, që do të ndodhë në vitin 1972 në Tiranë kur do të aprovohet norma e përbashkët për shqipen letrare, një fitore e madhe historike e shqiptarëve, me të cilën murit të tyre të ndarjes shpirtërore do të fillojnë t’i hiqen gurët e rëndë, që më vonë do të çojnë edhe te rrënimi i tij përfundimtar.

Nga kjo pikëpamje “Rilindja” bashkë me institucionet tjera me frymë kombëtare (Universiteti i Prishtinës, Akademia e Arteve dhe e Shkencave, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Enti për Botimin e Teksteve Shkollore dhe të tjera), do të gjenden në ballë të mbrojtjes së qenies kombëtare dhe institucionale të Kosovës prej nga, pas rrënimit të autonomisë së Kosovës me dhunë si dhe okupimit të të gjitha institucioneve të saj nga Beogradi, jo rastësisht do të fillojnë edhe nismat e fuqishme për organizim politik të shqiptarëve, të cilat pasqyrimin më të fuqishëm do të gjejnë më 23 dhjetor të vitit 1989 me themelimin e *Lidhjes Demokratike të Kosovës*, si parti e parë shqiptare, që si dihet, pas pak do të kthehet në një lëvizje gjithëpopullore shqiptare, e cila do të marrë përsipër dy veprime paralele historike: rrënimin e komunizmit në Kosovë dhe atë të shpërndarjes së Kosovës nga Serbia, me çka përfundimisht do t’i hapen dyert proceseve që do të çojnë kah pavarësia e Kosovës.

JETËT PARALELE

(Bashkim Kosova flet për jetën e dyfishtë “paralele”: atë që ka të bëjë me kyçjen në Lëvizjen kombëtare, e cila filloi me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës më 23 dhjetor 1989, në Kuvendin Themelues të së cilës ai do të marrë pjesë, si dhe për ndarjen familjare, kur Drita dhe i biri Valnori, për shkaqe shëndetësore do të detyrohen të largohen në Kroaci e pastaj në Austri, ndërsa ai do të mbetet në Prishtinë, ku edhe do të burgoset dhe do të dënohet me pesë vjet e dy muaj heqje lirie nën akuzën se ishte përfshirë në strukturat përgjegjëse për organizimin e vetëmbrojtjes që vepronin në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës).

Është folur dhe është shkruar shumë për të ashtuquajturën “Jetë paralele” në Kosovë, e cila do të shfaqet si pjesë e lëvizjeve kombëtare që nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës më 23 dhjetor 1989 e deri te fillimi i bombardimeve të NATO-s ndaj pozicioneve ushtarake serbe në Kosovë dhe pjesët tjera të Serbisë nga 24 marsi deri më 10 qershor të vitit 1999. Dhe ky organizimi kundër pushtimit serb, historikisht ndër më të fuqishmit dhe më të suksesshmit nga viti 1912 e tutje, nuk do të ishte i tillë, pa përfshirjen në të të gjitha

shtresave shoqërore dhe rrymave të ndryshme nga ato çlirimtarët të filluara nga pushtimi i serb i Kosovës në Luftërat Ballkanike dhe të ripushtimit të saj pas përfundimit të Luftës së Dytë, të atyre për bashkim kombëtar, qoftë edhe nën petkun revolucionar të shfaqura nga fundi i viteve të pesëdhjeta, dhe atë ideologjik të zhvilluara në vitet e gjashtëdhjeta, për të vazhduar pastaj me ato për barazi, të formuluar nga vitit 1968 me rastin e shpërthimit të demonstratave të para, të cilat për kërkesë do të kenë ngritjen e statusit të Kosovës në republikë të barabartë me të tjerat në federatën jugosllave, kërkesë kjo që fuqishëm do të përsëritet me një dinamikë vepruese edhe në demonstratat e mëdha të vitit 1981 për të vazhduar kështu gjithnjë edhe në programin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, me ç'rast jetësimi i saj do të nisë pasi që më dy korrik të vitit 1990 deputetët e Kosovës shpallën Deklaratën Kushtetuese, ndërsa më 7 shtator të atij viti, Kuvendi i Kosovës, në Kaçanik shpalli Kosovën Republikë, prej nga fillon organizimi i shtetit paralel të shqiptarëve, që bashkë me rezistencën e armatosur që do të shfaqet më vonë kur do të dalë në skenë "Ushtria Çlirimtare e Kosovës", do të çojë edhe deri te krijimi i rrethanave për shpalljen e shtetit të pavarur të Kosovës.

Natyrisht se "jeta paralele" në rrafshin shoqëror dhe atë politik, kishte edhe "jetët paralele" – një shumësi dramash, fatkeqësish dhe tragjedish madje të vogla dhe të mëdha, të para dhe të papara, të shënuara e të pashënuara, cilat ishin pjesë e pandashme e kësaj historie.

Nëpër këto drama të shumta, që do ta rrumbullakojnë dramën tonë të madhe, atë që mund të quhet jetësore, të cilën nuk do të mund ta ndreq as ndërhyrja shpëtimtare e NATO-s, as vendosja e protektoratit ndërkombëtar pas nxjerrjes së Serbisë nga Kosova, e sigurisht se nuk do ta ndreqë as shpallja e shtetit të Kosovës që si projekt evropiano-perëndimor do të bëhet një ditë, si pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës, në të do të përfshihem edhe unë dhe familja ime, prej nga do të mbesim të ndarë dhe me plagë të rënda shpirti, por që ngushëlluese në gjithë këtë shfaqet se nuk e kishim humbur atdheun, ku mund të varrosemi bashkërisht...

Por pasqyrimi i ndërlikushmërisë midis "jetës paralele" - si projekt yni shoqëror dhe politik për t'iu kundërvu pushtimit serb prej nga do të dalë edhe shteti ynë dhe, "jetëve tona paralele" - si pjesë e mbijetimit në rrethanat jetësore ndër më të veçantat me gjendje të jashtëzakonshme dhe me ato të lufës, të cilat nuk vareshin prej nesh, gjithsesi se nxjerr në dritë vartësitë dhe kushtëzimet midis tyre, ku mund të thuhet se "jetën paralele" e kishim *përcaktim* të domosdoshëm patriotik nga i cili nuk kishte shmangie, ndërsa "jetët tona paralele" i kishim *fat dhe fatkeqësi* madje. Dhe meqë *përcaktimi është pjesë e një qëllimi, ndërsa fati është i pashmangshmen*, atëherë mund të thuhet se të parën e kërkova dhe iu bashkova, ndërsa e dyta më gjeti.

Natyrisht se në këtë lëvizje të madhe institucionale ndër më madhoret e historisë sonë më të re, prej nga do të dalë edhe "shteti paralel", si për të tjerët, kishte vend edhe për mua. Mund të them se futja në këtë lëvizje, qysh nga fillet e saj, pra nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në Kuvendin Themelues të së cilës mora pjesë, paraqiti ilaçin më të mirë për ta përballuar depresionin dhe gjendjen e rëndë shpirtërore në të cilën isha futur qysh nga dueli im i fundit në Kampionatin Botëror të Boksit në Toronto të Kanadasë në verën e vitit 1986, kur nuk m'u lejua të luftoj për titullin e kampionit botëror që e kisha aq afër me çka sendërtohej ideali im për të arritur majat në përputhje me atë amanetin që kisha nga fotografia e tim Atë në valixhe rreth ndjekjes së vullnetin për fuqi dhe betimin që ia kisha

dhënë dashurisë sime të parë dhe të vetme në jetë, Nora Bardhit, se medalja më e madhe do t'i kushtohej asaj.

Në të vërtetë, pjesë e asaj lëvizjeje, do të ndjehem ditën që do të nis punën në “Rilindje”, ngaqë asaj, jo vetëm për mua por edhe për shumë e shumë të tjerë, do t'i shërbejë mbledhja komemorativë e mbajtur me rastin e vdekjes së gazetarit Bekim Shpati, i cili pësoi infarkt nga shqetësimi të madh gjatë mitingut protestues të serbëve dhe malaziasve para “Rilindjes”, kur turma e madhe e militantëve, në rrugë e sipër për në Fushë Kosovë, zunë të kërcënohen se do të kallin çdo gjë shqiptare.

“Nuk kemi nga t'ia mbajmë. Jemi të gjykuar të luftojmë ose të asgjësohemi turpshëm.”

Me këto fjalë, Ali Bala njëri nga oratorët e tubimit, nxori përfundimin se shqiptarëve tashmë botërisht u ishte shpallur luftë.

Ai me këtë rast citoi fjalën e poetit Komneniq :“me shqiptarët jemi në luftë”, të thëna ditë më parë në Beograd me rastin e duelit të shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë, që ishte mbajtur në Universitetin e Kollarcit para një publiku të gjerë intelektual dhe shkencor dhe diplomatëve të huaj, kur ai, i revoltuar pse shkrimtarët shqiptarë ia kishin arritur ta fitojnë duelin intelektual ndaj shkrimtarëve serbë.

Dhe, me atë që kishte thënë se “jemi gjykuar të luftojmë, ose të asgjësohemi”, Ali Bala, si pjesa më e madhe e intelektualëve shqiptarë, fillimisht kishte menduar për luftën politike, edhe pse që të gjithë ishin të vetëdijshëm se pas saj do të shfaqej edhe ajo e njëmendta, meqë Beogradi, me nxjerrjen në pah të Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Artëve, tashmë kishte treguar se ishte në rrugë e sipër që ajo që deri më atëherë quhej Jugosllavi e Titos ta kthente në Serbi të zgjeruar, pra në një vend të dominuar prej serbëve, dhe se këtë do ta bënin me hatër ose me dhunë. Millosheviqi këtë e kishte thënë në Gazimestan, me rastin e përkujtimit të 600 vjetorit të betejës së Fushës së Kosovës në praninë e një milion “pelegrinëve”serbë të dalldisur me fanatizëm, që i kishte sjellë nga të gjitha anët e vendit, me ç'rast, krahas shqiptarëve, ai do t'u kërcënohet edhe të tjerëve në Jugosllavi që do ta pengonin në këtë rrugë, dhe po ashtu kërcënime do t'i drejtoj edhe faktorit ndërkombëtar, që ta pranonte “vullnetin e popullit serb”, i cili nuk mund të pranonte pafundësisht “që në kohë paqeje t'i humb ato që i ka fituar me luftë”.

Dhe dita e shpalljes së luftës në Gazimestan, që një ditë mëgjithatë do të vijë, do të më mbetet në kujtesë edhe për diçka tjetër, që jetës sime i dha një kuptim të veçantë, pikërisht të tillë siç e kishte paraparë edhe doktor Afrim Bega kur do t'ia krijojë rrethanat bashkimit tim me Drita Rracin, asaj që do të kthehet në një lidhje tonë të përhershme jetësore ndër më të rëndësishme dhe ndër më të fuqishmet, pa marrë parasysh ndarjen që do të na hyjë pas pak dhe e tillë do të mbetet përgjithmonë, për të cilën do të bëhet fjalë pak më vonë.

Pra, atë ditë lindi *Valnori* ynë. Erdhi sikur të ishte një ngushëllim për ato sulme të njëpasnjëshme, që përjetonim nga dita që ishim bashkuar dhe tashmë kërcënonin jo vetëm lidhjen tonë, por edhe qenien si njerëz dhe shoqëri dhe, mund të thuhet se erdhi ngushëllim edhe për ato që do të vijnë pak më vonë...

Në të vërtetë, të strehuar në barakat e skajshme ngjit me Klinikën e Psikiatrisë dhe nën përgjimin e përhershëm të doktor Afrim Begës, përpiqeshim që ato që ndodhnin në atë kohë e gjendjes së jashtëzakonshme, e cila nuk do të vonojë e do të kthehet në një shtetrrëthim të ashpër, që dikur do të arrijë edhe gjendjen e luftës, t'i marrim si pjesë e përditshmërisë së

pashmangshme, me të cilën duhej të përballeshim siç përballeshin të tjerët, dhe të vepronim siç vepronin të tjerët, që do të thotë se edhe ne prananim rregullat e jetës paralele, të cilat do të vendosen sapo të fillojë organizimi i lëvizjes kombëtare, me të cilën shqiptarët i kundërviheshin pushtimit serb me anën e pushtetit të tyre paralel, pra te një vetorganizimi të paparë deri më atëherë, me ç'rast u krijuan institucionet e shqiptarëve që nga arsimi, shëndetësia, solidariteti, mbrojtja dhe vetëmbrojtja, por që ato kërkonin sakrifica të veçanta dhe nuk përjashtonin fatkeqësi të tjera, siç ishte ajo që kishte të bënte me pastrimin e plotë etnik të Kosovës prej nesh...

Në ato rrethana, kur dhuna e pushtetit serb po prekte çdo pore të jetës sonë dhe ajo tashmë kërcënonte me të madhe se nuk do të linte gurë pa përmbysur, gjë që për ne që kishim kaluar nëpër thyerje të rënda edhe para se të ndodhte kjo, kishim arsye edhe më të mëdha për shqetësim, Drita Rraci, ma bëri të ditur se kishte mbetur shtatzënë.

“Po ndjej një dridhërimë kënaqësie ndër më të jashtëzakonshmet e jetës sime”.

Kur m'i tha këto ma bëri të ditur po ashtu se ndjenja e shtatzënisë ia kishte ndryshuar për të mirë rrënjësisht qëndrimin ndaj botës dhe jetës madje. Shtoi se nëse deri më atëherë kishte hetuar një ndjenjë frike të brendshme, të kushtëzuar nga zhvillimet e jashtme, nga ai çast, përjashtonte çfarëdo druajtje.

E mora ngryk sikur të isha fëmijë që kërkon strehë nga e ëma, që i kthehet pas ndonjë ikje të paparalajmëruar. Një copë herë mbeta ashtu në atë shtrëngim ndërkohë që mendja ime po mudohej të përfytyronte përmasat e atij ndryshimi të jashtëzakonshme, që më përçoi fund e krye dhe sakaq bëri të ndjehem tjetër për tjetër, jashtë dilemave me të cilat, desh a pa deshtë rropateshe rreth asaj se çfarë mund të ishte e nesërmja jonë gjithnjë e kundruar nga këndvështrimi i një paqartësie të frikshme.

Ajo qau nga një ndjenjë përmbushëse, që nuk mund të shpjegohet me fjalë, ndërsa unë i premtova se nga ai çast e tutje jeta jonë kishte vetëm një përkushtim – fëmijën tonë të ardhshëm. Zhvillimi dhe lindja e tij mbetej çështje e çështjeve për ne.

Dhe, me këtë përkushtim, ne do t'ia dalim t'i përballojmë që të gjitha ato shqetësime, që kishin qenë aq të mëdha sa do të zgjasë shtatzënia e Dritës. Vlen të thuhet se ndërkohe deri te lindja e Valnorit, kishte qenë plot e përplot ngjarje, që ishin vendimtare për zhvillimet e mëtutjeshme, shumë prej të cilave do t'ia përcaktojnë kahun historisë më të re të Kosovës, por njëherësh bënë që edhe jeta jonë të vihet në binarë paralel dhe madje të marrë kahun e padëshirueshëm që mori për të na ballafaquar me ndarjen e përhershme, pa marrë parasysh ndjenjën e lidhjes së përjetshme edhe larg njëri tjetrit si diçka që jetës i jep kuptim të veçantë.

Kështu, pas rrënimit me dhunë të autonomisë së Kosovës, që nga shqiptarët do të vlerësohet si ripushtim i Kosovës nga ana e Serbisë (i treti me radhë nga ai vitit 1912), elita intelektuale e shqiptarëve, kryesisht shkrimtarë, gazetarë të “Rilindjes” por edhe intelektualë nga radhët e Universitetit të Prishtinës, institutet hulumtuese dhe shkencore si dhe inteligjencia e gjerë, pra pjesa më e ndërgjegjshme e shoqërisë sonë, e cila edhe deri më atëherë kishte bartur barrën e kundërvënies programeve serbomëdha mbi të cilat tashmë kishte filluar të orientohet politika hegjemoniste e Beogradit, siç ishte Memorandumi më i ri i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, filloi përpjekjet për një organizim të ri politik të shqiptarëve. Kjo ishte më se e domosdoshme dhe një përgjegjësi e madhe historike madje, sepse në rrethanat kur klasa e deriatëhershme politike ndonëse e shpenzuar dhe vazhdimisht në kursin e kompromiseve të dëmshme, dhunshëm ishte nxjerrë nga loja, ndërkohë që

priteshin çrregullime të mëdha në vend dhe më gjerë madje, intelektualët shqiptarë ishin të thirrur me marrë përsipër fatet e popullit të mbetur pa udhëheqje.

Më kujtohet se një mbrëmje, kur si rëndom merreshim me Valnorin tonë dhe përpiqeshim që me buzëqeshjen e tij të ëmbël, të anashkalonim ato që vinin nga jashtë, doktor Afrim Bega më tha se do të formohej partia e parë politike e shqiptarëve. Ma bëri të ditur se kishte shumë mjekë dhe të tjerë nga Klinikat të përfshirë në këtë projekt, veçmas ata të cilët kohë më parë kishin mundësuar krijimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Njerëzore, një si degë e Komitetit të Helsinkit, me çka ishin nxjerrë në pah shumë nga shkeljet e rënda që u bëheshin shqiptarëve nga regjimi i Beogradit.

“Aty ka vend edhe për ty”.

Më shikoi një copë herë, sikur të kërkonte miratimin tim dhe u largua.

Fillimisht largimi i tij nuk më bëri gjithaq përshtypje, meqë isha mësuar me ardhje-shkuarjet e tij të vazhdueshme, të cilat njëherësh paraqisnin njëfarë mbikëqyrje ndaj gjendjes sonë shëndetësore, por pas pak jehona e atyre fjalëve po më kthehej në një sëmbim të brendshëm, veçmas pse ai kishte thënë se aty kishte vend edhe për mua, që do të thoshte se kërkohej angazhimi im në një zhvillim politik, i cili deri më atëherë për mua ishte i papranueshëm pikërisht pse doktor Afrim Bega këtë e kërkonte me arsyetimin se kishin qenë trysnitë politike ato që kishin shkatërruar karrierën time sportive dhe më kishin futur në krizën e thellë shpirtërore, të cilën ndonëse dukej se e kisha përballuar, ajo edhe më tutje kërcënonte të më kthente në një gjendje të rëndë.

Por, si do të shihet, doktor Afrim Bega kur më kishte thënë se kishte vend edhe për mua në atë punë, kishte paraparë se pyka nxirret me pykë, pra që një depresion i thellë me shkaqe politike, të shërohej me anën e një angazhimi shoqëror dhe patriotik madje, i cili ishte i domosdoshëm në ato rrethana. Ndaj, mbetja ime jashtë, mund të kishte pasoja të rënda edhe për shëndetin tim, të cilit i duheshin sfidat e mëdha, ato historike...

Kujtoj se doktor Afrim Bega kishte të drejtë. Sepse, çfarëdo përpjekje t’u bishtnoja atyre që ngjisnin duke u strukur dhe shtirur sikur nuk po ndodh gjë, do të më sillte para shqetësimeve të tjera, në radhë të parë psikike, të cilave asnjë terapi nuk do t’u bënte punë. Që të ishte edhe më i drejtpërdrejtë më tha se ishte ardhmëria e Valnorit ajo që në ato rrethana kërkonte përgjigje prej nesh.

Do të mjaftonte vetëm ky vlerësim i doktor Afrim Begës, që të ta arsyetonte qëndrimin time për t’u kyçur në atë që do të kthehet në lëvizje kombëtare. Sepse, si do të shihet, të menduarit rreth ardhmërisë së tim biri, në të vërtetë për herë të parë më ballafaqonte me çështjen e një përgjegjësie jashtë atyre që në njëfarë mënyre te unë, prej kohësh, ishin të fiksuara si ideale, që lidheshin me arritjen e majave, të cilën e kisha nga ajo porosia që më bëhej se më vinte nga fotografia e vetme e tim Atë në valixhen e vjetër dhe me betimin ndaj dashurisë së vetme të jetës sime, Nora Bardhit. Në ato rrethana, vendin e atyre që te unë kishin shkaktuar trauma të rënda, pse nuk ishin përmbushur ose rrethuar dhunshëm, tashmë e kishte zënë Valnori dhe ardhmëria e tij. Por, për të duhej të luftohej, në mënyrë që ajo të sigurohej, pa marrë parasysch çmimin që duhej paguar për të. Sepse, ne mund të iknim nga ato që ndodhnin dhe madje me këtë disi edhe të mbroheshim, por kjo nuk vlente për fëmijën tonë.

Këtë mendim kishte edhe Drita Rraci. Si nënë, jo vetëm që kishte përballuar frikën nga ndikimi i sfidave të të kaluarës, siç ishte ndjenja e humbjes së Valonit dhe rreziku që

ideali i asaj dashurie t'ia pengonte të tjerat, por ajo thuhet se çdo gjë lidhte me mirëqenien e të birit.

“Jetoj për tim bir...Jeta ime e tëra i kushtohet atij...”

Ky qëndrim jo vetëm që na kishte bashkuar shpirtërisht, por ai kishte përcaktuar edhe veprimet tona jetësore, nga ndër më të drejtpërdrejtat deri te ato qenësoret, gjë që në përputhje me të ishin edhe sjelljet tona të mëtutjeshme, të cilat, së paku për nga dramën që do të përjetojmë, do të na barazojnë me të tjerët.

Kështu, kujdesi i deriatëhershëm të mos ngacmohemi gjithaq nga trysnitë ditore të realitetit të gjendjeve të jashtëzakonshme nëpër të cilat kalohej, do të kthehet në një përkushtim të përfshirjes në lëvizjen e kundërvënies atyre.

Doktor Afrim Begës i thashë se do të marr pjesë në Kuvendin Themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, meqë aty ishte vendi me u dëshmue përkushtimi ndaj një ardhmërie tjetër farë, e cila mund të përcaktohej prej nesh, me kusht që aty të gjendeshim bashkërisht dhe të flasim me një gjuhë.

Ai ma ktheu se kisha të drejtë dhe ma bëri të ditur se do të shkonim bashkë në Kuvendin Themelues që do të mbahej pas dy ditësh në ndërtesën e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

Mendja ma thotë se doktor Afrim Bega, edhe pse dukej se është i përfshirë në zhvillimet në të cilat shumica e mjekëve të Klinikës së Universitetit të Prishtinës, pjesëmarrjen në Kuvendin Themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që do të mbahet më 23 dhjetor, e kishte nga detyrimi që si mjek imi të më shoqëronte. Sidoqoftë, ne kishim shkuar aty dhe më kujtohet se hyrja ime në barakën e ngushtë të Shoqatës së Shkrimtarëve ishte pritur me dashamirësi nga ata intelektualët, të cilët tashmë kishin marrë përsipër organizimin e themelimit të partisë, të cilët në atë kuvend njëherësh do të marrin përsipër edhe përgjegjësinë e drejtimit saj për ta kthyer atë në një lëvizje kombëtare, ndër më të mëdhatë dhe ndër më të suksesshmet me të cilën do të vihet në binarë të pakthyeshëm historik lindja e shtetit të Kosovës.

Ballafaqimi im i parë me intelektualët e rëndësishëm, të cilët në tavolinën e vetme që ishte vendosur në pjesën ballore po pritnin ata që do t'i përgjigjeshin thirrjes së tyre, bëri që të ndjehem ndryshe, jashtë ngufatjeve të brendshme dhe stresit të përgjegjësisë. I gjendur për herë të parë në atë ambient për të cilin kohëve të fundit flitej aq shumë dhe midis atyre që tashmë kishin paralajmëruar se po merrnin përsipër një përgjegjësi historike ndër më të rëndësishmet e kohës, sakaq hetova se isha pjesë e një vlere. Mendja ma thotë se kapërcimi thuhet se i jashtëzakonshëm nga njëra gjendje në tjetrën, pra nga ajo ndjenja e hiqit te ajo e dikushit, ishte përshpejtuar me ato që Kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve m'u kishte drejtuar me fjalët “kampion i kampionëve” dhe “ambasadori ynë më i fuqishëm në botë”, për të shtuar se para meje dhe para secilit prej nesh tashmë binte përgjegjësia që fëmijët tonë të fitonin mundësinë të bëheshin edhe kampionë botërorë dhe për këtë të krenoheshin.

“Ke ngritur lart emrin dhe dinjitetin e Kosovës. Por, ne bashkërisht do të bëjmë që fëmijët tanë dhe fëmijët e fëmijëve tanë të jetojnë në një Kosovë të lirë dhe demokratike, në një Kosovë pjesë e qytetërimit perëndimor, prej nga do të kenë mundësi të arrijnë edhe oltarin botëror”.

Edhe të tjerët, që kishte pranë më përuruar. Njëri prej tyre tha diçka rreth duelit tim për titullin e kampionit olimpik në Los Anxhelos si dhe për ato që kishin ndodhur përreth

ringut (sigurisht se fjalën e kishte për demonstratat e zhvilluara me atë rast ku ishte spikatur parulla “Kosova republikë” dhe të ngjashme), por nga emocionet nuk isha në gjendje të kapja gjithë ato që thoshte, të cilat më bëhej se i ngjyroste edhe me çështje të tjera.

Megjithatë, duke parë elitën intelektuale në tavolinën ballore duke pritur pjesëmarrësit e kuvendit si dhe duke marrë me mend druajtjen e tyre që kishin për rrjedhën e atij tubimi, i cili si do të shihet do të kthehet në një ngjarje historike, që do të ndikojë drejtpërdrejtë rrugën e shkëputjes së Kosovës nga kthetrat e pushtimit serb dhe të bartjes së saj në binarët e shtetndërtimit, ai përballim, se si ma krijoi pamjen e një dueli të madh, të ngjashëm me atë të boksit, ku në njërin anë ndodheshin intelektualët shqiptarë dhe në tjetrën ata serbë, të cilët në vend të dorëzave kishin libra, harta, pergamene dhe gjithfarë dokumentesh, me të cilat ata mundoheshin të pushtonin hapësirën e ringut, e ku librat serbe, si më të shumta, në vend të shkronjave fshihnin thika të përgjakura...

Në të vërtetë, atë përfytyrimi e kisha qysh nga koha e atij që quhej “duel” i shkrimtarëve shqiptarë me ata serbë, që ishte mbajtur në prillin e vitit të kaluar në Beograd, që sipas vlerësimeve të medieve serbe u dash të ndërpritej nga shkaku se shkrimtarët shqiptarë, në vend se të përdornin argumentet shkencore dhe ato intelektuale, që “nuk mund t’i kishin”, “ishin shërbyer”, si thoshin “me propagandë irredentiste shqiptaromadhe”, të cilën e kishin “nga politika antiserbe e zhvilluar prej vitesh në Kosovë” dhe të ngjashme, me çka fushatës së deriatëhershme politike kundër udhëheqjes politike të Kosovës, do t’i shtohet ajo kundër intelektualëve dhe institucioneve kulturore dhe arsimore të Kosovës, në mënyrë që me ato pretekste ato të rrënohen ose të mbyllen, siç do të ndodhë, ndërkohë që me atë etiketë, shkrimtarët dhe intelektualët shqiptarë, sipas nevojës, jo vetëm që mund të ndiqeshin edhe penalisht, por atyre do t’u merret çfarëdo mundësie që të mbronin subjektivitetin shtetëror të Kosovës përballë ofensivës serbe të Beogradit me të cilën Kosovës do t’i imponoheshin ndryshimet kushtetuese me të cilat ajo praktikisht kthehej në një provincë serbe në përputhje me konceptin e Memorandumit më të ri të akademikëve serbë, të cilin politika serbe e kishte pranuar në tërësi dhe e kishte kthyer në një program të veprimit politik...

Se dueli midis intelektualëve shqiptarë dhe serbë i filluar në Beograd përnjëmend do t’i ngjajë atij ku shkronjat ktheheshin në armë dhe fjalët në urdhra për vrasje, kjo do të shihet me të shpejtë. E befasuar me përfshirjen thuajse që të gjithë shqiptarëve në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe rrënimin e plotë të komunizmit në Kosovë, Serbia do të kundërpërgjigjet me represion të përgjithshëm ndaj popullatës shqiptare si dhe institucioneve të tyre kulturore dhe arsimore. Kjo sjellje do të ashpërsohet veçmas pasi që Lidhja Demokratike e Kosovës, që tashmë me mbi shtatëqind mijë anëtarë, si parti më e fuqishme në hapësirat e ish Jugosllavisë dhe në përgjithësi në botën shqiptare kishte mandatin e gjithë popullatës shqiptare, do të marrë përsipër krijimin e infrastrukturës juridike dhe politike që Kosova në mënyrë legjitime së pari të shkëputjes nga Serbia dhe pastaj të përcaktohej edhe për fatin e vet në përputhje me rrethanat e reja, por gjithnjë si subjekt i pavarur që vendos për fatin e vet. Kjo do të arrihet me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990, pastaj me Kuvendin e Kaçanikut më 7 shtator të po atij viti kur Kosova do të shpallet republikë për të vazhduar pastaj me Referendumin për pavarësi që do të mbahet në vitin e ardhshëm, proces ky që do të përmbillet me sukses me zgjedhjet e para të lira pluraliste të cilat do të mbahen në prillin e vitit 1992 prej nga do të dalë edhe parlamenti i parë i Republikës së Kosovës.

E ndjejë për nder të them se këtij parlamenti do t'i takoj. Në listën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për nga votat e fituara, isha diku në krye të listës. Kjo mbase ishte edhe e arsyeshme pasi që shqiptarët e Kosovës krahas besimit të madh që kishin ndaj intelektualëve të tyre të njohur, të cilët kishin marrë përgjegjësinë për fatet e vendit në rrethanat më dramatike, respekt të madh tregonin edhe për ata, të cilët me punën dhe veprën e tyre, në një përballje të brendshme, por edhe të jashtme, kishin ngritur lart dinjitetin e Kosovës. Sukseset e mia të jashtëzakonshme në sport (titujt e shumtë që kisha fituar nga ai i Kosovës, i Jugosllavisë si dhe ata në arenën ndërkombëtare: i kampionit të Ballkanit, të Evropës, titulli i kampionit olimpiq dhe deri te ai i nënkampionit të botës), kishin bërë që të kthehem në idhull të tyre. Kësaj i kishte ndihmuar edhe qëndrimi im për t'i përkrahur demonstruesit, të cilët fitoret e mia në ndeshjet e boksit i shfrytëzonin për të nxjerrë parullën Kosova Republikë, që unë disa herë e kisha mbrojtur si të drejtë të shqiptarëve për t'u barazuar me të tjerët, gjë që kjo kishte qenë edhe arsyeja pse politika e Beogradit kishte bërë çmos t'i pengonte sukseset e mia sportive e mbi të gjitha titujt në arenën ndërkombëtare të boksit, siç kishte qenë ai i kampionit botëror në Toronto të Kanadasë kur ia kishte dalë të më privonte nga titulli i më të mirit në botë, por jo edhe ta ndalojë kërkesën për Republikën e Kosovës, që ajo të marrë përmasat që mori.

Zgjedhja për deputet të Parlamentit të parë plural të Kosovës, më barti thellë e më thellë në strukturat e shtetit paralel të Kosovës, që nisi të instalohet pas formimit të qeverisë së Kosovës. Fillimisht isha i angazhuar në Këshillin e Emergjencës, por pas pak prej meje u kërkua që të merrja pjesë në strukturat e vetëmbrojtës popullore, të cilat kishte filluar t'i ndërtonte Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kështu, për herë të parë u gjenda midis ushtarakëve të shumtë me grada të ndryshme nga ato më të ulëtat e deri më të lartat që shkonin edhe te gjeneralët, të cilët deri pak më parë kishin qenë të përfshirë në sistemin e vetëmbrojtjes ose si oficerë aktivë në kuadër të Armatës Popullore të Jugosllavisë, prej nga një pjesë e madhe e oficerëve shqiptarë ishin larguar...

Natyrisht se detyra ime në atë sistem ishte kryesisht e një natyre më shumë psikologjike se sa ushtarake, meqë emri im dhe prania ime duhej t'i shërbente mobilizimit dhe përfshirjes së gjerë të të rinjve në to, gjë që kështu edhe do të ndodhë. Si do të shihet më vonë, kur do të fillojë të përshkallëzohet dhuna policore dhe ushtarake serbe, puna ime në këto struktura kaloi edhe te organizimi i drejtpërdrejtë i rezistencës së armatosur, paçka se për pasojë pati ndjekjet dhe burgosjen time bashkë me shumë e shumë të tjerë si dhe dënimin me heqje liri prej pesë vitesh e dy muajsh, që do t'i mbaj në burgun e Nishit, prej nga dola në vjeshtën e vitit 1998 kur tashmë në Kosovë rezistenca e armatosur për t'iu kundërvënë ofensivës ushtarake serbe, më shfaqjen e njëjësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kishte hyrë në një fazë të luftës aktive, e cila gjatë asaj vere Kosovën e kishte kthyer në një fushëbetejë të hapur midis ushtrisë pushtuese dhe çlirimtarëve shqiptarë me çka çështja e Kosovës ishte kthyer në një krizë të përmasave ndërkombëtare, që kishte lëvizur diplomacinë dhe politikën e niveleve më të larta ndërkombëtare drejt zgjidhjes së saj me ndërhyrje të armatosur, siç ishte ajo e NATO-s pas një viti...

Por, para se të vijë deri te kyçja ime me përkushtim të plotë në strukturat paralele, që pas pak do të përfundojë me burgosjen time, ishte një zhvillim tjetër, që do të forcojë këtë përcaktim, meqë nga kahu i tij varej edhe fati i mëtutjeshëm i asaj që tashmë për mua shfaqej si "luftë për ardhmërinë e Valnorit tim", e cila mund të sigurohej vetëm po qe se Kosova ia

dilte të hiqte dhunën serbe dhe të ndërtonte shtetin e pavarur në përputhje me vendimet që ishin marrë në Referendumin për Pavarësi nga fundi i vitit 1991.

Dhe pikërisht kur do të kryhet ky referendum me sukses, pra kur shqiptarët e Kosovës do t'ia hapin rrugën shtetformimit, Dritës iu shfaq një sëmundje e rëndë (karcinomi i gjirit). Shenjat e saj i kishte hetuar kohë më parë, por i kishte fsheh nga unë përderisa ta diagnostifikonte si të tillë. Ishte një mbrëmje e qetë shtatori, kur në praninë e doktor Afrim Begës ma bëri me dije se kishte për të më thënë diçka të rëndësishme, që megjithatë, nuk duhej të më shqetësonte. Mbante Valnorin shtrëngueshëm dhe mendja më shkoi se mos fëmija kishte ndonjë telashe me ndonjë infeksion tjetër, nga ai që prej kohësh kishte në vesh, dhe mjekët hamendeshin si duhej përballuar: me antibiotikë apo me ndonjë ndërhyrje të lehtë kirurgjike, por që ato nuk paraqitnin ndonjë shqetësim për shqisën e ndijimit. Desha t'i thosha se infeksioni i Valnorit mund të priste edhe ca, por ajo ma bëri me dije se ishte diçka tjetër, që kishte të bënte me të.

Kur m'i tha këto, zërin e kishte të flashkët, ndërsa shikimin të zbetë, gjë që kjo ma krijoi parandjenjen se fjala ishte për ndonjë shqetësim të njëmendtë. Duke e parë në atë gjendje, mbeta si i ngrirë. Dukej se edhe ajo po ngrihej dhe mbase gjendja e ngrirjes do të na përfshinte të gjithëve, po mos të ishte doktor Afrim Bega, i cili nisi të fliste për atë se Drita kishte një tumor në gjirin e djathtë dhe shpresohet se pas një ndërhyrjeje kirurgjike çdo gjë do të jetë në rregull. Tha se provat e biopsisë kishin treguar se tumori është i mbyllur dhe se heqja sa më e shpejtë, shmangte mundësinë e ndonjë rreziku të mëtutjeshëm.

Pas asaj që tha doktor Afrim Bega, Drita, sikur të ishte liruar nga makthi që kishte deri më atëherë dhe, me një zë fare të natyrshëm dhe shikim të butë, shpjegoi se heqja e shpejtë dhe përkujdesja mjekësore largojnë çfarëdo dyshimi se gjendja mund të përkeqësohet.

“Jam e bindur se edhe këtë sfidë do ta përballojmë...”

Foli në shumës dhe bëri me krye kah Valoni, me ma ba me dije se ajo luftë që duhej me e fitue, ishte për Valonin, dhe se atë duhej fituar në vend se të mendohej për çfarëdo dëshpërimi apo dorëzimi.

E shikova për pak dhe e mora ngryk. Përpiqesha të mos lëshohesha, edhe pse ndjehesha fare i shkallmuar.

“Sigurisht se do ta fitojmë edhe këtë betejë...”

Më tutje, midis nesh, sikurse shkrepitima e gurit të rrufesë, krahas rrënimin të madh që kishte sjellë, aty për aty të kishte ndrequr ato që kishte dëmtuar, kishte filluar një bisedë rreth asaj se çfarë duhet bërë që sëmundja me u përballu pa pasoja. Çuditërisht, ne po merreshim me çështje teknike, pra si duhej me u ba largimi i asaj gjëndre, në vend se të bisedonim për një shërim, të cilit doemos i duhej një përkujdesje e gjatë mjekësore, e cila në ato rrethana në të cilat ndodheshim, sikur ishte e pamundur.

Por, pikërisht pse në Kosovë kjo ndërhyrje nuk mund të bëhej, përqendrimi ynë ishte dalja jashtë vendit, ku hë për hë ishin dy adresa: Shqipëria, ose Kroacia?

E para, pse mund të ishim bashkë dhe thuajse të lidhur me Kosovën, por që kishte telashin e kompetencës mjekësore, ngaqë mjekësia shqiptare profesionalisht e as teknikisht ende nuk i kishte përballuar ngecjet e mbylljes të cilave u duheshin edhe shumë kohë. Ndërsa adresa e dytë - Kroaci lidhej me dajën, gjeneralin kroat në pension, Josip Preleviq, i cili ishte në gjendje që të na mundësonte tretmanin e duhur mjekësor në klinikat më të mira të

Zagrebit, dhe po ashtu, ai do të mund të përkujdesej edhe për shërimin e mëtutjeshëm edhe për një kohë më të gjatë, po qe se do të jetë e nevojshme.

Pasi që rashë në lidhje me dajën në Zagreb dhe ia bëra me dije rastin, ai kërkoi që të nisesha menjëherë. Premtoi se do të bënte çmos që Drita të merrej ndorë nga mjekët më të mirë kroatë.

Natyrisht, se nuk na mbetej tjetër pos të niseshim sa më parë për në Kroaci. Meqë vendi ndodhej buzë shpërthimit të luftës (Armata Popullore e Jugosllavisë tashmë kishte ndërhyrë në Slloveni) dhe pritej ngjashëm të vepronte edhe në Kroaci (pas shpalljes së pavarësisë së Kroacisë, që pritej të bëhej pasi që të përfundojnë zgjedhjet e para të lira atje), doktor Afrim Bega, me ndihmën e një kushëriri, i cili në Zagreb prej vitesh punonte si argjendar i pavarur, mori përsipër shkarjen tonë të pavërejtur në Kroaci. Udhëtimin e bëmë me makinën e tij nëpërmes Malit të Zi, prej nga pa ndonjë vështirësi kaluam në Dubrovnik dhe prej andej nëpërmes magjistrales së Adriatikut, arritëm Zagrebin.

Ndarja me doktor Afrim Begën ishte e prekshme, meqë Drita u ligështua së tepërmi, sado që këtë mendohej ta fshehte, gjë që përshëndetja e tyre i përngjante një lamtumire të përhershme, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Sidoqoftë, në Zagreb na priti dajë Josipi me një përzemërsi të madhe. Kishim vite që nuk ishim parë. Sepse, lidhjet tona, që nga koha e largimit tim nga Zagrebi dhe kthimi në Prishtinë, ishin shkëputur fare. Dhe pa humbur kohë, shkuam në Klinikën e njohur “Rebro”, njërën ndër më të mirat e rajonit. Aty, Drita iu nënshtrua operacionit. Mjekët ia hoqën gjëndrën e përfshirë nga karcinomi, por nuk hetuan ndonjë shpërndarje të saj. Mbetej, pra një terapi e mëtutjeshme, që duhej të zgjaste së paku gjashtë muaj, prej nga pastaj do të vlerësohej si do të sillej trupi i saj.

Pra, për Dritën dhe për ne fillonte një luftë e gjatë dhe e paparashikuar me sëmundjen, kahu i së cilës do të varej nga terapia e mëtutjeshme, por mbi të gjitha edhe nga qëndrimi i Dritës në atë përballim me gjendjen e re, që ajo e kishte kuptuar drejt dhe iu kishte qasur me përkushtimin e fitores.

Në afërsi të spitalit “Rebro”, dajë Josipi mori për ne me qira një banesë njëdhomëshe të përshtatshme për banim. Na bëri me dije se sa u përket shpenzimeve nuk kishim arsye të brengoseshim fare, meqë mua më takonte një pjesë e trashëgimisë së gjyshit në Zarë, e cila, në emrin tim, prej kohësh ishte deponuar në një bankë kroate.

Por, ishte edhe kushëriri i doktor Afrim Begës, Iliazi, i cili na tha se mund të mbështetesh te ai për çfarëdo që na duhej.

Kështu, pas operacionit, pas dy javësh qëndrimi në spitalin “Rebro”, Drita u kthye midis nesh. Valnori nuk e kishte ndie gjithaq mungesën e saj, meqë ishim afër spitalit dhe një pjesë të madhe e kalonim aty.

Pas hemoterapisë, e cila zgjati gjashtë javë, dukej sikur Drita në tërësi mori veten, sado që duhej të rrinte aty në një mbikëqyrje disa muajsh. Dy herë në javë shkonte në spitalin “Rebro”, ku i nënshtrohej analizave të rregullta, të cilat tregonin se gjendjen e kishte të mirë.

Në fillim të muajit të dytë, m'u desh të kthehem për pak në Prishtinë, meqë mora lajmin e vdekjes së xhaxha Arsimit. Kushëriri i doktor Afrim Begës, Iliazi, ma bëri me dije se meqë ato ditë duhej të shkonte për një vizitë të shkurtër në Prishtinë, mund të shkoja me të dhe, pastaj të ktheheshim së bashku.

Drita ma mbushi mendjen të shkoja. Meqë ndjehej mirë dhe kishte dajë Josipin që vazhdimisht e kishte pranë dhe përkujdesej për të gjitha. Tha se e donte puna që për pak t'i gjendesha pranë edhe familjes në Prishtinë.

Dajë Josipi nuk ishte gjithaq i bindur se duhej të kthehesha në Prishtinë, përkundër detyrimeve që kisha ndaj familjes dhe veçmas ndaj xhaxha Arsimit, i cili ishte ndër më të merituarit që nuk kisha mbetur "fëmijë i askujt", por i isha kthyer familjes. Ma tërhoqi vërejtjen rreth të papriturave të pritshme që ishin të shumta, sidomos kur tashmë lufta ishte në prag dhe shpjegim mund të përfshinte gjithë vendin dhe të ngjashme, por ato nuk më ndalën që të nisesh përsëri në Prishtinë me bindjen se pas një vizite të shkurtër do të kthehesha.

Ndodhi megjithatë që ndarja jonë e përkohshme, me ato që i hunë në mes (plasja e luftës në Kroaci sapo arrita në Prishtinë), të kthehet në një ndarje të përhershme madje.

Ishte agresioni i Armatës Jugosllave ndaj Kroacisë, i filluar me rebelimin e serbëve të Kninit, të cilët, të drejtuar nga Beogradi, shpallën të ashtuquajturën Krahinë të Kninit dhe atë e shkëputën prej Kroacisë, bëri që ky vend, i shkëputur nga bota, i tëri të kthehet në një zonë lufte me një front të gjatë prej mbi një mijë kilometrash (fillonte në Vukovar, përfshinte Sllavoninë dhe nga ana e Krainës së Kninit, te Benkovci shkante deri në Adriatik).

Me këtë shkëputje, me të cilën gjysma e Kroacisë kishte rënë pre e pushtimit serb, serbët e Kroacisë dhe Armata Jugosllave e drejtuar nga gjeneralët serbë, njëherësh ia dolën që atë ta shkëpusin nga çdo lidhje me pjesët jugore të vendit, gjë që kjo ndërpriste jo vetëm lidhjet e natyrshme midis shqiptarëve të shumtë me banorët në Kroaci me familjet dhe të afërmit e tyre në Kosovë dhe Maqedoni, por mbi të gjitha mbante peng fatin e qindra e mijëra kadetëve dhe ushtarakëve shqiptarë që ndodheshin në shërbim të rregullt në Armatën Jugosllave atje ose si eprorë, shumë prej të cilëve do të kalojnë në radhët e Armatës së posaçë formuar të Kroacisë, në të cilën do të përfshihen edhe një pjesë e mirë e kadetëve shqiptarë, të cilën u larguan nga radhët e armatës jugosllave.

Pra, plasja e kësaj lufte, neve na i hapte edhe më telashet, dhe pa marrë parasysh se a do t'i rrinim afër apo larg, ajo po na përfshinte dhe siç do të shihet, do të ndikojë edhe fatin tonë...

Dhe, sapo të shpërthejë lufta, dajë Josipi, kryenvete bëri që Drita bashkë me Valnorin, të kalojë në Klagenfurt të Austrisë, ku do t'i sigurohet një qëndrim i përkohshëm në këtë vend si dhe mbikëqyrja shëndetësore në një spitali eminent të këtij qyteti.

Lajmin e mora kur nuk e dija se çfarë duhej të bëja. Por, ishte Drita që më mori në telefon prej andej dhe më tha se nuk duhej të lëvizja për deri sa të qetësoheshin punët. Ma bëri me dije se ishte në duart të sigurta dhe se dajë Josipi, që e kishte pranë dhe nuk i ndahej, po përkujdesej për të gjitha.

Doktor Afrim Bega, i cili po ashtu ishte i shqetësuar se mos ajo ndarje do të rikthente te unë krizën e njohur shpirtërore me të cilën isha ballafaquar dhe në saje të bashkimit me Dritën atë e kisha përballuar disi, kërkoi që të mos hyja në ndonjë aventurë, e cila do të ma përkeqësonte gjendjen dyanshëm. Më këshilloi, që të mbaja lidhje telefonike me Dritën në mënyrë që t'i bashkohesha kur të krijoheshin rrethanat e përshtatshme.

Në të vërtetë, këtë e kërkonte edhe Drita. Meqë kishte përkujdesjen e nevojshme mjekësore, së cilës i duheshin edhe disa muaj mbikëqyrje, kërkoi të tregohesha i durueshëm. Edhe pse gjatë bisedës telefonike, me ato që thoshte rreth durimit, përpiquej me e riejtë qetësinë, megjithatë zërin e kishte gjithë dridhërima, që nxirrte në pah shqetësimin që kishte

se mos ndarjes sonë do t'i hynë në mes shumë pengesa, që do ta zgjasin ose do ta pamundësojnë fare, siç do të ndodhë në të vërtetë. Ajo sa nuk më tha se duhej të mësoheshim me të papriturat, të cilat ishin bërë pjesë e jetës sonë, por jo vetëm sonës, dhe të ishim të gatshëm për të gjitha. Ia ktheva se të gjitha do t'i përballoja po qe se do të ishin në shërbim të shëndetit të saj dhe mirëqenies së tim bir, ndërsa ajo më tha se më me dëshirë do të pranonte një ndarje të përkohshme, pa marrë parasysh sa zgjat, se ndonjë bashkim që do të përcillej me ndonjë aventurë të rrezikshme.

Me një fjalë, ajo kërkonte të rrija në Prishtinë dhe ta prisja. Më tha se më e lehtë ishte që ajo të kthehej në Prishtinë sapo të përfundonte përkujdesja mjekësore se sa unë të merrja rrezikun për të shkuar në Austri rrugëve tepër të pasigurta, që tashmë i kishte ndërprerë lufta.

Duhet pranuar se në ato rrethana për mua më të rëndësishme ishin lajmet për mirëqenien e shëndetit të Dritës dhe të tim bir, të cilat ishin inkurajuese se sa nisja ime e pasigurt për në Austri, që do të mund të kthehej për ndonjë fatkeqësi tjetër për gjithë familjen. Këta ma thoshte edhe doktor Afrim Bega, i cili mbante lidhje me Klinikën e Klagenfurtit ku Drita merrte terapinë e nevojshme. Ndarja më dukej e rëndë, por kur kisha parasysh se në Prishtinë ajo nuk mund të shërohej dhe madje mund të ballafaqohej me gjithfarë telashesh, atëherë atë e pranoja si një fat në fatkeqësi.

Kështu, pra, “fati në fatkeqësi”, kishte filluar të na kthehej në atë që duhej ta merrnin si “normalitet” brenda për brenda abnormalitetit shoqëror, ku tashmë “jeta jonë paralele” (organizimi ynë insitucional nga qeverisja vendore e deri te qeveria, jashtë shtetit pushtues serb), shfaqej një si realitet që kushtëzonte por edhe arsyetonte “jetët tona paralele” (ndarjet e dhunshme të familjeve që përmes migrimëve dhe ikjeve të tjera jashtë, t'i ikej represionit shtetëror serb) bashkë me dramën dhe fatkeqësitë tjera të shumta, të cilat do t'i takojnë realitetit të përgjithshëm.

Megjithatë, që t'i pranoja paralelizmat ashtu si duhej, por që edhe të silleshe në përputhje me logjikën e tyre, nuk ishte as lehtë e as thjeshtë, meqë ato, sado që i pajtonte qëllimi ynë i përbashkët, që kishte të bënte me rezistencën institucionale pushtimit serb, i konfrontonte realiteti shoqëror dhe ai jetësor prej nga pastaj kishin burimin dramën tona të vogla dhe të mëdha bashkë me fatkeqësitë e shumta.

Me i përballë disi ato kundërtënie, do të më ndihmojë doktor Afrim Bega, por edhe Drita. Doktorin ma ruajti drejtimin jetësor, ndërsa Drita ma forcoi besimin shpirtëror. Do të vinë kohë madje kur njëri dhe tjetri, ndonëse nuk do t'i kem më pranë, do të kthehen në motivues të vetëm të jetës sime të ngjashme me atë thirrjen e vullnetit për fuqi që dikur më vinte nga fotoja e vetme e tim Atë në valixhen e vjetër kur më bëhej se fryma e tij më thoshte se duhej të luftoja për majat pa marrë parasysh vështirësitë, por tash si thirrje me qëndrueshmëri të pathyeshëm... Lufta, pra bëhej prej saj me dalë i pathyeshëm...

Dhe, nuk do të vonojë shumë dhe unë do të mbetem edhe pa praninë fizike të doktor Afrim Begën, siç kisha mbetur edhe pa Dritën dhe Valnorin. Ishte burgosja ime në fund të prillit të vitit 1993 pse kisha marrë pjesë në organizimin e sistemit të vetëmbrojtjes, që e kishte përcaktuar Ministria e Mbrojtjes e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe dënimi prej pesë vitesh e dy muajsh që jetës sime do t'ia ndryshojë kahun, por assesi përcaktimin që të mbetsha i pathyeshëm.

Përkundrazi, burgju i gjatë dhe ato që do të përjetoj në të, edhe në rrethanat e një shkëputjeje të dhunshme nga familja dhe shoqëria, më bënë edhe më të përqendrueshëm në mbrojtje të parimit me mbetë i pathyeshëm .

Këtë do ta hetoj edhe doktor Afrim Bega pas vizitës së parë dhe të vetme që ma bëri në burgun e Nishit, thujse një vit pas burgosjes. Më thotë se i vinte mirë që më shihte në një gjendje tejet stabile psikike.

Në të vërtetë, atë që doktor Afrim Bega do ta shohë si stabilitet psikik te unë, që do të vazhdojë të mbetet i tillë duke u forcuar në përputhje me vështirësitë, do të shfaqet që nga çasti që do ta kem të qartë se ndarja me Dritën dhe Valnorin jo vetëm se mund të ishte e gjatë, por mbase edhe e përhershme, por që ajo do të më motivojë t'i përballoj të gjitha, meqë vetëm ashtu ndërsjellash ndihmoheshim dhe forcoheshim pa marrë parasysh kohën dhe hapësirën që na rrinte në mes. Çuditërisht, në atë gjendje do të arrij deri te përfundimi se mund të jenë pikërisht largësia, shkëputjet dhe vuajtjet e ndërsjella që dashuritë i bëjnë edhe më të zjarra dhe të përhershme për t'i kthyer në motivues të jashtëzakonshëm me të cilën përballohen që të gjitha sfidat, madje edhe ato që duken të papërballueshme. Në rrethana të tilla njeriu fiton përshtypjen se është mbinjeri, meqë qëndron mbi çdo vuajtje dhe mbi çdo vështirësi dhe se fuqia e kësaj ndjenje barazon me perëndinë...

Se fuqia e kësaj ndjenje kishte filluar të më përshkonte, këtë e hetova vetëm pak ditë pasi që isha kthyer vetëm në Prishtinë ndërkohë që Drita kishte mbetur në Zagreb bashkë me Valnorin. Ende pa mbaruar pamja në shtëpinë e xhaxha Arsimit, i vdekur sa isha në Zagreb dhe kishte shërbyer si shkas që të kthehesha për pak, doktor Afrim Bega ma kishte bërë me dije se nuk mund të kthehesha më në barakën e skajshme ngjit me Klinikën e Psikiatrisë, meqë administrata e dhunshme serbe e vendosur ato ditë, krahas largimit të të gjithë mjekëve shqiptarë, kishte marrë vendimin i gjithë ambienti të pastrohej nga “gjërat e tepërta”. Doktor Afrim Bega mezi ia kishte dalë me nxjerrë ca nga gjërat tona personale prej aty (libra, fotografi dhe ca cikërrime të tjera).

Edhe pse me atë barakë më lidhnin kujtime të paharrueshme të jetës sime, siç ishin ato të njohjes dhe afrisë me Drita Rracin dhe bashkimit me të, që do të çojë te martesja jonë, pastaj të lindjes së Valnorit, që jetës sime i dhanë një një kuptim të veçantë, megjithatë dëbimin e dhunshëm prej saj dhe shkeljen nëpër gjërat personale, e pranova pa ndonjë shqetësim të veçantë. Do të vendosëm në shtëpinë e vjetër dhe thujse të lënë “shkret” të xhaxha Arsimit në Hade, e cila merrte gjallërim sado pak muajve të verës kur familja largohej nga Prishtina, dhe aty, do të përpiqem që atë mjedis të qetë dhe në dukje sikur të ishte i shkëputur nga ato që ndodhnin gjithandej, ta mbush me përfytyrimin e Dritës dhe të Valnorit sikur ata të ishin pjesë e pandashme e frymës dhe e hapësirës së atyshme.

Doktor Afrim Bega ndonëse do të befasohet për të mirë me sjelljen time të qetë, veçmas pse ndarjen me Dritën dhe Valnorin e kisha pranuar ashtu si duhej, vazhdimisht më gjendej pranë. Si i përjashtuar nga puna me të gjithë mjekët dhe personelin mjekësor të spitalit, menjëherë ishte kyçur në sistemin paralel shëndetësor, që përkujdesej për mbrojtjen shëndetësore të popullatës, pa marrë parasysh kushtet tepër të rënda jashtë institucioneve, që e përcillnin atë. Dhe, me qenë pranë meje, kishte zgjedhur komunën e Obiliqit. Një ditë madje, hapi çështjen e shfrytëzimit të shtëpisë ku banoja për ambulancë për fëmijët, që pa një pa dy dhashë pëlqimin. Lejova madje, që edhe pjesët tjera të pashfrytëzuara të shtëpisë nga kohët kur ajo shërbente si shtëpi e përbashkët e familjes së gjerë, të përshtateshin për një

stacion gjinekologjik, i cili pas pak u vendos aty. Duke parë fëmijët si merrnin ndihmën mjekësore nga ekipi (dy pediatre dhe tri motra) si dhe duke përcjellë vizitat e nënave në pjesën që tashmë ishte kthyer në stacion gjinekologjik, më bëhej se shihja pranë e pranë Dritën time dhe Valnorin tonë dhe ashtu çmallesha, sepse vetëm ashtu ndjeja se vleja diçka. Kjo i pëlqeu edhe doktorit që më tha kjo lëvizje mund të ketë sukses po që se i madh e i vogël e gjen vendin në të, dhe se, priste që edhe unë të gjendesha në të, ku e kisha vendin. Më tha se njerëzit si unë kishin vlerë të veçantë.

E dija se ai dëshironte të më mbante me çdo kusht të lidhur për çështjen tonë, që tashmë i ngjante një lumi me shumë ujë, që nuk kishe të ndalur. Në këtë lum më bëhej se ishte një varkë në të cilën gjendeshin Drita dhe Valnori, të cilën duhej ta shoqëroja deri te limani i fundit...

Dhe futja në atë që e shihja si lumin tonë të pandalshëm nëpër të cilin varka me Dritën dhe Valnorin do ta gjente limanin e fundit, ndodhi pas pak. Ishin dy veta, që më thanë se ishin oficerë rezervë nga Vetëmbrojtja Territoriale e Kosovës, të cilët ma bënë me dije se vinin për të biseduar rreth përfshirjes time në mbrojtjen territoriale, e cila kishte filluar të organizohej me urdhrin e Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më thanë se bëhej fjalë për nismën që në gjithë vendin, në nivel lokal, të krijoheshin njësitet e vetëmbrojtjes, të cilat do të trajnoheshin për detyra të ndryshme për t'u ndihmuar popullata për t'u vetëmbrojtur nga të papriturat. Sipas tyre, më binte barra që të ushtroja fizikisht të rinjtë, të cilët, në rast nevojë, do të mobilizohen nga Shtabi Territorial i Vetëmbrojtjes Popullore. Ata më thanë se më mbetej që të përcaktohesha për programin e trajnimit fizik si dhe për përfshirjen e të rinjve në këto aktivitete, të cilat nuk duhej të binin gjithaq në sy.

Ato që m'u thanë dhe u kërkuan prej meje ishin të pritshme, meqë në ato rrethana ndërtimi i institucioneve të pavarura kërkonte që edhe vetëmbrojtjes t'i kushtohej rëndësi e veçantë, pa marrë parasysh se mbi çfarë filozofie politike do të mbështetej rezistenca ndaj pushtuesit serb. Dhe, mendja ma tha se mënyra më e mirë që të përfshija sa më shumë të rinj në këto veprimtari gjithsesi se ishte formimi i një ekipi të boksit, që do të ishte i hapur edhe për gara lokale, e ku do të mund të punohej pa qenë nevoja për fshehje. Këtë ia thashë të nesërmen atij që ishte përgjegjës për Vetëmbrojtjen Territoriale në pjesën e Obiliqit dhe ai e miratoi pa ndonjë hezitim. Ia bëra me dije se në Hade do të themeloja një klub të boksit prej nga pastaj do të vazhdoj edhe me të tjerë në komunën e Obiliqit. Thash se ishte mirë që klube të ngjashme të formohen edhe në komunat tjera të Kosovës dhe ato të përfshihen në kuadër të një lidhje të boksit të Kosovës, e cila do të kishte edhe sistemin e garave dhe kalendarin e saj. Propozova që ngjashëm të veprohet edhe me klubet e atletikës dhe të sporteve të tjera, ku mund të përfshihen sa më shumë të rinj.

Ideja ime jo vetëm që u përkrah, por me të shpejtë erdhën te unë disa nga zyrtarë të rëndësishëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët kërkuan që t'ua hartoja planet për Lidhjen e Sporteve të Republikës së Kosovës, ku do të përfshiheshin lidhja e futbollit, ajo e boksit, e hendbollit, e atletikës dhe e të gjitha degëve të tjera, që kishin vepruar deri më atëherë.

Kështu, pas pak formova klubin e parë të boksit në Hade. E quajtëm "Kosova". Në të ishin përfshirë mbi tridhjetë të rinj, të ndarë në kategorinë e parë dhe atë të dytë, pra të juniorëve.

Ato ditë rashë në kontakt me disa nga drejtuesit e klubit të boksit “Prishtina”, kampionit të shumëfishtë të Kosovës dhe të Jugosllavisë, i cili si klubet tjera sportive të Kosovës, që nuk kishin pranuar masat e dhunshme në sport të regjimit të Beogradit, ishin përjashtuar nga garat, me ç’rast atyre u ishin ndaluar edhe stërvitjet dhe çfarëdo veprimtarie tjetër në objektet sportive. Me ta u morëm vesh që dy nga trajnerët që punonin me të rinj, për një kohë të vinin në Hade dhe t’i ndihmonin klubit të ri. Po ashtu, kërkova që në Hade, të krijonim mundësi për stërvitjen e klubeve të tjera nga Fushë Kosova dhe Obiliqi që u ishte ndaluar veprimtaria në terrenet sportive dhe objektet shoqërore. Thash se livadhet do t’i kthejmë në stadione, ndërsa depot në halla sportesh.

Ato që kisha thënë rreth livadheve stadione dhe depove halla sportesh, sikur u kthyen në moto të përgjithshme të një hovi të ri, që përfshiu sportin anëmbanë Kosovës. Aktivistë të shumtë të të gjitha sporteve, pastaj sportistë të dalluar, të cilët dikur kishin qenë pjesë e elitës së vendit (kishte reprezentues të boksit, të futbollit, të mundjes dhe të sporteve të tjera), kthenin err e terr në Hade. Aty bisedohej jo vetëm për frymën sportive, që duhej mbajtur të gjallë me anën e veprimtarisë së hapur, por edhe për përgatitjen fizike të të rinjve, që në çdo çast të ishin të gatshëm t’i shërbenin sistemit të vetëmbrojtjes në përputhje me qëndrimet që do të merreshin nga kreu politik. Klubeve të boksit dhe të mundjes, por edhe atyre të atletikës, që kishim formuar në të gjitha qytetet dhe qytezat e vendit dhe numri i tyre tashmë arrinte mbi gjashtëdhjetë, u binte barrë e veçantë në këtë sistem.

“Hade është kthyer në qendër të botës”, më tha një ditë Afrim Bega si me shpoti.

I thashë se qendra kurdoherë shfaqej te pika lëvizëse, aty ku ndodhë diçka.

Dhe do të jetë pikërisht frika nga lëvizja e gjërave drejt kahut të duhur, ajo që Hadën e njohur deri më atëherë si katund që duhej të zhdukej nga ekskavatorë e mihjes sipërfaqësore prej nga termocentralet e Kosovës furnizoheshin me linjit, do t’ia japë epitetin e një “Kampi luftarak të separatistëve shqiptarë”, ku “trajnohej për luftë kundër Serbisë” dhe çmos tjetër!

Këto lajmë alarmuese u shfaqen në shtypin e Beogradit, gjë që lente për të kuptuar se Hades tashmë i ishte vu syri dhe se ishte çështje kohe kur ajo do të sulmohej.

VITET E BURGUT DHE VETMIA E PËRHERSHME

(Bashkim Kosova shkruan për burgosjen, përjetimet e burgut si dhe vetminë e tij të përhershme që do të fillojë në pavijonin e psikiatrisë së burgut të Nishit kur do të marrë lajmin për migrimin e Dritës dhe të birit Valnorit në një vend të panjohur me identitet të ndërruar. Ky rrëfimi tronditës, të cilin halla Shpresa Kosova – Berisha, e gjeti në një dosje në mesin e plaçkave ditën që ai do të vritet, më 17 shkurt 2008, përfundon me lirimin e tij prej burgut në qershorin të vitit 1998. Vitet tjera, ato të administrimit ndërkombëtar e deri te pavarësia, sikur nuk kanë ekzistuar për të...)

Nuk vonoi dhe në një mëngjes të ftohtë të fillimit të dhjetorit shtëpia ime si dhe gjithë Hade me rrethinë gdhiu e rrethuar nga forca të mëdha policore ushtarake serbe. Njësitë speciale hyrën në oborrin tim pasi që me brutalitet të paparë thyen dyert dhe demoluan

rrethojat që shpinin në drejtim të hallës së improvizuar të sporteve në pjesën e skajshme të saj, ku ishin edhe disa nga terrenet sportive.

I hetova nga dritarja dhe nxitova t'u dilja përpara para se ta thyenin derën e brendshme të shtëpisë. Por, ishin njësitë speciale që atë e bënë para meje, duke e thyer me forcë.

M'i futën tytat e automatikëve në kraharor dhe kërkuan të mos lëvizja. Njëri më tha se dyshohesha për veprimtari armiqësore me paramendim, e cila drejtohej kundër rendit kushtetues dhe integritetit territorial të vendit. Pasi m'i lidhen duart, njëri që u paraqit si hetues, nxori vendimin për arrestim dhe për bastisje. Letrën ma afroi te hunda dhe më tha se edhe me armiq të shtetit veprohej në përputhje me ligjin. Ma bëri të ditur se më takonte dhe avokati mbrojtës bashkë me të drejtën që të mbrohesh si i pandehur.

Në të vërtetë, ato që ai tha se veprohej në përputhje me ligjin, ishin dokrra. Sepse, sapo më futën në një si furgon, zunë të sillen me brutalitet të paparë. Ashtu të lidhur, nga të gjitha anët me qëllonin me shqelma dhe me grushte dhe talleshin.

“Epo, si e ke hallin kampion i kampionëve?”

“Sa raunde të duhen deri te shkëputja e Kosovës nga trungu serb?”

“Ku e ke Brunon?”

“Do të bëhesh gjeneral?”

“Ringun e ke kthyer në politikë...”

Kishte gjithfarë fyerjesh dhe talljesh, por ato zunë të shoqërohen me shkëmbimet dhe grushtet, që nuk kishin fund. Nuk kisha si të mbrohesh. Rashë në gjunjë dhe dikur m'u bë se u alivanosa. Koka ime përjashtoi ato që edhe më tutje i vinin si pjesëza të shkëputura fyerjesh dhe talljesh dhe iu dha një shurdhimi të përgjithshëm, një gjendje jashtë vetes, që nuk e di sa zgjati, por që mori fund çastet kur sytë e mi të mjegulluar, pak nga pak, zunë ta formësojnë pamjen e luhatshme të një trashamani që më rrinte përpara dhe sikur vazhdonte të tallej, por pa më qëlluar siç kishin vepruara ata që sapo më kishin futur në furgon m'u kishin sulur sipër me shqelma dhe grushte.

Dëgjova të më drejtohej me ironi me fjalët “kampion i kampionëve”, të cilat i shoqëronte me ato “gjeneral shqiptar”.

“Që moti na ke shpallur luftë...”

“Kush lyp luftë e gjen...”

“Por, kjo do të jetë lufta jote e fundit...”

“Fundi juaj...”

“Loja mbaroi...”

“Erdhi fundi...”

“Fundi juaj...”

“Fundiii...”

Fjalët për fundin po i theksonte me një ngjyrim të ashpër të zërit që po më vinin si të rëna të veçanta, saqë një çast se si m'u duk se në saje të tyre tashmë gjendesha në atë duelin e pa mbajtur për titullin e kampionit botëror, në finalen e Torontos me rusin Igoriev, ku kundërshtari im kishte dorëza të hekurit, të përskuqura fare, të cilat nxirrnin shkëndija të përflakura, por që atyre u bëja ballë disi me anën e një energjie të brendshme e formësuar si mburojë, që më vinte nga përfytyrimi i Nora Bardhit dhe i Drita Rrecit. Madje, dikur, ajo mburojë që e kisha nga ai përfytyrim, kishte bërë që ta mbante larg rusin Igoriev dhe dorëzat

e tij të hekurta, që nxirrnin shkëndija të përflakura. Dhe sa më larg që kisha rusin Igoriev, në hapësirën e mbrojtur shfaqeshin Nora Bardhi dhe Drita Rraci që po më thoshin se edhe atë luftë të pabarabartë do ta fitoja dhe të ngjashme, që pak nga pak më qetësuan dhe bënë që të ndjehesha fitues madje saqë zura të flisja sikur më në fund kisha fituar titullin e kampionit botëror, pikërisht atë prej të cilit isha privuar dhunshëm nga anëtarët e shtabit të të Lidhjes së Boksit të Jugosllavisë të drejtuar nga delegatët serbë, të cilët më kishin shpallur të paaftë për duel.

Fjalët për fitoren dhe për titullin e kampionit botëror në Toronto, që kisha nxjerrë në atë gjendje të shkallmuar fare, sikur e kishin ndezur hetuesin, i cili deri pak më parë po më tallte me ato që m'i thoshte pareshtur “kampion muti”.

Më shqelmoi me sa fuqi kishte dhe prapë më quajti “kampion muti”. I shtrirë në dysheme dhe me përshtypjen e dorëzimit të plotë para dhunës, këpuca që më kishte qëlluar aq fort, preku hundën time dhe nisi ta shtypte.

“Tash e tutje gjendesh në mëshirën e pamëshirë tonën...Ne vendosim për jetën dhe vdekjen tendë...”

Gjatë asaj kohe ma bënte të ditur se fati im mund të ndryshonte nga sjellja ime. Për të mirë, ose për të keq. Për të mirë - gjë që, nëse ndryshoja mendjen dhe sjelljen, që do të thoshte të pranoja lojalitetin e shtetit serb dhe të deklarohesha haptas për të, mund të fitoja të drejtën të luftoja edhe për titullin e kampionit botëror me gjasa të mira që edhe ta fitoja, ose për të keq – që të përfundoja qençe, i ngordhur në ndonjë hendek.

Kur po m'i thoshte këto, këmbën e mbante sipër kokës sime. Priste qëndrimin tim, por kur unë vazhdova heshtjen, që ai e vlerësoi se nuk pranoja, këmba e tij prapë iu sul kokës sime edhe më fuqishëm saqë nga shtypja humba lidhjen me vetveten.

Nga ajo gjendje nuk e di kur dola, por kur u përmenda, isha në një dhomë të vogël, i shtrirë në një shtrat lëvizës, i mbuluar me një çarçaf të bardhë, ndërkohë që kokën e kisha të lidhura me fasha të shumta. Të lirë kisha vetëm sytë dhe pjesën e hundës dhe të gojës. Drita që vinte nga ana e prapme ishte e zbehte, por mjaftonte që hapësirën ta bënte edhe më të mistershme nga që dukej.

Nuk vonoi dhe aty hyri në motër medicinave e shoqëruar nga një polic i armatosur. Ajo ma preku gjoksin, sikur të kërkonte diçka dhe u mundua që birat e hundës të m'i lironte nga mbetjet e trashura të gjakut, gjë që kjo ma lehtësoi frymëmarrjen.

Polici, që i rrinte pranë, kërkoi që ajo të largohej, e bashkë me të doli edhe ai. Ndjeva çelësat e rëndë se si kyçen derën e hekurt, paçka nuk e kisha të vështirë të kuptoja se gjendesha në ambulancën e burgu.

Dhe në atë gjendje tepër të rëndë (isha me plagë në kokë dhe fytyrë dhe i shkallmuar në gjithë trupin), gjëja e parë, që m'u soll në kokë, ishte parafytyrim i Dritës dhe i Valnorit. Në atë heshtje shurdhe ata sikur po më thoshin se ishin pranë meje dhe do të më shoqëronin gjithmonë.

“Jemi me ty...”

“Të duam...”

“Baba...”

“Jem me ty...”

“Të duam...”

“Baba...”

“Shpirt...”

“Mos u jep...”

“Nuk jepemi...”

“Do të mbesim bashkë, qoftë edhe të ndarë...”

“Bashkë...”

Ndjeva se po qaja, se po më qante shpirti, por njëherësh në atë shfrim sikur kishte edhe diçka që më mbushte me një fuqi të jashtëzakonshme, që nuk mund të ishte tjetër pos pjesë e frymës së Dritës dhe e Valnorit, që do të bëjë të ngrihesha mbi të gjitha vuajtjet, mundimet dhe vështirësitë e jashtëzakonshme nëpër të cilat do të kaloj gjatë atyre pesë viteve e dy muajve në burgun e Nishit.

Por, deri sa do të arrij deri te burgu i Nishit dhe vitet që do të kaloj aty, do të jenë tre muaj tejet të vështira në hetuesi, që do t’i paraprijnë gjykimin në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, ku bashkë me 127 të tjerë, (të shumtën ushtarakë që kishin dezertuar nga radhët e Armatës Popullore të Jugosllavisë kur ajo tashmë kishte filluar fushatën luftarake kundër Sllovenisë dhe Kroacisë dhe policë nga radhët e forcave të mbrojtjes territoriale të Kosovës dhe të Shërbimit Policor të Kosovës, të cilët po ashtu ishin përjashtuar nga ky shërbim pasi që nuk kishin pranuar t’i nënshtroheshin aparatit policor represiv serb), do të dënohem nën aktakuzën, siç thuhej “të bashkimit për përgatitjen e luftës nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës në ekzil kundër integritetit territorial të Serbisë”, gjë që pjesa e parë, ajo që fliste për përgatitje luftarake, në rast të mbrojtjes, qëndronte dhe me të isha pajtuar, por jo edhe pjesa e dytë, ku thuhej se “lufta drejtohej kundër integritetit territorial të Serbisë”, kur dihej se fjala ishte për vetëmbrojtje të Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Kaçanikut, e assesi për veprime jashtë saj, e aq më pak në Serbi.

Në kuadër të kësaj akuze, roli im shihej, siç thoshte prokurori, “në formimin dhe përgatitjen fizike të njërive paramilitare, të maskuara nën firmën e aktiviteteve të klubeve sportive”. Kështu, prokurori, më ngarkonte me barrën e udhëheqësve të rëndësishëm të atyre që ai i quante “struktura paralele paramilitare”.

Natyrisht se teletisja e padisë në kuadër të kësaj “veprimtarie armiqësore”, “dëshmohej” me drejtimin e klubit të boksit “Kosova” në Hade si dhe hapjes së qendrës sportive, pa leje, në pronën time familjare, ku ushtronin ekipet e Obiliqit dhe të Fushë Kosovës dhe të rinjtë, të cilët ishin përzënë dhunshëm nga objektet sportive. Ato që i kisha thënë gjatë hetuesisë rreth angazhimit tim në klubin e boksit “Kosova” si dhe përpjekjeve që të organizohen garat paralele në të gjitha sportet ku kjo ishte e mundur (në boks, mundje, hendboll, basketboll dhe futboll), dhe do të përfshihen sa më shumë të rinj, do të interpretohen si “pjesë e planeve për përgatitje luftarake të separatistëve shqiptarë” në kuadër të atij që quhej shtet paralel i shqiptarëve të Kosovës, i cili për Beogradin, ishte ilegal dhe ligjshmërisht i dënueshëm.

Por, krahas “veprimtarisë së drejtpërdrejt në kuadër të forcave të vetëmbrojtjes së Kosovës”, një pjesë e mirë e akuzës, më ngarkonte edhe si “burim indoktrinimi shumëvjeçar i të rinjve me nacionalizëm dhe separatizëm shqiptar”, ku radhitesha edhe ndër “inspiratorët kryesor të parullës Kosova-Republikë”. Me këtë rast thuhej se kisha shfrytëzuar klimën e përshtatshme për këtë veprimtari që ishte mundësuar nga udhëheqja partiake krahinore e Kosovës, e cila përfaqësimin në federatë ishte munduar ta shfrytëzonte për t’u shkëputur njëanshëm nga Serbia. Që të “dëshmohej” kjo, prokurori kishte radhitur

“shpërthimet e shumta nacionaliste dhe separatiste”, që ishin shënuar nga viti 1981 e tutje gjatë ndeshjeve të boksit në Prishtinë dhe jashtë saj, si dhe manifestimet që ishin mbajtur në Kosovë me rastin e krenimit të fitoreve të mia, me ç’rast sjellja ime u kishte ndihmuar skenarëve të organizatorëve të “demonstratave armiqësore”, ku ishte hedhur parulla “Kosova-Republikë”, e edhe ndonjë për bashkim me Shqipërinë.

Që dënimi im të ishte maksimal, pra deri në nëntë vjet heqje lirie, prokurori kërkesën e kishte arsyetuar me “mundësitë e mia të mëdha që kisha si sportist me renome ndërkombëtare për ta keqpërdorur atë” si dhe me aftësitë e mia që me anën e mashtrimit t’i përvetësoj shumë nga të rinjtë për veprimtari armiqësore.

Trupi gjykues, edhe pse në të gjitha pikat kishte mbështetur qëndrimet e prokurorit, megjithatë nuk ma kishte shqiptuar dënimin prej nëntë vitesh, por ishte ndalur te pesë vjet e dy muaj, me arsyetimin se dënimet maksimale duhej t’u takonin atyre të strukturave udhëheqëse (oficerëve të lartë) që ishin të lidhura drejtpërdrejt me Ministrinë e Mbrojtjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërkohë që shërbimeve përcjellëse, siç ishte pjesa jonë organizative në bazë, dhe veçmas “të rinjve të mashtruar”, siç thuhej, t’u jepej rast që ta kuptonin gabimin dhe të përmirësoheshin madje.

Dhe, si do të shihet, dërgimi im në burgun e Nishit dhe vitet e atjeshme, jo vetëm që nuk kishin luhatur qëndrimin tim, siç thuhej, por kishin shtuar edhe më tutje besimin se puna ime në përbërje të strukturave të shtetit paralel, që kishte filluar të vepronte në Kosovë që nga viti 1989 e tutje, jo vetëm që nuk kishte qenë armiqësore ndaj shtetit serb dhe popullit serb, siç thuhej, por kishte qenë e drejtë e jonë që të luftojmë për barazi me të tjerët, pra që Kosova të fitojë statusin e Republikës, ndërkohë që kur federata do të rrënohet pikërisht pse Serbia nuk e kishte lejuar këtë, qëndrimi për shtet të pavarur ishte në përputhje me përcaktimet e popullit tim për liri dhe pavarësi, që buronin nga e drejta për vetëvendosje dhe shfrytëzimi i saj në mënyrë dhe me mjete demokratike, siç ishte vepruar në të vërtetë me Referendumin për Pavarësi dhe zgjedhjet e para pluraliste që ishin mbajtur në prillin e vitit 1992 prej nga kishte dalë edhe parlamenti i parë i Republikës së Kosovës, ku isha zgjedhur si deputet me një përqindje të madhe të votave thuajse të ngjashme me atë të Presidentit të Kosovës. Ato që kishin ndodhur gjatë viteve të burgut: thellimi i luftës në Kroaci, pastaj bartja e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, masakrat e tmerrshme në këtë vend ndaj boshnjakëve, që do të arrijnë përmasat e gjenocidit, të cilat do të çojnë edhe deri te ndërhyrja e pjesërishtme e Aleancës Veriatlantike nga ajri ndaj caqeve ushtarake serbe përreth Sarajevës dhe në disa pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës me çka pastaj pas humbjes së armatës serbe në Bosnjën Perëndimore dhe në Kroaci, nga amerikanët do të imponohet marrëveshja e Dejtonit, kishin tumirur bindjen time se isha në rrugën e drejtë, por jo vetëm timen, pa përjashtuar këtu edhe disa serbë me bindje jugosllave, të cilët ishin burgosur dhe dënuar qoftë pse kishin kundërshtuar politikën militariste të Millosheviqit kur kishte filluar agresionin në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë, qoftë pse disa prej tyre, ndonëse në fillim kishin përkrahur politikën e Millosheviqit e cila bëhej me sloganet mashtruese “të barazisë së Serbisë me republikat tjera” dhe madje edhe i ishin bashkuara fushatave luftarake në Slloveni dhe Kroaci që bënte Armata Jugosllave me “këto pretekste”, më vonë e kishin kundërshtuar atë pa ngurruar që të largoheshin nga frontet e luftës për çka ishin dënuar si dezertorë dhe trajtoheshin keq njësoj si ne.

Meqë në burgun e Nishit, pjesa më e madhe e të burgosurve ishin shqiptarë, kryesisht të rinj që ishin dënuar pse kishin demonstruar për republikën e Kosovës, ose të tillë pse kishin marrë pjesë në strukturat e shtetit paralel, ishte e natyrshme që lidhja jonë të forcohej mbi këto parime, gjë që kjo kishte sjellë edhe deri te një solidaritet i ndërsjellë që shumë nga të rinjtë ose të papërgatiturit me u përballë me rrethana të tilla, të mbrohen nga thyerjet psikike, të cilat ishin të mundshme.

Megjithatë, me kalimin e kohës, midis të burgosurve do të përvijohen dy si qëndrime, të cilat dal nga dalë do të kthehen në rryma të ndryshme thujse përçarëse. Fjala pra ishte për njërën palë që mbështeste kërkesën për Kosovën si shtet të pavarur me çka mbrohej shteti paralel dhe strukturat e tij, të cilat kishin marrë përsipër sistemin arsimor, atë shëndetësor, e ku bënte pjesë edhe vetëmbrojtja dhe mbrojtja popullore (pale se ato që në fillim nga represioni i vazhdueshëm policor dhe ushtarak serb do të pamundësohen të veprojnë ashtu si duhej), ndërsa pala tjetër kërkonte bashkim me Shqipërinë, meqë sipas tyre, me shpërbërjen e Jugosllavisë ishin krijuar rrethanat e volitshme që shqiptarët e ndarë me dhunë nga trangu i vet qysh nga Luftërat Ballkanike të bashkoheshin në një shtet të përbashkët.

Por, edhe brenda për brenda këtyre bindjeve, të cilat do të kthehen në ndasi dhe madje në kundërthënie të hapura, që mund të thuhet se nuk ishin jashtë interesit të dikujt që shqiptarët të përçaheshin mbi këto përvijime, kishte dallime dhe madje edhe shpërputhje të ndjeshme, të cilat do t'u ndihmojnë përçarjeve të brendshme. Kështu, në radhët e përkrahësve të shtetit të pavarur të Kosovës kishte një rrymë, që mbështeste kryekreje drejtimin e rezistencës institucionale, pa përjashtuar këtu edhe atë të armatosur, po qe se për këtë shfaqet nevoja, kjo duhej bërë në përputhje të plotë me faktorin ndërkombëtar, në radhë të parë me amerikanët, dhe kishte një rrymë tjetër, e cila pas Dejtonit e tutje, vlerësonte se lëvizjes institucionale, apo si quhej rezistencë paqësore, i kishte ikur koha, dhe se duhej kthyer luftës së armatosur në mënyrë që të hapej një front lufte midis shqiptarëve dhe serbëve, ku pastaj Shqipëria domosdoshmërisht do të përfshihej në të gjë që me futjen edhe të bullgarëve, grekëve, turqve në të, krizën e bënte rajonale dhe europiane, me çka faktori ndërkombëtar i vendosjes do të detyrohej të ndërhynte, ku pastaj edhe shqiptarët do të mund të llogarisnin se në përputhje me luftën do të fitonin të drejtën që të bashkoheshin.

Fillimisht, argumentet dhe kundër argumentet që shfaqeshin si pikëpamje të ndryshme, dukeshin të arsyeshme, meqë ishin zhvillimet e ndryshme që atyre u jepnin shkas, ku dukej se të gjithë kishin të drejtë. Por, pak më vonë, veçmas pas marrëveshjeve të Dejtonit, ato do të fillojnë të ashpërsohen dhe madje të kthehen edhe në përçarje të hapura, të cilat do të krijojnë ndasi dhe taborre të ndryshme dhe armiqësore madje midis të burgosurve. Kjo zuri të më brengoste jo vetëm mua por edhe një pjesë tjetër të atyre që dëshironin t'u rrinin sa më larg këtyre përçarjeve, meqë ishte më se e qartë se krahas shqetësimit të arsyeshëm, krahas nevojë së shoshitjes të të gjitha opsioneve për t'u parë si cili ishte më i përshtatshmi dhe më i dobishme për rrethanat, kishte përpjekje finoke, po pse jo edhe të drejtpërdrejta, që të burgosurit shqiptarë të ndaheshin, të përçaheshin dhe madje edhe të armiqësoheshin mes veti mbi këto baza prej nga pastaj secili te secili të shihte kundërshtarin, të dyshuarin dhe madje edhe "bashkëpunëtorin" e dikujt "tradhtarit" dhe çmos...

Kështu, nuk do të vonojë, dhe në Pavijonin E, pas një "riorganizimi të brendshëm" nga ana e drejtorisë së burgut, u vendosën thujse të gjithë "institucionalisët", që përkrahnin shtetin paralel, ndërsa në Pavijonin C, do të gjenden "radikalët", që kërkonin luftë të

armatosur, por që edhe midis tyre kishte “krahë” të ndryshëm, ku disa kërkonin së pari bashkimin me luftë të të gjithë shqiptarëve nga hapësirat e ish Jugosllavisë në një “shtet kalimtar shqiptar” (dhe të tillët nuk pranonin as Maqedoninë e as Malin e Zi, ndonëse këto tashmë ishin shpallur shtete të pavarura dhe ndërkombëtarisht ishin njohur), ndërsa disa të tjerë, jo vetëm që nuk pranonin kurrfarë “shteti kalimtar shqiptar” që do të krijohej me bashkimin e Kosovës, atyre të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, që kishte pasur Jugosllavia në kufijtë e vet që nga Versaja e tutje, por ata kërkonin bashkim të menjëhershëm të këtyre viseve me Shqipërinë, duke kërkuar njëjtë edhe për Çamërinë, në mënyrë që në Ballkan të krijohej, si thoshin, Shqipëria etnike.

Natyrisht, se këtyre bisedave nuk mund t’u rrihej larg, edhe pse shumë prej tyre ishin mjaft të shkapërderdhura dhe herë-herë edhe të ngjyrosura ideologjikisht, gjë që nuk ma kishte marrë mendja se në ato rrethana kur tashmë kishte rënë edhe Muri i Berlinit dhe po shpërbëhej edhe perandoria e kuqe e Kremlinit, kishte edhe të tillë që edhe më tutje i bashkonte platforma ideologjike marksiste-leniniste. Të tillëve ishte e pamundur t’ua heqje Enverin nga koka, edhe pse atij kishte kohë që i ishte thyer qafa edhe në Tiranë.

Meqë ato biseda dhe të ngjashmet me kalimin e kohës po bëheshin gjithnjë e më të ashpra dhe mosdruuese saqë të ktheheshin edhe në grindje të hapura, zura që të punoj që ato të mos merrnin kahun e tillë. Bashkë me disa intelektualë morëm përsipër që të mos bisedohej as për ideologji e as për “krahë të kundërt”, por për një emancipim intelektual dhe shpirtëror tonin, në mënyrë që burgun ta kalonim duke u pasuruar me diçka në vend se të ushqeheshim me ndasi dhe urrejtje të panevojshme. Kështu, kërkova që bisedat e ashpra të shumtën koti të zëvendësoheshin me ato për libra dhe çështje letrare dhe aso shoqërore, sipas një orari, ku dy herë në javë, do të trajtonim ndonjë roman nga letërsia shqipe apo ajo botërore, nga ata të paktët që kishte biblioteka e burgut. Dy nga profesorët e letërsisë, Petriti i letërsisë shqipe dhe Shaipi i letërsisë botërore, morën përsipër që t’i udhëhiqnin këto biseda. Një sociolog, Bedriu nga Prizreni, doli me propozimin që të bisedohej për mentalitetet patriarkale dhe rolin e autoritetit në rrethanat e reja, veçmas kur kishte rënë sistemi socialist, ndërkohë që në Kosovë ideologjia komuniste ishte rrënuar brenda disa ditësh sikur mos të kishte qenë kurrë.

Por, kur dukej se futja e bisedave letrare dhe kulturore në vend të atyre politike, do të përjashtonte ndasitë, shfaqen disa “kryengritës”, që zunë me na quajtë “mashtues” dhe madje “pacifistë”, që vinim “nga shteti paralel”, që sipas tyre “bënim punën e Beogradit”, se ishim “spiun” dhe të ngjashme, ani pse kjo zuri të kundërshtohet nga shumë të rinj dhe të tjerë, të cilët po tregonin gjithnjë e më shumë interesim për biseda të tilla se sa për ato që u vinin nga kruzhohet ideologjike, që me asgjë nuk mund të arsyetoheshin pos se edhe mëtutje mbeteshin ve të qyqes.

Natyrisht, se drejtorja e burgut, që mund të thuhet se kishte qenë e interesuar për një klimë të tillë, pra që midis të burgosurve shqiptarë të mos ketë pajtim, e aq më pak për emancipim intelektual për aq sa lejonin mundësitë, por të kishte përçarje dhe grindje ndër më të ndryshmet, do t’u kthehet “masave shtesë”, me anën e të cilave, krahas ndarjes së shqiptarëve në dy pavijone, të bëhet edhe ndarja e tyre në reparte të veçanta pune, që do të arsyetohen “si masa të domosdoshme që të parandalohen konfliktet politike”, me anën e të cilave, në të vërtetë do të çimentohen dallimet midis “krahëve kundërshtarë” me çka synohej që një pjesë e të burgosurve, të lidhur për kurthin e këtyre ndasive, ose pse kishin detyra të

caktuara, sapo të dalin, në vend të përpjekjeve të përbashkëta për t'u liruar nga pushtuesi serb, t'i ushqejnë ndasitë, që mbi këto baza, midis tyre të ndezët një luftë e brendshme...

Duke parë përcaktimin tim dhe të shumë intelektualëve të tjerë, që të burgosurve t'u sqaroheshin kurthet në të cilat po binin dhe nga frika se ndikimi ynë, përkundër aparatit të specializuar për punë të tilla, do ta bënte të veten, pra do t'i parandalonte këto zhvillime të dëmshme, drejtoria e burgut, mori masa që një pjesë të mirë të intelektualëve t'i largojë nga repartet e përbashkëta të punës për t'i shpërndarë në pjesë të ndryshme. Kështu, mua më larguan nga reparti i prodhimit të pajisjeve elektronike dhe më caktuan në bibliotekën e burgut. Ngjashëm do të veprohet edhe me ata intelektualë, të cilët kishin autoritet dhe mund të ndikonin që shqiptarët të mos përçaheshin mbi baza ideologjike dhe "të krahëve" të ndryshëm por të mendonin për ato që i bashkonin. Disa mjekë do t'i dërgohen që të punojnë në ambulancë dhe spitalin e burgut, ndërsa disa profesorë dhe një gazetar, do të caktohen me punë në administratën e burgut.

Me anën e këtyre masave, drejtoria e burgut ia kishte dalë që të veçonte intelektualët dhe ata që mund të kishin ndikim që të mos thelloheshin përçarjet në radhët e të burgosurve shqiptarë, veçmas tek të rinjtë që ishin të shumtë në numër dhe nga gjendja e rëndë nëpër të cilën kishin kaluar si dhe mjegullina që përcillte skenën politike shqiptare, lehtë binin pre e këtyre ndasive, ndërkohë që me anën e bashkëpunëtorëve të vet, intelektualët e "shpërblyer" në këto vende, njëherësh lehtë anatemohehin si "bashkëpunëtorë" të Beogradit, gjë që kështu dhe në këtë mënyrë i ndihmohej bindjes së kamotshme të fabrikuar prej vetë pushtetit serb, që bënte jetë tek shtresat e caktuara shoqërore se intelektualët ishin njerëz të kompromiseve, ose edhe bashkëpunëtorë të maskuar të regjimit, që futeshin nëpër burgje "për të mashtruar ata që kishin shpirt revolucionar" dhe "ishin të gatshëm që të luftonin për bashkim kombëtar" dhe të ngjashme.

Natyrisht se kjo sjellje, e cila megjithatë diku-diku pinte ujë dhe nuk do të mbetet pa pasoja, nuk ishte as e re e as e panjohur, meqë Beogradi kishte bërë çmos që shqiptarët të jetonin me dyshime të brendshme, ku jo vetëm shkollimi, ngritja intelektuale, por edhe mbijetimi i thjeshtë duhej të zgjonte dyshimin se arrihej me anën e bashkëpunimit me regjimin. Kjo madje kishte bërë që për një pjesë të popullatës, e cila kishte jetuar nën trysnitë e ndjekjeve të vazhdueshme, vetëm i vrari, i burgosuri (pa marrë parasysh pse futej në të dhe si mund të binte pre e përpunimeve të ndryshme), të shpallej i ndershëm dhe atdhetar madje.

Kur isha në Zagreb, dajë Josipi, i cili kishte përvojë të madhe në shërbimet informative të Jugosllavisë që nga paslufta e deri në fillim të viteve të shtatëdhjeta (kishte shërbyer si atashe ushtarak në Shqipëri, Turqi dhe së fundi në Itali) dhe mund të merrej me mend se njihnte edhe metodat më perfide, të cilat ky shërbim vazhdimisht kishte përdorur ndaj shqiptarëve, ma kishte bërë të ditur se në rrethanat nëpër të cilat po kalohej dhe do të kalohej (ishte pragu i luftës dhe Jugosllavia do të shpërbëhej dhunshëm), shqiptarët e përcaktuar për pavarësi (pasi që ishte shpallur Deklarata e Pavarësisë më dy korrik 1990 dhe më 7 shtator Kuvendi i Kosovës në Kaçanik kishte shpallur Kosovën Republikë të pavarur), më shumë se pushtimin serb, të cilin një ditë do të mund t'ia dilnin që ta hiqnin qafesh, për kundërshtar do ta kenë përçarjet e brendshme, që do t'u ndizen nga shërbimi informativ jugosllav UDB-ja, dhe veçmas nga ai i Armatës Jugosllave KOS, të cilët në tërësi ndodheshin në duar të Serbisë prej nga kishin përvetësuar pjesën më të madhe të dosjeve dhe të dhënave të tjera strategjike, të cilat do të mund të përdreshin për qëllime të caktuara.

“Beogradi ka shumë e shumë bashkëpunëtorë midis shqiptarëve të rekrutuar në forma të ndryshme midis tyre qysh nga koha e Perandorisë Osmane, kur Serbia lidhte marrëveshje herë të hapura e herë të fshehura me disa nga feudalët e njohur shqiptar për gjoja luftë të përbashkët kundër osmanëve, me ç’rast, krahas dhënies së armëve, atyre u është premtuar ruajtja e pronës, e besimit dhe e lirive qytetare edhe pse do të ndodhë e kundërta dhe disa prej tyre madje edhe do të likuidohen në situata kur priteshin kthesa të cilat përkohësisht do ta përjashtonin pushtimin serb të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, siç ishin ato gjatë Luftës së Parë Botërore pas depërtimit të ushtrive austriake-gjermane dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore pas kapitullimit të mbretërisë jugosllave në vitin 1941 kur do të krijohet e ashtuquajtura Shqipëri e Madhe. Pas ripushtimit të Kosovës nga partizanët jugosllav në vjeshtën e vitit 1944, që do të bëhet në marrëveshje me partizanët e Shqipërisë, krahas terrorit të njohur ndaj popullatës së pambrojtur që të shpërngulej nga Kosova dhe krahas përdorimit të metodave të tjera që të mos lejohej kthimi i tyre, Beogradi edhe më tutje vazhdoi politikën e gjetjes së “jatakëve” ndër shqiptarë, duke u dhënë privilegje disa familjeve, të cilat pranonin lojalitetin e shtetit serb dhe më pas atë jugosllav. Por, Beogradi, i cili ka pasur për qëllim pastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët, asnjëherë nuk u ka besuar as bashkëpunëtorëve e as atyre që kishin pranuar lojalitetin e shtetit serb, meqë ka ekzistuar bindja se shqiptarët edhe kur e bëjnë këtë në shpirt ruajnë armiqësinë e thellë kundër serbëve, e cila shpërthen sapo t’i vijë rasti. Kjo e ka shtyrë Beogradin që t’i përkryejë metodat që t’i parandalojë ata që këtë armiqësi ta kanalizojnë kur duhet dhe si duhet, duke bërë çmos që ajo, qoftë edhe si rezistencë e armatosur, të derdhet e mbikëqyrur dhe në përputhje me planet serbe, në mënyrë që pastaj të arsyetohen edhe mjetet e luftës për shkatërrimin e saj.

Dajë Josipi më kishte folur gjerë e gjatë jo vetëm rreth asaj si Beogradi kishte futur kthetrat e veta midis shqiptarëve në Jugosllavi me anën e metodave ndër më të ndryshmet dhe ndër më perfidet, por edhe për veprimet që të fusë gishtat sa më thellë edhe në Shqipëri dhe në diasporë madje, në Turqi, Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kudo ku ata jetojnë qoftë edhe në bashkësi të vogla, siç janë ato në Australi dhe Zelandë të Re.

Meqë një kohë kishte shërbyer si atashe ushtarak jugosllav në Tiranë dhe Ankara dhe sigurisht se kishte pasur mbikëqyrje ndaj një pjese të veprimeve informative, tregonte se Shqipëria e Enver Hoxhës ishte mbikëqyrur fund e krye nga agjentët jugosllavë, me shumë e shumë bashkëpunëtorë, të infiltruar në të gjitha strukturat e udhëheqjes dhe në të gjitha nivelet, të shumtën shqiptarë, të cilët me përkushtim të madh kishin punuar për shërbimet informative të Beogradit. Sipas tij, shumë prej tyre kishin mbetur “të fjetur” edhe pas prishjes së Enverit me Titon në vitin 1948 për të vazhduar gjithnjë deri në ditët tona.

“Beogradi ka pasur njerëzit e vet në aparatën policor dhe ushtarak shqiptar edhe atëherë kur Shqipëria ishte me rusët, edhe kur ishte me kinezët dhe gjithnjë, edhe pse Enver Hoxha krenohej se gjithë shqiptarët janë vigjilentë dhe nuk u shpëton as miza pa e parë.”

Si storie tragjike, dajë Josipi kishte përmendur ndikimin e shërbimeve informative të Jugosllavisë në Shqipëri për ndjekjen dhe likuidimin e forcave nacionaliste shqiptare në këtë vend, që bëheshin në emër të qërimit të hesapeve me nacionalistët, kolaboracionistët dhe gjoja bashkëpunëtorët e fashizmit, kur pjesa më e madhe e tyre ishin burgosur por edhe likuiduar sipas listave që Tirana kishte marrë nga shërbimet jugosllave. Ngjashëm ishte vepruar edhe me kosovarët, të cilët ishin ndjekur në Kosovë dhe kur kishin kërkuar strehim

në Shqipëri, me të shpejtë i ishin dorëzuar organeve ndjekëse të Jugosllavisë, ku ishin likuiduar.

Dajë Josipi më kishte folur edhe për ripushtimin e Kosovës nga aradhet partizane jugosllave, që ishte bërë me marrëveshjen midis Titos dhe Enverit më 22 shtator të vitit 1944, pasi që ky i pari këtë e kishte kërkuar nga vartësi i tij shqiptar gjoja në emër të masivizimit të frontit antifashist nga radhët e nacionalçlirimtares në Kosovë në fazën përfundimtare të tërheqjes së njësive gjermane nga Greqia dhe Shqipëria në drejtim të veriut, me çka me këtë ishte zhvlerësuar e gjithë struktura antifashiste e kosovarëve, e cila kishte punuar që në kuadër të frontit antifashist ta ruante bashkimin me Shqipërinë. Nga ai kisha marrë vesh edhe për terrorin e paparë që kishte shpërthyer në Kosovë pas Komunikatës së Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë të dy dhjetorit 1944, me të cilën në Kosovë duhej të fillonin operacionet pastruese për likuidimin e forcave balliste dhe atyre që kishin marrë pjesë në anën e fashizmit. Kësaj fushate të egër terrori do t'u bashkohen edhe aradhet partizane të Shqipërisë (Divizioni V, VI dhe i VII). Partizanët shqiptarë, të cilët ishin pritur mirë nga popullata shqiptare e Kosovës, me shpresë se do të merren në mbrojtje nga forcat çetnike serbe, nuk kishin qarë kokën për frikën e arsyeshme të kosovarëve dhe për paralajmërimet se e ashtuquajtura luftë e përbashkët mbi bazat e internacionalizmit proletar, nga partizanët jugosllavë, shumica prej tyre çetnikë të konvertuar në partizanë pas marrëveshjes Tito-Shubashiq, do të mund të shfrytëzohej për hesape të vjetra, siç kishte ndodhur në të vërtetë, kur brigadat partizane serbe e Moravës në drejtim të Gjilanit dhe e Bokelit e Malit të Zi, në drejtim të Pejës, do të fillojnë të vrasin shqiptarë me arsyetimin se luftonin kundër ballistëve. Kur shqiptarët u ankoheshin komandantëve të aradheve shqiptarë se çfarë po ngjiste në të vërtetë, ata merrnin përgjigjen e prerë:

“ Jugosllavët i kemi vëllezër. Prej tyre duhet të kenë frikë vetëm bashkëpunëtorët e fashizmit dhe ata që i kanë duart të përljera me gjak”.

Kështu, gjatë këtyre operacioneve të përbashkëta midis partizanëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë, në dimrin e vitit 1944/45, që do të udhëhiqen nga partizanët jugosllavë, ndërsa veprimet pastruese nëpër zona të caktuara do të bëhen nga partizanët shqiptarë, do të vriten me mijëra atdhetarë shqiptarë, të shumtën intelektualë që nuk ishin pajtuar as me komunizmin e as me ripushtimin jugosllav, që ishte bërë në emër të internacionalizmit proletar. Në Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe qytetet tjera të Kosovës, në emër të qërimin të hesapeve me kulakët dhe strukturat e mbetura të shtetit shqiptar që u vendos nga gjermanët, shtresa qytetare shqiptare do të asgjësohet brenda natës.

Krahas qërimin të shpejtë të hesapeve me qytetarinë shqiptare, me vendosjen e gjendjes ushtarake më 10 mars, që do të zgjasë deri më 10 qershor - krahas anulimit të marrëveshjes së Bujanit, kur patriotët shqiptarë nga Kosova nga radhët e frontit antifashist të tubuar rreth nacionalçlirimtares do të aprovojnë rezolutën që t'i bashkohen Shqipërisë dhe krijimit të rrethanave të dhunshme që në Konferencën e Prizrenit të 10 korrikut të atij viti shqiptarët të detyrohen të deklarohen se gjoja me vullnet i bashkohen Serbisë – Kosova do të pastrohet edhe nga djalëria e saj dhe çdo gjë e vlefshme. Gjatë kësaj kohe, në frontet e Anamoravës, të Drenicës dhe të Dukagjinit dhe në pjesët tjera, gjatë fushatës si thuhej “për likuidimin e kundërrevolucionarëve dhe shërbëtorëve të fashizmit”, do të vriten mijëra e mijëra shqiptarë, ndërkohë që disa mijëra të tjerë do të pësojnë gjatë fushatës së mobilizimit të tyre, ku shumë prej tyre, të dërguar si vullnetarë, do të gjejnë vdekjen në frontin e Sremit.

Eshalonët e të rinjve shqiptarë të mobilizuar do të masakrohen edhe gjatë kalimit nëpër Shqipëri për në Bregdet, siç do të jetë rasti me rreth tre mijë veta të cilët, për në golgotën e Tivarit do të përcillen nga aradhet partizane të Shqipërisë.

“Në Kosovë gjatë katër viteve të luftës antifashiste ishin vrarë rreth dyqind veta, ndërsa nga dhjetori i vitit 1944 e deri në vjeshtën e vitit 1945 ishin vrarë mbi dyzet mijë veta. Fjala pra ishte për një gjenocid, i cili buron nga Memorandumi i Dytë i Vasa Çubrilloviqit, i hartuar në nëntor të vitit 1944, cili do t’i dërgohet Titos dhe do të pranohet nga ai. Aty do të elaborohen metodat që me pakicat (gjermanët, hungarezët dhe shqiptarët) të qëroheshin hesapet përfundimisht në emër të bashkëpunimit të tyre me okupatorët nazi-fashist.”

Dajë Josipi më kishte treguar se terrori ndaj popullatës shqiptare të Kosovës, asaj të Maqedonisë dhe në Mal të Zi, kishte vazhduar edhe në rrethanat e “bashkim-vëllazërimit” gjatë kohës sa vazhdonte “idili i dashurisë internacionaliste” midis Enverit e Titos, por ajo ishte bërë edhe më e ashpër pas prishjes së marrëdhënieve me Shqipërinë, kur Enver Hoxha ishte lidhur me Bashkimin Sovjetik dhe kishte hyrë në Paktin e Varshavës. Situatën e re kundër shqiptarëve e kishte shfrytëzuar Serbia dhe shërbimet e saj informative, që të fabrikonin “bashkëpunëtorë” të ndryshëm dhe të shumtë të Tiranës në Kosovë, në mënyrë që pastaj ata të ndiqeshin fillimisht si informbyroistë e pastaj si ithtarë të modelit të socializmit stalinist që vinte nga Shqipëria. Mjaftonte të gjendej në ndonjë skutë ndonjë libër i Enver Hoxhës (të shumtën qëllimisht i futur nga bashkëpunëtorët e UDB-së) apo ndonjë afish qoftë edhe në ndonjë nevojtoje publike, ku përmendej Shqipëria, (që shkruheshin nga persona të dyshimtë), që të terrorizohej një katund ose lagje të tëra të qyteteve.

“Për shqiptarët e Kosovës, të rënda do të jenë vitet e pesëdhjeta, kur Serbia bëte çmos që në emër të ndikimit të Shqipërisë staliniste dhe të propagandës së saj, që futej ilegalisht në Kosovë”, të luftojë edhe ato që në planin e emancipimit elementar arsimor dhe kulturor ishin arritur pas luftës me hapjen e shkollave fillore në gjuhën shqipe, pastaj mjeteve të informimit (gazetës “Rilindja” dhe Radio Prishtinës) si dhe botimit të disa librave në gjuhën shqipe, të shumtën të përkthyer nga serbokroatishtja, po ku kishte edhe aso të autorëve shqiptarë, që bënin hapat e parë në krijimtari. Në këto rrethana Beogradi inskenoi Procesin e Prizrenit dhe futi në burg shumë nga gazetarët dhe redaktorët e “Rilindjes”, por njëherësh filloi edhe aksionin famëkeq për mbledhjen e armëve, me ç’ratë gjatë dimrit të vitit 1954/55 popullata shqiptare e Kosovës, do t’i nënshtrohet një terrori të paparë. Shumë veta do të burgosën, e më shumë të tjerë do të maltreohen nga UDB-ja serbe me metodat më të egra, gjë që kjo do të përshpejtojë shpërnguljen e një pjese të mirë të shqiptarëve për në Turqi. Kësaj do t’i ndihmojë ratifikimi i marrëveshjes shtetërore midis Jugosllavisë dhe Turqisë nga viti 1936, me të cilën një pjese e mirë e popullatës shqiptare ishte shpërngulur për në Turqi. Disa nga krimet e rënda ndaj shqiptarëve të bëra në vitet pesëdhjeta dhe në ato të gjashtëdhjetat, do të pranohen edhe në Plenumin e Brionëve në verën e vitit 1966, kur Tito, nëpërmes të shqiptarëve dhe me mbështetjen e fshehur të Perëndimit, do t’i qërojë hesapet me unitarizmin serb dhe Rankoviçin, i cili në të vërtetë paraqiste rrezik për Jugosllavinë që serish të futej në kthetrat e Moskës.

Me rënimin e Rankoviçit, Tito arriti dy favore të mëdha strategjike: ia hapi rrugën federalizmit të vendit, ku edhe Kosova fitoi të drejtën që të jetë njësi e barabartë e saj, ndërsa forcoi rolin si lider në lëvizjen e të paikuadruarve, gjë që Jugosllavisë, si tampon zonë midis blloqeve antagonistë, i siguroi favore të mëdha, të cilat vendit i mundësuan një zhvillim të

hovshëm ekonomik ndër më të fuqishmit në Europën Juglindore, ndërkohë që në skenën e brendshme politike, vetëqeverisja bëri që socializmi jugosllav të jetë liberal.”

Mëtutje, dajë Josipi, më kishte treguar se Beogradi, edhe pse në planin ekonomik kishte përfituar më së shumti nga kursi vetëqeverisës jugosllav, megjithatë forcat unitariste serbe, të cilat asnjëherë nuk ishin pajtuar me federalizmin - ku Kosova me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 praktikisht ngrihej në njësi të pavarur të federatës, meqë kishte fituar të drejtën e konsensusit në Kryesinë e shtetit – ishin bërë gati që pas vdekjes së Titos të fillojnë hakmarrjen e madhe ndaj Kosovës por edhe republikave perëndimore, Kroacisë dhe Sllovenisë, për t’i kthyer në tutelën e saj.

“Pas Titos nuk do të ketë Tito, por Jugosllavi serbe...Kjo solli luftën dhe kjo solli tragjedinë që do të vazhdojë...Kasaphana ballkanike nuk do të ketë fund...”

Ato që m’i kishte treguar dajë Josipi sa kisha qëndruar në Zagreb gjatë kohës kur Drita po operohej në spitalin “Rebro”, jo vetëm që ma kishin rrotulluar mendjen, por kishin përmbysur shumëçka të jetës sime. I tillë kishte qenë edhe njoftimi se im Atë, Naim Kosova, pilot i aviacionit të Armatës Popullore të Jugosllavisë, dhe ime amë, Maria Paleviq, motër medicinale po ashtu e punësuar në Armatën Popullore të Jugosllavisë, ishin likuiduar nga shërbimi informativ ushtarak (KOS), edhe pse pastaj, e gjitha ishte treguar se ishte fjala për një aksident (rrëzimi i aeroplanit MIG-49), siç ishte paraqitur aksident edhe dalja e xhipit nga rruga me të cilin udhëtonte ime amë në rrugë për në spitalin e Bileqes. Dajë Josipi thoshte se kishte të dhëna të sigurta për këtë dhe se ato m’i kishte përgatitur, t’i kisha. Ma bëri të ditur se në plikon e madhe prej lëkure, që e kishte përgatitur prej kohësh për mua, kishte edhe një të vogël, të dyllosur, që duhej t’i jepej personalisht njeriut të parë të Kosovës vetëm pasi që ajo të bëhet shtet. Më kishte thënë se ishte mirë që plikon ta hapja vetëm kur të përfundonte lufta.

“Ka gjëra që në kohë të turbullta vjellin helm...”

Plikon e lëkurës e kisha marrë me vete kur isha larguar nga Zagrebi për në Prishtinë pa dyshuar aspak në ato që m’i kishte thënë dajë Josipi. Pa denjuar që ta hapja, por që këtë do ta bëja, kur t’i vinte koha, e kisha vendosur midis gjërave të vlefshme dhe bashkë me shënimet e ndryshme, dokumentet dhe shkrimet e shumta që kisha mbledhur nga gazetatat, ia kisha dërguar hallë Shpresës në Vushtri t’i ruante në pjesën e arkivit tonë të familjes.

Por, nuk ishin vetëm ato që m’i kishte thënë dajë Josipi rreth marifeteve të shërbimeve informative të Beogradit dhe lojërave me shqiptarët që t’i fuste gishtat kudo për të prishur çfarëdo përpjekje të drejtë të tyre që të çliroheshin nga pushtimi serb (që nga koha e Luftërave të Para Ballkanike dhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore) ose që të luftonin për barazi në rrethanat e ideologjisë komuniste (pasi që të jenë ripushtuar nga partizanët jugosllavë), që pak a shumë, në burgun e Nishin po më dilnin para. Fjalë të ngjashme kisha dëgjuar edhe nga disa të burgosur politikë (hungarez, rumun, kroatë, boshnjakë dhe disa intelektualë serbë nga Vojvodina e Serbia), të cilët nuk ishin pajtuar me politikën e Millosheviqit që kur ajo kishte filluar të rrënohte autonomitë dhe udhëheqjet politike të tyre një nga një me parullën e “bashkimit të Serbisë” (fillimisht atë të Vojvodinës dhe pastaj atë të Kosovës) dhe të vente marionetat e veta, siç nuk ishin pajtuar edhe me luftën që Beogradi kishte nisur në Slloveni, Kroaci, Bosnje Hercegovinë epilogu i së cilës dihej se çfarë do të ishte.

Njëri prej tyre Zvezdan Markoviq, oficer i lartë i Armatës Popullore të Jugosllavisë, i cili kishte shërbyer prej vitesh në Sarajevë, paraqiste mostrën më tipike të viktimës që duhej ta pësonte nga shkakut e rrethanave të reja jetësore të “vëllazërim-bashkimit”, siç kishte pësuar edhe im atë, dhe siç duhej ta pësoja edhe unë dhe shumë e shumë të tjerë, që vinin nga martesat e përziera, të cilëve moslejimi i barazisë pse ajo gjoja rrezikonte Serbinë (siç ishte rasti me Kosovën dhe kërkesën e saj për Republikë të barabartë me të tjerat, që ishte hedhur në demonstratat e shqiptarëve në nëntor të vitit 1968 dhe ishte përsëritur edhe në ato të vitit 1981 dhe me atë frymë ishte shkuar edhe në Lëvizjen Kombëtare të vitit 1989), ose rrënimi i saj, siç do të ndodhë me republikat tjera, që nga ardhja e Millosheviqit në fuqi, u kthehej në fatkeqësi dhe tragjedi jetësore, sepse të tillët nuk i pranonte as koncepti shoqëror nacionalist e as ai unitarit, ndërkohë që asnjansia i bënte të dyshimtë të dyfishtë.

“Ç’ e do që kemi lindur nga dashuri të ndaluara, që më parë të gjykuara për dështim”.

Ndonëse foli si me shaka, në ato fjalë kishte mundim, dëshpërim, e mbi të gjitha kishte dhimbje të thellë njerëzore, që shpërthen nga brenda.

“Vëllazërim-bashkimi na u kthye në mallkim”.

Zvezdani ishte fëmijë i përzier nga e ëma boshnjake dhe i ati serb i Kroacisë, avokat i njohur i shkolluar në Vjenë, i ardhur në Sarajevë pas Luftës së Parë Botërore i bindur se shteti i përbashkët i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, pas rrënimit të Perandorisë Austro-Hungareze, do të paraqesë një vazhdimësi të qytetërimit perëndimor në këto hapësira. Aty ishte martuar me një boshnjake (arsimtare e letërsisë botërore e shkolluar në Zagreb) dhe kishin pasur një fëmijë, të cilin ishin munduar ta edukonin në frymën e një përbashkësie qytetëruese jashtë kornizave fetare dhe atyre të ngurta nacionale. Për ta, krahas dashurisë, kultura dhe qytetërimi perëndimor ishin emërues i përbashkët që i kishte bashkuar dhe i kishte bërë të lumtur në jetë dhe shpresonin se kjo do ta bënte të lumtur edhe krijesën e tyre më të dashur. Të birin e kishin dërguar në gjimnaz ushtarak e pastaj në akademi ushtarake në Beograd, prej nga ishte martuar me një hungareze nga Novi Sadi, juriste e njohur. Pasi kishte marrë gradën e oficerit, ishte komanduar në Komandën e Garnizonit të Armatës Popullore të Jugosllavisë në Sarajevë, ndërkohë që bashkëshortja Magda fillimisht ishte zgjedhur gjykatëse në një gjykatë komunale të Sarajevës në mënyrë që më vonë të avancohet në postin e Gjykatës Supreme të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Ai, fillimisht kishte komanduar njësinë tankiste të Sarajevës e më vonë edhe atë të korparmatës, ku kishte marrë edhe gradën e kolonelit me perspektivë që të fitonte edhe atë të gjeneralit sapo të përmbushte moshën pesëdhjetëvjeçare, që shfaqej si kusht.

Me bashkëshorten Magda, kishte dy fëmijë: vajzën Vera (njëzet e dy vjeçare) dhe djalin Goran (njëzet vjeçar). Që të dy ishin të rritur në Sarajevë dhe nuk ndjeheshin as serbë, as boshnjakë, as hungarezë, por njëherësh ndjeheshin edhe serbë, ndjeheshin edhe boshnjakë, ndjeheshin edhe hungarezë, gjë që për këta kjo përbashkësi i bënte që të shfaqeshin me një identitet jugosllav në kuptimin intelektual dhe atë shoqëror, pra ku asgjë nuk përjashtojë dhe asgjë nuk ndalohej e ku çdo gjë lejohej në kuptimin pozitiv të shprehjes.

Por, pas shpalljes së Memorandumit të tretë të Akademisë Serbe të Shkencave në verën e vitit 1986 kur do të fillojë euforia nacionaliste e udhëheqjes së Beogradit, familja Markoviq kishte filluar t’i ndjejë shqetësimet e para. Fëmijët e tyre tashmë nuk kishin alternativën e përbashkësisë si qytetërim, por atë të përcaktimit nacionalit. Si fëmijë të një ushtaraku të suksesshëm duhej që të deklaroheshin serbë. Nuk bënte më punë as formula e

jugosllavizmit me të cilën shmangeshin deklaratimet e njëanshme, të cilat në Bosnje dhe Hercegovinë, por edhe në Kroaci dhe Vojvodinë, kishin arritur përmasa të gjëra shoqërore.

“Kremtimi i Vidovdanit në Fushë të Kosovës më 29 qershor të vitit 1989 dhe ato që do të thuheshin aty nga Millosheviqi qenë mesazh i qartë se familjes sime, por jo vetëm asaj, po i përgatitej shkatërrimi. Sepse as unë e as ime shoqe, e aq më pak fëmijët e mi, nuk mund ta pranonin formulën e serbizimit si emblemë e vetme dhe e detyrueshme shoqërore. Magda, nuk do të gjejë më paqe me ato që do të ndodhin pas pak në Vojvodinë, kur paramilitarët e Millosheviqit do të rrënojnë autonominë e kësaj krahine shumetnike, e cila kishte qenë e njohur për harmoni të ndërsjellë, të kultivuar qysh nga koha e Austro-Hungarisë. E tmerruar me ato që kishte përjetuar si fëmijë, pas depërtimit të partizanëve sovjetikë në ato pjesë si dhe ardhjen e kolonëve serbë nga Hercegovina dhe vendosjen e tyre në shtëpitë e gjermanëve të përzënë, Magda kishte kërkuar që fëmijët t’i largojmë jashtë vendit me arsyetimin se do të studiojnë, edhe pse ata fillimisht nuk kishin qenë të bindur se gjerat mund të shkojnë deri aty sa t’u rrezikohet ardhmëria. Shpresonin se epidemia e çmendisë që kishte mbërthyer etërit e tyre nuk do të jetë në gjendje që t’i përfshijë edhe ata. Besimi i tyre më pëlqente, por e dija se ata do të binin viktimë të besimit, sepse fitili tashmë i kishte hyrë Armatës Popullore të Jugosllavisë, pikërisht forcës kryesore të vendit, që merrej si garantuese e përbashkësisë si dhe socializmit vetëqeverisës. Ndonëse ushtarakët, që përfaqësonin një elitë shoqërore e cila më së shumti i ishte nënshtruar modelit të vëllazërim-bashkimit (martesat e përziera si dhe edukata socialiste jashtë kornizave nacionaliste), do të duhej të kundërshtonin pse ashtu mbronin veten dhe familjet e tyre, hierarkia e komandës e kishte kthyer atë në militante të nacionalizmit serb, ngaqë kreu ushtarak (Këshilli Ushtarak i Federatës) ishte i pari që do të përkrahë kërkesën e Serbisë për ndryshime kushtetuese, me moton e “unitetit të vendit”, që për kusht kishte “Serbinë unike”, pra që krahinave (Kosovës dhe Vojvodinës) t’u merrej subjektiviteti në federatë dhe konsensusi, me çka ato serish dhe dhunshëm ktheheshin nën tutelën e Serbisë, gjë që automatikisht rrënoonte baraspeshën në federatë. Kjo ma kishte krijuar bindjen se duhej bërë çmos që fëmijët t’i mbroja nga kjo gjendje dhe kjo mund të bëhej nëse do t’i largoja nga vendi, së paku për derisa të shiheshin se nga po shkonin punët, por çështje ishte si mund të arrihej kjo kur Shërbimi Informativ Ushtarak (KOS) kishte vu në shënjestër ushtarakët dhe dihej se ne përcilleshim nga të katër anët. Magda sikur gjeti një zgjidhje, kur verën e vitit të ardhshëm, mori fëmijët dhe shkoi për një vizitë në Budapest, te vëllai dhe kushërinjtë tjerë, që kishte atje. Edhe pse çdo gjë duhej të dukej si vizitë e rëndomtë, megjithatë, agjentët e KOS-it me të shpejt m’u hodhën në qafë dhe kërkuan sqarime. U përpoqa që të shtiresha se fjala ishte për një vizitë të rëndomtë familjare, siç kishte ndodhur çdo verë, por meqë ata kishin përgjuar bisedat në banesën time, ma tërhoqën vërejtjen se duhej t’i përmbahesha kodeksit ushtarak, që për largimet e familjarëve jashtë vendit, në një kohëzgjatje për më shumë se dy javë, duhej të njoftoja paraprakisht.

Te kjo pikë në të vërtetë do të fillojë nyja e fatkeqësisë sonë, sepse Magda e cila kishte shtyrë pushimin edhe për tri javë të tjera, pse këtë duhej ta bënte meqë kishte pasur një operacion në zorrën çorre, me të shpejtë ishte suspenduar nga puna. Gazeta “Veçernje Novosit” e Beogradit kishte sjellë një lajm se ajo bashkë me fëmijët kishte kërkuar azil politik në Hungari me arsyetimin se ndjehej e rrezikuar nga nacionalizmi serb! Edhe pse kjo nuk kishte qenë e vërtetë (ambasada hungareze në Beograd këtë e kishte demantuar), kjo do të mjaftojë që të fillonte rrënimi i karrierës sime që do të çojë edhe te ndarja e familjes sonë.

Pa ndonjë sqarim, Komanda e Armatës së Dytë më suspendoi nga puna. Bashkë me të erdhi edhe urdhëresa që të mos e lëshoja Sarajevën. Me këtë rast m'u mor pasaporta. Shtypi i Beogradit, por edhe ai i Sarajevës që drejtohej nga Beogradi dhe garonte për "të gjetur" sa më shumë "të dyshuar dhe të papërshtatshëm" në kreun e armatës, kishte filluar të hidhte në opinion gjithfarë shpifjesh kundër meje dhe një grupi oficerësh, gjë që e gjitha përfundoi me arrestimin tim pas një jave nën akuzën e përpjekjeve për puç ushtarak! Bashkë me mua ishin burgosur edhe gjashtëmbëdhjetë oficerë të lartë nga Armata e Dytë, të shumtën që vinin nga martesat e përziera ose që ishin të lidhur me martesat e përziera. Midis tyre kishte dy kroatë dhe një oficer shqiptar, i cili ishte i martuar me një serbe. Pas gjashtë muajsh, u dënuam, jo për përgatitje të puçit ushtarak, meqë kjo ishte vërtetë qesharake dhe komprometuese, por për sjellje oportuniste, pse kishim kundërshtuar organizimin e ri ushtarak i cili bëhej në përputhje me qëndrimet e reja të kreut politik të vendit, e ku vetëmbrojtjes së deriatëhershme territoriale të republikave dhe krahinave, duhej t'u merreshin kompetencat dhe t'i ktheheshin armatës. Te kjo pikë ishte shfrytëzuar një qëndrim im i dhënë në komandën e garnizonit me rastin e një shqyrtimi kur kisha mbrojtur vendimin që mbrojtja territoriale të ruante armatimet që shkojnë deri te topat e kalibrit 45 milimetra, pra të armëve mobile antitanke dhe antiajrore, meqë kjo ishte në përputhje me doktrinën e vetëmbrojtjes në të cilën ishte investuar shumë gjatë viteve të fundit.

Sidoqoftë dënimi im prej pesë vitesh burg kishte më shumë peshën e kërcënimeve që u bëhej ushtarakëve, të cilët hezitoinin t'i nënshtroheshin kursit të ri të Armatës Jugosllave, që kryekreje po i nënshtrohej udhëheqjes politike serbe dhe ithtarëve të kursit unitar në federatë, e që nuk do të vonojë dhe mbi këtë bazë, ajo do të fillojë edhe luftën në Slloveni dhe Kroaci për ta bartur pastaj edhe në Bosnje dhe Hercegovinë, në mënyrë që atë ta përmbyll në Kosovë, luftë kjo që pos që do ta shkatërrojë Jugosllavinë e Titos, njëherësh do të shkatërrojë edhe shumë e shumë familje, që u besonin ligjeve të jetës dhe jo atyre të politikës së dhunshme, siç ishte ajo e udhëheqjes serbe, që solli tragjedi të papara në këto anë, ndër më të mëdhatë e pasluftës, të cilave ende nuk u shihet fundi..."

Këtu Zvezdani për pak kishte ndërprerë rrëfimin e tij. Ishte përfshirë nga një ngërç i fuqishëm sa që i ishte dashur të përdorte hapat qetësues për të parandaluar shembjen. I kisha ndihmuar që të merrte veten, duke ia bërë me dije se kjo luftë më kishte prekur edhe mua, duke ma shpërndarë familje, siç kishte prekur edhe shumë e shumë të tjerë, dhe për fat të keq, do të prekte këdo, madje edhe ata që kishin menduar se mund t'i shpëtonin po qe se do t'i rrinin manash, ose do të largoheshin fare prej saj me anën e ikjes jashtë, për t'i thënë se nuk duhej humbur shpresat pse ishte kështu, por përkundrazi, duhej besuar se e mira do të kthehej në vend të vet e të ngjashme.

"Familja ime tashmë është shkatërruar...Ajo nuk është më...Jeton si fantazmë..."

Prapë nisa t'i flisja se nuk duhej humbur shpresa, veçmas pse ata ishin jashtë vendit dhe kjo mbase ishte rrethanë lehtësuese, por ai ma bëri të ditur se, që ta shpëtonte atë dhe veten, kishte kërkuar që gruaja dhe fëmijët ta ndërronin identitetin...

"Nuk kishte zgjidhje tjetër. Shërbimi informativ ushtarak (KOS) nuk do t'i linte të qetë kurrë. Një ditë mund të më shantazhonte me anën e tyre, ose ata me anën time, krejt një, për të bërë ndonjë punë që nuk bëhej... Sepse, ata janë në gjendje të bëjnë atë që nuk ta merr mendja...Veçmas të përdorin familjet dhe familjaret për qëllime të tyre. Për këso marifetesh nuk kanë shokë...Ua kalojnë edhe rusëve dhe amerikanëve prej të cilëve kanë marrë mësimet

e para... Andaj, kërkova që të ndaheshim përgjithmonë...Për mua ardhmëria e fëmijëve të mi ishte më e rëndësishme se çdo gjë tjetër...Nuk duhej të lejoja që të vijnë në gjendje time...Kush do të thoshte se nga dashuria e madhe njeriu edhe në këtë mënyrë heq dorë prej gjërave më të dashura dhe më të çmueshme?...Kush?...”

Fjalët e fundit të Zvezdanit se si më qëlluan si gur rrufeje shkrep nga qielli. Mendja më shkoi te Drita dhe Valnori, që ishin në Austri. Por, që mund të ndiqeshin ose që unë të kthehesha në peng të tyre, gjë kjo më e lehta, për këtë asnjëherë nuk kisha menduar. Ndërkohë që ai edhe mëtutje po fliste si e kishte marrë këtë vendim, që ia kishte ndryshuar jetën, mua po më shfaqej Drita dhe Valnori në duart e xhelatëve të padukshëm, që po u thoshin diçka për mua, çmos, ndërkohë që ata përpiqeshin të shpëtonin prej tyre duke kërkuar ndihmën time.

“Duhej t’i mbroja disi...Nuk kishte zgjidhje tjetër...Ia vlen sakrifica e njerit që të shpëtojnë të tjerët...Ç’ë do që kemi ardhur në këtë gjendje të rëndë jonjerëzore!...”

Rreth ndarjes së dhunshme me familjen më kishte treguar edhe oficeri hungarez, Lajosh Varga, i cili kohë më parë kishte ardhur në burgun e Nishit për të vuajtur dënimin prej tri vitesh. Ishte dënuar nga Gjykata Ushtarake e Beogradit pse, pasi që ishte rrethuar nga forcat kroate nga të gjitha anët, kishte dorëzuar një garnizon në frontin e Sllavonisë, që sipas urdhrit të marrë nga komanda ushtarake e Zonës së Katërt të Armatës Popullore të Jugosllavisë që gjendej në Vukovar, duhej të mbrohej deri në njeriun e fundit. Por, për Lajoshin, kishte rëndësi që të anashkalohej gjakderdhja e panevojshme, që për të ishte e natyrës politike, gjë që kësaj ia kishte dalë, sepse pas marrëveshjes që kishte bërë me forcat kroate, ishte larguar pa asnjë therë në këmbë bashkë me njëqind e njëzet ushtarët dhe oficerët që komandonte. Me të dalë nga rrethimi kishte lejuar rekrutët, të shumtën shqiptarë e disa hungarezë, që me kërkesën e tyre të mbeteshin në Kroaci dhe të kërkonin strehim të përkohshëm. Por, burgosja dhe dënimi nën akuzën se kishte refuzuar të luftonte në Kroaci, për Lajoshin do të thoshte më shumë se aq. Meqë ishte i martuar me serbe dhe kishte dy fëmijë të vegjël (vajzën katër vjeçare dhe djalin një vjeçar), të cilët që nga fillimi i luftës me urdhrin e komandës ushtarake ishin tërhequr në Zemun dhe, shkurorëzimi nga bashkëshortja ishte i domosdoshëm. Sepse, ajo nuk mund të jetonte në Serbi nën “hipotekën” e tradhtisë që kishte bëri bashkëshorti si ushtarak. Andaj, qysh gjatë mbajtjes në hetuesi kishte kërkuar të shkurorëzoheshin. E shoqja, këtë nuk kishte dashtë ta pranonte dhe kishte qenë e gatshme që të gjente mënyrë të largohej nga vendi, si shumë familje të tjera të ushtarakëve, por ai e kishte bindur se kjo ishte zgjidhja më e mirë për të dhe veçmas për fëmijët e tyre, të cilët meritonin atdheun. I kishte thënë se po qe se një ditë çmendia merr fund, dhe sipas tij asaj megjithatë do t’i vinte fundi, po qe se në ndërkohë nuk do t’u hynte diç mes që këtë ta pamundësonte, do të bashkoheshin.

Lajoshi thoshte se në rrethana të tilla duhet zgjedhur të keqën që është më pak e keqe, duke ma bërë me dije se për të kishte rëndësi vetëm ardhmëria e fëmijëve të tij për të cilën ishte në gjendje që të sakrifikonte çdo gjë.

“Mund të pajtohem që të mos i takoj më bashkëshorten dhe fëmijët, por assesi që ata të vuajnë nga shkaku im...”

Në pjesën e bibliotekës së burgut, kisha takuar edhe të tjerë që përballeshin me këso telashe. Secili kishte nga një rrëfim të veçantë në këtë tragjedi, që edhe më tragjike i bënte ballafaqimi në ato rrethana, sa të besohej se në atë vend ishin qëllimisht të shpalosnin

përmasat e shkaktarit dhe epilogun e njëjtë për të gjithë, që ishte i pashmangshëm dhe me këtë dënimi ynë kohor, si shpirtëror, kthehej në vuajtje të përhershëm para të cilit, kush më herë e kush më vonë, dorëzohej meqë jeta e tillë humbte çfarëdo kuptimi.

Kështu, i pari që do t'i japë fund jetës me vetëvrasje ishte kolonel Zvezdan Makoviq. Pas tij të njëjtën do ta bëjë hungarezi Lajosh Varga, ndërsa ngjashëm do të veprojnë edhe një profesor kroat nga Vojvodina, një mjek serb nga Uzhice, dhe një ushtarak boshnjak nga Novi Pazari. Vargu i vetëvrasjeve nga pavijoni i kulturës, ku ishte biblioteka përfundoi me oficerin shqiptar Zahir Hamza nga Bujanovci, i martuar me rumune, me të cilën kishte një vajzë gjastëmbëdhjetë vjeçare, që do t'i kthehet në shkak të vetëvrasjes, meqë lajmin për dhunimin e saj, nuk kishte qenë në gjendje që ta përballonte.

Kolonel Zezdan Markoviq, kishte bërë vetëvrasje të nesërmen e nënshkrimit të marrëveshjeve të Dejtonit. Atë pasdite dhe në mbrëmje, diku deri nga ora tetë, sa lejohej të qëndronim në bibliotekë, kishim marrë lajmin, që i retushuar nga qendra për informim e burgut, dukej sikur ishte një fitore për Millosheviqin, meqë ai jo vetëm që shfaqej nënshkrues i marrëveshjes bashkë me presidentin amerikan, Klinton, atë francez, kancelarin gjerman, premierin britanik dhe presidentin rus, njëherësh kthehej në “njeri të paqes botërore”, në një partner të pashmangshëm të bashkësisë ndërkombëtare përkundër asaj që kishte filluar luftën, që kishte shkatërruar vendin dhe mbi të gjitha kishte bërë një gjenocid të paparë në Bosnje dhe Hercegovinë, ku rasti i Srebrenicës ishte më i tmerrshmi, meqë dorëzimi dhe gjithë masakra me mbi tetë mijë boshnjakë të vrarë, ishte bërë me një marrëveshje me përfaqësuesit e Kombeve të Bashkuara, pasi që ky qytet, bashkë me gjashtë të tjerë, kishte tretmanin e “zonave të mbrojtura nga OKB”, gjë që në këtë krim domosdoshmërisht përfshihej edhe Organizata Botërore, e me të edhe e gjithë bashkësia ndërkombëtare.

“Kush do të thoshte se një vrasës i tillë kthehet në partner të fuqive botërore?...Kush do të thoshte se xhelati ynë kremtohet?... Kush do të thoshte se amerikanët do të pranojnë gjenocidin, por edhe projektin e Beogradit për krijimin e Serbisë së Madhe. Bosnja e Dejtonit nuk paraqet tjetër pos Serbi të Madhe dhe Kroaci të Madhe. Ajo është shpërblim për krimet kundër njerëzimit!...Bota ime nuk ekziston më...Ajo përfundimisht u shemb në Dejton...Ah, Bosnja ime! Ah! Nuk do të jesh më e atyre që ta falën shpirtin...Bosnja ime e përgjakur!...”

U mundova me kot ta me e qetësue disi, duke ia bërë me dije se mbase kjo ishte zgjidhja e vetme, me të cilën gjërat mund të ktheheshin në vend të vet. I thashë se nëse njerëzit nuk e pranojnë ndarjen, ajo nuk do të bëhet...

“Lëri njerëzit...Kush qanë kokën për ta...Kjo u pa...Në Bosnje u vra ajo që për shekuj ishte e përbashkët...Ky është një krim që ngarkon ndërgjegjen e gjithë botës...Është krim me paramendim...Të gjithë janë bashkëfajtorë...Të gjithë, engjëjt dhe djajtë, të gjithë...”

Ashtu edhe u ndamë. Kur po largohej më tha se druante se edhe Kosova ime nuk do t'i shpëtonte fatit të Bosnjës.

“Uroj që Kosova të mos kthehet në Bosnje...Uroj, vëlla...Dejtoni tregoi se të mëdhenjtë kanë hesapet e veta dhe janë në gjendje që të bëjnë paqe edhe me djallin...Me zgjedhjen e kriminelëve dhe vrasësve për partnerë, siç ndodhi tash dhe pritet që të ndodhë edhe në pjesët tjera, nuk paqësohet Ballkani e as nuk zgjidhen telashet pos që mbesin plagët qëllimisht të hapura të mbushura me qelb, që të shfrytëzohen për qëllime të caktuara të atyre që mbajnë peng të ardhmen tonë dhe luajnë me të sipas nevojës...Medet për ne...”

Të nesërmen morëm lajmin për vetëvrasjen e tij (ishte lidhur me një rrip në pjesën e radiatorit) dhe kjo nuk më befasoi.

E kishte vrarë Dejtoni...

Pas një jave të njëjtës rrugë kishte shkuar edhe oficeri hungarez Lajosh Varga. Ai kishte prerë venat e duarve me një xham. Thuhej se kishte lënë një letër për familjen, në të cilën ishte arsyetuar se ai fund mund t'i shërbente një fillimi të ri, po qe se ai do të mund të quhej i tillë...

Edhe boshnjaku Salko Halilović, nga Novi Pazari, që kishte kërcyer nga kati i dytë, kur po fshinte dritare, kishte lënë një letër, në të cilën thuhej se nuk kishte kuptim të jetohej në një kohë kur bëheshin gjenocide të tmerrshme sy botës, ndërsa shkaktarët e saj ktheheshin në heronj...

Vetëvrasja e oficerit shqiptar Zahir Hamza nga Bujanovci, disa ditë para se të lëshohej nga vuajtja e dënimit prej katër vitesh (ishte dënuar pse nuk kishte pranuar që të granatonte një qytet boshnjak në Lim para se të evakuohej popullata), kishte qenë e drejtuar fund e krye nga Shërbimi Kundërinformativ Ushtarak (KOS) të kishte atë epilog. Njeriu fjalëpakë nga Bujanovci, kadet i shkëlqyeshëm i Akademisë Ushtarake të Beogradit, i martuar me rumune nga Banati, që mbahej jugosllave dhe babë i një vajze, sikur nga fillimi e kishte pasur të qartë se hakmarrja ndaj tij do të fillonte te familja dhe se kjo do të bëhej që ta lëndonte si prind dhe si njeri. Disa herë kishte zënë ngojë brengën për fatin e vajzës, Mirës, e cila pas burgosjes së tij kishte shkuar të jetonte me të amën te i vëllai, në një katund të vogël të Baçkës së Vovjodinës, të banuar me sllovakë, ku ai prej vitesh punonte si furrtar. Që ta mbante sa më larg telashit vajzën, kishte kërkuar që as e ëma e as ajo të mos e vizitonin në burg, të mos i shkruanin letra dhe të mos e zënin ngojë para të tjerëve. Pra, të silleshin sikur ishin të shkëputur prej tij. Nga i vëllai, Ferati, që e vizitonte në burg, vazhdimisht kërkonte që Mira të mbahej nën mbikëqyrje të përhershme, veçmas të mos lejohej të futej në ndonjë shoqëri të dyshimtë. I vëllai i kishte thënë se ajo ishte një vajzë e mbarë, se vazhdonte gjimnazin me sukses, ndërkohë që kohën tjetër e kalonte në furrë bashkë me të amën. Por, vetëm disa ditë pa u lëshuar, sikur ta priste se e keqja më në fund do ta gjente, Zahirin i erdhi lajmi se e bija ishte gjetur e vdekur në një periferi pas një përdhunimi të shumëfishtë, dhe se për përdhunuesit nuk dihej, por po punohej që të kapeshin...Kjo kishte mjaftuar që njeriut të shkretë t'i turbullohej mendja dhe rrugës për në qeli, kërceu nga shkallët e katit të tretë...

Pas daljes nga burgu, ndonëse i mbyllur në lëvozhgën time dhe pa far vullneti që të merrem me punët e botës, megjithatë fjalë mbas fjale, mora vesh se përdhunimi i vajzës së oficer Zahirin kishte ndodhur qëllimisht, pasi që ai nuk kishte pranuar të infiltrohej në radhët e lëvizjes së rezistencës së shqiptarëve të Kosovës. Shërbimi Informativ Ushtarak i kishte ofruar ta nxirrte nga burgu me ndonjë truk, siç e kishte zakon të bënte me bashkëpunëtorët e vet më të sofistikuar, të cilët, të shumtën i trajnonte nëpër burgje, rëndom me metoda tepër perfide, duke ua krijuar pedigrenë e të përndjekurve politikë, nacionalistëve të paepur, gjoja të rebeluar nga radhët e policisë, pastaj të dezertorëve nga Armata Jugosllave dhe çmos tjetër, të cilët për hesapet e Beogradit infiltroheshin në radhët e partive politike, këshillave për të drejtat e njeriut, pjesëtarëve të shoqërive civile për t'u futur pastaj edhe në strukturat e caktuara të lëvizjeve të rezistencës në Kroaci, Bosnje Hercegovinë, në Maqedoni dhe në Kosovë... Disa nga këta bashkëpunëtorë, me të njëjtat metoda, nxirreshin jashtë, herë me identitete të rreme e herë me atë të "kundërshtarëve të përбетuar të Serbisë dhe të Beogradit"

me stazh të gjatë burgu “si nacionalistë të përbetuar” ose “anti-titistë” dhe ndryshe-ndryshe, në mënyrë që pastaj, pa ndonjë vështirësi të futeshin nëpër shoqata, klube dhe madje edhe nëpër mekanizmat e fondeve për luftën, atyre për blerjen e armëve dhe çmos, prej nga mund të merret me mend, se ku ia dilnin që këtë ta bënin, të luanin lojën e Beogradit...

Por, vetëvrasja e Zahirit, mbi të gjitha, m’i përkujtonte ato që m’i kishte thënë Zvezdani rreth mbrojtjes së familjes me anën e ndryshimit të identitetit, masë kjo tepër e dhimbshme, por e vetmja që mbase deri diku bënte punë në ato rrethana.

“Ne edhe ashtu jemi viktima, por nuk duhet lejuar që fëmijët tonë ta përjetojnë këtë...”

Me një rast madje Zahiri më kishte thënë se isha me fat që familjen e kisha jashtë, por ma kishte tërhequr vërejtjen që duhej pasur kujdes që të mbroheshin, meqë edhe atje ishin të lëndueshëm, madje edhe më keq se të ishin brenda, gjë që e vetmja mundësi mbetej identiteti i ndërruar dhe qëndrimi sa më larg Europës (në Zelandë të Re ose Australi). Kjo, sipas tij, duhej të bëhej, sepse shërbimet informative jugosllave, në saje të bashkëpunimit të mirë që kishin me simotrat e shteteve të rëndësishme europiane dhe me vetë amerikanët, me të cilat, për hesape të ndërsjella qysh nga Lëvizja e Painkuadrimit kur Jugosllavia e udhëhiqte atë dhe përfitonte si shumë nga e ashtuquajtura “botë e tretë” vazhdonin t’i ruanin lidhjet, kishin në shënjestër të përhershme qendrat e mërgatës shqiptare, pastaj refugjatët, klubet dhe shoqatat e tyre, me anën e të cilëve, mund t’i shantazhonin familjarët e tyre në vend.

Vetëvrasjet e njëpasnjëshme dhe shkaqet e tyre, sikur më binden se duhej bërë çmos të mbroja familjen time, qoftë edhe t’i ndryshohej identiteti, edhe pse ajo ishte jashtë dhe për të përkujdesej dajë Josipi, i cili pse kishte përvojë të madhe në shërbimin informativ ushtarak, mund të merrej me mend se do të bënte çmos që Drita dhe im bir, të mbroheshin ashtu si duhej.

Dhe kur për këtë tashmë sikur isha pajtuar, doktor Afrim Bega ma bëri të ditur se Drita dhe Valnori, tashmë ishin në një vend të panjohur me identitete të ndryshuara. Gjatë vizitës së fundit me anën e gjuhës së rrotullave, enkas për t’i shkëmbyer të dhënat e besueshme, që nuk duhej t’i merrte vesh drejtorja e burgut, e cila përgjonte bisedat, ma kishte bërë të ditur këtë masë, e cila ishte e mirë për të gjithë. Kur mora mesazhin, që sikur e kisha pritur, m’u bë se shikimi i tij po më kapte njeri të lëndueshëm...

Dhe nuk e di se kjo a më kishte çliruar, sikur të hiqja një barrë të rëndë shpirti, apo më kishte shembur përgjithmonë?

Kujtoj se ishin të dyja.

E para pse pas gjithë atyre që kisha dëgjuar dhe përjetuar në burg, veçmas pas vetëvrasjeve të njëpasnjëshme të atyre që ishin të ngarkuar me këtë çështje, kisha fituar bindjen se familja ime mund të mbrohej vetëm ashtu, siç mbroheshin edhe unë nga mundësia që ajo të përdorej kundër meje. Edhe pse kjo shfaqej si ngushëlluese, megjithatë, e kisha të qartë se familjen time, gjënë më të dashur, e kisha humbur përgjithmonë, sado që mund të jetonte diku e sigurt, sado që im bir, ndoshta një ditë mund të shkonte gjurmëve të mia dhe si boksier të bëhej edhe kampion botëror dhe andralla të tjera, me të cilat mund të ngushëllohesha dhe, mirë që ishte ashtu, por kjo nuk e ndryshonte atë se ne ishim ndarë dhunshëm, gjë që për mua kjo do të thoshte jetë pa jetë, gjendje thuajse e njëjtë me atë që kisha përjetuar kur isha privuar dhunshëm nga titulli i kampionit botëror në Toronto dhe për një kohë isha futur në një depresion të thellë...

Gjendja e depresionit të thellë, që më kishte mbërthyer menjëherë pas atyre që m'i kishte thënë doktor Afrim Bega për familjen time dhe më kishte mbajtur për shumë kohë, por pa e përbulluar dot lirin e plotë prej saj, dukej se kishte pasur edhe "të mirën e vet", nëse mund të thuhej ashtu, sepse përkohësisht më kishte mbrojtur nga prapaskenat e mundshme të cilat në ato rrethana ishin të pashmangshme, e mbi të gjitha, më kishte mbajtur larg atmosferës së përçarjeve që ishte futur midis të burgosurve shqiptarë dhe mund të merrej me mend se pasojat e saj barteshin edhe jashtë mureve të burgut për të arritur edhe aty ku nuk duhej ta kishin vendin...

Në këto rrethana, kur thuajse m'u kishte kthyer gjendja që e kisha pas Torontos e shoqëruar edhe me shenjat e herë pas hershme të një skizofrenie, ishte pavijoni i psikiatrisë "fole imja", ku të shumtën do të kaloj pjesën tjetër të burgut prej dy vitesh e një muaji, që do të më mbrojë nga tmerret tjera të burgut...Siç kisha fat që gjatë krizës së parë të thellë shpirtërore ta kem pranë doktor Afrim Begën, edhe këtë herë do të jetë një psikiatër tjetër, i quajtur Marko Orllloviq, që më ndihmoi me i ba ballë asaj që shfaqej si krizë burgu.

Marko Orllloviq, ishte psikiatër i njohur nga Beogradi, ekspert me nam, i cili për vite të tëra kishte drejtuar klinikën e Psikiatrisë në Akademinë Ushtarake të Beogradit, por që kishte përfunduar në burg pasi që një artiste e njohur e Beogradit, me të cilën ai kishte pasur lidhje të hapura, ishte gjetur e vdekur në banesën e tij nga një sasi e tepruar droge që kishte marrë, ndërkohë që e njëjta substancë ishte gjetur edhe te mjeku Orllloviq, por në një sasi më të vogël, gjë që kjo kishte mjaftuar që ai të shpallej fajtor për përdorim të tepruar të substancës narkotike dhe të dënohet me katër vjet burg. Edhe pse doktor Orllloviq kishte mohuar përdorimin e substancës narkotike, por pa përjashtuar mundësinë që ajo mund t'i ishte futur tinëzisht nga dikush në pije, megjithatë, ishte folur e përfolur se e gjitha ishte një kurdisje e Shërbimit Informativ Ushtarak (KOS), për ta larguar nga klinika e psikiatrisë e Akademisë Ushtarake, ku gjithnjë e më shumë si pacientë me çrregullime psikike shfaqeshin ushtarakë të lartë të kreut të Armatës Jugosllave, të cilët nuk pajtoheshin me politikën e luftës dhe të ngjashme, ku mund të merrej me mend se shumë prej atyre çrregullimeve që duhej të mos dilnin në shesh, me anën e të cilave shërbimet e huaja informative, do të ishin në gjendje për ta parë gjendja e vërtetë në Armatën Jugosllave si dhe disponimi kundër luftës që mbretëronte te ushtarakët e lartë.

Sidoqoftë, doktor Orllloviq, kishte ndërgjegjen e pastër se nuk ishte vrasës, dhe se, e gjitha ishte pjesë e një kurdisjeje, që herdo-kurdo do të sqarohet. Në spitalin e burgut të Nishit, doktor Orllloviq, megjithatë kishte gjetur vendin e vet dhe mund të thuhet se u kishte ndihmuar me të madhe atyre që kishin nevojë për të e që ishin si shumë. Njëri ndër ta isha edhe unë pasi që m'u kishte rikthyer kriza e rëndë bashkë me shenjat e skizofrenisë.

Doktor Orllloviq më njihte nga koha kur një pjesë e madhe e dashamirëve të boksit në Jugosllavi më kremtonin si kampion të kampionëve dhe të unë shihnin mishërimin e idealeve të tyre shoqërore në kudër të një bashkësie të barabartë dhe të qytetëruar, ku barazia qoftë nën formulën ideologjike të vëllazërim-bashkimit shfaqej si vlerë. Madje, ai mbante mend edhe qëndrimin tim disaditësh në Klinikën e Psikiatrisë së Akademisë Ushtarake nën përkujdesjen e doktor Antonijeviqit, që asokohe e drejtonte atë, kur isha kthyer i thyer shpirtërisht nga kampionati botëror i boksit në Toronto pasi që m'u kishte pamundësuar në finale të luftoja për titullin e kampionit.

"Nuk është mirë me u shpallë i shëndoshë në shoqërinë e të çmendurve."

Këto m'i kishte thënë si me shaka, pasi që kisha filluar ta marr paksa veten dhe kjo kishte ndodhur pas katër javësh krize të thellë që më kishte futur thajse në një komë psikike.

Me atë rast, pasi që ma bëri të ditur gjendjen e përgjithshme, që e quajti me përmirësime, më tha se edhe mëtutje do të mbetesh në repartin e tij, në një dhomë të veçantë.

“Pate e nuk pate nevojë për mua, do të bëj çmos të mbetesh këtu...”

Sipas tij, terapia im e domosdoshme dhe e përhershme kishte dy ilaçe. Së pari - leximin sa më me përkushtim të librave, fillimisht romaneve të caktuara, që si literaturë m'i përshkruante ai. Dhe së dyti - bisedat rreth librave të lexuara, pa përjashtuar këtu, që në një fazë të mëvonshme, do të përfshihen edhe përshtypjet me shkrim rreth disa çështjeve që shtroheshin në to, që mund të zgjeroheshin edhe me vlerësime të ndryshme shoqërore.

Në kuadër të terapisë ishin edhe disa udhëzime të tjera që duhej pasur parasysh siç ishin takimet sa më të rralla me të burgosurit tjerë dhe, veçmas përjashtimi i çfarëdo bisede me ta apo këdo për çështje politike, qoftë kjo edhe kur kërkohet prej tij në ndonjë rast të veçantë, siç ishin bisedat “informative” me autoritetet e burgut. Në raste të tilla duhej të mbrohesha me sjelljet e “të çmendurit”.

Sa për udhëzimet ku parashiheshin ndalesat, kjo nuk më prishte punë fare. Sepse, në ato rrethana kur duhej të pajtohesh se kisha humbur përgjithmonë familjen dhe duhej të uroja që ata të mbeteshin të panjohur për këdo, nuk shihja ndonjë arsye që atë humbje ta zhdëmtoja me ndonjë shoqërim me të tjerët e aq më pak që dikujt t'ia hapja zemrën rreth çështjeve që i merrja çështje të mbyllura përgjithmonë.

Dhe në këto rrethana, do të vinë kohë, kur vetëm vetmia dhe të menduarit rreth gjithësisë dhe vendit të njeriut në të, si qenie që vjen dhe shkon vetëm, më mbronin.

Natyrisht se deri te ky fiksim që pak nga pak do të shkojë edhe kah të menduarit filozofik, do të më drejtojë leximi i librave, si terapi e domosdoshme, që ma kishte caktuar doktor Orlloviqi.

Por, duhet thënë se fillimisht drejtimi kah leximi dhe librat më kishte krijuar vështirësi të theksuara, jo pse deri më atëherë kisha lexuar pak sosh dhe për këtë duhej të kisha ndonjë qëndrim refuzues ndaj letërsisë dhe krijimtarisë në përgjithësi, por pse ishte mënyra e leximit të librit si dhe qasja ndaj çështjeve që shtroheshin në të ajo që pengonte. Sepse, doktor Orlloviqi, krahas librit, caktonte edhe kapitullin me të cilin duhej nisur leximi, që nuk do të thoshte përherë se duhej të fillonte nga faqja e parë dhe të përfundonte me të fundit. Shpesh ndodhte që sipas udhëzimeve të marra prej tij leximi i një libri të niste nga kapitulli fundit, i mesmi ose ndonjë tjetër jashtë radhës, në mënyrë që me atë ngatërrim të përfundohej libri.

Kështu, më kujtohet se terapia e parë e leximit libri fillonte me librin “Robinson Kruso” të shkrimtarit Daniel Defo, libër ky për të cilin kisha dëgjuar dhe madje dikur rreth përjetimeve të Krusos kisha parë edhe një film për të rinj, por që leximin u desh ta filloja prej kapitullit të fundit, pastaj, të vazhdoja me atë të katërtin, në mënyrë që herë në gjysmë e teposhtë e herë në gjysmë e përpjetë, të kryej leximin. Ishte një si pështjellim, që edhe më të madh e bënte biseda rreth kapitujve të lexuar, të cilët duhej emërtuar ashtu si i përshtateshin asaj që ndodhte. Kështu, doktor Orlloviqi shtronte pyetje provokuese dhe vazhdimisht në kahun e zhdrejtë si ato: çfarë do të ndodhte po qe se anija nuk do të përplasej para atij ishulli të vetmuar, por në afërsi të Nju Jorkut? Çfarë do të ndodhte po qe se Robinsoni nuk do ta

kishte me vete Premtin, por ndonjë Sandokan ose ndonjë bukuroshe? Dhe gjithnjë me ato çfarë-çfarë të cilat ma rrotullonin gjithë përmbajtjen me të cilën isha ballafaquar. Madje, kjo sikur ma humbte edhe vullnetin për lexim, i cili edhe ashtu më mungonte. Megjithatë, më kohë, sikur do të mësohem me këtë çrregullim dhe do të ndodhë që edhe kur ndonjë libri duhej t'i qasesha natyrshëm, pra nga faqja e parë kah ajo e fundit, kërkoja shkëputjet, ndërhyrjet, ngatërrimin, në mënyrë që prej tij të krijoja “rregullin tim”, i cili nuk ishte thënë që të përkonte me atë të autorit.

Kjo qasje, në njëfarë mënyre, zuri të më kthente në një “rikrijues” ose “kundërshtar” të autorit, i cili veprën e lexonte me sytë e rrënuesit njëherësh si rindërtues.

Më kujtohet se kjo qasje bëri që Idiotin e Dostojevskit ta shoh në një fytyrë tjetër, saqë vetë doktor Orloviqi kundrimin tim ta quajë “tepër rrënues”.

Mbi këtë kundrim zura t'i rishoh edhe personazhet e Remarkut, Heses, Xhojsit madje edhe ata të tragjediave të njohura të Shekspirti, duke i zhvendosur në kohë dhe hapësira të ndryshme, ku jo rrallë mbretërit shiheshin si shërbëtor, shërbëtorët si mbretër, vrasësit si shpëtimtar, shpëtimtarët si vrasës dhe kështu poshtë e përpjetë saqë erdha te përfundimi se rivlerësimi i vlerave duhej të bëhej nëpërmes një zhvlerësimi të përgjithshëm, i cili ishte i domosdoshëm për të ardhur te një e vërtetë tjetër nga ajo që nga shfaqej ose duhej ta shihnim si të tillë... Që gjërat të kthehen në rendin e vet, atë të duhurin, thashë se ato duhej të zhvendosen në tërësi. Pra, isha kthyer në një mohues të çdo gjëje, çështje kjo sikur më shfaqej si ngushëllim ndaj realiteteve që kishin qenë kundër meje.

Doktor Orloviqi, një ditë më pyeti prej nga e njihja Niçen dhe Shopenhauerin, kur veprat e tyre nuk ishin pjesë e literaturës që ma përcaktonte ai dhe mbikëqyrte leximin e tyre.

I thashë se për të parin kisha dëgjuar vetëm në saje të një mendimi të cituar nga Nora Bardhi gjatë takimit tonë të fundit kur më kishte thënë se “bota e hiçit, sillet rreth hiçit për qëllimet e hiçit”, mendim ky që në kokën time kishte mbetur i turbullt për nga domethënia por i kthjelltë përherë për nga kujtimi që më lidhte me Norën dhe dioptria me të cilën ajo shihte botën kur e kishte më se të qartë se do të ndahej shpejt prej saj. Ç'filozof është ky që njerëzit i përgatit për ta pranuar fundin pa denjuar që ta kundërshtojnë sado pak, thashë atëherë? Ndërsa për të dytin, pra për Shopenhauerin, që mezi ia nxora emirin, shtova se nuk kisha dëgjuar ndonjëherë dhe nuk e dija se a ishte shkrimtar apo filozof, por që me dëshirë do t'i lexoja veprat e tij, po që se kjo do të kërkohej prej meje.

Doktor Orloviqi ma kishte kthyer se ato vepra nuk gjendeshin në bibliotekën e burgut dhe as që ishin të domosdoshme të lexoheshin.

Por, mënyra si kishte folur për to, njëfarë respekti i ftohtë, ma kishin shtuar kureshtjen që t'i lexoja sapo të më jepej rasti.

Kur do të lirohem nga burgu (pas dy vitesh e dy muajsh të kaluara në pavijonin e psikiatrisë) dhe hapësira e Hadës do të caktojë kufirin e botës sime prej nga nuk do të dalë kurrë, gjëja e parë që bëra ishte shoqërimi me librat e Niçes (“*Kështu fliste Zaratustra*” dhe “*Vullneti për fuqi*”) dhe të Shopenhauerit (“*Bota si vullnet dhe përfaqësim*”), me të cilat mbeta i varur përgjithmonë, duke përjashtuar kështu edhe veprat letrare çfarëdo qofshin dhe përkushtimin ndaj tyre, që e kisha nga doktor Orloviqi, në saje të të cilave në të vërtetë kisha përballuar shumëçka nga kriza e rëndë psikike në të cilën isha përfshirë kur kisha marrë vesh se Drita dhe im bir Valnori kishin ndryshuar identitetin, por pa u liruar plotësisht nga shenjat e skizofrenisë që më shfaqeshin herë pas herë dhe me të cilat sikur isha mësuar meqë klithma

e shumëzëshmërisë ma krijonte përshtypjen e një ngritjeje të veçantë shpirtërore që më nxirrte nga realiteti i vrazhdë, me shumë e shumë kameleonë, hardhuca, jokurrizorë, zvarranikë dhe qenie të tjera të neveritshme, të gatshme për çfarëdo poshtërsish dhe krimesh ndër më të paparashikuarat, siç ma krijonte edhe përshtypjen e të qenit mbinjeri...

Por, para se t'u kthehem përfundimisht dy filozofëve gjermanë dhe me ta të mbetëm përherë i lidhur, duhet thënë se në pavijonin e psikiatrisë të spitalit të burgut të Nishit, leximi dhe në përgjithësi terapia e letërsisë si rilexim, më kishte shkëputur thuajse në tërësi nga lidhja me jetën e burgut, pa marrë parasysh se ndonjëherë më binte të takohesha me të burgosur, të shumtën nga Kosova, kur ndonjëri prej tyre më vizitonte, që të shihte se mos më kishte kaluar çmendia, pse e kisha bërë zakon, se në vend se t'u përgjigjesha pyetjeve që më shtroheshin se cilin opsion përkrahja: atë të rezistencës institucionale (meqë edhe mëtutje isha deputet i Parlamentit të Kosovës) ose rezistencën e armatosur rreth së cilës gjithnjë e më shumë flitej dhe shumica e të burgosurve anonin kah ai, u thosha se shihja njësoj Idiotin e Dostojevskit ose Don Kishotin e Servantesit...

Megjithatë, leximi dhe të menduarit për letërsinë siç ma kishte përcaktuar doktor Orloviqi, që e kisha pranuar dhe, sipas tij madje, e kisha përvetësuar për ta kthyer në një të menduar të çuditshëm ndryshe nga ai që e kap mendja e shëndoshë, gjithashtu më kishte privuar nga obsesioni i shkëputjes me familjen time, gjënë më të dashur, të cilën nuk e shihja më si humbje të dhimbshme dhe tragjike madje siç e kisha ndjerë kur për ndërrimin e identitetit më kishte folur kolonel Zvezdan Marković apo hungarezi Lajsosh Varga dhe ndonjë fatkeq tjetër, por e merrja si një lirim nga kurthi i emocioneve të tepërta dhe të panevojshme, të cilat ndihmojnë pranimin e realiteteve në përputhje me rrethanat e caktuara qofshin ato jashtë çdo normaliteti. Ishte pra kjo një prerje e ashpër midis ndjenjës së përbashkësisë dhe asaj të vetmisë së skajshme jashtë çdo ndjenje sociale, kur do të përcaktohem për këtë të dytën, jo që t'i largoj gjerat që më takojnë dhe u takoj, por t'i përvetësoj në një mënyrë tjetër, që çdo gjë ta kthej në vullnet për fuqi të brendshme, që të merrem me rishqyrtime të përhershme të natyrës shpirtërore, gjë që pas liritimit nga burgu i Nishit, ku kisha mbajtur dënimin prej pesë vitesh dhe dy muajsh, kthimi im në Hade te Obilic do të shënojë mbylljen përfundimtare në vetvete, që për mua paraqiste një fitore të madhe, meqë ashtu isha në gjendje t'i mbizotëroja që të gjitha çështjet: si ato që nuk vareshin prej meje, si ato që i ktheja në varësi timen dhe ua caktoja vendin në përputhje me qëndrimin tim ndaj gjërave pa marrë parasysh se nuk përkonte me realitetin...

Duhet thënë se këtij përcaktimi sigurisht se i ndihmoi edhe mungesa e doktor Afrim Begës, të cilin për herë të fundit e pashë para dy vitesh e gjysmë me rastin e vizitës në burgun e Nishit kur me gjuhën e shenjave ma bëri të ditur lajmin për largimin e përhershëm Dritës dhe Valnorit në një vend të panjohur me identitete të ndryshuara, lajm ky që sikur e kisha pritur madje, pse jo, në njëfarë mënyre edhe e kisha dëshiruar.

Halla Shpessa nga Vushtrria, që kishte ardhur të më merrte në Nish dhe kishte mbetur e habitur kur më kishte parë në atë gjendje, që asaj mund t'ia kishte krijuar dyshimin se kisha rrjedhur fare, vetëm kur kishim arritur në Hade, ma kishte bërë të ditur se prej kohësh nuk dihej gjë për doktor Afrim Begën.

Pasi e kisha shikuar ftohtë pa e pyetur se cili ishte fati i tij, kishte folur se në Kosovë më shumë se mosprania e dikujt, ishte prania që shfaqte befasi...

SHTOJCË

*(Biseda e autorit me **Shpresa Berishën – Kosovën**, hallën e Bashkim Kosovës, ku ajo shpjegon se i nipi i saj kishte dy pamje: atë të sportistit të madh dhe po ashtu të intelektualit të madh, i cili ishte i vetëdijshëm se karriera e tij sportive dhe sukseset e përmasave botërore lidheshin me atë të pasqyrimin të aspiratave të Kosovës, që si shoqëri dhe shtet t'i takonte qytetërimin perëndimor ku e kishte vendin. Te kjo e dyta ajo shihte edhe shkaqet për vrasjen që i kishte ardhur Bashkim Kosovës nga ata që Kosovën dëshironin ta shihnin ndryshe, duke e kthyer kështu në peng të kusuritjeve me të cilat asaj mund t'i merret jo vetëm e kaluara, por edhe ardhmëria...)*

***Autori:** Keni pasur përshtypjen se Bashkim Kosova, pas kthimit nga burgu i Nishit, dukej njeri tjetër, i humbur fare? Kishte të bënte kjo me mungesën e mjekut dhe mikut të tij doktor Afrim Bega, i cili mund t'i ndihmonte, siç i kishte ndihmuar herën e parë, që të shënonte atë kapërcimin nga kriza e rëndë shpirtërore tek normaliteti jetësor, apo fjala ishte për një rrënim përfundimtar nga shkakut i ndarjes së përgjithmonshme nga bashkëshortja Drita dhe i biri Valnori, pasi që ata kishin shkuar në një drejtim të panjohur me identitete të ndryshuara?*

Shpresa Berisha – Kosova: Fillimisht dukej ashtu. Por, kjo ishte një përshtypje e gabuar, që e kisha nga takimi i parë pas pesë e sa vitesh me tim nip, kur ai shfaqej shumë i ftohtë dhe thuajse nuk i bënte përshtypje fare ndërrimi i gjendjes nga i burgosuri në një njeri “të lirë”. Madje, ashtu si më përshëndeti (ftohtas) dhe si i bëmë hapat e parë jashtë dyerve të burgut deri te vetura që na priste në pjesën tjetër të rrugës, mund të mendohej se ai as që kishte qenë i interesuar për atë që atë ditë po ndodhte.

Edhe pse gjatë gjithë rrugës kishte vazhduar të mos shfaqte interesim për asgjë dhe madje edhe pyetjeve më të domosdoshme: “mos do kafe”, “mos do ujë”, ose edhe kur në të hyrë atyre në Kosovë, në afërsi të Podujevës nëpër një kontroll policor gjatë legjitimitetit nga polici do t'i shtrohet pyetja “aha, Bashkim Kosova”, do t'u përgjigjet vetëm me lëvizje koke poshtë-lartë ose djathas-majtas, megjithatë fitoja përshtypjen se ai gjuhën e fjalëve e kishte zëvendësuar me atë të mendjes. Kjo do të dëshmohej si e vërtetë, me çka mund të thuhet se im nip, Bashkim Kosova, gjatë atyre dhjetë viteve, pra nga fillimi i shkurtit 1998 e deri në ditën e shtatëmbëdhjetë të shkurtit të vitit 2008, pra kur u vra, pasqyronte anën shpirtërore të njeriut, i cili për shumë vite kishte qenë “i të tjerëve”, ose i “të gjithëve” deri te njeriu i vetvetes, ai i mbylluri, që megjithatë në atë “mbyllje”, me anën e shkrimeve të shumta që do t'i lë dhe, për fat do t'i gjej të fshehura në plaçkat (pasi që ato i kishin shpëtuar një bastisjeje të hollësishme që i ishte bërë shtëpisë, pasi që ishte vrarë, ku mund të merret me mend se ishte kërkuar diçka), do të japë dy pamjet e të njëjtit njeri: atë të jashtmen dhe atë të brendshmen.

Pamja “e jashtme” e njeriut “të të tjerëve” dhe “i të gjithëve”, ku sekush do të marrë dhe do të lërë atë që kishte nevojë për të, e ku do të ndërliidhen edhe aspektet shoqërore dhe ato politike te një spektri të gjerë ndër më emblematikët nëpër të cilën kaloi shoqëria jonë gjatë gjysmë shekullit të fundit, ka të bëjë me karrierën e tij të jashtëzakonshme të kampionit të madh, që shkoi deri në zenit, edhe përkundër atyre që u munduan ta pengojnë (rreth të cilave ai do të deklarohet në ato që do t’i shkruajë).

Ndërsa si “njeri i vetvetes”, Bashkim Kosova, i pasqyruar “nga brenda”, sikur shfaqet ndryshe, sa që, kur lexohen ato që kanë të bëjë me vitet e burgut dhe veçmas me atë të qëndrimit në pavijonin e psikiatrisë te doktor Orloviqi, të krijohet përshtypja se kemi të bëjë me një njeri tjetër, që mbase pse ka kaluar nëpër rrethana tepër të vështira, siç kanë qenë ato të krizës së rëndë nga e cila ishte përfshirë në burg, ka ndryshuar rrënjësisht qëndrimin, por që nuk është kështu...

***Autori:** Por, kur lexohen gjithë ato që ka lënë, dhe veçmas “Jetët paralele” dhe “Vitet e burgut”, ku në të parën ai flet me aq përkushtim për kyçjen e tij në Lëvizjen Gjithpopullore si dhe përfshirjen e tij në sistemin e Vetëmbrojtjes Popullore, prej nga edhe do të burgoset me akuzën “se ka përgatitur të rinjtë për luftë kundër pushtetit serb”, ndërsa në të dytën, ai tërhiqet i tëri dhe “vetminë” dhe mbylljen në Hade e quan “shpëtim shpirtëror” e të ngjashme, megjithatë fitohet përshtypja se këto çështje përjashtojnë njëra tjetrën saqë shtrohet dilema se cili në të vërtetë është Bashkim Kosova: ai para burgut, apo ai pas burgut? Ishte ai që i gëzohet familjes dhe sakrificës për të? Apo, ishte ai që nuk ka më familje (pasi që ajo e ka braktisur), dhe rrënimi i saj paraqet një shkas që çdo gjë të shihet si rrënim i përgjithshëm?*

***Shpresa Kosova – Berisha:** Bashkim Kosova nuk mund të ndahet assesi në pamje “të ndryshme”, që në dukje ofrojnë ato që ka lënë të shkruara e aq më pak që mbi këto të ndërtohet ndonjë qëndrim që ai të shfaqet “kundërthënës”. Përkundrazi, Bashkim Kosova është po ajo figurë emblematike edhe kur tregon për përpjekjet e tij që të jetë sa më i suksesshëm në jetë, dhe po ashtu, emblematike mbetet si figurë edhe kur “mbyllet në vete” në atë pjesë të lenë të Hadës dhe err e terr merret me Niçen dhe Shopenhauerin.*

Në këtë dihomi megjithatë unë shoh ndërliidhjen e jetësore me atë shpirtëroren në një mënyrë tepër të veçantë, me çka tumiret ajo që gjithnjë ka qenë e njohur se personalitetet e jashtëzakonshme çfarë ishte Bashkim Kosova, nuk mund të jenë të njëanshme, por shumë komplekse, pikërisht pse edhe ngritja, e edhe “rënia” e tyre përjetohen prej të tjerëve në mënyrë të veçantë me çka kthehen në identifikues shoqëror dhe frymëzues shpirtëror te një epoke. Në këtë drejtim, Bashkim Kosova edhe kur ngrihet në pedestal, por edhe kur përfundimisht mbyllet në vetvete dhe në atë rreth që ia ka vu vetit, do të presë fundin, pa marrë parasysh si dhe sa do të jetë tragjik, pajton mrekullisht shoqëroren me shpirtëroren, pajton madhësinë e ngritjes dhe tragjiken e rënies...

Kështu, aspekti i parë, pra ai i ngritjes, edhe pse dukej se me emrin (*Bashkim*) dhe mbiemrin (*Kosova*), veçmas ose bashkë, gjithë çështjes shoqërore gjatë ndërtimit të kërkesave të njohura politike të kohës, siç ishin ato për barazi që do të dalin në pah nga viti 1967 e tutje në mënyrë që në vitin 1968, 1981 dhe në vazhdimësi, do t’ia sigurojë njërën ndër metaforat më fuqishme, që kjo lëvizje do t’i shfrytëzojë si shkas për të demonstruar, siç

do të demonstrohet, megjithatë këtu kemi të bëjë me manifestimin e dy koncepteve fundamentale që kanë të bëjnë me përcaktimet shqiptare rreth ardhmërisë së tyre të përbashkët, pa marrë parasysh sa dhe si ai fillimisht ka qenë i vetëdijshëm për këtë. Kujtoj se nuk do të kalojë shumë dhe ai detyrimisht, jo vetëm që do ta hetojë këtë, por nga dita në ditë, do të kuptojë se emri dhe mbiemri që mbante, nuk shfaqte vetëm “simbolikën e një keqkuptimi politik” siç do të shkruajë shtypi i Beogradit, ku thuhej se “shfrytëzohej për qëllime nacionaliste dhe irredentiste”, por shfaqte dilemën kryesore shoqërore dhe politike të shoqërisë shqiptare brenda dhe jashtë vendit në rrethanat e tronditjeve të mëdha në të cilët do të hyhet, mbi të cilën pastaj do të mbështeten edhe qëndrimet e të tjerëve ndaj tyre.

Në të vërtetë, edhe po qe se çështja e emrit dhe mbiemrit *Bashkim* dhe *Kosova*, do të përjashtonte aspektet e jashtme, pra ato shoqërore dhe politike bashkë me simbolikën e tyre të njohur dhe e gjitha do të shihej e rrudhur brenda për brenda sferës personale-familjare, kjo do të ishte e pamundur, sepse edhe ai, si çdo tjetër, do të përfshihet në një zhvillim historik ndër më domethënës kur tashmë, me fillimin e procesit të rrënimit të Jugosllavisë nga brenda, ishte hapur çështja se çfarë përgjigje do t'i jepej fatit të Kosovës: shtet i barabartë me të tjerët në kuadër të Jugosllavisë, po qe se ajo do të vazhdonte të ekzistonte, ose të bashkohej me Shqipërinë, me çka do të korrigjohej një e padrejtë historike që u ishte bërë shqiptarëve nga krijimi i shtetit shqiptar e tutje, kur mbi gjysma e pjesëve të saj, si pasojë e pushtimeve të shteteve fqinje gjatë Luftërave Ballkanike (Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë), kishin mbetur jashtë trungut të saj?

Duhet pranuar se im nip, qysh gjatë kohës kur nëpër stadiumet sportive brenda dhe jashtë vendit fitoret e tij do të shfrytëzohen për të demonstruar në mbështetje të kërkesës për Republikën e Kosovës, me të cilën për herë të parë ishte demonstruar më 27 nëntor të vitit 1968 për t'u rikthyer edhe më e fuqishme dhe kuptimplote në demonstratat e vitit 1981 dhe si e tillë të futet edhe në programin e Lëvizjes Gjithpopullore, që filloi më 23 dhjetor 1989 me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pra ai do të identifikohet me atë kërkesë, më tepër nga përmbajtja se nga forma, sepse, siç do të shkruajë, i besonte barazisë shoqërore dhe politike në të gjitha aspektet, gjë që nuk mund të kuptonte pse kjo kërkesë vlerësohej “armiqësore”, “kundërrevolucionare” dhe të ngjashme. Këtë e thoshte djaloshi nga një piedestal shoqëror ndër më të lartit, i cili edhe mund të mos fliste, po qe se do ta shikonte rahatën e vet, e mbi të gjitha karrierën e shkëlqyeshme sportive me të cilën mund të arrinte majat botrore...

Megjithatë, duhet pranuar se shkrimet e Bashkim Kosovës, në dukje paraqesin dy gjendje shpirtërore: një të shpresëdhënëse – kur ai do të përfshihet drejtpërdrejtë në Lëvizjen Gjithpopullore dhe, tjetër të shpresëhumbëse – atë të viteve të burgut, veçmas kohën nga pavijoni i psikiatrisë, që do të vazhdojë edhe pasi që të jetë kthyer në Kosovë gjithnjë deri ditën sa do të vritet.

Por, nuk duhet harruar se ato kushtëzohen nga dy kriza të rënda shpirtërore nëpër të cilat ai do të kalojë nga faktorët shoqëror: herën e parë kur në kulmin e karrierës, iu pamundësue lufta finale për titullin e kampionit botëror në Toronto me çka ai duhej ta përmbushte idealin që e kishte, si thotë, nga porosia e heshtur rreth vullnetit për fuqi të cilën duhej ndjekur për t'i arritur majat e suksesit, që i vinte nga fotografia e vetme e të Et që e mbante në valixhen e vjetër, dhe herën e dytë - kur me ndarjen nga bashkëshortja dhe i biri - të cilët, për t'u mbrojtur nga ndjekjet e mëtutjeshme të shërbimeve informative të Beogradit,

do të shkojnë në një drejtim të panjohur me identitete të ndryshuara - do t'i rrënohet ideali jetësor i familjes.

Meqë fjala është për një dhunë shoqërore të paparë, është e natyrshme që edhe qasja ndaj pasojave që prodhon ajo të jetë e ndryshme. Kështu, herën e parë Bashkim Kosova dhunës së asgjësimit, do t'i kundërpërgjigjet me krijimin e familjes qoftë edhe në rrethanat e një trajtimi psikiatrik, siç ishte martesë me Dritën gjatë kohës së terapisë në Pavijonin e Psikiatrisë të Klinikës së Universiteti të Prishtinës, ku i lindi i biri Valnori. Ndërsa herën e dytë - dhunës së shkatërrimit, këtë herë atij shpirtëror, iu përgjigj po ashtu në rrethanat e terapisë psikiatrike në pavijonin e spitalit të burgut të Nishit, kur në vend se të vetëvritej, siç do t'u ngjasë shumë prej atyre që kishin kaluar nëpër të njëjtat vuajtje, do t'i kundërpërgjigjet me mburojën shpirtërore, me durimin dhe pathyeshmërinë, duke iu kthyer leximeve, meditimeve filozofike dhe shkrimit të një pjese të tyre, pasi që të jetë kthyer në Hade, ku do të mbyllet përfundimisht...

***Autori:** Nëse mund të pranohet vlerësimi se shkrimet që ka lënë Bashkim Kosova - dhe ato kryesisht vinë nga koha pasi që ai të jetë kthyer nga burgu – “në dukje” paraqesin “dy gjendje shpirtërore” si kundërpërgjigje ndaj faktorit që i ka kushtëzuar ato (fjala është për dhunën shtetërore te Beogradit), megjithatë si duhet shpjeguar qëndrimin e Bashkim Kosovës, të mbyllet brenda për brenda një hapësire (ajo e Hades), prej nga për vite të tëra nuk do të dalë më, madje edhe atëherë kur do të arrihet, që pas ndërhyrjes së NATO-s (me nxjerrjen e Serbisë nga Kosova), me instalimin e administratës ndërkombëtare, të përfundojnë shkaktarët e tragjedisë së tij? Mund të ishte i pakënaqur me atë zhvillim? Ose, pse kishte ndonjë arsye tjetër që do t'ia kishte kushtëzuar atë gjendje?...*

***Shpresa Kosova – Berisha:** Sjellja e tillë ishte edhe e kuptueshme. Sepse, Bashkim Kosova kishte humbur njëherësh dy gjëra: botën e madhështisë dhe familjen pa kurrfarë kundërvlere. Kur flas për “kundërvlerën” nuk mendoj për ndonjë zhdëmtim material apo tjetër, me të cilën shumëkush kënaqet dhe ashtu projektton edhe “përmasat” e ndryshimeve shoqërore dhe politike, por fjalën e kam për kalimin nga një gjendje e dhunës te një gjendje e turbullt fare, ku rrënimi i një sistemi vlerash, pa marrë parasysh çfarë ka qenë, nuk zëvendësohet me tjetrin, atë që pritej dhe duhej të ishte në përputhje me konceptin qytetëruar të një shoqërie të lirë perëndimore që i kishte besuar aq shumë në të. Në vend të saj kemi shfaqjen e një gjendje kalimtare, pa vlera dhe jashtë normave elementare morale, ku çdo gjë lejohet pa qarë kokën për pasojat.*

Për ta kuptuar dëshpërimin, zhgënjimin e thellë dhe vetë neveritjen madje nga gjithë kjo rënie që e mbërthen idealistin e paepur, mjafton këtu të shihen sjelljet e disa liderëve politikë që kanë marrë pjesë në lëvizjen kombëtare në të gjitha fazat e saj: nga ajo institucionale (shteti paralel) e deri te rezistenca e armatosur dhe lufta, ku ideali i lirisë dhe i bërjes së shtetit është kthyer në ideal të zhvatjes së shtetit dhe të kthimit të tij në një plaçkë për kusuritje gjithëfare dhe me këdo, qofshin ata edhe pushtuesit dhe vrasësit e deridjeshëm!

Gjatë takimit të fundit pak ditë para se të vritej, dukej tepër i thyer shpirtërisht, sikur me padurim priste atë që do t'i vijë ditën e shtatëmbëdhjetë shkurtit me marrë fund ai mundim. Në dhomën e errtë dhe të ftohtë, prej nga ishte mbyllur dhe prej kohësh nuk dilte, gjendja e tij vinte edhe më e zymtë nga ç'dukej, sepse ai nuk pranonte kurrfarë ndihme dhe,

ç' ishte më keq, nuk dëshironte me asgjë që këtë ta ndryshonte. Ata që i rrinin pranë dhe nuk i ndaheshin (ishin dy boksierët e rinj Luan Hoti dhe Bekim Krasniqi, që e kishin gjetur pas atentatit dhe e kishin dërguar për në spital), kishin bërë me dije për gjendjen e tij të rëndë, veçmas pse ai kohëve të fundit fliste përçartë për vrasës të padukshëm, të plotfuqishëm, që e kishin vrarë të djeshmen mizorisht, që po e vrisnin të sotmen dhe do ta vrasin edhe të nesërmen, prej të cilëve nuk kishte shpëtim...

Diç të ngjashme m'u bë se ma tha gjatë takimit të fundit.

“Mos bën përpjekje të më ndihmosh, meqë kjo është e pamundur...”

Deklaratat e Luan Hotit dhe Bekim Krasniqit dhënë Autorit rreth gjendjes së Bashkim Kosovës para se të vritej

Luan Hoti: Tetë vjet më parë, erdhi në shkollën e sapo hapur në Hade dhe pas një bisede me arsimtarin e edukatës fizike, kërkoi që disa prej nesh të mbeteshim me të, si tha, rreth arritjes së një marrëveshje sportive.

Disa prej nesh kishin dëgjuar si në mjegull për kampion e madh, ndër më të madhin në botë, që ishte kthyer në Hade, por nuk e kishim parë. Si fëmijë, që kishim kaluar nëpër tmerret e luftës, e parafytyronim të madh, tepër të madh, një njeri lis dhe çmos, i cili do të ishte në gjendje të na mbronte nga të papriturat dhe frika, me të cilat edhe mëtutje kokën e kishim plot, edhe pse në afërsi të katundit tonë gjendeshin forcat e NATO-s për të cilat thuhej se ishin më të fortat në botë.

Kampioni i madh, na tha se disa prej nesh mund të bëheshin kampionë të ardhshëm, dhe se aty ishte që të na ndihmonte ta arrinim këtë. Na bëri të ditur se kishte ndërmend të hapte një shkollë boksi për të rinjtë, për të cilët do të përkujdesej personalisht. Kërkoi që të përzgjedhurit të vinin me prindër, meqë ky ishte si kusht për t'ia nisur punës.

Kështu edhe ndodhi. Prindërit, që e njihnin, ishin të lumtur që kampioni i madh, siç e quanin me adhurim, po na merrte në dorë.

Bashkë me të tjerët, ushtronim në një hallë skaj shtëpisë së tij në Hade, ku pak nga pak mësonim shkathtësitë e boksit.

Më vonë, disa prej nesh do të pranojmë në ekipin e juniorëve të klubit “Kosova”, ndërkohë që dy vjet më vonë, do të kalojmë në ekipin e dytë prej nga bashkë me Bekimin, do të bartem në ekipin e parë, unë në kategorinë veltër, ndërsa ai në atë mesme. Do të bëjmë gara deri atëherë kur për arsyet të pakuptueshme për ne, klubit i boksit “Kosova”, duhej të kalonte nga prona e Bashkim Kosovës në Hade në Qendrën Sportive në Fushë Kosovë, ku thuhej se kishte kushte më të mira.

Kjo ndodhi para një viti.

Kampioni na mblodhi dhe na tha se “kështu kishte vendosur dikush”. Pasi që na tha se mbase kështu mund të ishte më mirë për karrierën e tyre dhe se ishim të lirë të shkonim, na bëri me dije se nuk do të vinte me ne.

“Për mua, pjesa tjetër e botës jashtë Hadës, ka humbur çdo kuptim...”

Kur na i tha këto uli shikimin, sikur të dëshironte të fshihte prej nesh diçka që nuk duhej ta kuptonim.

Unë dhe Bekimi nuk pranuan të ndaheshim. I thamë se për ne ai mbetej mësuesi ynë i vetëm dhe i përhershëm.

Nuk kundërshtoi, pos që tha se kjo nuk do t'i bënte boksierë.

Në të vërtetë, ne i mbetëm pranë, edhe pse nuk ushtruam më. Shkëputja nga klubi ashtu si u bë dhe ndarja prej atyre që i ushtronte me aq përkushtim, e kishte ndryshuar fare.

Megjithatë, ne pritnim që ai të rikthente dëshirën e dikurshme për boks. Por, nga dita në ditë shihej qartë se Kampioni i madh nuk ishte më ai i dikurshmi.

Gjatë dy-tre muajve të fundit u mbyll fare. Pak nga pak filloi të mos pranonte as ushqimet dhe ndonjë ndihmesë tjetër.

E vetmja gjë që bënte ishte leximi në një mugëtirë dhe pastaj shkrimi në disa letra, që i mbante të shpërndara.

Muajin e fundit, la fare leximin dhe shkrimin. Pa libra dhe pa fletët në të cilat shkruante, dukej edhe më i vetmuar dhe i brishtë fare.

Herë pas herë fliste për vrasësit e shumë...Thoshte se janë të padukshëm dhe të plotfuqishëm...

Në atë gjendje e gjeti edhe halla Shpresa Kosova-Berisha, e cila na dha numrin e telefonit dhe na tha se duhej ta lajmëronim menjëherë nëse gjendja do t'i përkeqësohej.

Nga ajo ditë e tutje, mbylli derën. U shkëput fare nga bota. Askush nuk kishte qasje në atë shtëpi...

Bekim Krasniqi: Çfarë të them tjetër pos atyre që Kampioni i Madh, pas vizitës së Shpresa Kosovës – Berishës, jo vetëm që nuk pranoi ke brenda, por u mbyll përfundimisht në dhomën e errët...

Qysh dhe si u gjend Kampioni i Madh atë paraditen e shtatëmbëdhjetë shkurtit para kafiterisë “Vatra” në atë gjendje, që e gjetëm, këtë mund ta dinë vetëm ata që e kanë bërë atë krim të rëndë?...

Sigurisht se ishin ata vrasës për të cilët ai kohëve të fundit çapitshim thoshte se po i shihte në të gjitha anët, si të padukshëm dhe të gjithëfuqishëm...

(Biseda e autorit me dajën e Bashkim Kosovës, Josip Paleviq, gjeneral i Armatës Popullore të Jugosllavisë, njëri prej drejtuesve të Shërbimit Kundërinformativ të Armatës Popullore të Jugosllavisë (KOS)nga fillimi i saj e deri në vitet e shtatëdhjeta, kur do të pensionohet me akuzën se i takonte “Pranverës kroate” prej nga del vlerësimi i tij se vrasja e Bashkim Kosovës ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte një komplot ndërkombëtar në bashkërenditje me vendorët si hakmarrje jo vetëm ndaj atyre që ishin frymëzues të idesë së shtetësisë së saj që duhej të arrihej në rrugë legjitime, si e drejtë e saj për vetëvendosje, por edhe ndaj atyre që luftojnë që shteti i Kosovës ta fitojë sovranitetin e plotë jashtë çdo prapaskene që ai të mbetet as mish e as peshk. Me këtë rast ai flet për dosjen më të vjetër në botë qysh nga antika “Pellazgjia-Dardania”, e cila nga Mesjeta njihet me emrin “Bizanti”, ndërsa nga Kriza Lindore e tutje shfaqet si “Kosova”, një si nyje e të gjitha konfigurimeve të sferave të interesit në rajon, mbi të cilën do të veprojnë koniunktura ndërkombëtare të rëndësisë gjeostrategjike dhe gjeopolitike të nivelit më të lartë, gjë që, sipas tij, rëndësinë e saj si çështje botërore do ta dëshmojë edhe rezoluta 1244 e OKB-së

dhe vënia nën protektorat të Organizatës Botërore, në mënyrë që nxjerrja e Kosovës nga kurthi i kësaj dosje t'i ndihmojë shpalljes shtet i pavarur. Gjenerali kroat mendon se, edhe përkundër kësaj, dosja "Kosova" do të mbetet e hapur, meqë Beogradi dhe jo vetëm ai, do të përpiqet që Kosova e mos pranuar kurrë si shtet nga ana e saj, të mbahet e ndarë nga brenda (me Veriun serb) si bashkësi multietnike, por me identitetin e ortodoksisë serbe në të ndërkombëtarisht të legjitimuar (siç do të ndodhë me të ashtuquajturën Pako të Ahtisarit), gjë që kjo gjendje e pengut, mund të shtyjë shqiptarët që një ditë të kërkojnë të bashkohen me Shqipërinë, që për pasojë mund të ketë ndarjen përfundimtare të saj sipas projekteve serbe...)

Autori: Në një pjesë të shënimeve të Bashkim Kosovës, që për fat kanë shpëtuar në saje të përkujdesjes së hallës Shpresa Kosova-Berisha, flitet për takimin e fundit që kishit në Zagreb nga fundi i vitit 1991, ku pos tjerash bëhet fjalë për një pliko të mbyllur në të cilën ishte edhe një tjetër, e cila, nga ana e tij, duhej t'i jepej personalisht Presidentit të Kosovës sapo ajo të shpallej shtet. Është kjo pjellë e fantazisë së Bashkim Kosovës në rrethanat kur ai pasi që të jetë kthyer nga burgu i Nishit, ku kishte kaluar pesë vjet dhe dy muaj dhe, pa familjen, ndodhej në një gjendje të rëndë psikike, apo fjala është për diçka të vërtetë, sado që thuhet se pliko nuk është gjetur midis shkrimeve dhe dokumenteve që kishte fshehur ai?

Gjeneral Josip Paleviq: Plikoja "e veçantë" ka ekzistuar, por ajo ishte e zbrastë. Madje, kujtoj se ajo ka shkuar ku duhet dhe po mos të ishte ajo nuk do të rihapeshin hetimet për vrasjen e Bashkim Kosovës, ku paraprakisht ishte paraparë të trajtohej vetëm si çështje e një "aksidenti të komunikacionit" dhe me aq çdo gjë të merrte fund.

Autori: Çfarë do të thotë kjo?...

Gjenerali Josip Paleviq: Për ata që marrin vesh sado pak në punët e fshehta të shtetit, ardhja e plikos së zbrastë nga një adresë e një niveli të tillë, do të thotë porosi për lidhje të tjera të drejtpërdrejta. Pra, me këtë rast nga shteti kroat shtetit të Kosovës i bëhej me dije se Zagrebi ka shumë e shumë informata, të cilat, Prishtina, me anën e kanaleve të veçanta shtetërore, duhej t'i merrte. Pra, fjala është për dosjen e hapur "Kosova", më të vjetrën në botë, qysh nga Antika (fillimisht të quajtur "Pellazgjia-Dardania", pastaj "Bizanti"), ndërsa nga Kriza Lindore e tutje, serish e rikthyer në lojë për të mbetur e tillë edhe deri në ditët tona si pjesë e sferave të rëndësishme të interesit të koniunkturave gjeoplotike dhe gjeostrategjike, sado që ajo me shpalljen e shtetit të pavarur të Kosovës, do të duhej të mbyllej njëherë e përgjithmonë, që si po shihet nuk do të jetë kështu, gjë që kjo nuk i përjashton shqetësimet në këtë pjesë, ndaj të cilave as Kroacia e as të tjerët përreth nuk mund të jenë të qetë, ngaqë ato mbajnë të gjallë frymën e gogolëve nga e kaluara...

Autori: A mund të flitet në opinion pse ajo dosje, si thoni "e hapur", është aq e rëndësishme për rajonin e më gjerë madje dhe, a ka të bëjë ajo me vrasjen e Bashkim Kosovës?

Gjenerali Josip Paleviq: Në parim mund të thuhet se fjala është për informata të natyrës tepër sekrete që Shërbimi Informativ i Kroacisë i ka siguruar nëpërmes kanaleve të ndryshme, e që kanë të bëjë me ruajtjen e mëtutjeshme të të ashtuquajturave “resurse informative” të Beogradit në Kosovë gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar, të cilat, “të heshtura” ose aktive vazhdojnë të mbeten të tilla edhe pas shpalljes së pavarësisë së shtetit të Kosovës, të cilat në njëfarë mënyre mund të kenë pasoja edhe në Kroaci dhe në pjesët tjera të ish Jugosllavisë.

Para se t’i përgjigjem pjesës së dytë të pyetjes rreth asaj se a ka të bëjë dosja e hapur “Kosova” me vrasjen e Bashkim Kosovës, gjë që mund të thuhet se ka, se mund të thuhet madje se ishte një hakmarrje e vonuar ndaj idealistëve të bërjes së shtetit të Kosovës me identitet shqiptar dhe përkatësi europiane-perëndimore, duhen dhënë disa sqarime paraprake që flasin për shfaqjen e kësaj dosje, rolin e saj në përgjithësi në tragjedinë shqiptare, si dhe fuqinë e saj që edhe më tutje të ndikojë sferat e interesit, pa përjashtuar këtu edhe kobët që dalin prej saj, qofshin ato edhe të natyrës personale siç ishte ai i vrasjes së Bashkim Kosovës dhe shumë e shumë të tjerëve të kryera në mënyra të ndryshme dhe nga duar të njëjta, të cilat kanë mbetur të shkëputura nga kjo dosje dhe, pa përjashtuar edhe të tjera që mund të vinë nga mallkimi i saj dhe, në rrethana të caktuara të përdoren kundër Kosovës...

Pra, dosja e hapur “Kosova” është më e vjetra në botë. Fillimisht është quajtur “Pellazgjia-Dardania” e pastaj “Bizanti”, që pas dy shekujsh “heshtjeje” në realitetin osman kur dukej se kishte humbur rëndësinë që kishte, nga Krizës Lindore e tutje serish të shfaqet, por këtë herë me rolin e çelësit se kujt do t’i takonte fuqia rajonale pas kohës osmane. Hapësira thuhetse magjike ku me të drejtë mendohet se ka zanafillën qytetërimi më i vjetër dhe nga kjo enigmë varet edhe shpjegimi i kohës historike, në rrethanat e reja, duhej të përcaktonte profilin e faktorit të ardhshëm dominues rajonal se a do të vihej mbi bazat e trashëgimisë mesjetare për të cilin pretendonin serbët duke ia ndajmbathur kështu vetit edhe “meritat shekullore të mbrojtësit të krishterimit perëndimor në këtë pjesë”, apo atë të trashëgimisë pellazgo-ilire-dardane, e cila shqiptarët i nxjerr popull autokton antik në këto hapësira. Zgjidhja nuk ishte as e lehtë e as e thjeshtë, meqë prej saj varej se cila sferë e interesit do të ishte më e fortë: ajo sllavo-ortodokse, e cila mbështeste serbët që tashmë kishin shtetin e tyre dhe kërkonin të zgjeroheshin në dëm të etnisë shqiptare, apo ajo e fuqive europiane të boshtit (Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe Italisë), të cilët mbështetnin shqiptarët dhe hapësirën e tyre etnike e kishin shpallur “digë mbrojtëse” kundër shtrirjes së ndikimit rus-ortodoks në Ballkan, që nuk e kundërshtonte as Perandoria Osmane, por kërkonte që faktorit shqiptar ky “rol” t’i jepej “nën firmën e mbrojtësit të islamit”, pra si “faktor mysliman” në pjesën europiane, gjë që këtë nuk e pranonin as evropianët e as shqiptarët, të cilët kërkonin rikthimin në familjen europiano-perëndimore me identitetin e tyre kombëtar dhe lashtësinë antike. Në këto rrethana, pra kur vëmendja e evropianëve do të bjerë mbi shqiptarët dhe etninë e tyre, shqiptarët do të dalin me një zgjidhje “të ndërmjetme” – pajtuese nga pikëpamja e kufirit të qytetërimeve, siç ishte projekti i bashkimit të katër vilajeteve në një të vetëm, njëfarë Shqipërie Osmane, e cila në rrethanat kur do të largohej Perandoria Osmane nga Europa, do të kthehej në Shqipëri Europiane, do të jetë Serbia atëherë autonome e mbështetur nga Rusia cariste dhe vendet ortodokse të Ballkanit, që me “Naçertanjen” e Garashaninit do të dalë me projektin “Kosova serbe”, jetik për serbët dhe Serbinë, por edhe për shtrirjen e ndikimit të mëtutjeshëm rus në Europë.

Projekti “*Kosova serbe*”, e quajtur “*Serbi e Vjetër*”, “*Jerusalem serb*” dhe ngjashëm, Beogradi do të fillojë ta sendërtojë me anën e luftës qysh në dimrin e vitit 1877/8, kur edhe pse do të humbë luftën me osmanët, do të shfrytëzojë disfatën e osmanëve në luftën e po atij viti me rusët, që kur ata iu afruan mureve të Kostandinopojës, të pushtojë pjesët veriore të Vilajetit të Kosovës (tokat nga Krusheci deri në Prokupje dhe ato nga Nishi deri në Kurshumli).

Në Kongresin e Berlinit disa nga këto pushtime Serbisë do t’i përlijen me çka ajo do të trimërohet që të shkojë mëtutje kah jugu, siç do të veprojë gjatë Luftërave të Para Ballkanike në vjeshtën dhe dimrin e vitit 1912/13 kur do të pushtojë Kosovën dhe një pjesë të madhe të Vilajetit të Manastirit dhe të Selanikut madje, pjesë këto që Konferenca e Londrës do t’ia njohë.

Paralelisht me pushtimet serbe në veri të vilajetit të Kosovës (Prokupjes dhe Kurshumlisë) do të shfaqet edhe projekti “*Kosova shqiptare*”, që si tillë do të vijë deri në ditët tona. Lidhja Shqiptare e Prizrenit shtroi kërkesat e saj të njohura për bashkimin e katër vilajeteve në një shqiptar, ku Kosova shfaqej si nyje e Shqipërisë Osmane. E gjithë Rilindja kombëtare shqiptare dhe lëvizjet politike që do të pasojnë nga kjo kohë e deri te pavarësia e shtetit shqiptar, do të mbështeten mbi formulën ku Kosova merr përsipër rolin e faktorit kyç, që për çështjen shqiptare do të thotë me qenë ose mos me qenë. Andaj jo rastësisht në Kosovë do të ndodhë epiqendra e revolucionit xhonturk të vitit 1908, pastaj jo rastësisht në Kosovë do të përqendrohet lufta për emancipimin kombëtar shqiptar (hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kongresi i alfabetit me shkronja latine e të tjera) dhe jo rastësisht në Kosovë do të fillojnë kryengritjet e mëdha nga vitit 1910 e deri në vitin 1912, të cilat në gushtin e atij viti, në Shkup do të kurorëzohen me aprovimin e Memorandumit të Shkupit ose të si do të quhet Katërmbëdhjetë pikat e Hasan Prishtinës, marrëveshje kjo që do t’ia hapë rrugën Shqipërisë Osmane dhe përfundimisht edhe shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Marrëveshja e Shkupit, krahas legjitimitit të katër vilajeteve shqiptare, ishte e rëndësishme edhe për atë që shqiptarët i nxori si faktorin më të rëndësishëm perandorak por edhe rajonal njëherësh, i cili nuk do të mund të tejkalohet si deri më atëherë, gjë që detyroi shtetet ballkanike të mbështetura nga Rusia cariste me luftë ta rrënonin këtë realitet historik, që ishte i barasvlershëm me shtetin shqiptar, i cili u shfaq tre muaj më vonë me shpalljen e tij në Vlorë, përkundër asaj që vendet ballkanike fituan luftën me Perandorinë Osmane dhe në këtë luftë realizuan aspiratat e tyre për t’i copëtuar tokat shqiptare.

Por, shpallja e shtetit shqiptar në Vlorë, sado që dukej se do të vendos edhe garën e fituesit për Kosovën në dobi të Serbisë, kjo nuk do ta mbyllë përfundimisht luftën rreth fituesit të përhershëm të Kosovës, edhe pse Beogradi nga Londra e tutje, së paku ndërkombëtarisht posedonte “tapitë” e saj, pa marrë parasysh si dhe me çfarë mjetesh i kishte fituar ato. Kështu që do të vinë kohë kur Kosova do të kalojë nga njëra anë në tjetrën, kalime këto që përherë kishin çmimin e madh të gjakut shqiptar që në Kosovë derdhej.

Fillimisht, kjo lëvizje do të nis në pranverën e vitit 1916 kur në luftë me Austro-Hungarinë, Gjermaninë dhe Bullgarinë, nga ushtritë e këtyre vendeve pushtuesi serb në Kosovë do të zëvendësohet me ndarjen e saj në dy zona: atë austro-hungareze dhe bullare me ç’rast dukej se Kosova po shkonte drejt bashkimit qoftë edhe të pjesshëm me trungun shqiptar në përputhje me projektin austro-gjerman. Dy vjet pas, do të ndodhë e kundërta: Kosova prapë do të shkojë dhunshëm kah Serbia, por këtë herë nën mbretërinë serbo-kroate-

sllovene në atë që nga Konferenca e Paqes e Parisit do të pranohet si një konstrukt i ri shtetëror në Ballkan, që do të kthehet në Jugosllavi. Në vitin 1941, prapë do të jenë fuqitë e boshtit, Gjermania dhe Italia, që pas kapitullimit të Jugosllavisë nga forcat gjermane, një pjesë të mirë të Kosovës dhe Maqedonisë dhe të Çamerisë do t'ia bashkojnë të ashtuquajturës Shqipëri Etnike, nën kurorën e Italisë fashiste të Viktor Emanuelit. Pas kapitullimit të italianëve Gjermanët do të miratojnë “një Shqipëri pjesërisht të natyrshme”, ku Kosova kishte rol të rëndësishëm në të. Berlioni premtonte se në rast fitoreje përfundimisht do të rikthente Shqipërinë në Ballkan, të tillë çfarë e kishte propozuar Princi gjerman Vilhelm fon Vid (Wielhelm von Wied) në memorandumun e tij të vitit 1917. Në fund të vitit 1944, edhe përkundër konferencë së Bujanit, kur forcat patriotike shqiptare nga Kosova të tubuar në frontin antifashist (edhe me pjesëmarrjen e disa serbëve) do të votojnë rezolutën për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë nëse në të dy vendet fitojnë forcat antifashiste që drejtoheshin nga komunistët, do të jetë ideologjia dhe internacionalizmi proletar, si formulë e re në lojë, që Kosovën serish do “t’ia kthejë” Jugosllavisë, por këtë herë me një “identitet” të rrudhur “autonom” brenda për brenda Serbisë.

Beogradi, pra, këtë herë, për herë të parë do të ketë pëlqimin e Tiranës bashkë me atutë ideologjike të “vëllazërim-bashkimit” si një armë të fortë që Kosovën përfundimisht ta nxjerr nga “dosja shqiptare”.

Madje, si do të shihet, Beogradi me ndihmën e internacionalizmit proletar, për herë të parë erdhi në një situatë tepër të favorshme historike, që krahas Kosovës ta gëlltisë edhe Shqipërinë dhe këtë madje ta bëjë në sja të një marrëveshje të arritur midis Enverit dhe Titos për krijimin e të ashtuquajturës “*Republikë të shtatë shqiptare*” në Jugosllavi, ku bashkë me Kosovën edhe Shqipëria do t’i bashkohej federatës Jugosllave, në mënyrë që pastaj asaj t’i bashkëngjitej edhe Bullgaria për të krijuar kështu një “*Ballkani*”, e cila nuk do të ishte tjetër pos një Jugosllavi e zgjeruar në trekëndëshin: Alpe – Adriatik – Det i Zi, që do të kthehej në njërin ndër fuqitë më të mëdha rajonale, por që do të mbetet vetëm në letër, në sja të ndërhyrjes së Stalinit, nga frika se një bashkim i tillë, do t’ia dobësonte pozitat Bashkimit Sovjetik dhe një ditë madje mund të bëhej pre e lehtë e Perëndimit.

Pas prishjes së marrëdhënieve “tejet vëllazërore” midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, kur pas Rezolutës së Informbyrosë Tito ia doli që t’ia kthejë shpinën Stalinit dhe konceptit sovjetik të kolkozeve për të kultivuar me vetëqeverisjen socialiste një socializëm më liberal, ndërsa Enveri do të bëjë aleat ideologjik Kremlinin për t’ia hapur rrugën njërit ndër sistemeve më totalitare në lindje, që Shqipërinë do ta mbyllë dhe Tirana zyrtare do të krenohej se “në rast se ishte nevoja që të triumfonte komunizmi stalinist shqiptarët do të hanin edhe bar”, Beogradi, nën trysinë e politikës serbe, serish kartën e bashkimit të Kosovës do ta zhvendos në drejtim të Serbisë, këtë herë duke përdorur fuqinë e shtetit të përbashkët, tashmë si tampon zone midis dy blloqeve antagonistë, për t’ia kthyer asaj përfundimisht “identitetin etnik serb”, gjë që kjo nënkuptonte zvogëlimin e shqiptarëve nga Kosova me anën e shpërnguljes së tyre për në Turqi (në përputhje me konventën jugosllave-turke të nënshkruar në vitin 1936 e cila do të ratifikohet në vitin 1953), por edhe të hapjes së kanaleve për migrime të tjera të shqiptarëve nëpër vende perëndimore (si gastarbajterë apo edhe si të përndjekur politikë).

Megjithatë, ky projekt për t’u vu në lëvizje ashtu si duhej, kishte formulën e ushtrimit të dhunës shtetërore në Kosovë ndaj çdo gjeje shqiptare që nga kultura, gjuha si dhe familja

në mënyrë që të provokohet pakënaqësia e përmasave të mëdha, që pastaj ndaj çfarëdo reagimi shqiptar të pasonte kundërpërgjigja me terror policor-ushtarak.

Në këto rrethana thuajse që të gjithë shqiptarët shiheshin të dyshimtë dhe armiq madje, gjë që kjo do t'ua hapë rrugën ndjekjeve të atyre intelektualëve të paktë që ishin, ndaj të cilëve, ku nuk bënte punë hipoteka “e bashkimit kombëtar”, atëherë shfaqej ajo ideologjika, pra e “zbulimit” të ithtarëve të stalinizmit të Enver Hoxhës.

Në këtë fushatë të egër ndaj shqiptarëve, Beogradi, do të përfshijë që të gjithë shqiptarët e hapësirave të Jugosllavisë, pa përjashtuar edhe ata që në njëfarë mase shiheshin se me pranimin e formulës së “vëllazërim-bashkimit”, siç ishin disa nga nëpunësit e federatës, ata të ushtrisë dhe të policisë dhe sidomos ata që në kuadër të këtyre strukturave ishin martuar me serbe, malaziase ose të tjera, kishin pranuar rregullat e reja të lojës dhe madje ishin në gjendje që të pranonin edhe “jugosllavizmin” si identitet socialist.

Por, edhe përkundër kësaj dhune shtetërore kundër shqiptarëve, e cila ishte pasqyruar me shpërnguljen e një numri të mirë të tyre për në Turqi (rreth një çerek milioni), Beogradi megjithatë nuk do t'ia dalë që të provokojë një kryengritje të armatosura të shqiptarëve të përmasave të mëdha, siç kishte qenë ajo e dimrit të vitit 1913 ose ato nga lëvizjet kaçake në fillim të viteve të njëzeta të shekullit të kaluar, ku do të përdorte dhunën ushtarake kundër shqiptarëve të Kosovës, meqë këtë skenar, krahas shqiptarëve që nuk e pranonin (edhe pse nuk mund të mohohet fakti se nga paslufta e tutje kishte grupe ilegale dhe organizata të ndryshme por gjithnjë të palidhura që luftonin për këtë), nuk do të mund ta përballonte as shteti jugosllav, ngaqë kjo do t'i hapte telashe të paparashikuara nga brenda dhe nga jashtë, por nuk do ta lejonte as faktori ndërkombëtar në krye me SHBA-të, që e dinin se kujt mund t'i çonte ujë destabilizimi i saj (mendohej të Bashkimi Sovjetik).

Përballë kësaj gjendje, edhe pse Beogradi do të mundohet që të ruajë intensitetin e provokimeve të vazhdueshme ndaj shqiptarëve me anën e diskriminimit të hapur dhe dhunës që e ushtronte me “pretekste të ndryshme”, megjithatë nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta, më konkretisht pas plenumit të njohur të Brionëve të vitit 1966, kur Tito do ta eliminojë nga skena politike rivalin kryesor për pushtet, serbin Aleksandar Ranković bashkë me linjën unitariste serbe që kërkonte marrjen e plotë të frenave të vendit, në mënyrë që atë ta orientojë kah Moska, e cila mund të thuhet se me shërbimet e veta ishte shumë aktive në këtë kohë dhe në forma të ndryshme madje trimëronte edhe “idetë e bashkimit ideologjik shqiptar” me mjete revolucionare që të fuste në një konflikt ushtarak Shqipërinë dhe Jugosllavinë prej nga fitonte shansin që të kthehej prej nga ishte përzënë, karta Kosovë, nga ana e Titos dhe përëndimit që i rrinte pas dhe e këshillonte për të, serish do të futet në lojë, që me ndryshimin e pozitës së saj në federatë si faktor konstituiv i saj (me amendamentet kushtetuese të vitit 1968 dhe me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974), praktikisht të arrihet të nxirret nga mbikëqyrja serbe për të kaluar në atë federative, me çka ndryshoheshin balancet e brendshmen në vend në dobi të republikave me frymë përëndimore dhe në dobi të konceptit vetëqeverisës ndaj atij etatist-stalinist. Në përputhje me trendët që Jugosllavia të shkonte sa më shumë drejt Përendimit, gjë që ky ishte edhe interes jetik edhe i shqiptarëve për të bërë njëherësh shkëputje të dyfishtë nga ideologjia komuniste dhe Lindja, do të shfaqet kërkesa për Republikën e Kosovës, e shpalosur botërisht në demonstratat që do të mbahen në disa qytete të Kosovës në nëntorin e vitit 1968 për t'u përmbyllur me ato të Prishtinës më 27 nëntor, demonstrata këto që do të hapin kutinë e Pandorës, prej nga do të dalë fryma e

barazisë, e cila nuk do të ndalët më kurrë, qoftë edhe me finokërinë e tezës sovjetike të “bashkimit ideologjik” në Shqipërinë. Kjo kërkesë do t’i homogjenizojë shqiptarët politikisht dhe shpirtërisht që t’u bëjnë ballë sfidave me të cilat do të ndeshën pak kohë pas vdekjes së Titos, të cilat ishin te një natyre ekzistenciale dhe si të tilla kërkonin mençuri dhe pjekuri politike, ku edhe më tutje formula e barazisë shfaqej emëruesi më i përshtatshëm që nga krizat e ardhshme me shumë kërcënime, jo vetëm të shpëtohej, por edhe të shporrej pushtimi serb pa ndonjë çmim të madh. Kështu, kërkesa për republikën e Kosovës, e cila do të rikthehet fuqishëm në demonstratat e vitit 1981 dhe, si e tillë do të mbetet edhe atëherë kur Jugosllavia, në saje të hegjemonizmit serb që do të dalë në skenën politike pas ardhjes në pushtet të Millosheviqit, do të shfrytëzohet si formulë për nxjerrjen e Kosovës nga Serbia, gjë që kjo edhe do të ndodhë pas ndërhyrjes ndërkombëtare në pranverën dhe verën e vitit 1999, por kjo nuk do të thotë se Kosova përfundimisht do të nxirret nga dosja serbe e as nga planet e saj që serish ta kthejë ku ishte.

Përkundrazi, ajo dosje e fshehur shtetin e Kosovës do ta ndjekë si hije në dy drejtime: që ta pengojë vendosjen e sovraniteti të saj shtetëror në Veri dhe njëherësh të ruajë praninë shpirtërore mesjetare në Kosovë, duke përvetësuar trashëgiminë ortodokse sikur kishat dhe manastiret e atjeshme të ishin të saj dhe jo kulte të përbashkëta të krishterimit, që shqiptarët e kishin pranuar shtatë shekuj para tyre në këtë pjesë të botës, ku ai edhe ishte kthyer në besim zyrtar të Bizantit.

***Autori:** Ç’lidhje ka në këtë zhvillim vrasja e Bashkim Kosovës, për të cilën thatë se është një hakmarrje e vonuar e Beogradit dhe, pse ajo mund të quhet edhe komplot ndërkombëtar?*

Gjeneral Josip Paleviq: Mund të thuhet se shfaqja e Bashkim Kosovës, si sportist kulmor, i cili me sukseset e tij të jashtëzakonshme në vend dhe në arenën ndërkombëtare shkëlqeu si meteor, qiti në plan të parë idenë e afirmimit të Kosovës si njësi e barabartë federative dhe të barazisë si koncept të pandalshëm qytetërues, veçmas kur ajo në demonstratat e vitit 1981 do të shfaqet me rikthimin e parullës Kosova Republikë, kjo do ta nxjerrë nga loja, së paku ashtu si ishte, idenë e drejtë, por jo reale të bashkimit me Shqipërinë me anën e luftës çlirimtare të drejtuar nga grupet e ndryshme ilegale, e cila në masë të madhe shihej e lidhur me ideologjinë komuniste të Enver Hoxhës.

Ky përcaktim do ta brengosë tepër Beogradin, meqë fjala ishte për një lëvizje të përgjithshme për barazi, që do t’i bashkohen që të gjitha rrymat dhe drejtimet shqiptare nga e djathta dhe e majta, ilegale dhe legale, e cila nuk do të mund të inkriminohej me hipotekat e ndryshme të “rrënuesit të Jugosllavisë” dhe të ngjashme, ku shqiptarët do të fajësoheshin kuturu herë si kundërrevolucionarë, herë si stalinistë, herë si të djathtë e ndryshe-ndryshe, siç ishte vepruar deri më atëherë. Në këto rrethana, Beogradi, do të mundohet që simbolikës së Bashkim Kosovës, e cila në radhë të parë nënkuptonte kërkesën për republikën e Kosovës në federatën jugosllave, t’ia shohë vetëm “hilen”e bashkimit ideologjik kombëtar. Andaj nuk është aspak e rastit që shtypi serb i Beogradit, qysh në fillim të fushatës kundër karrierës së Bashkim Kosovës (pas demonstratave të vitit 1981 e tutje), emrin e tij do ta shkruajë vazhdimisht *Bashkim+Kosova (Bashkim plus Kosova)*, për të treguar se me kërkesën për republikën e Kosovës, shqiptarët nuk kishin hallin e statusit të barabartë me të tjerët, por

hapjen e rrugës për bashkim kombëtar, me çka gjithë rajonit i krijohej mundësia e një krize të re, të cilën askush nuk do ta lejonte.

Dhe po ky shtyp i Beogradit, kur Millosheviqi erdhi në pushtet dhe me dhunë rrënoi autonominë e Kosovës, jo rastësisht emrin Bashkim Kosova do ta shkruajë *Bashkim minus Kosova*, që do të thoshte *Bashkim pa Kosovën*, formulë kjo që paralajmëronte pastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët, që do të thotë se edhe Serbia ishte e interesuar për një “bashkim” shqiptar në Shqipëri, që do të thoshte se shqiptarët duhej të dëboheshin me dhunë nga Kosova dhe si refugjatë kalonin në Shqipëri.

Duke iu referuar të dhënave tepër sekrete shihet se Beogradi me faktorët e rëndësishëm të vendosjes kishte lënë të hapur edhe ndarjen e Kosovës, sipas kutit serb, pra që pjesën më të madhe ta marrë Serbia, ndërkohë që diçka të saj (Dukagjinin pa Pejën dhe Deçanin, pa përjashtuar këtu edhe Tetovën dhe Gostivarin) t’i bashkohen Shqipërisë me çka sipas Beogradit njëherë e përgjithmonë paqësohej Ballkani. Në këtë lojëra ishte munduar të tërhiqej edhe udhëheqja e LDK-së me disa intelektualë të tjerë të Prishtinës, të cilët e kishin refuzuar. Këto përpjekje, pra për ndarjen e Kosovës, Beogradi do t’i vazhdojë edhe në rrethanat e vendosjes së protektoratit ndërkombëtar në Kosovë, por tash me anën e fakteve të krijuara edhe me ndihmën e pranisë ndërkombëtar, siç është Veriu i Kosovës, ku praktikisht do të legjitimohet ndarja “e heshtur” e Kosovës.

***Autori:** Bashkim Kosova pas daljes nga burgu do të mbyllet përgjithmonë në rrethin e një katundi të vogël, në Hade. Kohëve të fundit, madje nuk do të dalë jashtë fare dhe do t’i presë të gjitha lidhjet edhe me më të afërmit. Ishte kjo pse kishte frikë nga vrasja, të cilën sikur e priste, apo pse ishte shthurur fare?....*

Gjenerali Josip Paleviq: Nëse merren parasysh ato që ndodhen dhe si shkuan punët nga koha e luftës dhe pas saj, kur u vendos protektorati ndërkombëtar, ndërkohë që pushtetin e morën ata që nuk kishin ideal bërjen e tij, por gllabërimin e tij dhe të tjerat që dolën në pah gjatë kësaj kohe kalimtare me rrënime gjithfarë, ku më së shumti pësoi sistemi i vlerave, e mbi të gjitha humbja e shpresës për ardhmërinë, mund të thuhet se kishte nga pak nga të dyja. Nga shkrimet e lëna, por edhe nga disa të dhëna të tjera, që kanë arritur deri në Zagreb, del se ndaj tij ishte ushtruar vazhdimisht trysni e madhe psikike. Kjo është bërë edhe atëherë kur ai ishte kampion i madh me renome botërore dhe, është fare e natyrshme, që në rrethanat e burgut kjo të jetë vazhduar me mjete të ndryshme, ku sigurisht se faktori familje ka luajtur një rol shumë të madh që ta humbë drejtpeshimin, që si do të shihet nuk do të jetë në gjendje ta kthejë kurrë. Kur them këto kam parasysh rolin që ka luajtur ajo (martesa me Drita Gecin) për ta përballuar krizën e parë psikike që do t’i shkaktohet nga ndërhyrja e Beogradit që ta privojë nga titulli i kampionit botëror në Toronto, të cilin e kishte në dorë. Ndarja prej saj për arsye shëndetësore, ndonëse e menduar si e përkohshme, do t’i kthehet në të përhershme dhe, ai madje, do ta pranojë këtë vetëm e vetëm që ajo të mbrohet disi nga ndjekjet dhe shantazhet që mund t’i bëheshin nga shërbimi informativ, përfundimisht do ta fusë në binarët e krizës së thellë shpirtërore prej nga nuk do të dalë më. Meqë gjatë burgut, siç shkruan, ka pasur rastin të shohë gjithfarë marifetesh dhe për së afërmi të njihet edhe me lojërat që Beogradi ka përgatitur prej andej, në mënyrë që t’i shërbejnë prapaskenave që do t’i bëhen Kosovës, që ajo të mbesë sa më shumë që të jetë e mundur në kurthin e politikës së Beogradit qoftë edhe

në rrethanat kur do të shpallet shtet i pavarur, por pa sovranitet territorial dhe shpirtëror, Bashkim Kosova do të mbërthehet nga sindroma e fobisë së përhershme, që pas daljes nga burgu kur pas pak, pas ndërhyrjes së NATO-s nga ajri dhe nxjerrjes së Serbisë nga Kosova, do të vendoset protektorati tetëvjeçar mbi të, kjo do t'i përkeqësohet edhe më shumë sa që të përfundojë me mbyllje të plotë, siç do të ndodhë pak kohë para se të vritej.

***Autori:** Meqë ishte kështu, atëherë pse duhej të vritej kur ai ndodhej para vetëvrasjes?*

***Gjenerali Josip Paleviq:** Kësaj pyetje duhet t'i japin përgjigje vetë shqiptarët, nëse nuk dëshirojnë të mbetën edhe më tutje pjesë e dosjes së hapur...*

Prishtinë, mars 2011- shtator 2014.

SHËNIME PËR AUTORIN

Jusuf Buxhovi lindi në Pejë, më 4 gusht të vitit 1946. Fëmijërinë e kaloi në Gjakovë, ku kreu shkollimin e mesëm. Në vitin 1968 u diplomua në Universitetin e Prishtinës (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe). Në vitin 1979 kreu studimet pasuniversitare në degën e Historisë të Universitetit të Prishtinës. Magjistroi në temën "Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet gjermane".

Karrierën e gazetarit e filloi në gazetën "Rilindja" në vitin 1967, fillimisht si gazetar i kulturës, e më vonë redaktor i saj. Nga viti 1976 deri në vitin 2000 ishte korrespondent i përhershëm i kësaj gazete, i akredituar në Bon të Gjermanisë.

Deri tash ka botuar këto vepra:

1. "**Cirku**", tregime, "Rilindja" – 1972
2. "**Pioni**", tregime, "Rilindja" - 1975
3. "**Matanëkrena**" – roman, "Rilindja" - 1976
4. "**Çaste**" - vështrime letrare, "Rilindja" -1978
5. "**Dinozauri**" – dramë, "Rilindja" - 1979
6. "**Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit**" – roman, "Rilindja" - 1982
7. "**Ura e Fshejit**" – novela, "Rilindja" - 1983
8. "**Pranvera e zhveshur**" - dy drama, "Rilindja" - 1984
9. "**Nata e shekujve**" - roman, "Rilindja" - 1985. (Fitoi Çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)
10. "**Galeria e të vdekurve**" - roman, "Rilindja" - 1987
11. "**Libri i të mallkuarve**"- roman triptik, "Rilindja" -1989. (Fitoi çmimin letrar "Hivzi Sulejmani")
12. "**Prapë vdekja 1**" - roman, "Rilindja" - 1991 (Fitoi Çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)
13. "**Prapë vdekja 2**" - roman, "Rilindja" -1993

14. "*Prapë vdekja 3*" - roman, "Rilindja" - 1995
15. "*Qyteti i dënuar me vdekje*" - roman, "Faik Konica" - 2000
16. "*Letrat për Kryepriincin*" - roman, "Faik Konica" - 2003
17. "*Vdekja e Kolonelit*" – roman, "Faik Konica" - 2004
18. "*Vera e fundit e Gjin Bardhit*" – roman, "Faik Konica" - 2004
19. "*Kujtimet e zonjës Von Braun*" - roman, "Faik Konica" - 2005
20. "*Kodi i dashurisë*" - roman, "Faik Konica" - 2006. (U nderua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli", si vepra më e mirë e vitit)
21. "*Udhëtimi i Mendim Drinit*" - roman, "Faik Konica" - 2006.
22. "*Libri i Bllacës 1 - Shënime nga psikiatria*" – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
23. "*Libri i Bllacës 2 - Bota e përmbysur e Urtakut*" – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
24. "*Libri i Bllacës 3 - Etër e bij*" – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
25. "*Fletëza gjermane*" – publicistikë, "Faik Konica" - 2008.
26. "*Kongresi i Berlinit 1878*" – historiografi, "Faik Konica" - 2008.
27. "*Libri i Gjakovës*" – roman, "Faik Konica" - 2008.
28. "*Kthesa historike 1 - Vitet e Gjermanisë dhe Epoka e LDK-së*" – historiografi. Botoi "Faik Konica" – 2008.
29. "*Jeta lakuriqe*", tregime. Botoi "Faik Konica" – 2009.
30. "*Kthesa historike 2 - Shteti paralel dhe rezistenca e armatosur*" – historiografi. Botoi "Faik Konica" – 2009.
31. "*Kthesa historike 3 - Lufta e Perëndimit për Kosovën*" – historiografi. Botoi "Faik Konica", 2009.
32. "*Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane*", historiografi. Botoi "Faik Konica", Prishtinë, 2010.
- "*Kosova*" I,II,II – historiografi. Botoi "Faik Konica" Prishtinë – "Jalifat Publishing" Houston, 2012.
- "*Jeniçeri i fundit*", roman. Botoi "Faik Konica" Prishtinë – "Jalifat Publishing" Houston, 2013.

Përkthime në gjuhët e huaja:

"*Zapisi Dzona Nikolle Kazazija*", "*Jedinstvo*", Prishtinë, "Nolit", Beograd, 1986.

"*Beleske Dzona Nikolle Kazazija*", Maribor, Slloveni, 1989.

"*Qui resiste a la peste resiste au diable*" (*Le Journal de Gjon Nikollë Kazazi*), botoi "L'Harmatann", Paris, 2010.

"*Kosova*" I,II,II anglisht. Botoi "Jalifat Publishing", Houston 2013.

....